



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR RI-AUDITIMI
“MBI PËRPUTHSHMËRINË NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE
SHOQËRORE”

24 SHTATOR 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-11
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-9
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9-11
II.	HYRJA	11-14
1	Objekti i auditimit	11
2	Qëllimi i auditimit	11
3	Identifikimi i çështjes	12
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5	Përgjegjësitë e audituesve	12
6	Kriteret e vlerësimit	12-13
7	Standardet e auditimit	13
8	Metodat e auditimit	13-14
9	Dokumentimi i auditimit	14
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-200
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	15-200
2.1	Auditimi i saktësisë së raportimit të treguesve në funksion të zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2019-2020. Raportimi për zbatimin buxhetor në nivel programi. Opinioni mbi përputhshmërinë e zbatimit të buxhetit të fondit të sigurimit shoqëror. Ecuria e treguesve të skemës së pensioneve të qytetit dhe të fshatit, për vitin 2019-2020 dhe trendi në 5 vitet e fundit.	15-34
2.2	Mbi nivelin e të ardhurave të realizuar referuar skemës së fashtit dhe problematikat e konstatuara. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në këtë drejti, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.	34-47
2.3	Mbi bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me të ardhurat e skemës së qytetit të mbledhur gjatë vitit 2019-2020. Problematikat e hasura në zbatim të kërkesave të marrëveshjeve dypalëshe. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.	47-68
2.4	Testimi i sistemeve të kontrollit lidhur me përputhshmërinë e pagesave të pensioneve. Niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet më problematik. Çështjet gjyqësore, ndjekja e tyre dhe efektet në sigurimet shoqërore.	69-81
2.5	Mbi funksionimin e strukturave të kontrollit: Aktiviteti i Njësisë së Inspektimit të Pensioneve, Drejtorisë Ligjore dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.	81-147
2.6	Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga entiteti. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë shërbime nga subjekti i audituar. Argumentimi dhe përlllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë dhe shërbime.	147-179
2.7	Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rekrutimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në buxhet. Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve që kanë fituar gjyqin me vendim të gjykate të formës së prerë.	179-199
2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	199-200
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	200-215
V.	ANEKSE	215-222



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Ri-Auditim Përputhshmërie në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, nga data 27.01.2021 deri më datë 27.04.2021, për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2020.

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e përputhshmërisë, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, është pjesë e Planit Vjetor 2020-2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit.

Ri-Auditimi në Institutin e Sigurimeve Shoqërore u planifikua të zhvillohej nga data 27.01.2021 deri në datën 09.04.2021. Nisur nga arsye objektive, afati i përfundimit të ri-auditimit në terren u ndryshua në 27.04.2021. Periudha e audituar është 01.01.2019 deri 31.12.2020.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacioneve mbi akt-konstatimet e lëna, hartoi projektraportin e auditimit dhe pasi kaloi shkallët e kontrollit të cilësisë, u dërgua në Ministrinë e Financave me shkresën përcjellëse nr. 195/5, datë 03.08.2021.

1.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
2	Në fund të vitit 2019, debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 12.6 mld lekë, ndërkohë që deficit i skemës së qytetit, për vitin 2019, ka rezultuar në shumën 18.1 mld lekë, pra niveli i borxhit llogaritet sa 70% e deficitit të skemës së qytetit. Në vitin 2019, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 86,558 ose 13,818 subjekte më shumë se në vitin 2018. Shuma totale e debisë në vitin 2019 arriti në 12.6 mld lekë ose 0.7 mld lekë më shumë se në vitin 2018. Numri i subjekteve debitorë është rritur me 19%, ndërkohë që debia është rritur në masën 5.9% krahasuar me vitin 2018. Borxhi prej 12.6 mld lekë u përket 86,558 subjekteve, prej të cilave: 39,626 subjekte ose 46% e tyre janë subjekte aktive, me një debi në shumën 6,4 mld lekë, ose 51% e debisë totale; 35,897 subjekte ose 41% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 5,7 mld lekë, ose 45% e debisë totale (diferenca prej 13% janë subjekte të cregjistruar/kërkesë për cregjistrim/falimentuar). Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2020 paraqitet në shumën 19.2 mld lekë, ndërkohë që deri në fund të vitit 2020 debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 14.4 mld lekë, pra niveli i borxhit është sa 75% e deficitit të skemës së qytetit, me një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 96,833 ose 10,275 subjekte më shumë se në vitin 2019.	faqe 69-81	e lartë	a. ISSH në bashkëpunim me MFE të ndërmarrin masat e nevojshme për realizimin e pagesës dhe sistemin e borxheve të subjekteve buxhetore dhe krahas tyre të marrin masat për sistemin e kontributeve individuale në llogaritë e periudhave të sigurimit. b. Nga ana e ISSH me qëllim për të zgjidhur problematikën e krijuar ndaj individëve të punësuar në subjekte juridike e që rezultojnë me detyrime kontributive të papaguara, gjë për të cilën, jo për fajin e tyre, nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, si dhe për të zgjidhur problematikën e shfaqura në mosnjohjen e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Shuma totale e debisë në vitin 2020 arriti në 14.4 mld lekë ose 1.8 mld lekë më shumë se në vitin 2019. Numri i subjekteve debitorë është rritur me 12%, ndërkohë që debia është rritur në masën 14% krahasuar me vitin 2019. Borxhi prej 14.4 mld lekë u përket 96,833 subjekteve, prej të cilave: 45,818 subjekte ose 47% e tyre janë subjekte aktive me një debi në shumën 7,4 mld lekë, ose 51% e debisë totale; 38,398 subjekte ose 40% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 6,3 mld lekë, ose 44% e debisë totale; 3 janë subjekte të rrëgjistruara me debi prej 7,515 lekë; 12,613 janë subjekte që kanë bërë kërkesë për rrëgjistrim me debi në shumën 0.6 mld lekë dhe vetëm 1 subjekt i falimentuar me debi në shumën 10,000 lekë. Ndër 50 subjektet juridike debitorë me debinë më të lartë përmendim: A, A A, V, F A, K, Etj... <i>Mospagesat e kontributeve nga ana e punëdhënësve për punëmarrësit e tyre, krijojnë deficit në fondin e sigurimeve shoqërore në tërësi dhe në mbulimin e shpenzimeve të programuara për pagesat e pensione në vecanti. Pas borxheve të subjekteve debitorë qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk përfitojnë, jo për fajin e tyre, nga skema e sigurimeve shoqërore.</i>			periudhave të sigurimit, të punëmarrësve, subjektet e të cilëve kanë detyrime kontributive, të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative duke përfshirë, përse është e mundur dhe e nevojshme dhe atë të inicimit të ndryshimeve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.
3	Nga auditimi mbi administrimin e skemës së fshatit dhe problematikën e saj, konstatohet se, për vitin 2019 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 14,065,531 mijë lekë, të cilat i kanë përfituar 121,208 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrëllindjet. Për vitin 2020 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 13,676,769 mijë lekë me një ulje prej 388,762 mijë lekë nga viti 2019, të cilat i kanë përfituar 115,443 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrëllindjet. Konstatohet së shpenzimet e skemës së fshatit sipas programeve, krahasuar me të ardhurat e mbledhura janë mbuluar kryesisht nga buxheti i shtetit, ku diferencën më të madhe e ka dega e barrëllindjeve, në të cilën të ardhurat për vitin 2020 mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndërsa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë. Problematikë mbetet subvencionimi i skemës së fshatit në një masë shumë më të madhe edhe në pagimin e pensioneve, duke krijuar subvencionim të dyfishtë për fermerët, si në kontribut, por dhe në përfitim, gjë që është e unifikuar në përfituesit e tjerë që paguajnë vetë të gjithë kontributin, pasi shteti ka kontribuar në skemën e fshatit në subvencionimin në vitin 2019 në shumën 1,980 milion lekë, ose në masën 47.2% të të ardhurave të skemës dhe në vitin 2020 në shumën 1,684 milion lekë, ose në masën 50.2% të të ardhurave të skemës. Për shkak të interesit shumë të ulët të të vetëpunësuarve në bujqësi për të paguar kontribut, në vitet e fundit nuk është bërë rritja e masës së kontributit, duke “ngrirë” në një nivel prej 38,400 lekë për zonat fushore dhe 29,400 lekë për zonat malore, ndërkohë që një i vetëpunësuar në qytet paguan 66,240 lekë në vit kontribut, ku për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e përballon buxheti i shtetit, ndërsa për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë. Subvencionimi i lartë për kontributet nga buxheti i shtetit për bujqit, pjesëmarrja e ulët në skemë edhe për shkak të masës së lartë të kontributit referuar dhe produktivitet të ekonomive bujqësore, shpesh me sipërfaqe të vogla dhe jo eficiente, pamundësia e detyrimit për të paguar kontribute, si dhe lënia mbi baza vullnetare e pagesës së kontributit, ka sjellë problematikat e skemës së fshatit, duke thelluar deficitin e saj dhe mbulimin në masën më të madhe nga buxheti i shtetit pasi	faqe 34-47	e lartë	Nga ISSH të merren masat e nevojshme për vazhdimin e kërimit për realizimin e inicimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, i ndryshuar, me qëllim që në të të parashikohet mundësia që nëse një bujq dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlogaritur mbi bazën e një page më të lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	kontributet e derjtpërdrejta mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndersa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë. Defiçiti i skemës së fshatit edhe pse rezultoi më i ulët në krahasim me programimin, sikurse në disa vite radhazi, ka pësuar rritje duke kaluar nga 9,796,089 lekë ose 0.58% të PBB për vitin 2019 në 10,322,244 lekë ose 0.66% PBB në vitin 2020. Në kushtet e thellimit të defiçitit të skemës, e cila përballohet nga buxheti i shtetit, me qëllim eliminimin sa më shumë të këtij defiçiti e për pasojë dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit mbetet e vetmja rrugë ajo e zbatimit të sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Kjo kërkon rishikimin me qëllim zgjerimin e parimit kontributiv të sistemit duke riformuluar skemën e pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi. Për këto arsye, ashtu si dhe vetë ISSH ka konkluduar, duhet që të realizohen ndryshimet e nevojshme ligjore, në mënyrë që të krijohet mundësia që nëse një bujq dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlogaritur mbi bazën e një page më të lartë. Një ndërhyrje e tillë në legjislacionin garanton nga njëra anë mos cënimin e sistemit, të formulës së llogaritjes së përfitimeve apo të parimit kontributiv të skemës dhe nga ana tjetër adreson dhe krijon nxitjen e nevojshme të një kategorie të caktuar të popullsisë në drejtim të rritjes e ndërgjegjësimit për mundësinë e përfitimit të një pensioni më të lartë. Kjo do të krijojë ofrimin e një mundësie shtesë si për skemën ashtu dhe për individin.			
4	Gjatë kontrolleve të kryera nga Sektori i Kontrollit të Pagesave, gjatë vitit 2019, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 861 raste, në shumën 20,486,744 lekë, ose 66% më pak se në vitin 2018, ku dëmtimet arritën në shumën 68 mln lekë. Në vitin 2020, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 969 raste, në shumën 18,364,470 lekë, ose 11% më pak se në vitin 2019, ku dëmtimet arritën në shumën 20,486,744 lekë. Shkeljet e konstatuara për vitin 2019 kanë rezultuar të natyrave të ndryshme si: dublim pagesash, pagesa pas vdekjes, pagesa marrë tepër ose pagesë jashtë afatit, prej të cilave, 64 raste, ose 7% e rasteve, rezultojnë dublim pagese në shumën 1,844,694 lekë; 702 raste, ose 82% e tyre, rezultojnë pagesa pas vdekjes në shumën 15,916,229 lekë dhe 95 raste, ose 11% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 2,275,821 lekë. Për vitin 2020 shkeljet e konstatuara sipas natyrës renditen në 46 raste, ose 4.5% e rasteve, dublim pagese në shumën 838,849 lekë; 863 raste, ose 92% e tyre, pagesa pas vdekjes në shumën 16,868,822 lekë; 60 raste, ose 3.5% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 656,799 lekë. Rastet e dublimit të pagesës lidhen kryesisht me pagesat në ato banka që ende nuk janë pjesë e sistemit on line. Sistemi on- line zbatohet për mbi 60 % të pagesave. Jashtë këtij sistemi janë kryesisht bankat e nivelit të dytë, BKT dhe I S B A që kanë 90 % të pensioneve of-line që paguhen në banka	faqe 69-81	E mesme	ISSH të intensifikojë bashkëpunim me Bankat BKT dhe I S B A, të cilat kanë 90 % të pensioneve që paguhen në banka of line, me qëllim finalizimin e automatizimit të sistemit të pagesave të pensioneve nga këto banka (kalimin on-line), duke synuar eliminimin e pagesave të dubluara.
5	Problematikë në zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH mbetet dërgimi i listëpagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012. Në fund të vitit 2019 rezultojnë gjithsej 1,506,140 listëpagesa të munguara prej të cilave, 1,423,634 ose rreth 94.5% janë listëpagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznes i vogël); 78,804 ose 5.32% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,702 apo 0.25% janë listëpagesa të munguara të subjekteve publikë (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Gjatë vitit 2019 u janë dërguar nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve, gjithsej 14,283 listëpagesa të munguara të subjekteve paguese që i	faqe 47-68	e lartë	ISSH të zhvillojë një program informatik, nëpërmjet të cilit të mundësojë krijimin e bazës së të dhënave për personat Të vetëpunësuar të vetëm”, duke përdorur informacionin e marrë zyrtarisht nga DPT, me synim zgjidhjen e mbi 80% të rasteve, për këtë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	përkasin periudhave tatimore 2006–2012 prej të cilave, 832 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 2,106 listëpagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 11,345 listëpagesa të subjekteve biznesi i vogël. Në fund të vitit 2020 rezultojnë gjithsej 1,501,931 listëpagesa të munguara (4,209 më pak krahasuar me vitin 2019), prej të cilave 1,421,307 ose rreth 94.6% janë listëpagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznesi i vogël); 77,033 ose 5.13% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,591 apo 0.24% janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Volumin më të madh të listëpagesave të munguara për periudhën 2019-2020 me rreth 95% të totalit e ka biznesi i vogël, të cilët përgjithësisht janë “Të vetpunësuar të vetëm”, por një pjesë e tyre janë persona “Të vetpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë” sic janë anëtarë të tjerë të familjes që punojnë e jetojnë me të vetpunësuarin. Sipas marrëveshjes ISSH-DPT <u>pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për këtë kategori biznesi do të merren si listëpagesa të mirëfillta.</u>			kategori personash, që rezultojnë me listëpagesa të munguara. Për personat “Të vetpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë”, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, ISSH të iniciojë një fushatë sensibilizimi, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listëpagesave për këtë kategori.
6	Strategjia afatgjatë e sistemit të sigurimeve shoqërore e materializuar në Dokumentin e Politikave të Pensioneve të miratuara nga Qeveria, në themel të saj ka: Respektimin e të drejtave financiare të fituara, duke i garantuar dhe zhvilluar ato; Formatimin e një sistemi pensionesh në përgjithësi dhe veçanërisht të pensioneve individuale të varura drejtpërdrejt nga kontributet e paguara, nëpërmjet të cilit standardizon dhe ruan në një shkallë të pranueshme raportin pagë/pension në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë; Një qëndrueshmëri fiskale të sistemit të përmirësuar në një periudhë afatmesme. Gjatë periudhës 2019-2020, krahas arritjeve në realizimin e objektivave të vendosur nga ISSH, janë identifikuar risqe të cilët vënë në rrezik arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, ndër të cilët më kryesorët janë: Niveli shumë i lartë i detyrimeve për kontribute të papaguara në subjektet juridike dhe fizike; Mangësi administrative në zbatimin e përgjegjësi të posteve të ërk-floë të konformimit dhe gjenerimit të përfitimeve për pagesë, mosllogaritja drejt e bazës së vlerësuar, si dhe vitet e sigurimit, për shkak të mossigurimit të dokumenteve, vonesave në proceset gjyqësore, moszbatim të koeficientëve të indeksimit, mostrajtimi i njëjtë nga ana e DRSSH-ve për probleme të njëjta sa i përket mënyrës së llogaritjes së pensione; Mangësi në identifikimin e numrit të ri të përfituesve për shkak të emigracionit dhe programimit të përafërt të pensioneve të pleqërisë invaliditetit dhe familjar, që mbyllen; Vonesa në inspektimin e përfitimeve(krahasuar me momentin e caktimit të përfitimit); Vonesa në dixhitalizimin e listëpagesave të kontributeve për periudhën 1994- 2011, etj	Faqe 47-68	E mesme	Strukturat përgjegjëse në ISSH, me synim arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme përbushjen e indikatorëve të vendosur në plan veprimin e zbatimit të strategjisë afatmesme, me synim minimizimin e risqeve, që vënë në rrezik përbushjen e indikatorëve të vendosur me fokus, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimin e deficitit të skemës së pensioneve duke synuar rritjen graduale, por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.
7	Nga verifikimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020 për fondet e demtuara të vitit 2019, rezultoi se kanë mbetur pa paarkëtuar gjithsej 36 raste në rajonin e Tiranës, të gjitha pagesa të pensioneve pas vdekjes së përfituesve të paguara me autorizim ose prokurë, në shumën 534,866 lekë ose rreth 3% e totalit të fondeve të demtuara. Për fondet e demtuara të vitit 2020, nga verifikimi i pagesave të kryera deri në datën 19.04.2021, rezultoi se janë pa arkëtuar 29 raste, të gjitha pagesa pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë në shumën 593,884 lekë. Në marrëveshjen shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare nuk parashikohet në asnjë dispozitë mënyra e rekuperimit të këtyre fondeve të paguara me prokurë në rast të vonesave në arkëtimin e tyre, si dhe nga ana e I.S.SH nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim në rekuperimin e fondeve.	faqe 69-81	e lartë	ISSH të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative me qëllim arkëtimin e fondeve të demtuara nga pagesat e pensioneve të kryera pas vdekjes së përfituesve me autorizim ose prokurë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

9	Nga auditimi janë konstatuar 81 raste të përtifuesve debitorë, që janë akoma në proces arkëtimi me një vlerë totale debitorë 25,377,547 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 4,709,362 lekë dhe kanë mbetur pa arkëtuar 20,668,185 lekë, më hollësisht trajtuar sipas tabelës “Lista e subjekteve debitorë në proces arkëtimi për vitet 2019-2020”, 11 subjekte përfitues debitor që nuk janë futur në proces arkëtimi me vlerë 1,990,346 lekë, trajtuar sipas tabelës “Lista e subjekteve debitorë që nuk janë futur në proces arkëtimi 2019-2020”, Kreu V-Anekse, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.	faqe 83-112	e lartë	ISSH të marrë masa të fillojë procesin e arkëtitimit për 11 përfitues në vlerën 1,990,346 lekë si dhe të ndjekë në vazhdimësi procesin e arkëtitimit për 81 përfitues në vlerën e mbetur 20,668,185 lekë.
11	Nga auditimi rezulton se nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, afatet për evadimin e materialeve, gjithashtu ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Në asnjë prej rregulloreve të administruara në ISSH nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi inspektimit në terren, mbajtja e akt konstatimeve, hartimi i Raportit Paraprak, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i Raportit Përfundimtar dhe evadimi i materialeve të inspektimit. Në dosjet e inspektimit nuk administrohen informacione periodike për raportimin e ecursisë së inspektimit nga Specialistët dhe nga Përgjegjësit e Sektorit në kundërshtim me përcaktimet bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, pika 1.7.2 dhe 1.7.3, gjithashtu në Rregullore nuk është parashikuar periudha periodike e raportimit. Në rregullore ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, pasi në Kreun X- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Prezantimi Detyrues/ për Auditues, ndër të tjera citohet se: - <u>Kontrollon respektimin e standartëve të cilësisë për administrimin e shërbimeve; - për përfitimet afatshkurtra dhe afatgjata: Kontrollon respektimin e rregullave të dhënies së të drejtës, vërtetësisë së dokumentave justifikuese dhe llogaritjen e përfitimeve.</u> Në këtë pikë në kompetencat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është përfshirë dhe kontrolli i përfitimeve afatgjata që është kompetencë e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve	Faqe 81-107	e lartë	ISSH të marrë masa për të bërë ndryshime në rregulloret, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj, duke përcaktuar qartësisht afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi i inspektimit në terren deri tek evadimi i materialeve të inspektimit, afatin për raportimin periodik nga çdo inspektor dhe Përgjegjësi i Sektorit. Gjithashtu të bëjë ndryshimet përkatëse në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, me qëllim shmangien e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve
32	Nga auditimi rezultoi mungesë e një databaze të plotë dhe gjithë përfshirëse të vendimeve gjyqësore të ISSH dhe DRSSH-ve, ndër vite, ndjekjen dhe ecurinë e tyre. Informacioni i disponuar grupit të auditimit është informacion statistikor, sipas së cilit nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënë numri i proceseve gjyqësore nga 6316 në 5195 procese, gjithashtu ka rënë dhe numri i proceseve gjyqësore që janë humbur nga 3543 në 2504 procese, si dhe numri i proceseve gjyqësore që nuk janë ankimuar për shkak të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, dhe VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, nga 2775 në 1987 procese. Nga të gjithë çështjet në gjykata në dy shkallët e para, rreth 84 % e tyre kanë kaluar në favor të kërkuësve, shumica e këtyre proceseve, të cilat rezultojnë të humbura, janë me objekt “Vërtetimi fakti juridik”, me bazë ligjore nenin 388, të Kodit të Procedurës Civile, ku DRSSH-të kanë qenë palë e tretë. Këto gjyqe kanë karakter njohjeje. Në Gjykatën e Lartë aktualisht janë 1221 procese gjyqësore të mbartura ndër vite për shkak të	Faqe 112-144	e lartë	a.Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të hartojnë një databazë të plotë të vendimeve gjyqësore, për ndjekjen dhe ecurinë e tyre për të gjitha shkallët e gjyqësorit, për t'i mundësuar menaxhimin monitorimin, analizën dhe vlerësimin e ecursisë së proceseve në tërësinë e tyre. b. Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të evidentojë shpenzimet e vendimeve gjyqësore, duke mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për ekzekutimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	mosfunksionimit normal të kësaj gjykate, të cilat përbejnë kosto si për individin ashtu dhe për institucionin. Gjithashtu Drejtoria Juridike nuk ka mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbarrim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, nuk ka relacione për ndjekjen dhe raportimin e tyre. Veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhrit nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu- Detyrat dhe Përgjegjësit.			vendimeve gjyqësore të formës së prerë. për rastet e vendimeve që janë ekzekutuar me përmbarrim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, ndjekjen dhe raportimin e tyre, si dhe të marrë masa për zbatimin e afateve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke shmangur rritjen e shpenzimeve përmbarrimore..
15	Në Rregulloren e Brendshme të ISSH-së, për shkak të vjetërsisë në kohë të saj, e cila është hartuar që nga viti 2008 dhe mos amendimit në lidhje me Strukturën e DAB pas daljes së ligjit të AB në vitin 2014, paraqet mangësi në përcaktimet e saj në lidhje me: Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtuesin e njësisë dhe specialistët e AB, të cilat nuk janë të plota sipas përcaktimeve në nenet 14,15 dhe 16 të e ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe MAB Kapitulli II pikat 2.6.1 dhe 2.6.3. Sipas rregullores Drejtori i NJAB ngarkohet me detyrë t’i propozojë Drejtori i Përgjithshëm argumenta për masa disiplinore, detyrë e cila nuk përfshihet në dispozitat ligjore të sipërpërmendura; Stafi i auditimit të brendshëm nuk përjashtohet nga aktivitetet operacionale, ku në përshkrimin e punës të Drejtorit të AB në rubrikën “Marrja e vendimit” përcaktohet: “... nis dhe përgatit në bashkëpunim me Drejtoritë e ISSH, ligje, nënligje, udhëzime dhe rregullore për përmirësimin e veprimtarisë së ISSH”, bazuar në raportet e auditimit...”, detyrë kjo në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili përcakton se: “Audituesve të brendshëm u ndalohet të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese”. Kriteret e diplomës, të përvojës së punës në profesion dhe në fushën e auditimit të brendshëm si për Drejtuesin e DAB ashtu edhe për specialistët janë vendosur në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nuk janë përcaktuar qartë linjat e komunikimit dhe raportimit, në disa drejtime, ndërmjet DAB, Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Bordit të Drejtorëve, Këshillit Administrativ, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi i veprimtarisë së DAB konstatohet se nga ana e audituesve në 16 raste nuk janë respektuar afatet e dërgimit të projekt raportit dhe raportit përfundimtar njësisë së audituar. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin. nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 14,15,16,17 të Kapitullit IV të Manuali i Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm (MAB) në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020, Kapitullit IV pika 4.1.12	faqe 135-147	e lartë	a. ISSH të marrë masa për të finalizuar procesin e rishikimit të përmbajtjes së Rregullores së Brendshme të Funksionimit të saj, në lidhje me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm si për drejtuesin e njësisë dhe audituesit e brendshëm, si dhe mos përfshirjen e DAB në veprimtari operacionale me qëllim mos cënimin e objektivitetit, kompetencën dhe pa anësinë e audituesve. b. Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të marrë masa, që të shmangë vonesat dhe të kërkojë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë, të respektojë dhe ti përmbahet kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në drejtim të respektimit të afateve të hartimit të dokumenteve të auditimit dhe përcjelljes së tyre në subjekt, përkatësisht projekt-raportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

17	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2020 me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore” zhvilluar në 2020, me fond limit 7 816 350 lekë, u konstatua se: Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar veçoritë apo karakteristikat për objektet, ndërtimet edhe konstruksionet shoqëruar me foto, skica apo planimetri, gjendjen teknike të tyre. Gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214- Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218 inventarin ekonomik. Në termat e referencës është përfshirë dhe sigurimi për rastet:- Përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij; - Rrëshqitjes së Tokës. Për këto raste nuk ka asnjë të dhënë, relacion apo studim risku nëse këto ngjarje, që kanë ndodhur në të kaluarën dhe mundësia e ndodhjes së tyre. Mangësit në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. - Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjektit mbi vlerësimin e procedurës për shpalljen fitues të shoqërisë “I. V. I. G”, konstatohet se OE ka përmbushur kriteret e DST, përveç përcaktimit të kontratës së risigurimit, pasi sipas letër konfirmimit datë 06.01.2020, kontrata e risigurimit për shoqërinë “I. V. I. G” mbulon vetëm vitin 2020, ndërkohë që në kriteret për kualifikim është përcaktuar se: Ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit, që kërkohet në këtë procedurë prokurimi. Kontrata e sigurimit të aseteve është lidhur për një periudhë 1 vjetare nga data 10.03.2020-09.03.2021, pra periudha e kontratës për vitin 2021 nuk është e mbuluar me kontratë risigurimi, sipas përcaktimeve të DST. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59- Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, neni 66-Shqyrtimi dhe Vlersimi i ofertave.	faqe 147-179	e lartë	a. ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë që, për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, të përcaktojë nevojën për punë, shërbime dhe mallra si dhe të bëjë argumentimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues. Gjithashtu në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. b. ISSH të marrë masa të analizojë rast pas rasti mangësit e konstatuara në procedurat e prokurimit, të nxjerrë përgjegjësit, si dhe të inicioj kontrolle në vijimësi për respektimin e procedurave.
20	Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2019 dhe 2020, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ (VKA) nr. 3/2, datë 26.02.2008, të ndryshuar me VKA nr.15, datë 20.10.2017, e cila paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrat Nr.2518 prot datë 03.04.2019, Nr.2597 prot datë 05.04.2019, Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Struktura organizative sipas kësaj rregulloreje, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të drejtorisë të Aparatit të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtorinë Rajonale. Ndryshimet në strukturë janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74, pika b/1 “Kompetencat e Këshillit Administrativ” ku citohet se “Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Por me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së, Drejtori i Përgjithshëm është autorizuar për rialokime të burimeve njerëzore dhe ndryshime në strukturë, pa tejkalim të numrit total të punonjësve të miratuar nga VKA. Nga ana e ISSH-s janë marrë masa për rikonceptimin e një rregulloreje të re përgjatë vitit 2020, e cila është miratuar me mbledhjen nr. 2 e KA me Vendimin nr.5, datë.14.08.2020 “Për disa shtesa e	faqe 179-199	E mesme	ISSH të marrë masa, për amendimin e Rregullores dhe miratimin e saj në me VKA, për përmisimin e saj në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative të ISSH, për t’iu përgjigjur strukturës aktuale organizative, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet ligjore për struktura të veçanta. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masa për mbikëqyrjen e Rregullores dhe implementimin e saj në ISSH, sipas përcaktimeve dhe kuadrit ligjor në fuqi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ndryshime në rregulloren Nr.3/2, date 26.02.2008.” Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” i cili ka përcaktuar rregullat dhe kriteret e rekrutimit dhe të punonjësve, lëvizjet, hartimin e kontratave, marrdhëniet e punës deri në largimin e tyre, duke mos trajtuar strukturën organizative aktuale dhe funksionin e saj (misionin detyrat dhe përgjegjësitë).			
--	--	--	--

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Opinion i Auditimit mbi përputhshmërinë (ISSAI 4100¹)

Nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i ISSH, është përgjithësisht në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme, të cilat justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar** të përputhshmërisë, por për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin

Në auditim përputhshmërinë e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe udhëzimet që lidhen dhe ndikojnë në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet në përgjegjësi të tij dhe nga burime të tjera, si dhe përdorimin e fondeve/burimeve të krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Theksimi i Çështjes”

Nga të dhënat e mbledhura dhe të audituara arritëm në konkluzionin e përgjithshëm se:

Me gjithë përpjekjet dhe punën e mirë të evidentuar gjatë vitit 2019 dhe 2020 në administrimin e kujdesshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore u konstatuan përsëri problematika, që kanë ndikuar negativisht në treguesit financiar dhe në qëndrueshmërinë fiskale të këtij sistemi. Kështu, për vitin 2019 dhe për vitin 2020 financimi nga buxheti i shtetit për të balancuar buxhetin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore ashtu si në vitet e mëparshme mbetet përsëri tepër i lartë. Konkretisht:

-Për vitin 2019, shpenzimet e përgjithshme të sistemit të sigurimit shoqëror (përfitime dhe administrimi) janë në shumën 131,238 milion lekë, ndërsa të ardhurat janë në shumën 131,066 milion lekë me një rezultat fiskal negativ prej -172 milion lekë. Nga këto të ardhura të ardhurat nga kontributet janë në shumën 84,198 milion lekë, të cilat mbulojnë vetëm 64% të shpenzimeve. Diferenca prej 46,868 milion lekë është financuar nga buxheti i shtetit. Në këtë financim, vetëm deficitin neto i sistemit të pensioneve që subvencionohet direkt nga buxheti i shtetit është në masën 37,717 milion. lekë dhe zë 33 % të shpenzimeve neto të pensioneve publike (114,019 milion lekë) në Shqipëri, ose 2.24 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

-Për vitin 2020, shpenzimet e përgjithshme të sistemit të sigurimit shoqëror janë në shumën 134,152 milion lekë, ndërsa të ardhurat janë në shumën 141,649 milion lekë me një rezultat fiskal pozitiv prej + 7,497 milion lekë. Nga këto të ardhura, të ardhurat nga kontributet janë në shumën 82,420 milion lekë, të cilat mbulojnë vetëm 61% të këtyre shpenzimeve. Diferenca prej 58,228 milion lekë është financuar nga buxheti i shtetit dhe në këtë financim, vetëm deficitin neto i sistemit të pensioneve që subvencionohet direkt nga buxheti i shtetit është në masën 39,835 milion lekë dhe zë 35 % të shpenzimeve neto të pensioneve publike (115,127 milion lekë) në Shqipëri, ose 2.54 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

¹ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nisur nga gjendja e treguesve fiskalë të skemës së sigurimeve shoqërore në kuadër dhe në vazhdim të strategjisë së reformës së sigurimeve shoqërore e cila ka filluar të implementohet që nga viti 2015 dhe parashikohet të shtrihet deri në vitin 2056, vlerësojmë se:

Deri në vitin 2020 impaktet pozitive, që ka sjellë zbatimi i kësaj reforme, janë ende larg pritshmërisë apo larg një skenari optimist, për mundësinë e financimit të buxhetit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore nga të ardhurat e kontributeve dhe jo nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit si, në aspektin e një perspektive afatshkurtër dhe afatmesme, ashtu dhe të një perspektive afatgjatë.

Për sa më sipër, e gjykojmë të rëndësishme marrjen e masave ligjore dhe organizative nga aktorët kryesorë shtetërorë që mund të garantojnë suksesin e kësaj reforme si ISSH, MFE, MBZHRAU dhe Këshillin e Ministrave për:

Minimizimin e evazionit fiskal; mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensione; skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare; sistemin e pensione, pasi dega e pensione reflekton një deficit, që zë 2.54 % të PBB, si dhe 50.2 % e kontributeve rurale financoheshin nga buxheti i shtetit; stimulimin e pjesëmarrjes në skemën e kontributeve të personave të vetëpunësuar në bujqësi, ristrukturimin dhe reduktimin e deficitit financiar të kësaj degë të pensione, gjë që vjen nga masa e lartë e subvencioneve kontributive që paguan buxheti i shtetit për të vetëpunësuarit në bujqësi: *etj.*,

Ndërmarrjen e masave të nevojshme për mbledhjen e borxheve, të cilat për vitin 2019 janë në shumën 12,636 milion lekë dhe përbëjnë 70 % të deficitit të skemës së qytetit, ku për vitin 2020 janë në shumën 14,392 milion lekë, duke u rritur me 1,756 milion lekë ose në masën 14%.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Këshilli Administrativ i ISSH si organ më i lartë ekzekutiv është përgjegjës për vendimmarrjet e përcaktuara në zbatim të nenin 74 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993: Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21 të VKM-së nr.161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimit Shoqërore”, i ndryshuar.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale të institucionit të përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 24 dhe 25 të VKM-së nr.161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimit Shoqërore”, i ndryshuar dhe “Rregulloren e Brendshme të ISHS-së”.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar: Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000 dhe 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Ri-Auditimit nr. 95/1, datë 29.01.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me programin nr. 95/2 prot, datë 19.03.2021, nr. 95/3 prot, datë 08.04.2021, në subjektin Instituti i Sigurimeve Shoqërore për aktivitetin e kryer për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2020 u krye auditimi “Auditim përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I.Sh, Përgjegjës Grupi
2. B.Z, Anëtar
3. A. P, Anëtar
4. B.Z, Anëtar
5. E. H, Anëtar
6. E.A, Anëtar

II.1. Objekti i auditimit: Në zbatim të programit të auditimit objektivi kryesor është dhënia e një opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore me ligjin nr.7703 datë 11.05.1993, ligjin e buxhetit të shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në funksion të realizimit të misionit dhe objektivit të këtij Institucioni, si dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

II.2. Qëllimi i auditimit: Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse aktiviteti financiar dhe informacionet e raportuara në zbatim të buxhetit të shtetit, si dhe të veprimtarisë së subjektit nën auditim, janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

II.3. Identifikimi i çështjeve: Nisur nga eksperiencat e auditimeve të mëparshme në Instituti i Sigurimeve Shoqërore, problematikave të konstatuara dhe çështjeve të vlerësuara me risk të lartë, auditimi u adresua në çështjet e mëposhtme:

1. Auditimi i saktësisë së raportimit të treguesve në funksion të zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2019-2020. në nivel programi. Opinioni mbi përputhshmërinë e zbatimit të buxhetit të fondit të sigurimit shoqëror. Ecuria e treguesve të skemës së pensioneve të qytetit dhe të fshatit, për vitin 2019-2020 dhe trendi në 5 vitet e fundit.
2. Mbi nivelin e të ardhurave të realizuar referuar skemës së fashtit dhe problematikave të konstatuara. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

objektivave të strategjisë kombëtare në këtë drejti, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.

3. Mbi bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me të ardhurat e skemës së qytetit të mbledhur gjatë vitit 2019-2020. Problematikat e hasura në zbatim të kërkesave të marrëveshjeve dypalëshe. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.

4. Testimi i sistemeve të kontrollit lidhur me përputhshmërinë e pagesave të pensioneve. Niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet më problematik. Çështjet gjyqësore, ndjekja e tyre dhe efektet në sigurimet shoqërore.

5. Mbi funksionimin e strukturave të kontrollit: Aktiviteti i Njesisë së Inspektimit të Pensioneve, Drejtorisë Ligjore dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

6. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga entiteti.

7. Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rekrutimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në buxhet.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunësi autorizues*), Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunës autORIZUES I DYTË ZËVENDËSUES*), Drejtori i Drejtorisë së Financës (*Nëpunësi zbatues*), si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës (*Nëpunësi zbatues i dytë, zëvendësues*), janë përgjegjës për përputhshmërinë e vepimtarisë së ISSH me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e tyre, përfshirë rregullat mbi prokurimet, mbi limitet buxhetore, si dhe rregulloret, marrëveshje që ndikojnë në përdorimin e fondeve /burimeve të ISSH.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e audituesve të KLSH është, që të japim një opinion sa më objektiv, të drejtë, të paanshëm e profesional në lidhje me Institutit të Sigurimeve Shoqërore për aktivitetin e përputhshmërinë e tij me aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Për këtë qëllim auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

II.6. Kriteret e vlerësimit: Për kryerjen e këtij auditimi, në lidhje me dhënien e opinionit për aktivitetin financiar dhe përputhshmërinë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), kriteret e vlerësimit bazohen në :

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Per sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 99/2018, datë 03.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2019, si dhe Aktet Normative që kanë ndryshuar gjatë vitit;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2019” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për procedurat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 464, datë 22.07.1998 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”;
- VKM nr. 429, datë 12.02.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”
- VKM nr. 730, datë 02.09.2015
- VKM nr. 263, datë 07.05.2014 “Për caktimin e funksioneve përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”
- VKM nr. 25, datë 17.01.2018 “Për miratimin e kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2019-2021”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
- Udhëzimet e Ministrit të Financave për procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit;
- Rregullorja e Personelit, VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008;
- Rregullore Financiare nr. 5, datë 25.05.2009 e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore

II.7. Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në referencë të Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë. ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi” ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare

II.8. Metodat e auditimit: Grupi i auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit, ka përdorur metoda si intervista me gojë dhe me shkrim ndaj subjektit të audituar, ka verifikuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe të paraqitur nga subjekti i audituar me qëllim përmbushjen e drejtimeve të auditimit, si dhe ka kryer testime dhe verifikime mbi dokumentat dhe të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit. Në bazë të kritereve të vlerësimit gjyqimit profesional audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

II.9. Dokumentimi i auditimit: Auditimi në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, u krye në kuadër të planifikimit fillestar të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuara në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të këtij Institucioni për vitet 2019-2020 paraqiten bazuar në Programin e Auditimit, duke u mbështetur në evidencat dhe materialet dokumentare të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH, duke qenë se, njësitë e tjera Rajonale, shpenzuese të ISSH, nuk kanë qenë objekt auditimi. Theksojmë faktin se, ISSH është një institucion, i cili auditohet nga KLSH pothuaj rregullisht për çdo vit për veprimtarinë e tij. Këto pika kanë të bëjnë me identifikimin, vlerësimin e riskut si dhe procedurat për testimin e tyre dhe përgatitjen e dorëzimit të dokumentacionit standart të auditimit, për të cilën përgjatë auditimit u përgatitën e u depozituan Aktkonstatimet përkatëse për të cilat nga personat e atakuar u paraqitën vërejtjet sipas rastit. Këto dokumenta pasqyrohen në Projekt Raport Auditimit dhe në Raportin Përfundimtar të auditimit, sipas pikave të auditimit për të cilat është mbajtur.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III. 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.104/2014, datë 31.07.2014, VKM nr.161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH” si dhe Rregullores nr.1 datë 30.04.1996 “Për funksionimin e Këshillit Administrativ të ISSH”. ISSH është përgjegjës për veprimtarinë në fushën e mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe administrimin e dhënies së përfitimeve nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe është e organizuar në tri nivele drejtimi: Drejtoria Qendrore, 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dy Degë të Sigurimeve Shoqërore për shkak të largësisë nga qendra, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, si dhe në Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në nivel qyteti ose qendre banimi relativisht të mëdha.

Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (këtu e më poshtë ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi, dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij Institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë, kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë. Objektivat e përgjithshme të ISSH-së janë:

- Vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve.
- Zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve dhe indeksimit të tyre.
- Përmirësimi të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Vazhdimi i punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- autorizimit dhe pagesave të pensioneve online, si për pagesat në zonat urbane, ashtu dhe ato rurale;
- e. Përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standardet e përcaktuara.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.B/1.Auditimi i saktësisë së raportimit të treguesve në funksion të Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitet 2019-2020. Raportimi mbi zbatimin e buxhetit në nivel programi. Opinion mbi përputhshmërinë e zbatimit të buxhetit të fondit të sigurimit shoqëror. Ecuria e treguesve të skemës së pensioneve të qytetit dhe të fshatit, për vitet 2019-2020 dhe trendi në 5 vitet e fundit.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi.

- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7703, datë 01.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;
- Ligji nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;
- Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.2006, i ndryshuar;
- Rregullorja financiare e ISSH nr. 5, datë 25.09.2009 miratuar nga Këshilli i Administrimit;
- Në udhëzimet e Ministrisë së Financave: nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat standarte të përgatitjes së PBA”; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; UMF nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; dhe UMF nr. 5, datë 27.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, me ndryshime; nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”: nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”; nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme” etj.
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Nga auditimi u konstatua:

Viti 2019

Programimi i buxhetit afat mesëm 2019-2021 dhe programimi i vitit 2019, realizohet në 15 njësitë e sistemit për: 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtoria Qendrore e Arkivit, Llogaria e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm); Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm, ku realizohen transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale për pagesat e pensioneve, marrëdhëniet financiare me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Bankën e Shqipërisë.

Faza e parë e PBA 2019-2021, për programin e përgjithshëm të të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

por pjesëmarrja e ISSH në këtë proces është vetëm në EMP-et (Ekipi i Menaxhimit të Programit) e ngritura në MFE, ku përfaqësues të saj janë anëtarë.

Bazuar në politikën e programeve, përvec mbulimit me fonde të drejtave të fituara me skemat e pensioneve për vitet 2019-2021 është përcaktuar:

-Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve me mesatarisht 3%, ku fondet e përcaktuara si kontigjencë për indeksimin e pensioneve, për të tre vitet janë 4,400 milionë lekë.

-Mbulimi i efekteve të shtesës natyrale të numrit të përfituesve e cila është parashikuar për tre vitet të jetë afërsisht 47,000 përfitues me një shtesë për 15,600 persona në vit, me një efekt financiar për 12,400 milionë lekë

-Mbulimin e skemave të reja të përfitimeve, naftëtarë dhe minatorë me një efekt financiar për 5,200 milionë lekë.

Me shkresën nr. 1362/1, datë 28.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore(EMP) sipas programit 10220 “Sigurimi Shoqëror” dhe sipas pemës së produkteve, por dhe aktiviteteve, ku pas përgatitjes së tyre me shkresën nr. 1362/2, datë 30.04.2018 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekomomisë.

Faza e dytë e PBA 2019-2021, është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 6892/1, datë 24.08.2018. Konstatohet se, në procesin e programimit nuk janë përfshirë të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit.

Miratimi me ligj i buxhetit 2019 të ISSH, krahasuar me tavanet e vendosura në Programin Buxhetor Afatmesëm (**PBA**) 2019-2021 (tavanet, shtesat për të tre periudhat), krahasuar me tavanet dhe miratimin e vitit 2018, janë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion

lekë

Nr.	Emërtimi	2018			2019				Diferenca e Faktit 2019 me:	
		Mir. KA	Plani me #	Fakti	Tavanet	Aprovuar	Plani me #	Fakti	Plani me #	Fakti 2018
I	Totali i shpenzimeve:	126,086	127,360	125,364	133,340	133,088	133,378	131,238	(2,139.82)	5,874.20
1	Shpenz për përfitime	107,755	105,850	105,426	112,878	113,286	112,836	112,027	(809.03)	6,600.79
2	Shpe per prog.të tjera	10,134	13,453	13,082	11,721	9,971	11,961	11,723	(237.54)	1,358.82
3	Shp për skemën supl.	5,721	5,507	4,722	6,122	7,213	5,963	5,195	(768.85)	472.62
4	Shpenzime administ	2,476	2,550	2,134	2,618	2,618	2,618	2,294	(324.39)	159.61
II	Totali i të ardhurave	126,086	127,360	128,139	133,340	133,088	131,211	131,067	-144	2,928
1	Nga kontributet	74,657	78,536	79,340	83,142	84,342	84,342	84,199	(143.11)	4,858.89
2	Nga buxheti i shtetit	51,429	48,824	48,799	50,198	48,746	46,869	46,868	(1.00)	(1,930.60)
III	Te ardhura – Shpenzime	-	-	2,775.00	-	(0.00)	2,166.62	(170.90)	1,995.71	(2,945.90)

Sa më sipër, Projekt-buxheti i ISSH për vitin 2019 është hartuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij, dhe është bazuar në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në aktet e tjera ligjore dhe nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim projektprogrami është miratuar me ligjin nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”. Sipas nenit 4 të këtij ligji, por dhe me ndryshimet me Akte Normative gjatë vitit, buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 është si më poshtë:

Në mln/lekë

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore sipas ligjit dhe akteve normative paraqitet si me poshtë:	
Sipas ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, buxheti për Sigurimet Shoqërore është :	
1	Skema e sigurimit të detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta
	Të ardhurat, gjithsej
	127,244



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Nga të cilat:	
	Kontributet	82,896
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	42,038
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	2,310
	Shpenzimet	127,244
2	Skema e sigurimit suplementar	
	Të ardhurat, gjithsej	5,844
	Nga të cilat:	
	Kontributet	1,446
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	4,258
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	140
	Shpenzimet	5,844
	Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe suplementar	133,088
	Nga të cilat:	
	Kontributet	84,342
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	46,296
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	2,450
	Shpenzimet	133,088
	Ndërkohë, në Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, ndryshojnë zëri Transferime nga Buxheti i Shtetit - 1,000 milion lekë, në mënyrë të detajuar është si më poshtë:	
1	Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror	
	Të ardhurat, gjithsej	126,244
	Nga të cilat:	
	Kontributet	82,896
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	41,038
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	2,310
	Shpenzimet	126,244
2	Skema e sigurimit suplementar	
	Të ardhurat, gjithsej	5,844
	Nga të cilat:	
	Kontributet	1,446
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	4,258
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	140
	Shpenzimet	5,844
	Totali buxhetit per ISSH-në në vitin 2019 sipas Aktit Normativ Nr.2 date 02.10.2019	132,088

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Mbledhja e ardhurave nga kontributet

Të ardhurat gjithsej nga 84,652,000 mijë lekë të programuara u realizuan 84,260,082 mijë lekë ose në masën 99.5 %.

Të ardhurat e programuara për vitin, të ndara sipas përgjegjësi, janë realizuar si më poshtë:

Për ISSH, të ardhurat ishin programuar 3,320,000 mijë lekë dhe u realizuan 3,415,997 mijë lekë ose 103%, me një tejkalim prej 95,997 mijë lekë. Nga të cilat:

-Të ardhurat për sigurimet shoqërore ishin programuar 3,010,000 mijë lekë dhe u realizuan 3,354,169 mijë lekë ose 111% me një tejkalim prej 344,169 mijë lekë;

-Të ardhurat për sigurimet shëndetësore ishin programuar 310,000 mijë lekë dhe u realizuan 61,828 mijë lekë ose 20% me një mosrealizim prej 248,172 mijë lekë.

Për DPT, të ardhurat ishin programuar 81,332,000 mijë lekë dhe u realizuan 80,844,085 mijë lekë ose 99 %.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 sipas përgjegjësi të tyre, paraqitet si më poshtë:

Në mijë/lekë

Nr	Emertimi	Gjithsej		ne %	Nga këto					
		Plan	Fakt		ISSH		ne %	Tatime		ne %
					Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1	Sektori Publik		33,049,669		-	-	-		33,049,669	
A	Buxhetore		28,796,868		-	-	-		28,796,868	
B	Jobuxhetor		4,252,801		-	-	-		4,252,801	
2	Sektori Privat		46,036,840		-	-	-		46,036,840	
A	Firma		42,626,673		-	-	-		42,626,673	
B	Bisnezi i Vogël		3,410,167		-	-	-		3,410,167	
3	Sigurim Suplem.		1,451,432		-	-	-		1,451,432	
4	Sigurim vullnetar	510,000	537,216	105	510,000	537,216	105	-	-	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

5	Te vetepunesuar ne bujqesi	2,400,000	2,351,269	98	2,400,000	2,351,269	98	-	-	
A	Sigurim shoq.	2,090,000	2,289,441	109.5	2,090,000	2,289,441	109.5			
B	Sigurim shend.	310,000	61,828	20	310,000	61,828	20			
6	Të tjera	410,000	822,309	201	410,000	516,165	126	-	306,144	
7	Derdhur llog të sig.	-	11,347		-	11,347		-	-	
	TOTALI (shoq & shend)	84,652,000	84,260,082	99.5	3,320,000	3,415,997	103	81,332,000	80,844,085	99
	Sigurim shend.	310,000	61,828	20	310,000	61,828	20			
	GJITHSEJ (Sig.shoq)	84,342,000	84,198,254	99.8	3,010,000	3,354,169	111	81,332,000	80,844,085	99

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Realizimi i të ardhurave, që u krijua ishte rrjedhojë e tejkalimit të të ardhurave nga sigurimi vullnetar dhe nga tejkalimi i të ardhurave “Të tjera”.

Për vitin 2019 planifikimi i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është kryer nga MFE, si për ISSH ashtu dhe për DPT.

Të analizuar sipas Drejtorive Rajonale, të ardhurat për vitin 2019, për **subjektet në përgjegjësi të ISSH** paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Rajoni	Gjithsej		ne %	Nga këto								
		Plan	Fakt		Te vetepunes. ne bujqesi		ne %	Sigurimi vullnetar		ne %	Te tjera dhe derdhje ne llog. e DRSSH-ve		
					Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1	Berat	160,100	158,820	99	140,000	136,662	98	20,100	22,105	110	-	-	53
2	Dibër	133,700	140,382	105	131,000	138,226	106	2,700	2,131	79	-	-	25
3	Durrës	179,800	172,337	96	124,000	112,695	91	55,800	59,631	107	-	-	11
4	Elbasan	331,000	315,506	95	307,000	291,312	95	24,000	23,713	99	-	-	481
5	Fier	417,000	417,147	100	379,000	377,230	99.5	38,000	39,867	105	-	-	50
6	Gjirokastrër	178,300	182,161	102	155,000	159,869	103	23,300	22,220	95	-	-	72
7	Korçë	318,300	308,696	97	281,000	271,829	97	37,300	36,820	99	-	-	47
8	Kukës	64,800	63,179	97	63,000	62,754	99.6	1,800	397	22	-	-	28
9	Lezhë	185,200	178,932	97	170,000	165,039	97	15,200	13,867	91	-	-	26
10	Shkodër	196,800	198,489	101	180,000	181,526	101	16,800	16,853	100	-	-	110
11	Tiranë	444,000	464,089	105	220,000	209,920	95	224,000	243,212	109	-	-	10,957
12	Vlorë	301,000	300,657	100	250,000	244,207	98	51,000	56,400	111	-	-	50
	SHUMA	2,910,000	2,900,395	99.6	2,400,000	2,351,269	98	510,000	537,216	105			11,910
	Te tjera	410,000	515,602	126	-	-	-	-	-	-	410,000	515,602	
	TOTALI	3,320,000	3,415,997	103	2,400,000	2,351,269	98	510,000	537,216	105	410,000	527,512	

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Si dhe pasqyrohet, të ardhurat janë realizuar dhe u tejkaluar nga Drejtorite Rajonale: Dibër 105%, Tiranë 105 %, Gjirokastrë me 102 %, Shkodër me 101%, Fier 100% dhe Vlorë me 100%.

-Të ardhurat e tjera.

Të ardhurat e tjera që përfshijnë kryesisht të ardhura nga investimi efektiv i fondeve përkohësisht të lira të ISSH në bonot e thesarit (fondi rezervë), nga interesat bankare, etj, ishin programuar 410,000 mijë lekë dhe u realizuan 516,165 mijë lekë, ose me realizim në masën 126%, me një tejkalim prej 106,165 mijë lekë, ndërsa të ardhura “Derdhur në llogari të ISSH” janë në shumën 11,347 mijë lekë. Gjithsej të ardhurat e tjera janë realizuar në shumën 527,512 mijë lekë, ose 117 milion lekë më shumë, apo në masën 128.6%.

Realizimi i numrit të kontribuesve gjithsej dhe sipas përgjegjësi.

Përsa i përket numrit të kontribuesve siç dihet ky tregues analizohet i ndarë në numrin e kontribuesve në përgjegjësi të organeve tatimore, që merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe në numrin e kontribuesve në përgjegjësi të organeve të sigurimeve shoqërore, që i nxjerr vetë ISSH. Numri mesatar i kontribuesve për vitin 2019 krahasuar me numrin e kontribuesve të vitit 2018 paraqitet:

Nr	Numri i kontribuesve ne pergjegjesi te DPT dhe te ISSH	Numri kontribuesve per vitin 2018	Numri kontribuesve per vitin 2019	Diferenca (ne plus ose minus) e
----	--	-----------------------------------	-----------------------------------	---------------------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

				krahasimit të vitit 2019 me vitin 2018
I	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të DP. Nga keto:	650,127	660,280	10,153
1	Buxhetore	141,112	140,568	-554
2	Jobuxhetore	17,390	17,403	13
3	Firma	408,247	418,552	10,305
4	Te vetepunësuar	83,378	83,756	378
II	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të ISSH. Nga keto:	66,927	69,541	2,614
1	Te vetepunësuar në bujqësi	58,973	61,568	2,595
2	Te siguruar vullnetarisht	7,954	7,973	19
	Gjithsej (I+II)	717,054	729,821	17,767

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH

Nga pasqyra përmbledhëse e mësipërme rezultojnë 17,767 kontribues më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, nga këto 10,153 nga subjektet në përgjegjësi të DPT dhe 2,614 kontribues nga subjektet në përgjegjësi të ISSH (të vetëpunësuarit në bujqësi dhe sigurimi vullnetar).

Shpenzimet sipas programeve.

Për vitin 2019 shpenzimet faktike për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore janë realizuar në shumën 131,238.2 milion lekë, kundrejt planifikimit, që ka qenë në shumën 133,378 milion lekë, ose realizuar në masën **98.3%** dhe paraqiten me kursim në vlerë absolute 1,063 milion lekë. Peshën më të madhe rreth 83% të shpenzimeve totale e zënë shpenzimet për sigurimin e detyrueshëm, që kanë të bëjnë me pensione pleqërie, barrëindje, sëmundje, etj, dhe administrohen direkt nën përgjegjësi të ISSH. Ndërsa shpenzimet që rrjedhin nga ligje të veçanta, që përfaqësojnë përfitimet për pensione speciale dhe të vecanta shtetërore si dhe pensione suplementare për disa kategori punonjësish kushtetues dhe të administratës publike, zënë rreth 15% të shpenzimeve totale dhe administrohen nga ISSH për llogari të qeverisë.

Për vitin 2019, shpenzimet faktike krahasuar me programimin janë realizuar në masën **98.4%**, ose nga 133,378 milionë lekë të programuara, shpenzimet janë realizuar 131,238 milionë lekë, me një mosrealizim prej 2,140 milionë lekë.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2019, në mënyrë analitike dhe sipas programeve paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Analiza	SHPENZIMET	Plan fillestar 2019	Shtesa/Paksi me gjatë vitit	Plan i rishikuar 2019	Fakt total 2019	Realizimi ne %
I	SHPENZIME PER PERFITIME	113,286,315	(450,500)	112,835,815	112,026,789	99
6060010	Shpenzime për Sëmundje	470,000	2,000	472,000	521,446	110
6060030	Shpenzime për Barrelindje	3,790,979	(2,200)	3,788,779	3,604,059	95
60600031	Shpenzime për Barrelindje Qytet	2,931,475	(3,200)	2,928,275	2,798,934	96
60600032	Shpenzime për Barrelindje Fshat	660,845	(6,500)	654,345	585,564	89
6060034	Shpenzime për Shperblim Lindje	198,660	7,500	206,160	219,562	107
					-	
6	SHPENZIME PER PENSIONE	109,001,022	(450,500)	108,550,523	107,880,347	99
6060005	Shpenzime për Pensione Qytet	95,838,049	(539,699)	95,298,350	94,731,333	99
	Shpenzime për Pensione Fshat	13,162,973	89,200	13,252,173	13,149,014	99
6060020	Per Aksidente dhe Sem. Profesionale	24,313	200	24,513	20,937	85
					-	
II	PER PROGRAMET E TJERA	9,970,729	1,990,000	11,960,728	11,723,184	98
6060090	Pensione Speciale e te Posaçme	93,663	-	93,663	85,855	92
6060110	Shperblime te Invalideve te Luftes dhe Veteraneve	126,703	-	126,703	113,296	89
6060120	Shtese nga Statusi i Invalidit te Punes	42,000	-	42,000	38,939	93
6060008	Kompensime	9,512,363	1,990,000	11,502,362	11,306,623	98
	Pensione Sociale	196,000	-	196,000	178,471	91
III	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	2,618,000	-	2,618,000	2,293,605	88
IV	SHPENZIME PER SKEMA SUPLEMENTARE	7,212,972	(1,249,500)	5,963,472	5,194,619	87
	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III+IV)	133,088,015	290,000	133,378,015	131,238,197	98



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Referuar të dhënave nga tabela e mësipërme, rezulton se mbi 98,3 % të shpenzimeve totale të ISSH përbëhet nga transfertat në buxhetet familjare që janë:

- a. **Sigurimi i detyrueshëm shoqëror** që financohet nga kontributet e drejtpërdrejta të personave juridikë dhe fizikë dhe nga financimet e Buxhetit të Shtetit të formës kontributeve dhe subvencionuese.
- b. **Programet e veçanta të shtetit** që financohen nga Buxheti i Shtetit.
- c. **Sigurimi suplementar** që financohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributi suplementar.

Nga një analizë të përgjithshme, lidhur me zbatimin e planit të shpenzimeve dhe mos realizimin e tij evidentojmë sa më poshtë:

- **Shpenzimet për pensione** janë realizuar në shumën 670 milion lekë më pak se programi, për shkak të moskryerjes së të gjitha pagesave të pensioneve brenda vitit me ritmet e parashikuara të viteve të mëparshme.
- **Shpenzimet për programe të veçanta** janë realizuar 238 milionë më pak se programi, për shkak të mosrealizimit të kompensimeve të ardhurave, pasi të gjitha pensionet e reja që lidhen me ligjin 104/2015 janë pa kompensime të të ardhurave dhe për shkak të pensioneve të mbyllura si rezultat i vdekjeve;
- **Shpenzimet në skemën suplementare** paraqiten me një mosrealizim prej 769 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve sipas njësive shpenzuese paraqitet në tabelën si më poshtë:

RAJONET	Plan	Fakt	Dif	Në %
Berat	6,656	6,656	0	100.0
Dibër	4,731	4,633	-98	97.9
Durrës	11,706	11,494	-212	98.2
Elbasan	11,822	11,794	-28	99.8
Fier	13,800	13,718	-82	99.4
Gjirokastrë	5,080	5,013	-67	98.7
Korcë	11,821	11,507	-314	97.3
Kukës	3,150	3,088	-62	98.0
Lezhë	5,689	5,620	-69	98.8
Shkodër	9,384	9,175	-209	97.8
Tiranë	37,163	36,736	-427	98.9
Vlorë	11,639	11,368	-271	97.7
DAQ	128	113.2	-15	88.4
Buxheti i Brendshëm (Administrata)	369	322	-47	87.2
Buxheti i Përgjithshëm	240	1.2543	-239	0.5
TOTALI	133,378	131,238	-2,140	98.4

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Siç evidentohet në tabelën e mësipërme shpenzimet janë mbajtur nën kontroll dhe nën limitet e programuara, jo vetëm sipas programeve dhe zërave por edhe në shpërndarjen e tyre, sipas njësive të administrimit. Në buxhetin e përgjithshëm në zërin shpenzime në fakt janë përfshirë fondet e pa shpenzuara për shpërblimin e pensionistëve të fundvitit 2019.

Rezultati financiar i vitit 2019 paraqitet:

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet: *Të ardhurat e drejtpërdrejta, nga kontributet e personave juridikë dhe fizikë janë realizuar me një diferencë prej 788.1 milionë lekë më pak se plani.* Dy janë faktorët kryesorë të mundësive të tejkalimit të të ardhurave; problemet e krijuara nga tërmeti dhe shtimi i detyrimeve debitore për kontribute të deklaruar por të pa derdhura nga subjektet juridike e fizike. Ndërsa për shkak të mos realizimit të shpenzimeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

programuara prej rreth 2,140 milionë lekë, rezultati financiar i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 rezulton me tejkalim të të hyrave mbi shpenzimet në shumën 1,935 milionë lekë.

REZULTATI FINANCIAR 2019		ne ooo leke		
Te Hyrat ne fondin e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
a.Te ardhurat per skemen e detyrueshme	82,896,000	82,746,822	(149,178)	99.8
kontributi i subjekteve juridike e fizike	79,886,000	79,097,856	(788,144)	99.0
kontributi i te vetepunesuarve ne fshat	2,090,000	2,213,047	123,047	105.9
kontributi nga sigurimi vullnetar	510,000	537,216	27,216	105.3
te ardhura te tjera	410,000	898,703	488,703	219.2
b.Te ardhurat nga kontrib. per skema suplement.	1,446,000	1,451,433	5,433	100.4
1.Te ardhurat e sigurimeve shoqerore (a+b)	84,342,000	84,198,255	(143,745)	99.8
2.Financime kontributibve te buxhetit	6,024,259	6,143,059	118,800	102.0
Totali i te ardhurave(1+2)	90,366,259	90,341,314	(24,945)	100.0
3. Financime programore dhe subvencione	40,905,741	40,725,341	(180,400)	99.6
4. Financime programore te brendeshme	2,106,000	2,106,622	622	100.0
Totali i te ardhurave(1+2+3)	133,378,000	133,173,277	(204,723)	99.8
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	133,378,000	131,238,197	(2,139,803)	98.4
skema e detyrueshme	112,835,800	112,026,789	(809,012)	99.3
programet e vecanta te shtetit	11,960,728	11,723,184	(237,544)	98.0
skemat suplementare	5,963,472	5,194,619	(768,853)	87.1
shpenzime administrative	2,618,000	2,293,605	(324,394)	87.6
Rezultati financiar	(0)	1,935,080		

Rezultati fiskal

Në ndryshim nga vitet e tjera kur rezultati financiar dhe fiskal kanë qenë të njëjta, për vitin 2019, rezultati fiskal paraqitet si në vijim:

REZULTATI FISKAL 2019		ne ooo leke		
Te Hyrat ne fondin e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
a.Te ardhurat per skemen e detyrueshme	82,896,000	82,746,822	(149,178)	99.8
kontributi i subjekteve juridike e fizike	79,886,000	79,097,856	(788,144)	99.0
kontributi i te vetepunesuarve ne fshat	2,090,000	2,213,047	123,047	105.9
kontributi nga sigurimi vullnetar	510,000	537,216	27,216	105.3
te ardhura te tjera	410,000	898,703	488,703	219.2
b.Te ardhurat nga kontrib. per skema suplement.	1,446,000	1,451,433	5,433	100.4
1.Te ardhurat e sigurimeve shoqerore (a+b)	84,342,000	84,198,255	(143,745)	99.8
2.Financime kontributibve te buxhetit	6,024,259	6,143,059	118,800	102.0
Totali i te ardhurave(1+2)	90,366,259	90,341,314	(24,945)	100.0
3. Financime programore dhe subvencione	40,905,741	40,725,341	(180,400)	99.6
4. Financime programore te brendeshme			-	
Totali i te ardhurave(1+2+3)	131,272,000	131,066,655	(205,345)	99.8
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	133,378,000	131,238,197	(2,139,803)	98.4
skema e detyrueshme	112,835,800	112,026,789	(809,012)	99.3
programet e vecanta te shtetit	11,960,728	11,723,184	(237,544)	98.0
skemat suplementare	5,963,472	5,194,619	(768,853)	87.1
shpenzime administrative	2,618,000	2,293,605	(324,394)	87.6
Rezultati financiar	(2,106,000)	-171,542		

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Pra, sa më sipër rezultati fiskal i ISSH për vitin 2019 rezulton negativ për 171,542 mijë lekë, kjo për shkak se në planifikim si burim financiar i mbulimit të shpenzimeve të ISSH është përcaktuar edhe shuma 2,106 milionë lekë, si financim i brendshëm me burim nga rezultati financiar pozitiv i vitit 2018. Ky burim financimi rregullon dhe përcakton zbatimin e buxhetit të ISSH për vitin 2019, por nuk përfshihet në rezultatin fiskal, që në fakt i referohet të hyrave kontributeve, financimeve dhe shpenzimeve të drejtpërdrejta të vitit.

Fondi rezervë

Mbajtja e fondit rezervë të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, që sipas të cilit ky fond përlllogaritet të jetë i mjaftueshëm për mbulimin e pagesave të përfitimeve për një muaj.

Në fund të vitit 2018, gjendja e fondit rezervë ishte 9,138,975,380 lekë dhe në vitin 2019 sipas vendimit të Këshillit Administrativ nr. 25, datë 06.12.2019 është bërë sistemimi i rezultatit financiar të vitit 2018, duke e shtuar fondin rezervë me 668,403,575 lekë, i cili ka arritur vlerën 9,807,378,954 lekë.

Viti 2020

Treguesit e projekt buxhetit të vitit 2020 dhe PBA 2020-2022

Programimi i buxhetit afat mesëm 2020-2022 dhe programimi i vitit 2020, kryhet dhe zbatohet në 15 njësitë e sistemit për: 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtoria Qendrore e Arkivit, Llogaria e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm); Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm, ku realizohen transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale për pagesat e pensione, marrëdhëniet financiare me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Bankën e Shqipërisë.

Faza e parë e PBA 2020-2022, për programin e përgjithshëm të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat, por pjesëmarrja e ISSH në këtë proces është vetëm në EMP-et e ngritura në MFE, ku përfaqësues të saj janë anëtarë.

Me shkresën nr.2089, datë 17.04.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore (EMP) sipas programit 10220 “Sigurimi Shoqëror” dhe me shkresën nr.3330/1, datë 10.05.2019 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Faza e dytë e PBA 2019-2021, është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 5893/1, datë 02.09.2019.

Konstatohet se, në procesin e programimit nuk janë përfshirë të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit.

Miratimi me ligj i buxhetit 2020 të ISSH, krahasuar me tavanet e vendosura në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020-2023 (tavanet, shtesat për të tre periudhat), krahasuar me tavanet dhe miratimin e vitit 2019, janë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2019	Tavanet	Faza I	Faza II	Mir. KA	Ligji vjetor 2020
I	Totali i shpenzimeve:	131,238	141,195	140,847	141,195	139,988	139,988
1	Shpenz për përfitime	112,027		121,032	120,897	120,130	120,130
2	Shpe per prog.të tjera	11,723		9,571	10,024	10,201	10,201
3	Shp për skemën supl.	5,195		7,465	7,495	7,007	7,007
4	Shpenzime administ	2,294		2,779	2,779	2,650	2,650
II	Totali i të ardhurave	131,067	141,195	140,847	141,195	139,988	139,988
1	Nga kontributet	84,198		89,733	89,733	88,609	88,609
2	Nga buxheti i shtetit	46,868		51,114	51,462	51,379	51,379

Projekt-buxheti i ISSH për vitin 2020 dhe ndryshimet me Akt Normativ

Sa më sipër, Projekt-buxheti i ISSH për vitin 2020 është hartuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Republikën e Shqipërisë” dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij, dhe është bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në aktet e tjera ligjore dhe nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në metodologjinë e programimit dhe në politikat e programeve, të miratuara nga Qeveria, përveç mbulimit me fonde të përfitimeve të pensionistëve dhe të programeve të veçanta e suplementare, në buxhetin e vitin 2020 janë parashikuar dhe mbuluar me fonde:

- *rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve me rreth 2.8%, duke vendosur në dispozicion një fond prej 2,520 milionë lekë i cili do të mbulojë indeksimin e pensioneve bazuar në ndryshimin akumulativ të indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe shërbimeve të zgjedhura për pensionistët.*
- *efektet financiare të rritjes së numrit të përfituesve të pensioneve, krahasuar me vitin 2019*
- *efektet mbetëse të indeksimit të pensioneve në vitin 2019- në vitin 2020, pasi indeksimi i pensioneve në vitin 2019 është me efekt nga 01.04.2019. Ky indeksim prek edhe pensionet e reja të caktuara në vitin 2020.*

Buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2020, së bashku fondet për rritjen e pensioneve, sipas ligjit të buxhetit të shtetit të vitit 2020, nr 88/2019 dt.18.12.2019 është përcaktuar 139,988 milionë lekë.

Për vitin 2020 transfertat në buxhetet familjare nga të tre programet, ndahen si më poshtë:

- Sigurimi i detyrueshëm shoqëror** 122,780 milionë lekë, ose rreth 92 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Sigurimi i detyrueshëm financohet nga kontributet e drejtpërdrejta të personave juridikë dhe fizikë dhe nga financimet e Buxhetit të Shtetit të formës kontributeve dhe subvencionuese.
- Programet e veçanta të shtetit** 10,201 milionë lekë, zënë 8 % të transfertave në buxhetet familjare dhe financohen nga Buxheti i Shtetit.
- Sigurimi suplementar** dhe trajtimet e veçanta 7,007 milionë lekë, zënë 5 % të shpenzimeve, dhe financohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributi suplementar.

VITI 2020	Shpenzimet	Struktura
Programet	milionë/lekë	%
Për skemën e detyrueshme	122,780	92%
Për programe të veçanta	10,201	8%
Për sig.suplementare	7,007	5%
TOTALI	139,988	105%
	Te Ardhurat	Struktura
Programet	milionë/lekë	%
kontribute të detyrueshme	87,076	62%
kontribute suplementare	1,533	1%
financime nga buxheti	48,859	35%
politika të reja pensionesh	2,520	2%
TOTALI	139,988	100%

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme evidentohet se programi më i rëndësishëm dhe me volum më të madh të transfertave në buxhetet familjare është sistemi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe në veçanti programi i pensioneve. Në totalin e shpenzimeve të sistemit të sigurimeve shoqërore ai zë 92 %.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në përfundim projekt buxheti i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore është miratuar me ligjin nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Me ndryshimet me Akte Normative gjatë vitit, buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2020 është miratuar në shumën 140,768 milionë lekë, si më poshtë:

Buxheti i ISSH-se për vitin 2020, sipas Akteve normative		Sipas Ligjit 88/2019 dt.18.12.2019	Sipas Aktit Normativ Nr.28, dt 02.07.2020	Sipas Aktit Normativ Nr.34, dt 16.12.2020
		Mln/Leke		
I	Skema e sigurimit të detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta			
1	Të ardhurat, gjithsej	133,300	132,530	134,230
	Nga të cilat:			
	Kontributet	87,076	79,340	81,040
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	43,854	51,190	47,790
	Transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2,370	2,000	2,000
	Transferta nga buxheti për bonusin e pensionistëve			3,400
	Shpenzimet	133,300	132,530	134,230
2	Skema e sigurimit suplementar			
	Të ardhurat, gjithsej	6,688	6,538	6,538
	Nga të cilat:			
	Kontributet	1,533	1,500	1,500
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	5,005	4,938	4,938
	Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	150	100	100
	Shpenzimet	6,688	6,538	6,538
II	Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe suplementar	139,988	139,068	140,768
	Nga të cilat:			
	Kontributet	88,609	80,840	82,540
	Transferimet nga Buxheti i Shtetit	48,859	56,128	52,728
	Transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2,520	2,100	2,100
	Transferta nga buxheti për bonusin e pensionistëve			3,400
	Shpenzimet	139,988	139,068	140,768

Realizimi i Buxhetit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2020

Për vitin 2020 në total, shpenzimet për të tre programet e sistemit të sigurimeve shoqërore së bashku me shpenzimet për administrimin u realizuan në shumën 134,152 milion lekë dhe krahasuar me planin fillestar të vitit 2020 rezultoi me pak në masën 5,836 milionë lekë ose në 4.2 % më pak.

Krahasuar me buxhetin përfundimtar të miratuar me aktin normativ Nr.34, dt 16.12.2020, për vitin 2020, nga 140,768 milionë lekë të programuara, realizohen 134,152 milionë lekë me një mos realizim në shumën 6,616 milionë lekë, të cilat kryesisht janë pasojë e mos tërheqjes brenda vitit të pensioneve, për shkak të pandemisë së COVID-19, nga pensionistët që jetojnë jashtë shtetit. (Sipas nenit 62 të ligjit 7703, e drejta për tërheqjen e pensioneve të njohura, parashkruhet me kalimin e 3 viteve).

Realizimi i të ardhurave nga kontributet e personave juridike dhe fizike dhe të ardhurave të tjera për vitin 2020 rezultoi në masën 83,420 milionë lekë, 5,189 milionë lekë ose 5.9 % më pak se plani fillestar i të ardhurave që ishte në shumën 88,609 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me programin e të ardhurave të rishikuara si rezultat i pandemisë në vitin 2020, nga 82,540 milionë lekë të programuara, janë realizuar 83,420 milionë lekë, ose 880 milionë lekë më shumë.

Financimet nga buxheti i shtetit për buxhetin e sistemit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2020, janë realizuar sipas planifikimit me Aktin Normativ nr.34, date 16.12.2020, në masën 58,228 milionë lekë financime, në masën 6,849 milionë lekë më shumë se plani fillestar, ose 13.3 % më shumë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në mënyrë të përmblendhur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2020, krahasuar me vitin 2019 paraqitet si në vijim:

	Plani 2019	Fakti 2019	%	Plani 2020 fillimit	Plani përfundimtar 2020	Fakti 2020	%
Totali i Shpenzimeve	133,088	131,238	99%	139,988	140,768	134,152	95%
Totali i të Ardhurave	133,088	131,067	98%	139,988	140,768	141,649	101%
Kontributet	84,342	84,198	100%	88,609	82,540	83,420	101%
Buxheti i Shtetit	48,746	46,868	96%	51,379	58,228	58,228	100%

Krahasuar me planin e çdo viti, për vitin 2019 shpenzimet janë realizuar në masën 98.3% dhe ndërkohë shpenzimet e vitit 2020, për shkak të mos tërheqjes së pensione nga bllokimi i lëvizjes së lirë për shkak të pandemisë, janë realizuar në masën 95.8%. Bazuar në të dhënat e bilancit financiar të ISSH, shuma e pensione të pa tërhequra për shkaqet e mësipërme evidentohet të jetë në masën 5,741.9 milionë lekë.

Nga evidenca financiare e ISSH, evidentohet se janë respektuar limitet e programuara për shpenzimet në përgjithësi dhe në veçanti të shpenzimeve administrative, ku ky program është realizuar si më poshtë:

- Për vitin 2020 shpenzimet administrative janë realizuar në masën 90.9 % pra nga 2,455 milionë lekë të programuara janë shpenzuar 2,232 milionë lekë, me një mos realizim prej 223 milionë lekë.
- Kosto e administrimit të sistemit zë këtë vit 1.66 % të shpenzimeve gjithsej nga 5% të shpenzimeve që parashikohet si limit në pikën 3, të nenit nr. 67, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar.
- Mos realizimi i shpenzimeve administrative kryesisht lidhet me bllokimin e shpenzimeve për investime si dhe mos realizimin e pagesave të komisioneve për pagesat e pensione, si pasojë e pensione të pa tërhequra të evidentuara më lart.

Të ardhurat e realizuara për vitin 2020 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Të ardhurat e realizuara për vitin 2020 nga kontributet e personave juridike dhe fizikë, janë në shumën 83,420 milionë lekë, me rreth 778 milionë lekë më pak se realizimi i vitit 2019, pra të ardhurat e vitit 2020 janë realizuar 8 % më pak, krahasuar me vitin 2019.

- Të ardhurat e programuara sipas ligjit të buxhetit për vitin 2020, që të mbulojnë shpenzimet në vlerë 140,768 milionë lekë, janë programuar në dy zëra kryesor:
- 1. *Nga kontributet e sigurimeve shoqërore, në vlerë 82,540 milionë lekë dhe që përbën 58.6% të totalit të të ardhurave;*
- 2. *Nga financimet e buxhetit të shtetit, në vlerë 58,228 milionë lekë dhe që përbën 41.4 % të totalit të të ardhurave, të cilat janë të adresuara përmbulimin e shpenzimeve për skemat e sigurimit suplementar, për programet e veçanta të qeverisë, dhe në formën e subvencionit të deficitit të sistemit të sigurimit shoqëror të detyrueshëm.*
- 3. *Në totalin e të ardhurave të akorduara nga Buxheti i Shtetit është i përfshirë edhe bonusi i fundvit në vlerën 3,400 milionë lekë.*

Mbledhja e ardhurave nga kontributet për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i planit të të ardhurave sipas përgjegjësive për mbledhjen e tyre, pasi të ardhurat kontributive të personave juridike e fizikë janë në përgjegjësi administrimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ndërsa ISSH është përgjegjëse për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të të vetpunësuarve në bujqësi, kontributet vullnetare dhe të ardhurave të tjera që lidhen me ato.

									Në mijë lekë	
N r	Emërtimi	Gjithsej			Nga këto					
		Plan	Fakt		ISSH			Tatime		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

				ne %	Plan	Fakt	ne %	Plan	Fakt	ne %
1	Sektori Publik		32,814,800		-	-	-		32,814,800	
a	Buxhetore		29,060,879		-	-	-		29,060,879	
b	Jobuxhetor		3,753,921		-	-	-		3,753,921	
2	Sektori Privat		46,195,458		-	-	-		46,195,458	
a	Firma		43,130,983		-	-	-		43,130,983	
b	Bisnezi i Vogël		3,064,475		-	-	-		3,064,475	
3	Sigurim Suplem.		1,419,993		-	-	-		1,419,993	
4	Sigurim vullnetar	450,000	371,309	83	450,000	371,309	83	-	-	
5	Te vetepunësuar ne bujqësi	2,103,000	1,782,230	85	2,103,000	1,731,771	90	-	-	
a	Sigurim shoq.	1,923,000	1,731,771	90	1,923,000	1,731,771	90			
b	Sigurim shend.	180,000	50,459	28	180,000	50,459	28			
6	Të tjera	447,000	864,670	193	447,000	508,423	114	-	356,247	
7	Derdhur llog të sig.	-	22,125		-	22,125		-	-	
	TOTALI (shoq & shend)	82,720,000	83,470,585	101	3,000,000	2,684,087	89	79,720,000	80,786,498	101
	Sigurim shend.	180,000	50,459	28	180,000	50,459	28			
	GJITHSEJ (Vetem Sig.shoq)	82,540,000	83,420,126	101	2,820,000	2,633,628	93	79,720,000	80,786,498	101

Realizimi i të ardhurave sipas përgjegjësi të tyre, paraqitet si më poshtë:

- Te ardhurat e programuara për subjektet në përgjegjësi të ISSH janë realizuar në masën 89%, me mos realizim prej vetëm 315,913 mijë lekë. Vetëm për sistemin e sigurimeve shoqërore, nga 2,820 milionë lekë të programuara, janë realizuar 2,663.6 milionë lekë ose 93 % me një deficit prej 186.4 milionë lekë.
- Të ardhurat në përgjegjësi të DPT janë realizuar në masën 101% me një tejkalim në vlerë për 1,066.4 milionë lekë, krahasuar me planin.
- Deficiti kryesor i të ardhurave në përgjegjësi të ISSH lidhet kryesisht me kontributet e personave të vetpunësuar në bujqësi të cilat janë realizuar në masën 85% me një mos realizim në vlerë në shumën 320.8 milionë lekë.

Të analizuar sipas Drejtorive Rajonale, të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi për vitin 2020, për subjektet në përgjegjësi të ISSH paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Rajoni	Gjithsej		ne %	Nga këto							
		Plan	Fakt		Te vetepunes. ne bujqesi		ne %	Sigurimi vullnetar		ne %	Te tjera dhe derdhje ne llog. e DRSSH-ve	
					Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt
1	Berat	142,500	121,821	85	124,500	104,339	84	18,000	17,465	97	0	17
2	Dibër	122,100	125,870	103	120,000	123,683	103	2,100	2,153	103	0	34
3	Durrës	150,500	126,216	84	100,500	82,556	82	50,000	43,649	87	0	11
4	Elbasan	276,500	253,216	92	256,500	238,038	93	20,000	15,142	76	0	36
5	Fier	362,500	305,375	84	329,000	271,516	83	33,500	33,822	101	0	37
6	Gjirokaštër	162,500	115,350	71	143,000	99,794	70	19,500	15,492	79	0	64
7	Korçë	273,500	215,586	79	242,000	193,436	80	31,500	22,124	70	0	26
8	Kukës	57,300	56,854	99	56,500	56,038	99	800	792	99	0	24
9	Lezhë	167,500	127,366	76	155,000	119,158	77	12,500	8,190	66	0	18
10	Shkodër	177,000	174,517	99	163,000	158,486	97	14,000	16,008	114	0	23
11	Tiranë	391,600	323,232	83	190,000	158,398	83	201,600	161,984	80	0	2,850
12	Vlorë	269,500	211,301	78	223,000	176,788	79	46,500	34,488	74	0	25
	SHUMA	2,553,000	2,156,704	84	2,103,000	1,782,230	98	450,000	371,309	105	0	3,165
	Te tjera	447,000	527,383	114	0	0		0	0	0	447,000	527,383
	TOTALI	3,000,000	2,684,087	89	2,103,000	1,782,230	85	450,000	371,309	83	447,000	530,548

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Si dhe pasqyrohet, të ardhurat janë realizuar dhe tejkaluar vetem nga Drejtoria Rajonale Dibër me 103%.

Mosrealizimi i të ardhurave nga Drejtoritë e tjera Rajonale ka ardhur kryesisht edhe si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19 konstatim i cili mbështetet edhe nga krahasimi me vitin 2019 si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Rajoni	Gjithsej	ne %	Rajoni	Gjithsej	ne %
----	--------	----------	------	--------	----------	------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

		Plan 2020	Fakt 2020		Plan 2019	Fakt 2019	
1	Berat	142,500	121,821	85	160,100	158,820	99
2	Dibër	122,100	125,870	103	133,700	140,382	105
3	Durrës	150,500	126,216	84	179,800	172,337	96
4	Elbasan	276,500	253,216	92	331,000	315,506	95
5	Fier	362,500	305,375	84	417,000	417,147	100
6	Gjirokastrë	162,500	115,350	71	178,300	182,161	102
7	Korçë	273,500	215,586	79	318,300	308,696	97
8	Kukës	57,300	56,854	99	64,800	63,179	97
9	Lezhë	167,500	127,366	76	185,200	178,932	97
10	Shkodër	177,000	174,517	99	196,800	198,489	101
11	Tiranë	391,600	323,232	83	444,000	464,089	105
12	Vlorë	269,500	211,301	78	301,000	300,657	100
	SHUMA	2,553,000	2,156,704	84	2,910,000	2,900,395	99.6
	Te tjera	447,000	527,383	114	410,000	515,602	126
	TOTALI	3,000,000	2,684,087	89	3,320,000	3,415,997	103

Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera ishin programuar 447,000 mijë lekë dhe u realizuan 864,670 mijë lekë, ose me realizim në masën 193%, me një tejkalim prej 417,670 mijë lekë, ndërsa të ardhura “Derdhur në llogari të ISSH” janë në shumën 22,125 mijë lekë.

Realizimi i numrit të kontribuesve gjithsej dhe sipas përgjegjësi

Përsa i përket numrit të kontribuesve ky tregues analizohet i ndarë në numrin e kontribuesve në përgjegjësi të organeve tatimore, që merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe në numrin e kontribuesve në përgjegjësi të organeve të sigurimeve shoqërore, që i nxjerr vetë ISSH.

Nr	Numri i kontribuesve në përgjegjësi të DPT dhe të ISSH	Numri kontribuesve për vitin 2020	Numri kontribuesve për vitin 2019	Diferenca (në plus ose minus) e krahasimit të vitit 2020 me vitin 2019
I	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të DP. Nga keto:	642,484	660,280	-17,796
1	Buxhetore	139,555	140,568	-1,013
2	Jobuxhetore	15,690	17,403	-1,713
3	Firma	405,003	418,552	-13,549
4	Të vetëpunësuar	82,236	83,756	-1,520
II	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të ISSH. Nga keto:	52,252	69,541	-17,289
1	Te vetëpunësuar në bujqësi	46,743	61,568	-14,825
2	Te siguruar vullnetarisht	5,509	7,973	-2,464
	Gjithsej (I+II)	694,736	729,821	-35,085

Konstatohet se janë 35,085 kontribues më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, nga këto 17,796 nga subjektet në përgjegjësi të DPT dhe 17,289 kontribues nga subjektet në përgjegjësi të ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi dhe sigurimi vullnetar).

Shpenzimet sipas programeve për vitin 2020

Për vitin 2020, shpenzimet faktike krahasuar me me programimin fillestar të buxhetit janë realizuar në masën 96.8%, ose nga 139,988 milionë lekë të programuara, shpenzimet janë realizuar 134,151.6 milionë lekë, me një mosrealizim prej 5,836 milionë lekë.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, në mënyrë analitike dhe sipas programeve paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Mijë lekë

Anali za	SHPENZIMET/	Plan fillestar 2020	Shtesa/Paksime gjate vitit	Plan përfundimtar 2020	Fakt total 2020	Realizimi ne %
----------	-------------	---------------------	----------------------------	------------------------	-----------------	----------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

I	SHPENZIME PER PERFITIME	119,979,667	-2,488,799	117,490,868	113,212,126	96.36%
	Shpenzime per Semundje	548,851	-34,064	514,787	461,419	89.63%
	Shpenzime per Barrelindje	3,881,081	39,879	3,920,960	3,898,889	99.44%
	Shpenzime per Barrelindje Qytet	3,062,490	32,810	3,095,300	3,090,007	99.83%
	Shpenzime per Barrelindje Fshat	597,548	1,954	599,502	588,400	98.15%
	Shpenzime per Shperblim Lindje	221,043	5,115	226,158	220,482	97.49%
		0	0	0	0	
	SHPENZIME PER PENSIONE	115,549,735	-2,494,614	113,055,122	108,851,818	96.28%
	Shpenzime per Pensione Qytet	100,674,264	-615,638	100,058,626	96,079,496	96.02%
	Shpenzime per Pensione Fshat	14,852,085	-1,879,814	12,972,271	12,750,693	98.29%
	Per Aksidente dhe Sem. Profesionale	23,386	838	24,224	21,630	89.29%
		0	0	0	-	
	PER PROGRAMET E TJERA	10,200,839	3,502,576	13,703,415	12,597,225	91.93%
	Pensione Speciale e te Posaçme	83,912	1,196	85,108	87,143	102.39%
	Shperblime te Invalideve dhe Veteraneve	103,176	1,723	104,898	91,530	87.26%
	Shtese nga Statusi i Invalidit te Punes	88,196	-2,567	85,629	34,712	40.54%
	Kompensime	9,736,093	3,499,762	13,235,855	12,199,929	92.17%
	Pensione Sociale	189,462	2,462	191,925	183,911	95.82%
III	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	2,650,000	-195,000	2,455,000	2,231,829	90.91%
IV	SHPENZIME PER SKEMA SUPLEMENTARE	7,157,494	-38,777	7,118,716	6,110,468	85.84%
	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III+IV)	139,988,000	779,999	140,768,000	134,151,648	95.30%

Nga një analizë të përgjithshme, lidhur me zbatimin e planit të shpenzimeve dhe mos realizimin e tij, bazuar ne shpenzimet dhe transfertet faktike në buxhetet e pensionistëve, evidentojmë sa më poshtë:

- **Shpenzimet për pensione** janë realizuar në shumën 108,852 milionë lekë, dhe krahasuar me planifikimin kemi një mos realizim në vlerën 4,203 milionë lekë, për shkak të moskryerjes së të gjitha pagesave të pensioneve brenda vitit me ritmet e parashikuara të viteve të mëparshme. Kjo vjen për arsye të përfituesve që jetojnë jashtë vendit dhe vijnë t’i tërheqin pensionet në fund të vitit.
- **Shpenzimet për programe të veçanta** janë realizuar 1,106 milionë më pak se programi, për shkak të mosrealizimit të kompensimeve të ardhurave, pasi të gjitha pensionet e reja që lidhen me ligjin 104/2015 janë pa kompensime të ardhurave dhe për shkak të pensioneve të mbyllura si rezultat i vdekjeve.

Shpenzimet në skemën suplementare paraqiten me një mosrealizim prej 1,008 milion lekë, i cili vjen pas daljes së ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera e në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji” pasi aplikimi i këtij ligji ka filluar mbas muajit korrik dhe nuk është realizuar lidhja e të gjithë përfituesve brenda vitit, si dhe të mosdaljes së akteve nënligjore sipas përcaktimeve të Ligjit i cili në nenin 14 të tij parashikon “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3, të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të pikës 5, të nenit 8, të nenit 10 dhe nenit 13 të këtij ligji”.

Realizimi i shpenzimeve sipas njësive shpenzuese paraqitet në tabelën si më poshtë:

SHPENZIMET/ milionë lekë	Plan	Fakt	Ndryshimi	%
Berat	7,105.34	6,877.34	(228.00)	0.97
Diber	4,859.31	4,810.21	(50.17)	0.99
Durres	12,323.19	11,569.37	(753.82)	0.94
Elbasan	12,587.23	12,143.27	(443.96)	0.96
Fier	14,904.97	14,428.64	(476.33)	0.97
Gjirokaster	5,312.20	5,029.92	(282.28)	0.95



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Korce	12,326.99	11,674.47	(652.51)	0.95
Kukes	3,228.95	3,174.87	(54.07)	0.98
Lezhe	5,989.31	5,826.81	(162.51)	0.97
Shkoder	9,720.29	9,292.88	(427.41)	0.96
Tirane	39,494.06	37,568.41	(1,925.64)	0.95
Vlore	12,262.86	11,285.89	(976.97)	0.92
DAQ	123.16	112.45	(10.70)	0.91
Buxheti brendshëm (Administrata)	358.00	337.05	(20.95)	0.94
Buxheti i përgjithshëm	172.14	19.96	(152.18)	0.12
TOTALI ISSH	140,768.00	134,151.64	(6,617.36)	95.3

Siç evidentohet në tabelën e mësipërme shpenzimet janë mbajtur nën kontroll dhe nën limitet e programuara jo vetëm sipas programeve dhe zërave por edhe në shpërndarjen e tyre sipas njësive të administrimit.

Rezultati financiar i vitit 2020 paraqitet:

Viti 2020 është mbyllur me një rezultat fiskal pozitiv, pra tejkalim të të hyrave me shpenzimet me 7,497 milionë lekë. Gjithashtu edhe duke zbritur koston e pensioneve të patërhequra të konstatuara për vitin 2020 me vlerën 5,742 milionë lekë, rezultati i vitit mbyllet me tepriçë të të hyrave mbi shpenzimet në shumën 1,755 milionë lekë.

Krahasuar me buxhetin e programuar, me transfertat faktike për pensionistët, me shpenzimet faktike për administrimin si dhe duke marr parasysh përfitimet e vitit 2019 të konstatuara por të papaguara brenda vitit, rezultati financiar i ISSH për vitin 2020 rezulton si më poshtë:

REZULTATI FINANCIAR 2020		ne ooo leke		
Te Hyrat ne fondin e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIF	NE %
a.Te ardhurat per skemen e detyrueshme	81,040,000	82,000,134	960,134	101.2
kontributi i subjekteve juridike e fizike	78,220,000	79,388,631	1,168,631	101.5
kontributi i te vetepunesuarve ne fshat	1,923,000	1,670,626	(252,374)	86.9
kontributi nga sigurimi vullnetar	450,000	371,309	(78,691)	82.5
te ardhura te tjera	447,000	569,568	122,568	127.4
b.Te ardhurat nga kontrib. per skema suplement.	1,500,000	1,419,993	(80,007)	94.7
1.Te ardhurat e sigurimeve shoqerore (a+b)	82,540,000	83,420,127	880,127	101.1
2.Financime kontributibve te buxhetit	6,417,793	6,418,193	400	100.0
Totali i te ardhurave(1+2)	88,957,793	89,838,319	880,527	101.0
3. Financime programore dhe subvecione	51,810,207	51,810,207	-	100.0
4. Financime programore te brendeshme	-	-	-	-
Totali i te ardhurave(1+2+3)	140,768,000	141,648,527	880,527	100.6
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	140,768,000	139,893,509	(874,491)	99.4
skema e detyrueshme	117,490,868	113,212,126	(4,278,742)	96.4
programet e vecanta te shtetit	13,703,415	12,597,225	(1,106,190)	91.9
skemat suplementare	7,118,716	6,110,468	(1,008,248)	85.8
shpenzime administrative	2,455,000	2,231,829	(223,171)	90.9
shtesa e gjendjes se pensioneve te pa terhequra		5,741,861		
Rezultati financiar	0	1,755,018		

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Rezultati financiar sipas pagesave të kryera

Bazuar në metodologjinë e raportimit sipas Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" krahas bilancit të hartuar sipas të drejtave të konstatuara, shpenzimet vjetore raportohen bazuar në pagesat faktike të kryera.

Për vitin 2020 raporti i zbatimit të buxhetit sipas pagesave faktike paraqitet në tabelën në vijim:

REZULTATI FISKAL 2020		ne ooo leke		
Te Hyrat ne fondin e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
a.Te ardhurat per skemen e detyrueshme	81,040,000	82,000,134	960,134	101.2
kontributi i subjekteve juridike e fizike	78,220,000	79,388,631	1,168,631	101.5
kontributi i te vetepunesuarve ne fshat	1,923,000	1,670,626	(252,374)	86.9
kontributi nga sigurimi vullnetar	450,000	371,309	(78,691)	82.5



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

te ardhura te tjera	447,000	569,568	122,568	127.4
b.Te ardhurat nga kontrib. per skema suplement.	1,500,000	1,419,993	(80,007)	94.7
1.Te ardhurat e sigurimeve shoqerore (a+b)	82,540,000	83,420,127	880,127	101.1
2.Financime kontributive te buxhetit	6,417,793	6,418,193	400	100.0
Totali i te ardhurave(1+2)	88,957,793	89,838,319	880,527	101.0
3. Financime programore dhe subvecione	51,810,207	51,810,207	-	100.0
4. Financime programore te brendeshme	-	-	-	-
Totali i te ardhurave(1+2+3)	140,768,000	141,648,527	880,527	100.6
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	PLAN	FAKT	DIFERENCA	NE %
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqerore	140,768,000	134,151,648	(6,616,352)	95.3
skema e detyrueshme	117,490,868	113,212,126	(4,278,742)	96.4
programet e vecanta te shtetit	13,703,415	12,597,225	(1,106,190)	91.9
skemat suplementare	7,118,716	6,110,468	(1,008,248)	85.8
shpenzime administrative	2,455,000	2,231,829	(223,171)	90.9
Rezultati financiar	0	7,496,879		

Fondi rezervë

Mbajtja e një fondi rezervë të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar me ligjin 104/2014, datë 31.07.2014, “Për Sigurimet Shoqërore ne Republikën e Shqipërisë”. Në vitin 2020 sipas vendimit të Këshillit Administrativ nr. 7 datë 27.11.2020 është bërë sistemimi rezultetit financiar të vitit 2019 duke e shtuar fondin rezervë me 360,200,895 lekë dhe në këto kushte fondi rezervë në fund të vitit 2020 ka arritur në vlerën 10,167,579,850 lekë, i cili shërben për mbulimin e pagesave të përfitimeve për një muaj.

Ecuria e treguesve të skemës së sigurimeve shoqërore për vitin 2019-2020 dhe trendi në 5 vitet e fundit

Skemës së pensioneve i adresohet pjesa më e madhe e fondeve të akumuluar. Për këtë skemë norma e kontributit është 21.6 % e pagës. Pensioni fillestar mujor i pleqërisë llogaritet në bazë të një formule ligjërish të përcaktuar dhe më pas ai është objekt vetëm i indeksimit, indeksi i të cilit miratohet e zbatohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas formulës, pensioni i plotë mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë ‘BAZË’ dhe një ‘SHTESË’. Shuma bazë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe merret e plotë kur personi ka një periudhë të plotë sigurimi sipas përcaktimeve në nenin 92 të ligjit. Shtesa mbi pensionin bazë është individuale, varet nga madhësia e kontributeve të paguara dhe zgjatja e periudhës kontributive dhe është 1 përqind për çdo vit sigurimi shumëzuar me pagën mesatare mujore mbi të cilën janë paguar kontributet gjatë gjithë periudhës kontributive. KM miraton çdo vit koeficientin e indeksimit të bazës së vlerësueshme duke përdorur shkallën e rritjes së kontributeve mesatare individuale të vitit përkatës me atë të vitit paraardhës.

➤ Disa tregues kryesorë të sistemit të sigurimeve shoqërore në vite.

a. Të ardhurat e drejtpërdrejta në vite:

Mijë lekë

Te Hyrat ne fondin e Sigurimeve Shoqerore	2016	2017	2018	2019	2020
a.Te ardhurat per skemen e detyrueshme	65,173,125	72,236,295	77,971,413	82,746,822	82,000,134
kontributi i ndermarrjeve buxhetore	23,137,836	26,340,293	27,392,951	28,796,868	29,060,879
kontributi i ndermarrjeve jobuxhetore	3,678,203	4,171,906	4,136,291	4,252,801	3,753,921
kontributi i firmave	29,723,146	33,813,527	39,549,951	42,626,673	43,130,966
kontributi i te vetepunesuarve ne qytet	5,985,878	5,107,316	3,671,509	3,421,515	3,064,475
kontributi i te vetepunesuarve ne fshat	1,918,522	2,110,883	2,123,102	2,213,047	1,670,626
kontributi nga sigurimi vullnetar	417,540	482,921	494,922	537,216	371,309
te ardhura te tjera	312,000	209,450	602,687	898,703	947,958
b.Te ardhurat nga kontrib. per skema suplement.	1,210,270	1,319,507	1,369,637	1,451,433	1,419,993
1.Te ardhurat e sigurimeve shoqerore (a+b)	66,383,395	73,555,802	79,341,051	84,198,255	83,420,127
2.Financime kontributive te buxhetit	5,021,902	4,679,688	4,903,289	6,143,059	6,418,193
Totali i te ardhurave(1+2)	71,405,298	78,235,490	84,244,340	90,341,314	89,838,319
3. Financime programore dhe subvecione	43,956,098	44,025,312	43,895,311	40,725,341	51,810,207
Totali i te ardhurave(1+2+3)	115,361,395	122,260,802	128,139,651	131,066,655	141,648,527



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se të ardhurat nga kontributet në harkun e kohor të viteve 2016-2019 kanë ardhur me rritje. Në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, konstatohet një ulje prej 746,688 mijë lekë.

Rritja e të ardhurave nga viti në vit, kryesisht është pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve, për shkak të zgjerimit të punësimit dhe reduktimit të evazionit. Numri i kontribuesve në vite dhe në persona pasqyrohet si më poshtë:

Emertimi/vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i kontribuesve	718.1	718.3	764	778	781	747.9
rritja nga viti ne vit						
ne vlere		0.2	45.7	14	3	-33.1
ne perqindje		0	6.4	1.8	0.4	-4.2

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH

Në harkun e 5 viteve numri i kontribuesve ka pësuar rritje dhe kjo vjen e gjitha nga sektori privat.

b. Shpenzimet për përfitime dhe administrimi:

Shpenzimet e Sigurimeve Shoqërore	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzimet e Sigurimeve Shoqërore	114,275,693	119,081,263	125,364,416	131,238,197	134,151,648
skema e detyrueshme	93,456,811	100,174,476	105,412,993	112,026,789	113,212,126
programet e vecanta te shtetit	13,686,652	11,829,155	13,097,470	11,723,184	12,597,225
skemat suplementare	4,973,111	4,933,122	4,730,472	5,194,619	6,110,468
shpenzime administrative	2,159,118	2,144,510	2,123,481	2,293,605	2,231,829
Rezultati fiskal	1,085,703	3,179,539	2,775,234	-171,542	7,496,879

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Reforma e pensioneve ndër të tjera, në mënyrë të veçantë përcaktoi, abrogimin e skemave të rritjes së diferencuar të pensioneve, të zbatuara përpara vitit 2013. Në nenin 61 të riformuar të ligjit nr. 7703, datë 01.05.1993, i ndryshuar përcaktohet; *“Pensionet sociale, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit”*.

Bazuar në këtë përcaktim, nga viti 2016 e në vazhdim pensionet janë indeksuar bazuar në rritjen vjetore të indeksit të çmimeve, të shportës së mallrave dhe shërbimeve të pensionistëve. Indeksi ka reflektuar rritje të shpenzimeve për përfitime nga skema e detyrueshme dhe suplementare për çdo vit.

Nderkohë, për shkak të zgjerimit të skemës së kompensimit të çmimit të energjisë elektrike dhe shpërblyerimit të fund vitit për pensionistët, rritje kanë pësuar edhe përfitimet nga programe të tjera.

Krahas indeksimit faktor i rëndësishëm në rritjen e shpenzimeve është dhe rritja e numrit të përfituesve. Në tabelën e mëposhtme evidentohen të dhëna për rritjen e numrit të pensioneve të pleqërisë në vite:

Emertimi/vitet	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i pensioneve te pleqerise	488	498.1	512.5	529.1	544.2
rritja nga viti ne vit					
ne vlere		10.1	14.4	16.6	15.1
ne perqindje		2.1	2.9	3.2	2.9%

Burimi: Drejtoria e Përitimeve në ISSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Si pasojë e vendosjes së skemës së shpërblimeve dhe zbatimit të saj për çdo vit, bazuar në mundësitë financiare dhe hapësirat financuese të buxhetit të shtetit, si dhe zgjerimit të skemave kompensuese, në total në vitin 2019, financimet e buxhetit, krahasuar me vitet e mëparshme, përjashtuar vitin 2017, rezultojnë me ulje.

Në pasqyrën mëposhtme janë evidentuar financimet nga buxheti i shtetit në vite:

Mijë lekë

	2016	2017	2018	2019	2020
Kontribute sipas degeve	65,173,125	72,236,295	77,971,413	82,746,822	82,000,134
semundje	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582
barrelindje	3,711,948	4,115,124	4,414,384	4,720,100	4,649,604
qytet	3,595,168	3,986,636	4,285,151	4,580,742	4,547,914
fshat	116,780	128,489	129,232	139,357	101,690
pensione	57,999,594	64,182,861	69,205,242	73,361,611	72,677,623
qytet	56,197,852	62,200,467	67,211,373	71,211,526	71,108,687
fshat	1,801,742	1,982,394	1,993,870	2,150,085	1,568,936
aksidente	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582
papunesi	2,076,950	2,362,986	2,611,072	2,791,193	2,803,745
Kontribute nga buxheti	3,712,221	3,236,755	3,326,156	4,163,059	4,734,193
barrelindje	20,553	27,742	28,651	1,026	0
pensione	3,691,667	3,209,012	3,297,505	4,162,034	4,734,193
Kontribute të buxhetit për bujkun	1,309,682	1,442,933	1,577,133	1,980,000	1,684,000
barrelindje	79,720	87,831	95,999	120,522	102,504
pensione	1,229,962	1,355,102	1,481,133	1,859,478	1,581,496
	70,195,027	76,915,983	82,874,702	88,889,882	88,418,327

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Financimet e buxhetit të shtetit, për skemat dhe për të financuar deficitin bruto të sigurimeve shoqërore, kanë mbetur pothuajse të stopuara përgjatë periudhës 2016-2018, ndërkohë për vitin 2018-2019 konstatohet një rritje, paraqitur sipas viteve në tabelën e mësipërme.

Mbi deficitin e skemës së sigurimit për periudhën 2016-2020

Kontributet për skemën e detyrueshme, në vite:

Skema e fshatit

Mijë lekë

Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020
Kontribute për fshatin	3,228,203	3,553,816	3,700,235	4,269,442	3,354,626
Barrelindje fshat	196,499	216,319	225,232	259,879	204,195
Pensione fshat	3,031,704	3,337,497	3,475,003	4,009,563	3,150,432

Sa më lart evidentohet se peshën më të madhe në kontribute e zë dega e pensione, kundrejt degës për barrëлиндjet.

Mijë lekë

Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzime për fshatin	14,821,363	14,924,908	14,230,157	14,065,531	13,676,870
Barrelindje fshat	625,125	644,690	930,692	682,629	710,461
Pensione fshat	14,196,237	14,280,218	13,299,465	13,382,902	12,966,410

Sa më lart evidentohet se peshën më të madhe në shpenzime e zë dega e pensione, kundrejt degës për barrëлиндjet.

Mijë lekë

Bilanci i fshatit	2016	2017	2018	2019	2020
Barrelindje fshat	-428,626	-428,371	-705,461	-422,750	-506,266
Pensione fshat	-11,164,533	-10,942,721	-9,824,462	-9,373,339	-9,815,978
shuma	-11,593,159	-11,371,092	-10,529,922	-9,796,089	-10,322,244

Deficiti si % ndaj PBB	-0.79	-0.73	-0.64	-0.58	-0.66
-------------------------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------

Skema e qytetit

Mijë lekë

Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020
----------	------	------	------	------	------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

I. Kontribute te personave juridike dhe fizike	63,254,603	70,125,413	75,848,311	80,457,380	80,329,508
II. Kontribute me destinacion nga buxhetit i shtetit	3,712,221	3,236,755	3,326,156	4,163,059	4,734,193
Gjithsej	66,966,824	73,362,167	79,174,468	84,620,440	85,063,701

Mijë lekë

Kontributet skema e qytetit	2016	2017	2018	2019	2020
Kontribute sipas degeve	66,966,824	73,362,167	79,174,468	84,620,440	85,063,701
semundje	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582
barrelindje qytet	3,615,722	4,014,378	4,313,803	4,581,768	4,547,914
pensione qytet	59,889,519	65,409,479	70,508,878	75,373,560	75,842,879
aksidente	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582
papunesi	2,076,950	2,362,986	2,611,072	2,791,193	2,803,745

Mijë lekë

Shpenzime	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzime sipas degeve	80,438,063	87,086,673	92,999,136	99,953,938	101,450,587
semundje	343,928	377,983	454,198	530,721	469,226
barrelindje qytet	2,002,014	2,428,979	2,511,856	2,985,538	3,254,390
pensione qytet	78,079,175	84,265,826	90,008,555	96,416,369	97,704,975
aksidente	12,947	13,884	24,526	21,310	21,996

Mijë lekë

Transferimet kontributi, drej deges se pensioneve NENI 8	2016	2017	2018	2019	2020
semundje	120,543	142,414	188,818	132,545	132,209
barrelindje	649,318	789,287	891,660	1,195,500	1,186,666
aksidente në punë dhe sëm. profesionale	2,453	3,310	5,667	4,409	4,398
TOTALI	772,313	935,011	1,086,145	1,332,454	1,323,273

Mijë lekë

Te ardhurat pas transferimit 1	2016	2017	2018	2019	2020
Kontribute sipas degeve	66,966,824	73,362,167	79,174,468	84,620,440	85,063,701
semundje	571,774	645,248	681,539	804,414	802,373
barrelindje qytet	2,966,404	3,225,091	3,422,143	3,386,268	3,361,247
pensione qytet	60,661,833	66,344,491	71,595,023	76,706,014	77,166,152
aksidente	689,864	784,352	864,690	932,550	930,183
papunesi	2,076,950	2,362,986	2,611,072	2,791,193	2,803,745

Mijë lekë

Teprica qe transferohen ne degen e pensioneve NENI 68	2016	2017	2018	2019	2020
semundje	227,846	267,264	227,341	273,693	333,147
barrelindje	964,390	796,111	910,287	400,730	106,857
aksidente në punë dhe sëm. profesionale	676,917	770,468	840,164	911,240	908,188
TOTALI	1,869,153	1,833,844	1,977,792	1,585,664	1,348,192

Mijë lekë

Te ardhurat sipas degeve pas transferimit 2	2016	2017	2018	2019	2020
Kontribute sipas degeve	64,889,874	70,999,181	76,563,395	81,829,247	82,259,956
semundje	343,928	377,983	454,198	530,721	469,226
barrelindje qytet	2,002,014	2,428,979	2,511,856	2,985,538	3,254,390
pensione qytet	62,530,986	68,178,334	73,572,815	78,291,678	78,514,345
aksidente	12,947	13,884	24,526	21,310	21,996

Mijë lekë

Rezultati financiar sipas degeve	-16,915,913	-15,548,189	-16,087,492	-16,435,740	-18,124,691	-19,190,631	-1,065,940
semundje	0	0	0	0	0	0	0
barrelindje	0	0	0	0	0	0	0
pensione qytet	-16,915,913	-15,548,189	-16,087,492	-16,435,740	-18,124,691	-19,190,631	-1,065,940
aksidente	0	0	0	0	0	0	0
Deficiti / GDP	-1.18	-1.06	-1.03	-1.00	-1.08	1.22	0.14

Mijë lekë

Vitet/deget	2016	2017	2018	2019	2020
Deficiti ne mije leke	-27,141,348	-27,458,584	-26,965,663	-27,920,780	-29,512,875



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

PBB nga Min Fin/ Vendimi 7, date 13.01.2021/	1,472,800,000	1,555,200,000	1,650,000,000	1,678,400,000	1,572,500,000
	-1.84	-1.77	-1.63	-1.66	-1.88

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH/Ministria e Financave

Nga tabelat e mësipërme konstatohet një rënie graduale e deficitit ndaj PBB, për vitet 2016-2019 që ishte dhe një nga detyrimet e reformës së pensioneve në vitin 2014, pra stopimi i deficitit dhe ulja graduale e tij ndaj PBB. Ndërkohë një rritje konstatohet nga viti 2018 në vitin 2019 dhe nga viti 2019 në vitin 2020.

Për sa më sipër është lënë akt-konstatimi Nr.1 datë 27.04.2021.

Titulli i gjetjes:	Mbi programimin e buxhetit të sigurimeve shoqërore.
Situata :	Nga auditimi i programimit të buxhetit të ISSH për vitin 2019-2020, i cili realizohet në 15 njësité e sistemit, u konstatua se: -Programi i përgjithshëm i të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve me përgjegjësi mbledhje nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat. Pjesëmarrja e ISSH në këtë proces është vetëm në Ekipin e Menaxhimit të Programit, ngritur në MFE, ku përfaqësues të saj janë anëtar. Funksioni i anëtarëve të EMP-s konsiston kryesisht në realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore. -Në procesin e programimit të shpenzimeve nuk janë përfshirë të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit. Për sa më sipër ISSH ka një ndikim të ulët në mbledhjen e të ardhurave, sidomos për subjektet që nuk paguajnë kontribute dhe në rakordimin e të dhënave të tyre me listë pagesat e dërguara nga DPT, problematikë që ndikon në jo vetëm në identifikimin e subjekteve debitorë të kontributeve por dhe në monitorimin e plotë të procesit.
Kriteret:	-Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; -Ligji nr.7703, datë 01.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; -Në udhëzimet e Ministrisë së Financave: nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat standarte të përgatitjes së PBA”; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; UMF nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; -Ligji nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;
Ndikimi:	Ndikimi i ulët i ISSH në mbledhjen e të ardhurave sjell riskun e mos-identifikimit të subjekteve debitorë të kontributeve. Nuk ofron një monitorim të plotë të procesit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa që:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	a. Strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vjetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të mundësojnë përfshirjen e ISSH në të gjitha fazat e programimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e këtyre të ardhurave, në mënyrë që ato mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen referuar një analize të drejtë dhe përfshirjen e të gjithë faktorëve ndikues. b. Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke pasur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të bazës së të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.
--	--

III.2.B/2. Mbi nivelin e të ardhurave të realizuar referuar skemës së fshatit dhe problematikat e konstatuara. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në këtë drejtim, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi.

Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nr.99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;

Ligji nr.7703, datë 01.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

Rregullorja financiare e ISSH nr. 5, datë 25.09.2009;

Udhëzimet Standarde të Ministrisë së Financave për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit;

❖ Mbi nivelin e të ardhurave të realizuar, referuar skemës së fshatit dhe problematikat e konstatuara.

Programimi i të ardhurave mbështetur sipas ligjit nr.99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019 dhe ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020 nga siguri i personave të vetëpunësuar në bujqësi, përgjithësisht është mbështetur në faktorët:

- Bilanci i popullsisë aktive në fshat si dhe zhvillimet, rezultatet e viteve të mëparshme dhe kryesisht të vitit paraardhës, duke përfshirë dhe objektivat përkatëse për rritjen e të ardhurave kontributive.

Bilanci i popullsisë aktive në bujqësi hartohet për çdo vit dhe 6-mujor, me qëllim që të pasqyrohen realisht lëvizjet demokratike të zonave rurale brënda vendit dhe jashtë vendit, ku dhe përcaktohet numri i personave që ushtrojnë aktivitet ekonomik në bujqësi. Më konkretisht, bilanci i popullsisë agrare për vitin 2020 është rreth 93 000 persona, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 91,123 persona, ndërkohë që bilanci i vitit 2018 ka qenë 100,736 persona.

Me vendim të Këshillit Administrativ në Korrik të vitit 2020, nisur nga deficit i lartë i skemës së sigurimeve shoqërore në fshat, është hartuar një dokument pune për rishikimin e kësaj skeme, ku ndër të tjera është studiuar bilanci i popullsisë agrare dhe kontribuesit e ardhshëm:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Duke pasur të dhënat nga tre burime; a) popullsia aktive dhe forca pune në fshat (referuar INSTAT-it), Anketa e tregut të punës (INSTAT-ndërmarrjet), Anketa e tregut të punës (INSTAT) dhe b) Bilanci i Popullsisë Agrare (ISSH) si dhe disa konkluzione të strategjisë sektoriale të bujqësisë na rezultojnë këto të dhëna lidhur me numrin e fermerëve që mund dhe duhet të paguajnë kontribute:

a. Bilanci i kontribuesve bujqësor, bazuar në numrin e popullsisë aktive dhe forcave të punës në fshat.

1. Popullsia aktive dhe forca pune sipas INSTAT 461,100 persona,
2. Ferma bujqësore, sipas shpërndarjes së tokës 362,000,
3. Rreth 98 % e fermave, pavarësisht nga sipërfaqja, kanë vetëm një person,
4. Rreth 27 % e fermave janë shumë të vogla dhe në pjesën veri - lindore malore,
5. Rreth 12.3 % e banorëve në moshë pune në zonën rurale janë të përjashtuar nga derdhja e kontributit dhe përfitojnë asistencë ekonomike,
6. Rreth 12 % e popullsisë rurale në moshë pune punon dhe ushtron aktivitet në sektorë të tjerë,
7. Edhe në zonat fushore konstatohen një numër i caktuar fermash me pak tokë, për shkak të copëzimit të saj dhe trungjeve familjare apo edhe të zënies me ndërtime.

Gjithsesi, referuar 6 faktorëve të mësipërm (përjashtojnë nga kontributi rreth 302 mijë persona), pa konsideruar faktorët emigracion sezonal si dhe fermat shumë të vogla bujqësore të zonës fushore, **numri i forcave të punës në fshat përlogaritët të jetë rreth 159 mijë.²**

b. Bilanci i kontribuesve bujqësor, sipas anketës së forcave të punës dhe të dhënave për ndërmarrjet

1. Subjekte bujqësore aktive gjithsej	45,705
2. Me 1-4 persona	45,543
3. Me 5-9 persona	85
4. Mbi 10 persona	77
5. Numri i të punësuarve dhe vetëpunësuarve	94,200

c. Bilanci i kontribuesve bujqësor sipas “Bilancit të popullsisë Agrare 2020 rreth 91 000 persona nga të cilët rreth 25 % janë në zonat malore-kodrinore dhe 75 % në zonat fushore kodrinore.

Bazuar në strukturën aktuale të prodhimit bujqësor, numrin e fermave, madhësinë e tyre dhe faktorë të tjerë të analizuar, mund të arrijmë në konkluzionin se numri mesatar i kontribuesve bujqësor në rastin më të mirë mund të arrijë në rreth 160 000 persona, ndërsa normalisht si bazë mbetet statistika e ndërmarrjeve dhe subjekteve të regjistruara, e cila përafërsisht është e barabartë me bilancin e popullsisë Agrare, ose rreth 93 000 persona.

- Faktor kryesor në programimin e të ardhurave nga të vetpunësuarit në bujqësi është dhe realizimi i numrit faktik të personave fizik. Kështu, numri i personave fizik të realizuar për vitin për vitin 2020 është 31,879 persona, ose 7679 persona me pak se në vitin 2019, për vitin 2019 është 39,636 persona, me një rritje të lehtë prej 927 kontribues, krahasuar me vitin 2018, ku numri i kontribuesve ishte 38,709 persona.

Të dhënat e bilancit si dhe realizimi i numrit të personave fizik të vitit të mëparshëm shërbejnë për të përcaktuar numrin e kontribuesve për vitin pasardhës.

- Element tjetër i rëndësishëm është dhe masa e kontributit mujor/tremujor dhe vjetor mbi të cilën fermerët derdhin kontributet përkatëse.

² *Përlogaritjet e mësipërme bazohen në të dhënat e instat dhe në disa përjashtime të përlogaritura në mënyrë “eksperte” në vartësi të disa faktorëve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

• Realizimi i të ardhurave vjetore nga të vetpunësuarit në bujqësi është një element tjetër mbi të cilin janë programuar të ardhurat për vitin pasardhës, duke respektuar edhe kuotat e rritjes së të ardhurave të dërguara nga Ministria e Financave.

Pas përcaktimit të të ardhurave kontributive të vitit pasardhës, duke patur dhe kuotën vjetore të derdhjes së kontributeve për të vetpunësuarit në bujqësi, të ndara në kuotat përkatëse sipas zonave fushore dhe zonave malore, përcaktohet dhe numri i kontribuesve për vitin pasardhës.

Kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi për vitin 2019 dhe 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Kontribute te skemes se fshatit	3,951,200	4,193,047	3,846,000	3,354,626
2	Kontribute te personave te vetpunesuar ne bujqesi	2,090,000	2,213,047	1,923,000	1,670,626
3	Diference kontributi fermeret	1,861,200	1,980,000	1,923,000	1,684,000

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Sa më sipër konstatohet se të ardhurat e drejtpërdrejta nga të vetpunësuarit në bujqësi zënë 50 % e të ardhurave kontributive të skemës së fshatit, ndërsa diferenca tjetër është kontributi i buxhetit të shtetit për skemat sociale. Kontributet e mbledhura sipas degëve paraqiten:

Në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
SKEMA FSHAT	3,951,200	4,269,442	3,846,000	3,354,626
per barre lindje	240,507	259,879	234,104	204,195
per pensione	3,170,692	4,009,563	3,611,986	3,150,432

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Sa më lart evidentohet, se peshën më të madhe në kontribute e zë dega e pensione, kundrejt degës për barrë lindjet që zë vetëm 6% të të ardhurave të skemës.

❖ Shpenzimet e skemës së fshatit

Në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
SKEMA FSHAT	14,266,484	14,065,531	13,683,852	13,676,769
per barre lindje	748,984	682,629	712,581	710,455
per pensione	13,517,500	13,382,902	12,972,271	12,966,314

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Shpenzimet për pensionet e fshatit për vitin 2020 janë në shumën **13,676,769** mijë lekë, ndërsa për vitin 2019 janë në shumën 14,065,531 mijë lekë. Pra kemi një ulje të shpenzimeve për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 në vlerën prej 388,762 mijë lekë. **Për vitin 2020** pension pleqërie, pension invadiliteti apo pensione familjare si dhe shpenzime për barrë lindjet kanë përfituar 115,443 persona dhe **për vitin 2019** kanë përfituar 121,208 persona. Konstatohet se shpenzimet e skemës së fshatit sipas programeve, krahasuar me të ardhurat e mbledhura janë mbuluar kryesisht nga buxheti i shtetit, ku diferencën më të madhe e ka dega e barrë lindjeve, në të cilën të ardhurat për vitin 2020 mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndërsa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj degë, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë.

❖ Deficiti i financiar i skemës së pensioneve të fshatit:

Mos mbledhja e të ardhurave nga të vetpunësuarit në bujqësi ka thelluar ndjeshëm deficitin e degës së pensioneve të fshatit të krahasuar me vitet e mëparshme. Sistemi i sigurimeve të detyrueshme në Shqipëri, që nga viti 1967 e në vazhdim, ka trajtuar të ndara dy skema, skemën e pensioneve shtetërore dhe skemën e pensioneve për fshatin. Kjo ndarje bëhet për shkak të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

periudhës kontributeve për fshatin e cila lidhet me ish kooperativat bujqësore si dhe me formulën e llogaritjes së përfitimit të pensioneve. Me skemën e re, sipas ndryshimeve të bëra në ligjin bazë të sigurimeve shoqërore, me ligjit 104/2014, datë 31.07.2014 llogaritja e pensionit është unifikuar, por ende në skemën e pensioneve të fshatit janë shumë përfitues (pensionistë të cilët kanë periudha kontributeve në kooperativa, para vitit 1990.

Bazuar në VKM nr. 77, datë 28.01.2015, me ndryshime, të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributeve vjetore, e cila për zonat fushore është 38,400 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 29,400 lekë në vit, kjo masë kontributi nuk është rritur për disa vite, e kjo për arsye të interesit shumë të ulët të bujqëve për të paguar kontribute, ndërkohë që një i vetëpunësuar në qytet paguan aktualisht 66,240 lekë në vit kontribut. Për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e paguan buxheti i shtetit dhe për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë.

Të ardhurat e skemës së fshatit për vitin **2019** janë realizuar në shumën 4,269,442 mijë lekë, shpenzimet e skemës janë 14,065,531 mijë lekë, pra më një deficit prej 9,796,089 mijë lekë, i cili mbulohet nga buxheti i shtetit.

Të ardhurat e skemës së fshatit për vitin 2020 janë realizuar në shumën **3,354,626** mijë lekë, shpenzimet e skemës janë **13,676,769** mijë lekë, pra më një deficit prej **-10,322,142** mijë lekë, i cili mbulohet nga buxheti i shtetit.

Rezultati i Skemës së fshatit sipas degëve dhe programeve për vitin 2019 dhe 2020:

Në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
SKEMA FSHAT	-10,315,284	-9,796,089	-9,838,772	-10,322,142
per barrelindje	-508,476	-422,750	-478,477	-506,261
per pensione	-9,806,808	-9,373,339	-9,360,295	-9,815,882

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Nga të dhënat e mësipërme konstatojmë se, në **vitin 2019**, edhe pse deficiti i skemës së fshatit është më i ulët në krahasim me programimin, përsëri sikurse në disa vite deficiti i kësaj skeme zë pjesën më të madhe të deficitit të skemës në tërësi, ose zë 35% të totalit prej 27,920,780 mijë lekë, ose 0.58% të PBB. Në **vitin 2020** krahasuar me planin, deficiti në fakt është rritur me 493,370 mije lekë dhe po kështu është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2019, në shumën +525,423 milion lekë. Të njëjtin trend përkeqësimi ka ndjekur edhe deficiti i përgjithshëm i skemës së fshatit, i cili ka arritur ne 0.66% te PBB dhe me një rritje prej 12,5% ndaj një viti me parë.

Burimi te dhenave : Drejtoria e Financës në ISSH si dhe VKM nr 7, date 13.1.2021 “ Për miratimin e kuadrit ekonomik-fiskal 2022-2024.

❖ Debitorët e vetëpunësuar në bujqësi.

Në zbatim të pikës 4, të kreut V, të VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe të shkresës së ISSH nr. 3838, datë 04.05.2015 “Për Evidentimin e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave, për personat e vetëpunësuar në bujqësi”, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë evidentuar, për çdo tremujor, numrin dhe detyrimet e debitorëve, të vetëpunësuar në bujqësi për vitin 2019.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucioni, në tabelën e mëposhtme paraqiten debitorët e vetëpunësuar në bujqësi dhe detyrimet e papaguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Debitorë (në numër)	Detyrime kontributive	Kamatëvonesa	Detyrimi gjithsej
-----	----------	------------------------	--------------------------	--------------	----------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

1	Gjendja në fillim të vitit 2019	17,557	1,424,791	14,391	1,439,182
2	Shtuar gjatë vitit	2,160	720,822	6,310	727,132
3	Pakësuar gjatë vitit	1,606	437,830	4,830	442,660
4	Gjendja në fund të vitit 2019	18,111	1,707,783	15,871	1,723,654

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH

Për vitin 2019 numri fizik i debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ka rezultuar 18,111 persona gjithsej. Në krahasim me gjendjen e tyre në fillim të këtij viti, ku numri fizik i debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ishte 17,557 persona, **kemi një rritje të tyre prej 554 persona.**

Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, debitorë në organet e sigurimeve shoqërore, shuma e detyrimeve të prapambetur në fund të vitit 2019 ka rezultuar 1,723,654 mijë lekë, nga të cilat 1,707,783 mijë lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe 15,871 mijë lekë kamatëvonesat.

Siç shihet ka një rritje të detyrimeve të prapambetura prej 284,472 mijë lekë gjithsej, nga të cilat 282,992 mijë lekë detyrime kontributive dhe 1,480 mijë lekë kamatëvonesa. Rritja është rrjedhojë e numrit të madh aktual të të vetëpunësuarve, llogaritjes së detyrimeve të tyre të prapambetura që nga viti 2016 dhe kalimit të kohës, nga momenti që duhej të paguheshin këto.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucioni, në tabelën e mëposhtme paraqiten debitorët e vetëpunësuar në bujqësi dhe detyrimet e papaguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Debitorë (në numër)	Detyrime kontributive	Kamatëvonesa	Detyrimi gjithsej
1	Gjendja në fillim të vitit 2020	18,507	1,707,782	15,870	1,723,652
2	Shtuar gjatë vitit	9,306	615,411	6,074	621,486
3	Pakësuar gjatë vitit	15,178	1,847,571	17,889	1,865,460
4	Gjendja në fund të vitit 2020	12,635	475,623	4,055	479,678

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH

Për vitin 2020 numri fizik i debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ka rezultuar 12,635 persona gjithsej. Në krahasim me gjendjen e tyre në fillim të këtij viti, ku numri fizik i debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ishte 18,507 persona, **kemi një ulje të tyre prej 5,872 persona.**

Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, debitorë në organet e sigurimeve shoqërore, shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020 ka rezultuar 479,678 mijë lekë, nga të cilat 475,623 mijë lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe 4,055 mijë lekë kamatëvonesat.

Siç shihet ka një ulje të nivelit të detyrimeve të prapambetura prej 1,243,974 mijë lekë gjithsej, nga të cilat 1,232,159 mijë lekë detyrime kontributive dhe 11,815 mijë lekë kamatëvonesa. Pakësimi i detyrimeve të debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ka ardhur si pasojë i arketimeve të kryera si rezultat i pagesave të kryera nga debitorët e vetëpunësuar në bujqësi.

Evidentimi i detyrimeve të vetëpunësuarve në bujqësi për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave ka filluar në 04.05.2015 sipas shkresës nr. 3838 prot datë 04.05.2015 të ish Titullares së institucionit drejtuar 12 DRSSSH-ve.

Detyrimet e debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi janë pasqyruar në kontabilitet në vitin 2017 sipas të dhënave të pasqyrave financiare për 12 DRSSH të vitit 2018 dhe sipas sistemit informatik të CMIS (ku të dhënat janë nga viti 2014 e në vazhdim).

❖ **Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së fshatit, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.**

Nga të dhënat e administruara nga I.S.SH rezulton se skema e pensionit për personat që kanë punuar në bujqësi e ka zanafillën në vitin 1972, kohë në të cilën u përfshinë në skemën e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përfitimit edhe anëtarët e kooperativave bujqësore. Kriteret e caktimit dhe masa e përfitimit të pensioneve kanë qenë të ndryshme krahasuar me pensionet e punonjësve të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore.

Me ndryshimin e sistemit në vitin 1993 hyri në fuqi ligji i ri i sigurimeve shoqërore, i cili ka njohur të gjitha të drejtat e fituara nën skemën e vjetër, si për pensionet dhe periudhat e sigurimit apo të vjetërsisë në punë që ishin realizuar gjatë periudhës së mëparshme. Edhe ky ligj i ka trajtuar të ndara të dy skemat, një skemë urbane dhe një skemë rurale, duke ofruar masa të ndryshme pensioni, ku pensioni i fshatit ishte rreth $\frac{1}{2}$ e pensionit urban. Në atë ligj ishte parashikuar, që periudha e sigurimit të realizuar pas vitit 1994 si i vetëpunësuar në bujqësi(bujk) merrej në konsideratë si periudhë e realizuar në sektorin urban dhe llogaritej si e tillë. Pra, personat që kontribuonin në skemë pas vitit 1994 përfitonin një pension më të mirë se ata që nuk vazhdonin sigurimin. Nëse gjysma e periudhës së sigurimit apo vjetërsisë në punë ishte në sektorin urban ose i suguruar pas vitit 1994 si vetëpunësuar në bujqësi, atëherë automatikisht përfitohej pension minimal urban, gjë që krijonte diferencime me ata që kishin një ndryshim dhe me një muaj të siguruar më pak.

Me reformën e vitit 2014 u eliminuan këto defekte dhe u vendos, që të përdoreshin të njëjtat kriteret dhe formulë llogaritje, si për ata që siguroheshin në sektorin urban, ashtu edhe për të vetëpunësuarit në bujqësi. Për këtë u përcaktua një pagë referuese për vitet e punës në ish kooperativat bujqësore dhe çdo viti iu dha rëndësia e vetë në masën e pensionit, duke eliminuar privilegjet për disa persona dhe kategori. Kjo u vendos në kuadër të parimit themelor që masa e pensionit është e lidhur drejtpërdrejt me kontributet e paguara. Aktualisht pensionet llogariten sipas së njëjtës formulë dhe për çdo vit sigurimi, ku pas viteve 1994 ka një pagë reali mbi të cilën janë paguar kontributet ose pagë referuese për vjetërsinë në punë para kësaj periudhe, duke marrë në konsideratë profesionin, shkollimin etj.

Në reformën e vitit 2014, për periudhën 2014-2020 janë përcaktuar këto objektiva:

Objektivi 1; Masa e kontributit të të vetëpunësuarve në bujqësi do të rritej çdo vit derisa në vitin 2019 të barazohet me kontributin e paguar nga i vetëpunësuari në zonën urbane, e kjo për faktin se një pjesë e konsiderueshme e kontributit të bujqëve subvencionohet nga buxheti i shtetit, i cili arrin në 60-70% të masës së kontributit, duke u bërë një barrë për buxhetin e shtetit. Ky objektivi nuk është realizuar.

Për shkak të shumë arsyeve, të trajtuara më poshtë, ku më kryesorja është interesi shumë i ulët i bujqëve për të paguar, në vitet e fundit nuk është bërë rritja e masës së kontributit duke “e ngrirë” atë në një nivel prej 38,400 lekë për zonat fushore dhe 29,400 lekë për zonat malore, aq sa është përcaktuar në vitin 2017. Një i vetëpunësuar në qytet paguan aktualisht 67.392 lekë në vit kontribut. Për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e paguan buxheti i shtetit dhe për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë.

Objektivi 2. Rritja e pjesmarjes. Numri i kontribuesve të vetpunësuar në bujqësi, së paku duhet të arrihet në 93 000 persona, bazuar në bilancin e popullsisë aktive. Për vitin 2020 numri fizik i të sigurve është realizuar për 31879 persona ose rreth 30 % e numrit të mundshëm. Për më tepër në vitin 2020 ky numër është ulur edhe krahasuar me një vit më parë. Në kokluzion, edhe ky objektivi konstatohet i pa realizuar.

Objektivi nr 3. Realizimi i planit të ardhurave për sigurimet shoqërore dhe për sigurimet shëndetësore.

Për vitin 2019 është parashikuar të realizohen 1923 milione lekë sigurim shoqëror dhe 180 milione leke të ardhura për sigurim shëndetësor, gjithsej 2,103 milion leke dhe në fakt janë realizuar 1,782.2 milione leke, sigurim shoqëror, shëndetësor dhe kamat vonesa ose 85% të planit, me një deficit në shuminë 320.8 milione leke. Edhe ky objektivi konstatohet i pa realizuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Objektivi 4. Ulje graduale e deficitit të skemës së sigurimeve shoqërore në fshat.

Per vitin 2020, deficitin e skemës së fshatit është rritur, si krahasuar me një vit më parë ashtu edhe në raport me PBB. Krahasuar me vitin 2019, deficitin rritet në shumën +525,423 miliona leke, dhe po kështu deficitin ka arritur në 0.66% të PBB dhe me një rritje prej 12,5% ndaj një viti më parë. Edhe ky objektivi konstatohet i pa realizuar.

Ecuria e kontributeve dhe deficitin e skemës së pensione në fshatit në 5 vitet e fundit ka rezultuar si më poshtë:

Emertimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Te ardhura kontributive	1,949	1,919	2,111	2,123	2,289	1,671
Shpenzime	14,927	14,821	14,925	14,230	14,066	13,677
Financimi buxhetor	12,978	12,903	12,814	12,107	11,776	12,006
Financim buxhetor/shpenz	86.9	87.1	85.9	85.1	83.7	87.8
Kontribues fizike	89,527	53,168	58,526	58,940	61,568	46,743
Pensioniste	144,769	139,154	132,778	127,084	121,208	115,443
Kontribut mesatar vjet/leke	21,772	36,084	36,067	36,021	37,186	35,741
Perfitim mesatar vjet/leke	103,108	106,511	112,405	111,974	116,045	118,472
Subveçion buxhetor/perfitues, ne leke	89,644	92,723	96,507	95,268	97,156	104,001
Mbulim nga kontributi/ne leke	13,464	13,787	15,898	16,706	18,889	14,471
Mbulim nga kontributi/ne %	13.1	12.9	14.1	14.9	16.3	12.2

Ndërsa deficitin e skemës së sigurimeve të fshatit paraqitet si më poshtë:

Bilanci i fshatit	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Barreldije fshat	-323	-429	-428	-705	-423	-506
Pensione fshat	-10,393	-11,165	-10,943	-9,824	-9,373	-9,816
Shuma	-10,716	-11,593	-11,371	-10,530	-9,796	-10,322
Deficitin si % ndaj PBB	-0.74	-0.79	-0.73	-0.64	-0.58	-0.58

Risqet dhe problematikat e hasura në relizimin e skemës së sigurimeve të fshatit janë:

1. Vështiresitë për zbatueshmërinë e masave shtrënguese

Mbështetur në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në kategorinë e personave të mbrojtur dhe të detyruar për tu siguruar, përfshihen dhe personat e vetëpunësuar në bujqësi. Në nenin 15 të këtij ligji, është përcaktuar se personat e vetëpunësuar në bujqësi, i paguajnë kontributet gjatë vitit kalendarik, një herë në tre muaj dhe për mos pagesat e kontributeve, inspektori i personave të vetëpunësuar në bujqësi, plotëson akt-detyrimin, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyrat e përmbarimit. Gjithashtu, në paragrafin (2) të nenit 16 të këtij ligji, është përcaktuar se për pagesat e kontributeve të personave vetëpunësuar në bujqësi, nuk kryhen brenda afateve të përcaktuara, personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë dhe kamatvonesat e llogaritura. Pavarësisht faktit që, sigurimi i personave të vetëpunësuar në bujqësi është një sigurim i detyrueshëm, hasen pengesa për “mbledhjen” e tij, për shkak se të gjitha procedurat shtrënguese dhe sanksionet e mësipërme, nuk janë të mundura të zbatohen.

Në këto kushte dhe për këtë qëllim, ka qenë dhe është e domosdoshme bashkëpunimi institucional në disa drejtime me qëllim zbatimin e ligjit dhe akteve nën ligjore në fuqi, pasi skema e sigurimit shoqëror të personave të vetëpunësuar në bujqësi është e detyrueshme, konkretisht:

Se pari, realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me evidentimin e fermave të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ardhurat e realizuara nga njësitë bujqësore dhe personat e mundshëm për tu siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi;

Për këtë Drejtoria e Kontributeve/Sektori i të Vetepunësuarve në Bujqësi në ISSH, gjatë viteve 2019 - 2020, ka realizuar fillimin e bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Ministrinë e Financave në mënyrë që të kordinohen dhe harmonizohen treguesit skemës së fshatit me masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë së zhvillimit bujqësor, me qëllim arritjen e pjesmarrjes në skemën e sigurimit shoqëror të gjithë të vetëpunësuarve që kryejnë aktivitet ekonomik në sistemin e bujqësisë (shkresa Nr. 6651, date 29.10.2020).

Se dyti, mos dhënia e programeve mbështetëse nga AZHBR për fermerët që ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe/ose blegtoral, pa u siguruar nga skema e sigurimeve shoqërore për periudhat e parashikuara në ligj.

Nisur nga bashkëpunimi me AZHBR-ne dhe referuar Udhezimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Per kriteret, procedurat dhe menyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural”, që prej vitit 2018, për të vetëpunësuarit në bujqësi të përfshirë në këto programe , është përcaktuar se: *“Përfituesi të ketë bërë shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”, në mënyrë që të përfitojë financimet për aktivitetin që do të ushtrojë.* Por në këto udhëzime, dokumenti për vertetimin e derdhjes së këtyre kontributeve të detyruara përcakton shlyerjen e detyrimit të kontributit për sigurimet shoqërore vetëm për periudhën koherente, në këtë rast vetëm 3-mujori i parë i vitit koherent, ndërkohë që mbështetur në VKM nr. 77, date 28.01.2015, kreu IV, pika 11, të ndryshuar me VKM nr.551, date 27.07.2016, të ndryshuar me VKM nr. 720 date 16.09.2020, të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, respektivisht për vitin 2016 e në vazhdim, dhe 2020 e në vazhdim, pavarësisht se mund të jenë të pasiguruar për vitet pararendëse.

Lidhur me politikat mbështetëse për fermerët, duke u bazuar nga nisma e qeverisë e vitit 2020 për lehtësi fiskale përsa i përket hidrokarbureve për fermerët që ushtrojnë aktivitet bujqësor, nismë e cila hyri në zbatim në 1 janar 2021, është parashtruar të merret në konsideratë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që në dokumentacionin e keëkuar fermerëve , të përfshihet edhe dokumenti për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore (shkresa Nr. 6620, date 28.10.2020).

2. Formalizimi i tregut të fermerëve

Referuar ligjit Nr. 7703, date 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, personat e vetëpunësuar në bujqësi, për efekt të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, konsiderohen fermerët të cilët prodhojnë produkte bujqësore dhe blegtorale, me destinacion shitjen e tyre në treg. Pavarësisht të dhënave zyrtare për të punësuarit në sektorin privat bujqësor, publikuar nga INSTAT, për vitin 2020 (446,000 të punësuar në sektorin bujqësor), rezulton se nga bilancet e popullsive agrare të hartuara nga DRSSH-të për dy vitet 2019 – 2020, rreth ¼ e tyre, janë kontigjent i mundshëm për tu siguruar si persona të vetëpunësuar në bujqësi, pasi jo të gjithë të punësuarit në sektorin privat bujqësor plotësojnë kushtet ligjore për tu siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi dhe jo të gjithë punojnë për të prodhuar produkte bujqësore dhe blegtorale, me destinacion tregtimin e tyre.

Pranë njësive administrative vendore janë ngritur struktura të posaçme që administrojnë tregjet lokale, nëpërmjet të cilave organizojnë aktivitetet dhe ambjentet, ku fermerët mund të shesin produktet e tyre.

Meqënëse në bazë të decentralizimit të pushteteve, pushteti vendor është i pavarur në organizim dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, është i nevojshëm dhe mbetet për tu bërë realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

vendor, që fermerët që do të shesin produktet në treg, të detyrohen të sigurohen për degët e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

3. Situata e vështirë ekonomike e fermerëve, sidomos në zonat malore

Në shumë zona rurale, sidomos në ato malore, situata ekonomike e familjeve fermere paraqitet e dobët, për shkak të relievit të vështirë në të cilin ushtrohet veprimtaria bujqësore dhe/ose blegtorale dhe si rrjedhojë edhe tregtimi i prodhimeve të tyre. Tashmë është tregues që dhe të ardhurat në skemë nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, janë më të larta në muajt gusht dhe dhjetor, për shkak se numri i emigrantëve që kthehen në atdhe në këto muaj është më i lartë dhe janë pikërisht ata që sigurojnë familjarët e tyre. Kjo tregon që familjet që punojnë dhe jetojnë në zonat rurale, përballen me një gjendje ekonomike të vështirë dhe mungesë të likujditeteve, për të mundur sigurimin e tyre si persona të vetëpunësuar në bujqësi. Kjo është dhe arsyeja se pse zona malore ka kuotë më të ulët të sigurimit se sa ajo në zonë fushore edhe pse të dyja kuotat ende nuk janë barazuar.

4. Shpërblimi dhe kushtet e vështira të punës së inspektorëve

Numri i inspektorëve të personave të vetëpunësuar në bujqësi arrin në 207 në rang vendi, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e të gjitha njësive administrative në gjithë Shqipërinë. Në disa raste, një inspektor është përgjegjës për më shumë se një njësi administrative, duke e bërë punën në terren tejet të vështirë për të mbuluar të gjitha zonat. Këta inspektorë mbulojnë 342 njësi administrative (ish komuna dhe bashki), të cilat në përbërje të tyre kanë 2,998 fshatra. Inspektorët e personave të vetëpunësuar në bujqësi, shpërblehen kundrejt pagës minimale në shkallë vendi prej 30,000 lekë dhe një koeficienti shtesë në bazë të të ardhurave që realizojnë nga sigurimi i personave të vetëpunësuar në bujqësi, në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, konkretisht 1.6% e të ardhurave mujore të grumbulluara në zonat fushore dhe 2.6% në zonat malore. Në këto kushte, motivimi i tyre në punë dhe i rezultateve pozitive, vijon të mbetet shqetësuese dhe në nivele shumë të ulta. Gjithashtu, duhet përmendur fakti që dhe shpenzimet administrative të punës së tyre në terren (dieta, transportet publike etj.) përballohen nga vetë inspektorët.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga specialistët e I.S.SH, në lidhje me të vetpunësuarit në bujqësi, për shkak dhe të faktorëve të përmendur më sipër, trokitja derë më derë e inspektorëve pranë qendrave të banimit të personave kontigjent për tu siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, mbetet shumë e vështirë, sidomos në periudhën e dimrit, kur dhe kushtet klimaterike ndikojnë negativisht në punën e terrenit që kryejnë inspektorët.

5. Specifikat e viteve 2019 – 2020

Këto dy vite u shoqëruan me ngjarje që ndikuan në sistemin ekonomik dhe financiar në vend dhe sigurisht edhe në mbledhjen e të ardhurave kontributive të programuara për ISSH-n dhe të vetëpunësuarit në bujqësi. Mosrealizimi si në nivel të ardhurash dhe në numër kontribuesish, veçanërisht në vitin 2020, u ndikua nga fenomeni i pandemisë globale.

Problematikë mbetet pjesëmarrja e popullsisë së fshatit në skemën e sigurimeve shoqërore dhe për pasojë numri i personave të vetëpunësuar në bujqësi që kontribuojnë është shumë i vogël, në nivelin e 40 - 50 % të numrit të kontribuesve të parashikuar.

Pasqyra e numrit të kontribuesve per periudhen 2013- 2020								
Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Nr. kontribuesve	64274	127728	89527	53168	58226	58973	61563	46743

Bazuar në urdhrat e ISSH-se për zbatimin e planeve të veprimit dhe Strategjisë Sektoriale 2018 – 2020 , në të cilat është kërkuar rritje me 4% e numrit të kontribuesve, ky tregues gjate vitit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

2020 nuk është arritur, madje ka patur një rënie me 3% krahasuar me vitin 2019. Gjatë vitit 2019 numri i kontrubuesve u rrit me 4% krahasuar me vitin 2018.

Sa më sipër, si rezultat i problematikave të konstatuara në funksionimin e degës së pensioneve të fshatit, ku më kryesorja mbetet thellimi i deficitit të skemës, e cila përballohet nga buxheti i shtetit mbetet detyrë zbatimi i sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe të thellimit të parimit kontributiv të sistemit në drejtim të riformulimit të skemës së pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi.

- Strategjia Afatgjate e ISSH-se e miratuar në vitin 2014 dhe e institucionalizuar me ligjin 104/2014 në thelb të saj përsa i përket zhvillimit të skemës së sigurimit të detyrueshëm për të vetëpunësuarit në bujqësi, është parë në këndvështrimin e realizimit të 2 indikatorëve si:
 1. rritjes së numrit të siguruarve dhe
 2. në uljen subvencionit të shtetit në pjesën e kontributeve, që duhet të paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi.

Në reformën e 2014, me ndryshimet në vitin 2015 në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993,” Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë “, neni 90, pika 2, u parashikua që masa e kontributit të të vetëpunësuarve në bujqësi do të rritej gradualisht deri në barazimin me kontributet e personave të vetëpunësuar në zonat urbane në vitin 2018. Kjo për faktin se një pjesë e konsiderueshme e kontributit të të vetëpunësuarve në bujqësi subvencionohej nga buxheti i shtetit. Ky subvencion arrinte në 60-70 % të masës së kontributit, duke u kthyer në barrë për buxhetin.

Një problem tjetër është se skema e fshatit subvencionohet në masë shumë të madhe edhe në pagimin e pensioneve, duke krijuar një subvencion të dyfishtë për fermerët edhe si kontribut, edhe si përfitim, gjë që është jo e drejtë me qytetaret e tjerë që paguajnë vetë të gjithë kontributin. Një i vetëpunësuar në qytet paguan aktualisht 77,760 lekë në vit kontribut. Për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e paguan buxheti i shtetit dhe për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë. Subvencioni i lartë për kontributet nga buxheti i shtetit për të vetëpunësuarit në bujqësi, pjesëmarrja e ulët edhe për shkak të masës së lartë të kontributit nëse do rritej, produktivitetit të ekonomive fshatare shpesh me siperfaqe toke të vogla dhe jo efëcente, mungesa e iniciativave për pjesëmarrje, pamundësia për t'i detyruar të paguajnë, por lënia praktikisht mbi baza vullnetare për të kontribuar, përbëjnë risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.

Në vijimësinë e sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore të pasqyruar edhe në **Strategjinë Afatmesme 2018 - 2023** të ISSH-se në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe të thellimit të parimit kontributiv të sistemit mbetet për tu arritur riformulimi i skemës së pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi, ku përfshihet edhe ndryshimi në masën e kontributit shoqëror që duhet të paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi.

Për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, është propozuar nga ana e ISSH me anë të një projektligji, që të vetëpunësuarit në bujqësi të kenë detyrimin të paguajnë kontributet për pension të llogaritura mbi një pagë minimale me e vogël se paga minimale në shkallë vendi e përcaktuar nga Keshilli i Ministrave, e përballueshme edhe për të vetëpunësuarit me të ardhura vjetore modeste, por për të shmangur diskriminimin midis të vetëpunësuarve qytet – fshat, propozohet që, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë detyrimin të paguajnë kontributet e llogaritura mbi pagën minimale për ta, por kanë edhe mundësinë që mund të paguajnë deri në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi (që paguajnë të vetëpunësuarit urban). Në raportin e vlerësimit të ndikimit të hartuar nga ISSH evidentohet nevoja e formulimit dhe zbatimit të një skeme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

sigurimi të personave të vetpunësuar në bujqësi, e cila të ketë kontribute të përballueshme bazuar në rendimet aktual të ekonomisë bujqësore. Gjithashtu në këtë projekt ligj parashikohet heqja e subvencioneve kontributive duke mos i shtuar detyrime të dubluara të buxhetit të Shtetit, pagesa kontributi në masë të barabartë si për zonën fushore dhe atë malore. Për realizimin e këtij propozimi është e nevojshme ndryshimi i disa neneve të ligjit 7703/1993 dhe nxjerrja e VKM-se, ku nga ISSH janë propozuar ndryshimet ligjore dhe nënligjore, por deri më tani nuk është vepruar nga ligjvënësi.

Ky opsion ruan sistemin, formulën e llogaritjes së përfitimeve, parimin kontributiv të skemës, rrit përgjegjësinë individuale për pensionin, garanton mbulimin me elementë të sigurimeve shoqërore, garanton drejtësinë e sistemit dhe trajtimin e barabartë të qytetarëve.

Konkluzion: Nga auditimi mbi administrimin e skemës së fshatit dhe problematikat e saj, konstatohet se, shpenzimet për pensionet e fshatit për **vitin 2019** janë realizuar në shumën 14,065,531 mijë lekë dhe për **vitin 2020** janë në shumën **13,676,769** mije leke, pra me një ulje prej 388,762 mijë lekë. Për **vitin 2020** pension pleqërie, pension invadiliteti apo pensione familjare si dhe shpenzime për barrë lindjet kanë përfituar 115,443 persona dhe për **vitin 2019** kanë përfituar 121,208 persona. Konstatohet se, shpenzimet e skemës së fshatit sipas programeve, krahasuar me të kontributet e drejtpërdrejta janë mbuluar kryesisht nga buxheti i shtetit, ku diferencën më të madhe e ka dega e barrë lindjeve, në të cilën të ardhurat për vitin 2020 mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndersa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë.

Në reformën e vitit 2014 është përcaktuar që masa e kontributit të të vetpunësuarve në bujqësi do të rritej çdo vit derisa në vitin 2018 të barazohej me kontributin e paguar nga i vetpunësuarin në zonën urbane, e kjo për faktin se një pjesë e konsiderueshme e kontributit të bujqëve subvencionohej nga buxheti i shtetit, i cili arrin në 60-70% të masës së kontributit duke u bërë një barrë për buxhetin e shtetit.

Problematikë mbetet subvencionimi i skemës së fshatit në një masë shumë më të madhe edhe në pagimin e pensioneve, duke krijuar subvencionim të dyfishtë për fermerët, si në kontribut, por dhe në përfitim, gjë që është e unifikuar në përfituesit e tjerë që paguan vetë të gjithë kontributin, pasi shteti ka kontribuar në skemën e fshatit në subvencionimin në **vitin 2019** në shumën 1,980 milion lekë, ose në masën 47.2% të të ardhurave të skemës dhe në **vitin 2020** në shumën 1,684 milion lekë, ose në masën 50.2% të të ardhurave të skemës.

Për shkak të interesit shumë të ulët të të vetpunësuarve në bujqësi për të paguar kontribut, në vitet e fundit nuk është bërë rritja e masës së kontributit, duke “ngrirë” në një nivel prej 38,400 lekë për zonat fushore dhe 29,400 lekë për zonat malore, ndërkohë që një i vetpunësuar në qytet paguan 66,240 lekë në vit kontribute, ku për të vetpunësuarin në bujqësi diferencën e përballon buxheti i shtetit, ndërsa për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë.

Subvencionimi i lartë për kontributet nga buxheti i shtetit për bujqit, pjesëmarrja e ulët në skemë edhe për shkak të masës së lartë të kontributit referuar dhe produktivitet të ekonomive bujqësore, shpesh me sipërfaqe të vogla dhe jo efëcente, pamundësia e detyrimit për të paguar kontribute, si dhe lënia mbi baza vullnetare e pagesës së kontributit, ka sjellë problematikat e skemës së fshatit, duke thelluar deficitin e saj dhe mbulimin në masën më të madhe nga buxheti i shtetit pasi kontributet e derjtpërdrejta mbulojnë vetëm 38% të skemës. Defiçiti i skemës së fshatit edhe pse rezulton më i ulët në krahasim me programimin, sikurse në disa vite radhazi, përsëri zë pjesën më të madhe të defiçitit të skemës së pensioneve në tërësi, që është 35% të totalit prej 27,920,780 mijë lekë, ose 0.58% të PBB.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në kushtet e thellimit të defiçitit të skemës, e cila përballohet nga buxheti i shtetit, me qëllim eliminimin sa më shumë të këtij defiçiti e për pasojë dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit mbetet e vetmja rrugë ajo e zbatimit të sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Gjë e cila kërkon rishikimin me qëllim zgjerimin e parimit kontributiv të sistemit duke riformuluar skemën e pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi.

Për këto arsye, ashtu si dhe vetë ISSH ka konkluduar dhe është pasyruar në analizat dhe raportet vjetore, duhet që të realizohen ndryshimet e nevojshme ligjore, në mënyrë që të krijohet mundësia që nëse një bujk dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlllogaritur mbi bazën e një page më të lartë. Një ndërhyrje e tillë në legjislacionin garanton nga njëra anë mos cënimin e sistemit, të formulës së llogaritjes së përfitimeve apo të parimit kontributiv të skemës dhe nga ana tjetër adreson dhe krijon nxitjen e nevojshme të një kategorie të caktuar të popullsisë në drejtim të rritjes e ndërgjegjësimin për mundësinë e përfitimit të një pensioni më të lartë. Kjo do të rezultojë në krijimin e ofrimit në një mundësi shtesë si për skemën ashtu dhe për individin.

Observacione: Në lidhje me akt-konstatimin nr. 8, datë 27.04.2021, janë paraqitur sqarimet me shkresën nr. 2848/1 prot, datë 04.05.2021, administruar në KLSH me nr. 95/4 prot, datë 04.05.2021, nga z. A H me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në lidhje me çështjet e trajtuara për skemën e fshatit, në të cilën sqarohet se:

Në vitin 2018 ISSH ka përgatitur një projekt ligj me qëllim zgjidhjen e disa problematikave të shfaqura gjatë zbatimit të Strategjisë së re të Sigurimeve Shoqërore, miratuar me ligjin nr. 104/2014 datë 31.07.2014. Një ndër problematikat e vecanta të trajtuara lidhej me ecurinë e skemës së sigurimeve shoqërore për personat e vetpunësuar në bujqësi, ku si zgjidhje u propozua rritja e masës së kontributit që paguajnë fermerët dhe caktimi i një page minimale për bujqit që i pëgjigjet kësaj mase kontributi duke ruajtur kriteret dhe parametrat e formulës aktuale të pensioneve.....Gjthashtu në këtë projekt ligj parashikohet heqja e subvencioneve kontributive duke mos shtuar detyrimeve të dubluara të buxhetit të Shtetit, pagesa kontributi në masë të barabartë si për zonën fushore dhe atë malore si dhe paga minimale e përcaktuar nuk mund të jetë më e vogël se paga referuese e indeksuar.

Në mbledhjen e muajit korrik 2020, Këshilli Administrativ i ISSH ka marrë në shqyrtim projekt ligjin. Për efekt të zbatimit të kësaj skeme nevojiten reflektime në VKM 77/2015 e ndryshuar.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Për sa më sipër, observacioni juaj merret në konsideratë dhe do të pasqyrohet në Projekt Raportin e Auditimit.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt konstatimi Nr.8 datë 27.04.2021 i dorëzuar e protokolluar në ISSH. Në lidhje me këtë akt u pasqyruan në projekt raport observacionet e subjektit.

Titulli i gjetjes: Mbi administrimin e skemës së fshatit dhe problematikat e saj.

Situata :

Nga auditimi mbi administrimin e skemës së fshatit dhe problematikat e saj, konstatohet se, për vitin 2019 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 14,065,531 mijë lekë, të cilat i kanë përfituar 121,208 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrëlindjet.

Për vitin 2020 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 13,676,769 mijë lekë me një ulje prej 388,762 mijë lekë nga viti 2019, të cilat i kanë përfituar 115,443 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrëlindjet.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Konstatohet së shpenzimet e skemës së fshatit sipas programeve, krahasuar me të ardhurat e mbledhura janë mbuluar kryesisht nga buxheti i shtetit, ku diferencën më të madhe e ka dega e barrëindjeve, në të cilën të ardhurat për vitin 2020 mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndërsa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë.

Problematikë mbetet subvencionimi i skemës së fshatit në një masë shumë më të madhe edhe në pagimin e pensioneve, duke krijuar subvencionim të dyfishtë për fermerët, si në kontribut, por dhe në përfitim, gjë që është e unifikuar në përfituesit e tjerë që paguajnë vetë të gjithë kontributin, pasi shteti ka kontribuar në skemën e fshatit në subvencionimin **në vitin 2019** në shumën 1,980 milion lekë, ose në masën 47.2% të të ardhurave të skemës dhe **në vitin 2020** në shumën 1,684 milion lekë, ose në masën 50.2% të të ardhurave të skemës.

Për shkak të interesit shumë të ulët të të vetëpunësuarve në bujqësi për të paguar kontribut, në vitet e fundit nuk është bërë rritja e masës së kontributit, duke “ngrirë” në një nivel prej 38,400 lekë për zonat fushore dhe 29,400 lekë për zonat malore, ndërkohë që një i vetëpunësuar në qytet paguan 66,240 lekë në vit kontribute, ku për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e përballon buxheti i shtetit, ndërsa për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë.

Subvencionimi i lartë për kontributet nga buxheti i shtetit për bujqit, pjesëmarrja e ulët në skemë edhe për shkak të masës së lartë të kontributit referuar dhe produktivitet të ekonomive bujqësore, shpesh me sipërfaqe të vogla dhe jo efçente, pamundësia e detyrimit për të paguar kontribute, si dhe lënia mbi baza vullnetare e pagesës së kontributit, ka sjellë problematikat e skemës së fshatit, duke thelluar defiçitin e saj dhe mbulimin në masën më të madhe nga buxheti i shtetit pasi kontributet e derjtpërdrejta mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndërsa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit për këtë degë.

Defiçiti i skemës së fshatit edhe pse rezulton më i ulët në krahasim me programimin, sikurse në disa vite radhazi, ka pësuar rritje duke kaluar nga 9,796,089 mijë lekë ose 0.58% të PBB për vitin 2019 në 10,322,244 mijë lekë ose 0.66% PBB në vitin 2020.

Në kushtet e thellimit të defiçitit të skemës, e cila përballohet nga buxheti i shtetit, me qëllim eliminimin sa më shumë të këtij defiçiti e për pasojë dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit mbetet e vetmja rrugë ajo e zbatimit të sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Gjë e cila kërkon rishikimin me qëllim zgjerimin e parimit kontributiv të sistemit duke riformuluar skemën e pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi.

Kriteret: Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar;

VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi sigurimeve shoqërore dhe sigurimit shëndetësor”, i ndryshuar

Ndikimi: Përkeqësim i skemës së fshatit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Nga ISSH të merren masat e nevojshme për uljen e deficitit të skemës së fshatit si dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit për këtë skemë, duke rritur numrin e kontribuuesve bujq, si dhe të vazhdohet realizimi i inicimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, i ndryshuar, me qëllim që në të të parashikohet mundësia, që nëse një bujq dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlogaritur mbi bazën e një page më të lartë.

III.2.B/3. Mbi bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me të ardhurat e skemës së qytetit të mbledhura gjatë viteve 2019-2020. Problematikat e hasura në zbatim të kërkesave të marrëveshjes dypalëshe. Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj. Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi.

- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT;
- Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Plotësues nr.1, datë 17.01.2019, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”
- Ligji Nr. 88/2019 Për Buxhetin e Vitit 2020 etj., dhe aktet normative në ndryshim të tij gjatë vitit 2020

Nga auditimi u konstatua:

Viti 2019

Mbi bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me të ardhurat e skemës së qytetit të mbledhur gjatë vitit 2019-2020. Problematikat e hasura në zbatim të kërkesave të marrëveshjeve dypalëshe.

Marrëdhëniet ndërinstitucionale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe marrëdhëniet e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me Drejtoritë Rajonale Tatimore janë ndërtuar dhe mbështeten në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, në të cilin është përcaktuar që DPT dërgon të gjithë të dhënat, në ISSH, bazuar në procedurën e komunikimit “on-line”, ndërmjet sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet si dhe më marrëveshjen e përbashkët të bashkëpunimit midis ISSH & DPT nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Qëllimi i kësaj marrëveshje është ripërcaktimi i detyrave dhe komunikimeve midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve të të dhënave statistikore dhe problematikave që dalin pas inspektimit nga ISSH, të të dhënave të kontributeve të procesuara në llogaritë individuale, si dhe plotësimi i mungesave të konstatuara në listë pagesat në format shkresor (letër) të personave juridike, të listëpagesave dhe të dhënat për pagesat e kontributeve nga personat fizikë, si dhe të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga subjektet, për periudhat e “pa informatizuara”.

Objekti i marrëveshjes është dërgimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore sipas “Protokollit të Komunikimit Elektronik të listëpagesave, për të dhënat e listëpagesave të subjekteve dhe raportet statistikore të tyre”, dhe konkretisht:

- transferimin on-line të të dhënave të listëpagesave mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore të deklaruar nga subjektet;
- dërgimin në format elektronik të të dhënave për kontributet e paguara çdo muaj nga çdo subjekt;
- dërgimin në format elektronik të të dhënave përmblledhëse të listëpagesave dhe raportet statistikore që lidhen me to;
- dërgimin në format elektronik të të dhënave për detyrimet kontributive progresive të paguara për çdo subjekt debitorë.

Bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit të mbledhur nga sistemet elektronike të deklarimit dhe pagesave të kontributeve, nga subjektet juridikë dhe fizikë, duke mundësuar:

- kontrollin dhe verifikimin e shumave të kontributeve të paguara nga subjektet,
- rakordimin e kontributeve të paguara në bankë me listëpagesat e dërguara në format elektronik,
- trajtimin e problematikave të mbartura lidhur me dërgimin e listëpagesave të munguara të formatit letër.

Mbështetur në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, DPT dërgon të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në bazë mujore, gjithsej janë dërguar 12 shkresa për secilin institucion, si vijon:

-Shkresa nr.4973, datë 06.03.2019 (Janar 2019); Shkresa nr.6516, datë 27.03.2019 (Janar-Shkurt 2019); Shkresa nr.7315, datë 08.04.2019 (Janar- Mars 2019); Shkresa nr.9798, datë 13.05.2019 (Janar-Prill 2019); Shkresa nr.11632, datë 11.06.2019 (Janar-Maj 2019); Shkresa nr.13732, datë 15.07.2019 (Janar-Qershor 2019); Shkresa nr.15414, datë 14.08.2019 (Janar-Korrik 2019); Shkresa nr.16813, datë 10.09.2019 (Janar-Gusht 2019); Shkresa nr.18426, datë 04.10.2019 (Janar-Shtator 2019); Shkresa nr.20416, datë 06.11.2019 (Janar-Tetor 2019); Shkresa nr.22194, datë 11.12.2019 (Janar-Nëntor 2019); Shkresa nr.643, datë 14.01.2020 (Janar-Dhjetor 2019).

Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr.618 datë 27.01.2020 drejtuar MFE : “ Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga DPT për kontributet e Sigurimeve Shoqërore ”ka përcjell në MFE rakordimin e të ardhurave të realizuara për kontributet e sigurimeve shoqërore nga sistemi C@TS për periudhën Janar- Dhjetor 2019 si më poshtë:

Rakordimi për transferimet dhe arkëtimet në TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore:

Në mijë lekë

Nr.Llog	Emërtimi i llogarive	DPT	MFE
---------	----------------------	-----	-----



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

7500100	Sig.shoq të punësuar sektori buxhetor	11,122,213	11,122,213
7500400	Kontribute suplementare	1,327,369	1,327,369
7501100	Sig.shoq të punësuar sektori jo buxhetor	1,649,250	1,649,250
7501400	Kontribute suplementare	3,717	3,717
7502100	Sig.shoq të punësuar sektori privat	15,536,871	15,536,871
7502400	Kontribute suplementare	48,760	48,760
7510100	Sig.shoq të punëdhënës sektori buxhetor	17,674,656	17,674,656
7510400	Kontribute suplementare	10,615	10,615
7511100	Sig.shoq të punëdhënës sektori jo buxhetor	2,603,551	2,603,551
7511400	Kontribute suplementare	0	0
7512100	Sig.shoq të punëdhënës sektori privat	27,089,801	27,089,801
7512400	Kontribute suplementare	60,971	60,971
7520100	Sig.shoq të vetëpunësuar	3,410,168	3,410,168
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar	80,537,942	80,537,942
7090101	Kamatvonesa të kontributeve sig.shoqërore	100,223	100,223
7115101	Gjoha të sigurimeve shoqërore	205,920	205,920
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar+kamt+gjoha	80,844,085	80,844,085

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Shumat e transferuara në TSA

Nr.	Emërtimi	Vlera në mijë lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2019	2,064,158
2	Tatimore (Llog.75)	80,537,941
3	Llogaria -711 (jo tatimore) gjoha	205,920
4	Llogaria 7090101- Kamatvonesa sig.shoq.	100,223
5	Totali i të ardhurave	80,844,085
	Transferuar nga TSA progresive	80,948,000
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	1,960,243

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Gjithashtu DPT ka përcjell on – line në bazën e të dhënave vetëm listëpagesat e likuiduara plotësisht, sipas Protokollit Elektronik të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet DPT-ISSH

Listëpagesat e deklaruar dhe dërguara në ISSH sipas DPT-ve për vitin 2019

Viti	Listëpagesa të transmetuara gjatë vititë 2019
2012	820,087
2013	1,011,515
2014	816,900
2015	1,178,822
2016	1,367,040
2017	1,306,971
2018	1,300,748
2019	987,956
TOTALI	8,790,039

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Nga informacioni i marrë rezulton se për vitin 2019, janë paguar plotësisht 8,790,039 listëpagesa, ku për vitin 2019 janë dërguar dhe deklaruar 987,956 listëpagesa të likuiduara plotësisht, nga 1,300,748 të dërguara në vitin 2018.

DPT në datë 22.01.2020 ka dërguar në formë elektronike dhe shkresore në ISSH numrin total të kontribuesve i cili paraqitet si vijon:

Nr.	Sipas Muajve	Nr.i kontribueve subjekte publike			Nr.i kontribueve subjekte jopublike			GJITHS EJ	VITI 2018	DIF 2019 - 2018
		Gjithsej	Buxhetore	Jobuxhetore	Gjithsej	Subj. T.V.SH.-se	Subj.e Biznesit Vogël			
1	Janar	157,481	140,099	17,382	490,374	410,062	80,312	647,855	638,963	8,892
2	Shkurt	158,032	140,729	17,303	489,606	408,863	80,743	647,638	638,598	9,040
3	Mars	158,735	141,432	17,303	491,946	410,455	81,491	650,681	643,094	7,587
4	Prill	159,782	142,467	17,315	496,322	414,908	81,414	656,104	648,065	8,039
5	Maj	160,723	143,299	17,424	499,216	416,992	82,224	659,939	655,174	4,765



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

6	Qershor	157,941	140,725	17,216	506,538	420,702	85,836	664,479	662,336	2,143
7	Korrik	156,955	139,654	17,301	517,639	431,250	86,389	674,594	671,125	3,469
8	Gusht	156,158	138,921	17,237	516,821	429,763	87,058	672,979	661,749	11,230
9	Shtator	155,972	138,613	17,359	509,813	423,947	85,866	665,785	659,830	5,955
10	Tetor	156,725	139,143	17,582	508,837	424,434	84,403	665,562	662,544	3,018
11	Nëntor	158,561	140,760	17,801	504,087	419,427	84,660	662,648	659,591	3,057
12	Dhjetor	158,589	140,971	17,618	496,503	411,824	84,679	655,092	650,127	4,965
	TOTALI	1,895,654	1,686,813	208,841	6,027,702	5,022,627	1,005,075	7,923,356	7,851,196	72,160
Nr mes.vjetor		157,971	140,568	17,403	502,309	418,552	83,756	660,280	654,266	6,013

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Për vitin 2019, numri mesatar vjetor i kontribuesve për sigurimet shoqërore është 660,280 nga të cilët: Buxhetorë 140,568; Jobuxhetorë 17,403 dhe Privatë 502,309. **Krahasuar me vitin 2018 numri i kontribuesve për skemën e qytetit është rritur me 6,013 kontribues.**

Aktualisht marrëveshja dypalëshe zbatohet konform kërkesave tëparashikara. Problematika ekzistuese janë problematikat e mbartur të periudhave të kaluara dhe i përkasin kërkesave të nënpikës “iii”, shkronja “b”, kreu i II-të i Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017 “trajtimin e problematikave të mbartura lidhur me dërgimin e listëpagesave të munguara të formatit letër”. Nga këto problematika vecojmë:

-Listëpagesat e munguara të formatit letër 2006-2012.

Listëpagesa të munguara në fund të vitit 2019

Nr	E m e r t i m i	Mungesat e listëpagesave situatë më 31.12.2018	Pakësimet e listëpagesave kundrejt tërheqjes së tyre nga tatimet	Mungesat e listëpagesave situatë më 31.12.2019	% ndaj totalit
1	Subjektet publike	4,534	832	3,702	0.24
2	Firma	80,910	2,106	78,804	5.23
3	Të vetëpunësuar	1,434,979	11,345	1,423,634	94.5
	Gjithsej	1,520,423	14,283	1,506,140	100

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Gjatë vitit 2019 është rritur komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Drejtorive Qëndrore, ISSH dhe DPT, si dhe ndërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për grumbullimin e listëpagesave të munguara dhe dërgimin e tyre në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Gjatë vitit 2019 u janë dërguar nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve, gjithsej 14,283 listëpagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012 dhe konkretisht janë 832 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 2,106 listëpagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 11,345 listëpagesa të subjekteve biznesi i vogël.

Mungesat e listëpagesave rrjedhin nga subjektet aktive që do të thotë se nuk ka mungesa të shtuara artificialisht pas kalimit në status pasiv të këtyre subjekteve.

Sic konstatohet edhe nga të dhënat e sipërcituara volumin më të madh të listëpagesave të munguara e ka biznesi i vogël me rreth 95% të totalit të listëpagesave. Këto biznese përgjithësisht janë të vetëpunësuar të vetëm.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi, të përpara vitit 2012 (kur u kalua në sistemin “on –line”) cdo biznes derdhjen e kontributeve mujore e shoqëronte me një listëpagese. Në rastin e biznesit të vogël me persona të vetëpunësuar derdhja e kontributeve është përcaktuar tre mujore dhe kjo derdhje duhet të shoqërohej me listëpagesë për të tre muajt, sipas formatit të përcaktuar.

Në uljen e numrit të mungesave të listëpagesave mujore në subjektet e biznesit të vogël, ka luajtur dhe dërgimi i pagesave nga ana e DPT për personat “Të vetëpunësuar të vetëm”, ku sipas marrëveshjes ISSH-DPT pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për këtë kategori biznesi do të merren si listëpagesa të mirëfillta.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Niveli i shpenzimeve në skemën e qytetit dhe treguesi i deficitit të saj.

Bazuar në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Sigurimi Shoqëror i Detyrueshëm jep përfitime për 4 degë të sigurimeve shoqërore, sëmundje, barrë lindje, pensione (pleqërie, invaliditeti dhe familjare) dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale.

Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen nga kontributet e punëdhënësve, të të punësuarve dhe personave të tjerë ekonomikisht aktivë të cilat përbëjnë kontributet e drejtpërdrejta, si dhe nga kontributet e buxhetit të shtetit për kategori të veçanta personash.

Kontributet e drejtpërdrejta paguhen nga persona juridik dhe fizik, ndërsabuxheti i shtetit, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, paguan kontribute për kategori të veçanta personash, ku përfshihen të papunët në pagesë papunësie, personat në pagesë kalimtare, ushtarakët në reformë, punonjësit e nëntokës, punonjësit e industrisë ushtarake, gratë që dalin në pension në vitin respektiv si dhe diferencën për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi.

Skema e përfitimeve dhe sistemi i sigurimeve në qytet i cili u adresohet kontribuesve të subjekteve juridikë dhe fizikë është më e plotë dhe e sistemuar sa i përket përfitimeve afatshkurtra. Sa i përket pensioneve sistemi vazhdon të jetë deficitar dhe subvecionohet nga buxheti i shtetit.

Kontributet sipas degëve për skemën e qytetit

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
Për sëmundje	821,966.76	804,414.08
Për barrë lindje	3,359,770.60	3,386,268.23
Për pensione	77,043,087.02	76,706,014.28
Për aksidente e sëmundje profesionale	936,098.54	932,549.94
Total	82,160,922.92	81,829,246.53

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Kontributet për skemën e qytetit (për pensione; për sëmundje; barrë lindje dhe aksidente e sëmundje profesionale) janë realizuar në shumën 81,829 milion lekë, nga 82,161 milion lekë që ishin programuar, ose në masë 99.6%, me një mosrealizim në shumën 332 milion lekë.

Me reformën e pensioneve që ka filluar zbatimin nga data 01.01.2015, formula e përlllogaritjes së pensioneve është unifikuar, por megjithëkëtë, për shkak të vijueshmërisë skemat evidentojnë të ndara si shpenzimet ashtu edhe të ardhurat. Bazuar në bilancin financiar të ISSH për vitin 2019, të ardhurat nga kontributet, vetëm për skemën e pensioneve të qytetit, të ndara sipas degëve për mbulimin e shpenzimeve që ato financojnë, krahasuar me vitin 2018 dhe vitin 2015 si viti i parë i reformës, paraqiten si më vijon:

Në mijë lekë

Kontributet Skema e Qytetit	Viti 2015 (Viti I i reformës)	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019-2018	Ndryshimi 2019-2015
Kontribute sipas degëve	60,641,624	79,174,468	84,620,440	5,445,972	23,978,816
Sëmundje	640,040	870,357	936,959	66,602	296,919
Barrë lindje qytet	3,230,076	4,313,803	4,581,768	267,965	1,351,692
Pension qytet	54,253,200	70,508,878	75,373,560	4,864,683	21,120,360
Aksidente	640,040	870,357	936,959	66,602	296,919
Papunësi	1,878,219	2,611,072	2,791,193	180,121	912,974
Kontribute të destinuar për mbulimin e shpenz.	58,763,405	76,563,396	81,829,247	5,265,851	23,065,842

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Në total kontributet e skemës së qytetit për vitin 2019 rezultojnë 84,620 milionë lekë por, të destinuar për mbulimin e shpenzimeve sipas degëve janë 81,829 milionë lekë, pasi përjashtohen kontributet e degës së papunësisë për të cilat nuk programohen por vetëm realizohen pagesa.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Kontributet në total në vitin 2019 janë rritur me 5,446 milionë lekë, ose 6.9% krahasuar me vitin 2018 dhe me 23,979 milionë lekë ose 40% krahasuar me vitin 2015 (viti i parë i reformës).

Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha, kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrë lindjeje, aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale dhe kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse.

Në këto kushte kontributet e përlllogaritura që transferohen për këta përfitues nga këto degë në drejtim të degës së pensioneve janë si më poshtë:

Në mijë lekë

Transferimet e kontributeve drej degës së pensioneve NENI 8	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019 - 2018
Sëmundje	188,818	132,545	-56,273
Barrë lindje	891,660	1,195,500	303,840
Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	5,667	4,409	-1,258
TOTALI	1,086,145	1,332,454	246,309

Pas këtyre transferimeve të ardhurat (kontributet) sipas degëve të sigurimit rezultojnë:

Në mijë lekë

Kontributet pas transferimit	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019 - 2018
Kontribute sipas degëve	79,174,468	84,620,440	5,445,972
Sëmundje	681,539	804,414	122,875
Barrë lindje qytet	3,422,143	3,386,268	-35,875
Pension qytet	71,595,023	76,706,014	5,110,992
Aksidente	864,690	932,550	67,859
Papunësi	2,611,072	2,791,193	180,121

Shpenzimet për skemën e qytetit

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
Për sëmundje	481,450	530,721
Për barrë lindje	3,115,652	2,985,538
Për pensione	97,206,357	96,416,369
Për aksidente e sëmundje profesionale	25,004	21,310
Total	100,828,463	99,953,938

Shpenzimet për skemën e qytetit (për pensione; për sëmundje; barrë lindje dhe aksidente e sëmundje profesionale) janë realizuar në shumën 99,954 milionë lekë, nga 100,828 milionë lekë që ishin programuar, ose në masë 99%, me një mosrealizim në shumën 874 milionë lekë.

Shpenzimet sipas degëve të sigurimit krahasuar me vitin 2018 dhe vitin 2015 si viti i parë i reformës, paraqiten si më vijon:

Në mijë lekë

Shpenzimet për degët e sigurimit të detyrueshëm	Viti 2015 (Viti I i reformës)	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019-2018	Ndryshimi 2019-2015
Shpenz. sipas degëve	75,679,317	92,999,136	99,953,938	6,954,802	24,274,621
Sëmundje	337,055	454,198	530,721	76,523	193,666
Barrë lindje qytet	1,958,720	2,511,856	2,985,538	473,682	1,026,818
Pension qytet	73,371,337	90,008,555	96,416,369	6,407,814	23,045,032
Aksidente	12,205	24,526	21,310	-3,216	9,105

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Shpenzimet në total për degët e sigurimit të detyrueshëm në vitin 2019 janë rritur me 6,955 milionë lekë, ose 7.5% krahasuar me vitin 2018 dhe me 24,275 milionë lekë ose 32% krahasuar me vitin 2015 (viti i parë i reformës).

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme kontributet mbulojnë totalisht shpenzimet për degën e sëmundjes, barrë lindjes dhe aksidenteve, ndërkohë mbetet deficitare dega e pensione. Bazuar në nenin 68 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 4 të Ligjit nr.99/2018 “Për Buxhetin e Vitit 2019”, teprica e rezultatit të degëve kalohet në degën e pensione, si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Teprica që transferohen në degën e pensione NENI 68	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019 – 2018
Sëmundje	227,341	273,693	46,352
Barrë lindje	910,287	400,730	-509,556
Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	840,164	911,240	71,076
TOTALI	1,977,792	1,585,664	-392,129

Pas këtyre veprimeve rezultati financiar i skemës së sigurimit të detyrueshëm në qytet rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Vitet/Degët	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019 – 2018
Rezultati financiar sipas degëve	-16,435,740	-18,124,691	-1,688,951
Sëmundje	0	0	0
Barrë lindje	0	0	0
Pensione qyteti	-16,435,740	-18,124,691	1,688,951
Aksidente	0	0	0
Deficiti / GDP	-1.00	-1.08	0.08

Rezultati për skemën e qytetit krahasuar me planifikimin:

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
Për sëmundje	340,516.76	273,693.29
Për barrë lindje	244,118.77	400,730.28
Për pensione	(20,163,270.09)	(19,710,354.66)
Për aksidente e sëmundje profesionale	911,094.54	911,240.11
Total	(18,667,540.02)	(18,124,690.98)

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
PBB	1,698,900.00	1,678,400.00
Dega e pensione qytet	-1.10	-1.08

Tendencat drejt përmirësimit të qendrueshmërisë financiare të skemës së qytetit janë të dukshme, si nga treguesit e mësipërm, por edhe kur kemi parasysh zhvillimet pozitive të numrit të kontribuesve në qytet, nivelin e evazionit të kontributeve, ku ka vend për mjaft përmirësime, zhvillimet e përgjithshme ekonomike pozitive, si dhe reduktimin e nivelit mjaft të lartë të evazionit të kontributeve, lidhur me pagën mesatare kontributive.

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2019 paraqitet në shumën 18.1 mld lekë nga 18.6 mld lekë që ishte deficit i planifikuar, pra rreth 1.2% më i ulët se planifikimi ndërkohë që, rezulton me rreth 1,7% më i lartë se viti 2018 dhe në rritje me 0.08% të PBB, ku ndër faktorët themelorë mund të përmendim dëmet në zhvillimin ekonomik, nga fenomeni natyror (21 Shtator dhe 26 Nëntor 2019) dhe shtimi i detyrimeve kontributive të papaguara. Deficiti në masën 18% të shpenzimeve do të thotë që kontributet mbulojnë vetëm 82% të pensioneve mujoreçka tregon që masat e marra për uljen e evazionit të kontributeve dhe sidomos për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

uljen e numrit të të papunëve, të cilët janë një burim mjaft i rëndësishëm për skemën e Sigurimeve Shoqërore, nuk kanë dhënë ende efekte të duhura financiare për përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale të sistemit.

Viti 2020

Mbi bashkëpunimin me DPT, lidhur me të ardhurat e skemës së qytetit të mbledhura gjatë vitit 2019. Problematikat e hasura në zbatim të kërkesave të marrëveshjes dypalëshe.

Mbështetur në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, DPT dërgon të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në bazë mujore, gjithsej janë dërguar 12 shkresa për secilin institucion, si vijon:

-Shkresa nr.4149, datë 24.02.2020 (Janar 2020); Shkresa nr.5712, datë 12.03.2020 (Janar-Shkurt 2020); Shkresa nr.6882, datë 21.04.2020 (Janar- Mars 2020); Shkresa nr.8188, datë 15.05.2020 (Janar-Prill 2020); Shkresa nr.10511 datë 15.06.2020 (Janar-Maj 2020); Shkresa nr.12662, datë 6.07.2020 (Janar-Qershor 2020); Shkresa e periudhës (Janar-Korrik 2020) rezultojn pa numër protokoll dhe pa datë; Shkresa nr.17476, datë 09.09.2020 (Janar-Gusht 2020); Shkresa nr.19355, datë 06.10.2020 (Janar-Shtator 2020); Shkresa nr.21620, datë 09.11.2020 (Janar-Tetor 2020); Shkresa nr.23741, datë 09.12.2020 (Janar-Nëntor 2020); Shkresa nr.736, datë 15.01.2020 (Janar-Dhjetor 2020).

Në vijim të emaileve midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dates 08.01.2021 dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të dates 14.01.2020 me prot 308/1 nr, lidhur me “ të ardhurat e realizuara për kontributet e Sigurimeve Shoqërore nga sistemi informatik C@TS për periudhën Janar-Dhjetor 2020”, të firmosur dhe konfirmuar respektivisht nga I.S.Sh dhe Ministria e Financave dhe sektori i llogarisë unike të thesarit, rezultojn një diferencë prej 126,332 lekë, ku sipas raportimit të D.P.T të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2020 janë 80,786,624,734 lekë, ndërsa sipas raportimit të M.F.E janë 80,786,498,402 lekë.

Nga auditimi rezultojn se kjo diferencë rezultojn nga raportimi i realizimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për periudhën Janar - Tetor 2020 dhe të dhënave të raportuara nga Drejtoria e Operacioneve të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nga komunikimet e vazhdueshme midis M.F.E, D/P/T dhe I.S.SH për sqarimin e diferencës së mësipërme rezultojn se diferenca prej 126,332 lekë vjen si pasojë e pakësimit në debi të llogarisë 75..... “Kontribute të sig. shoqërore”, prej 108,613 lekësh dhe llogarisë 7090101 “Kamatvonesa të sig. shoqërore” prej 17.719. Nga verifikimi i sistemit SIFQ rezultojn se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka deklaruar pa zbritur rimbursimet (126,332 lekë), kurse nga MFE ka zbritur rimbursimet dhe ka raportuar shumën neto të të ardhurave nga kontributet, gjordat dhe kamatvonesat e sigurimeve shoqërore.

Rakordimi për transferimet dhe arkëtimet në TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 vijon si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.Llog	Emërtimi i llogarive	DPT	MFE	Diference DPT - MFE
7500100	Sig.shoq të punësuar sektori buxhetor	11,379,118		
7500400	Kontribute suplementare	1,318,302		
7501100	Sig.shoq të punësuar sektori jo buxhetor	1,463,529		
7501400	Kontribute suplementare	3,382		
7502100	Sig.shoq të punësuar sektori privat	15,691,219		
7502400	Kontribute suplementare	29,938		
7510100	Sig.shoq të punëdhënës sektori buxhetor	17,681,760		
7510400	Kontribute suplementare	10,116		
7511100	Sig.shoq të punëdhënës sektori jo buxhetor	2,290,392		
7511400	Kontribute suplementare	0.45		
7512100	Sig.shoq të punëdhënës sektori privat	27,439,873		
7512400	Kontribute suplementare	48,254		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

7520100	Sig.shoq të vetëpunësuar	3,064,475		
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar	80,430,360	80,430,251	-109
7090101	Kamatvonesa të kontributeve sig.shoqërore	126,442	126,425	-18
7115101	Gjoha të sigurimeve shoqërore	229,822	229,822	
	Total llog.sig.shoqërore+suplementar+kamt+gjoha	80,786,625	80,786,498	-126

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Me shkresën prot 308/1 nr, të datës 14.01.2021 “Rakordim për transferimet dhe arketimet nga TSA për të ardhurat nga kontributet për periudhën Janar-Dhjetor 2020”, të firmosur dhe konfirmuar respektivisht nga I.S.Sh, Ministria e Financave dhe sektori I llogarisë unike të thesarit dhe D.P.T, është nënshkruar akt rakordimi final i të ardhurave të vitit 2020, ku totali i të ardhurave rezulton **80,786,498,402 lekë (sa raportuar nga M.F.E), nga të cilat** 79,869,741,990.00 janë transferuar nga TSA në mënyrë progressive dhe gjendja në datën 31.12.2020 për tu mbartur dhe transferuar rezulton 2,876,999,356 lekë.

Shumat e transferuara në TSA për vitin 2020 paraqiten si më poshtë :

Nr.	Emërtimi	Vlera në mijë lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2020	1,960,243
2	Tatimore (Llog.75)	80,430,251
3	Llogaria -711 (jo tatimore) gjoha	229,822
4	Llogaria 7090101- Kamatvonesa sig.shoq.	126,425
5	Totali i të ardhurave	80,786,498
	Transferuar nga TSA progresive	79,869,742
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	2,876,999

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Nga grupi auditimit është verifikuar mënyra e rakordimit të Llogarisë - 480 “Te ardhura për t'u klasifikuar”- ku sipas planit kontabël kjo llogari pasqyron në kredi derdhjet e bëra pa destinacion dhe që nuk mund të regjistrohen përfundimisht në momentin e arkëtimit. Me përcaktimin e saktë të qëllimit të arkëtimit bëhet sistemimi në Debi të kësaj llogarie, duke kredituar llogarinë përkatëse të ardhurave sipas rastit, e cila rezulton në shumën 339,393,620 lekë, e detajuar si më poshtë:

Teë dheënat e raportuara të Llogarisë - 480 “Teë ardhura për t'u klasifikuar për vitin 2020 sipas ISSH dhe MFE

Në mijë lekë		
	DEBI	KREDI
Janar	342,723	
Shkurt	43,389	
Mars	20,642	
Prill	9,271	
Maj	7,177	
Qershor	14,205	
Korrik	27,629	
Gusht	19,548	
Shtator	10,391	
Tetor	8,502	
Nentor	6,430	
Dhjetor	941,697	1,112,210
	1,451,604	1,112,210
Gjendja 2020	339,394	

Burimi: Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Nga kontabilizimi i klasës 4 në sistemin Oracle të MFE-se për vitin 2020 dhe rakordimi midis MFE dhe ISSH rezulton se kjo llogari përmban:

1. Në debi në muajin janar 2020 shpërblimin e pa tërhequr të fundvitit dhe shpërblimin e viteve të mëparshme të tërhequra gjatë vitit 2020. Gjate vitit, duke filluar nga muaji



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Janar e në vazhdim në llogarinë 480 janë kontabilizuar tërheqjet e shpërblimit të viteve të mëparshme, konkretisht në Janar 2020 shuma 342,723 mijë lekë përfaqëson pikërisht shumën e ketyre shpërblimeve. Fondi për shpërblimin e pensioneve është çelur në muajin Dhjetor dhe mbetet gjithnjë një pjesë e pagesave të patërhequra Brenda vitit, të cilat tërhiqen në Janar. Ndërkohë, në muajt e tjerë (Shkurt –dhjetor) në debi pasqyrohen tërheqjet e shpërblimeve të vitit 2019.

Fondi i shpërblimit celet apo transferohet sipas planit të Agjensive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku pjesa e planit të pa tërhequr apo pa realizuar gjatë vitit kontabilizohet në llogarinë 48.

2. Në fund të muajit Dhjetor ISSH kontabilizon në debi të kësaj llogarie në vlerën 941,697 mijë lekë, të ardhurat e realizuar për Sigurimet Shoqërore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilat nuk janë derdhur në llogarinë e ISSH-se. Kjo diferencë e pa transferuar njihet si një detyrim i MFE ndaj ISSH.
3. Në kredi të llogarisë në shumën 1,112,210 mijë lekë *pasqyrohet Shpërblimi i fundvitit 2020 i pa tërhequr gjatë vitit.*

Gjithashtu DPT ka përcjell on – line në bazën e të dhënave vetëm listëpagesat e likuiduara plotësisht, sipas Protokollit Elektronik të shkëmbimit të informacionit nërmjet DPT-ISSH

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DPT-ve për vitin 2020.

Viti	Listëpagesa të transmetuara deri në vitin 2019	Listëpagesa të transmetuara deri në vitin 2020	Listëpagesa të periudhës 2012-2019 të transmetuara gjatë vitit 2020
2012	820,087	820,128	41
2013	1,011,515	1,011,599	84
2014	816,900	817,579	679
2015	1,178,822	1,186,971	8,149
2016	1,367,040	1,367,389	349
2017	1,306,971	1,321,946	14,975
2018	1,300,748	1,325,505	24,757
2019	987,956	1,308,629	320,673
2020		1,151,068	
GJITHSEJ	8,790,039	10,310,814	369,707

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Nga informacioni i marrë në DPT dhe ISSH rezulton se për vitin 2020, janë paguar plotësisht 1,151,068 listëpagesa. Gjithashtu rezulton se gjatë kësaj periudhe janë paguar plotësisht 369,707 listëpagesa të periudha të mëparshme 2012-2019 të cilat gjatë vitit 2020 janë paguar plotësisht nga kontribuesit. Nga viti 2012 kur listëpagesat janë transmetuar elektronikisht rezulton se nga DPT janë trasmetuar në total 10,310,814 listëpagesa elektronike të paguar plotësisht.

DPT në datë 24.01.2021 ka dërguar në formë elektronike dhe shkresore në ISSH numrin total të kontribuesve i cili paraqitet si vijon:

Nr.	Sipas	Nr.i kontribueve subjekte publike			Nr.i kontribueve subjekte jopublike			Total 2020	GJITHSEJ 2019	Diferenca 2020-2019
	Muaj	Gjithsej	Buxhetore	Jobuxhetore	Gjithsej	Subj. T.V.SH.-se	Subj.e Biznesit Vogël			
1	Janar	151,554	139,794	11,760	504,701	423,431	81,270	656,255	647,855	8,400
2	Shkurt	151,942	140,145	11,797	505,522	423,544	81,978	657,464	647,638	9,826
3	Mars	151,528	139,631	11,897	495,181	414,365	80,816	646,709	650,681	(3,972)
4	Prill	155,163	138,566	16,597	451,140	375,182	75,958	606,303	656,104	(49,801)
5	Maj	155,405	138,786	16,619	463,709	385,573	78,136	619,114	659,939	(40,825)
6	Qershor	152,598	138,521	14,077	407,336	327,701	79,635	559,934	664,479	(104,545)
7	Korrik	154,533	137,250	17,283	505,037	420,556	84,481	659,570	674,594	(15,024)
8	Gusht	153,772	136,477	17,295	501,613	417,233	84,380	655,385	672,979	(17,594)
9	Shtator	156,401	138,832	17,569	501,136	416,782	84,354	657,537	665,785	(8,248)
10	Tetor	159,116	141,307	17,809	503,452	418,587	84,865	662,568	665,562	(2,994)
11	Nëntor	160,742	142,753	17,989	506,833	421,022	85,811	667,575	662,648	4,927



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

12	Dhjetor	160,190	142,599	17,591	501,205	416,060	85,145	661,395	655,092	6,303
Nr. Mesatar vjetor		155,245	139,555	15,690	487,239	405,003	82,236	642,484	660,280	(17,796)

Burimi: ISSH

Për vitin 2020, numri mesatar vjetor i kontribuesve për sigurimet shoqërore është 642,484 nga të cilët: Buxhetorë 139,555; Jobuxhetorë 15,690 dhe Privatë 487,239. **Krahasuar me vitin 2019 numri mesatar i kontribuesve për skemën e qytetit është ulur me 17,796 kontribues ose rreth 3%.**

Nëse analizojmë të dhënat e raportuara nga DPT në muajt janar-shkurt 2020 dhe nëntor-dhjetor kemi një rritje të numrit mesatar të kontribuesve, ndërsa në periudhën mars-tetor kemi një rënie të konsiderueshme, duke arritur nivelet minimale me 559,934 kontribues ose rreth 104,545 kontribues më pak në muajin qershor, shkaktuar kryesisht për efekt të pandemisë si dhe ndalimit të aktivitetit ekonomik në një pjesë të subjekteve kontribuese.

Aktualisht marrëveshja dypalëshe zbatohet konform kërkesave të parashikara. Problematika ekzistuese janë problematikat e mbarturave periudhave të kaluara dhe i përkasin kërkesave të nënpikës “iii”, shkronja “b”, kreu i II-të i Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017 “trajtimin e problematikave të mbartura lidhur me dërgimin e listëpagesave të munguara të formatit letër”.

Listëpagesa të munguara në fund të vitit 2020

Nr	Emertimi	Mungesat e listëpagesave situatë më 31.12.2019	Pakësimet e listëpagesave kundrejt tërheqjes së tyre nga tatimet	Mungesat e listëpagesave situatë më 31.12.2020	% ndaj totalit
1	Subjektet publike	3,702	111	3,591	0.24
2	Firma	78,804	1,771	77,033	5.13
3	Të vetëpunësuar	1,423,634	2,327	1,421,307	94.63
	Total	1,506,140	4,209	1,501,931	100

Gjatë vitit 2020 vazhdon komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Drejtorive Qëndrore, ISSH dhe DPT, si dhe ndërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për grumbullimin e listëpagesave të munguara dhe dërgimin e tyre në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve janë dërguar gjithsej 4,209 listëpagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012 dhe konkretisht janë 111 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 1,771 listëpagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 2,327 listëpagesa të subjekteve biznesi i vogël.

Sic konstatohet edhe nga të dhënat e sipërcituara volumin më të madh të listëpagesave të munguara e ka biznesi i vogël, ku këto biznese përgjithësisht janë të vetëpunësuar të vetëm.

Mungesat e listëpagesave rrjedhin nga subjektet aktive, që do të thotë se nuk ka mungesa të shtuara artificialisht pas kalimit në status pasiv të këtyre subjekteve.

Në organet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve të kujdesit shëndetësor dërgohet “on line” çdo version më i fundit i të dhënave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të likuiduar plotësisht për kontributet, sa herë që mund të ndodhin ndryshime në të dhënat e saj duke dhënë shpjegimet përkatëse në rubrikën “shënime”.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e listëpagesave të munguara për vitin 2020 sipas rajoneve:

	Listëpagesa të munguara deri më - 31.12.2019	Listëpagesa të marra në dorëzim	Listëpagesa të munguara gjithsej deri më - 31.12.2020
DRSSH	Listpagesa	Lpagesa	Listpagesa
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Berat	1,111	132	979
Dibër	59,380	-	59,380
Durrës	17,426	-	17,426
Elbasan	10,779	216	10,563
Fier	15,863	307	15,556



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjirokastrë	25,342	164	25,178
Korçë	7,649	58	7,591
Kukës	10,370	227	10,143
Lezhë	4,433	26	4,407
Shkodër	3,933	-	3,933
Tiranë	1,293,614	3,045	1,290,569
Vlorë	56,240	34	56,206
Total	1,506,140	4,209	1,501,931

Burimi: ISSH

ISSH me shkresën prot 2835 nr., datë 13.04.2018 “Për grumbullimin dhe arkëtimin në arkivat e sigurimeve shoqërore të listëpagesave të munguara të institucioneve buxhetore si dhe për plotësimin e vërtetimit për bazën e vlerësuar për efekt pensioni” ngarkon Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë e Arkivit Qëndror të kryejnë evidentimin e listëpagesave të subjekteve paguese, njoftimin e subjekteve aktive buxhetore dhe jo buxhetore që konsistojnë me mungesa në listëpagesa, marrjen në dorëzim të tyre, verifikimin dhe arkivimin e tyre.

Në leximin e të dhënave të tabelës së mësipërme për vitin 2020 nga ISSH theksohet **fakti se për rajonin e Tiranës nuk ka përfunduar akoma procesi i sistemimit të të dhënave të ardhura nga DPT lidhur me pagesat e të vetpunësuarve të vetëm, çka do të thotë se të dhënat e mungesave për listëpagesat e subjekteve fizike në rajonin Tiranë nuk janë të dhëna përfundimtare.** Listëpagesat e munguara për rajonin e Tiranës janë 1,290,569 ose rreth 86% e totalit.

Nga grupi i auditimit është marrë evidencë mbi ecurine e marrjes në dorëzim nga ana e ISSH të listëpagesave të munguara duke filluar nga viti 2015 (që përkon me databazën më të hershme që disponon ISSH), sipas tabelës së mëposhtme.

	Listëpagesa të munguara gjithsej 2015	Listëpagesa të dorezuara 2016	Listëpagesa dorezuara 2017	Listëpagesa dorezuara 2018	Listëpagesa dorezuara 2019	Listëpagesa dorezuara 2020	Listëpagesa total 2020
Berat	1,792	142	297	134	108	132	979
Dibër	68,947	623	410	5,723	2,811	-	59,380
Durrës	22,486	174	-	4,862	24	-	17,426
Elbasan	16,249	4,868	137	177	288	216	10,563
Fier	60,322	39,592	3,719	796	352	307	15,556
Gjirokastrë	26,643	324	309	409	259	164	25,178
Korçë	8,255	72	161	166	207	58	7,591
Kukës	29,368	13,040	3,672	1,793	493	227	10,143
Lezhë	5,976	250	42	1,136	115	26	4,407
Shkodër	4,506	387	40	146	-	-	3,933
Tiranë	1,621,403	16,005	35,457	272,226	4,101	3,045	1,290,569
Vlorë	106,623	25,531	16,475	2,852	5,525	34	56,206
Total	1,972,570	101,008	60,719	290,420	14,283	4,209	1,501,931
% listëpagesave mbetura nga viti 2015	100%	5%	3%	15%	1%	0%	76%

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përpunuar KLSH

Nga analiza e ecurisë së dorëzimit të listëpagesave të munguara të formatit letër rezulton se në vitin 2015 listëpagesat e munguara kanë qënë 1,972,570 duke arritur në 1,501,931 listëpagesa të munguara në vitin 2020, me një ulje prej 24% për periudhën 5 vjecare 2016-2020.

Evidentohet se ISSH nuk ka patur mbikqyrje të plotë të zbatimit nga ana e Drejtorive Rajonale të shkresës prot 2835 nr, datë 13.04.2018 dhe marrëveshjes së bashkëpunimit midis ISSH dhe DPT nr 4437/1 datë 23.05.2017.

Niveli i shpenzimeve në këtë skemë dhe treguesi i deficitit të saj.

Bazuar në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen si më poshtë:

- dega e sigurimit të sëmundjeve, 0.3 përqind e shumës së listëpagesave;
- dega e sigurimit të barrë lindjes, 1.4 përqind e shumës së listëpagesave;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

c) dega e sigurimit të pensioneve, 21.6 përqind të shumës së listëpagesave. Punëdhënësi përveç kësaj paguan: tek dega e sigurimit të aksidenteve dhe e sëmundjeve profesionale 0.3 përqind të shumës së listëpagesave dhe tek dega e sigurimit të papunësisë 0.9 përqind të shumës së listëpagesave.

Kontributet e drejtpërdrejta paguhen nga persona juridik dhe fizik, ndërsa buxheti i shtetit, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, paguan kontribute për kategori të veçanta personash, ku përfshihen të papunët në pagesë papunësie, personat në pagesë kalimtare, ushtarakët në reformë, punonjësit e nëntokës, punonjësit e industrisë ushtarake, gratë që dalin në pension në vitin respektiv si dhe diferencën për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi.

Kontributet sipas degëve për skemën e qytetit 2020 paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT	Dif %
Për sëmundje	918,612	934,582	102%
Për barrëlindje	4,481,640	4,547,914	101%
Për pensione	74,521,698	75,842,879	102%
Për aksidente e sëmundje profesionale	918,612	934,582	102%
Total	80,840,831	82,259,956	102%

Burimi: I.S.SH

Kontributet për skemën e qytetit (për pensione; për sëmundje; barrëlindje dhe aksidente e sëmundje profesionale) janë realizuar në shumën 82,260 milion lekë, nga 80,841 milion lekë që ishin programuar, ose në masën 102%, me një tejkalim në realizim në shumën 1,419 milion lekë.

Me reformën e pensioneve që ka filluar zbatimin nga data 01.01.2015, formula e përlogaritjes së pensioneve është unifikuar, por megjithë këtë, për shkak të vijueshmërisë skemat evidentojnë të ndara si shpenzimet ashtu edhe të ardhurat. Bazuar në bilancin financiar të ISSH për vitin 2020, të ardhurat nga kontributet, vetëm për skemën e pensioneve të qytetit, të ndara sipas degëve për mbulimin e shpenzimeve që ato financojnë, krahasuar me vitin 2020 dhe vitin 2015 si viti i parë i reformës, paraqiten si më vijon:

Në mijë lekë

Kontributet skema e qytetit	2015	2016	2017	2018	2019	2020	ndryshimi 2020-2019	ndryshimi 2020-2015
Kontribute sipas degëve	60,641,624	66,966,824	73,362,167	79,174,468	84,620,440	85,063,701	443,261	24,422,077
semundje	640,040	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582	-2,378	294,541
barrëlindje qytet	3,230,076	3,615,722	4,014,378	4,313,803	4,581,768	4,547,914	-33,854	1,317,838
pensione qytet	54,253,248	59,889,519	65,409,479	70,508,878	75,373,560	75,842,879	469,319	21,589,631
aksidente	640,040	692,317	787,662	870,357	936,959	934,582	-2,378	294,541
papunesi	1,878,219	2,076,950	2,362,986	2,611,072	2,791,193	2,803,745	12,551	925,525
Kontribute të destinuar për mbulimin e shpenz.	58,763,405	64,889,874	70,999,181	76,563,395	81,829,247	82,259,956	430,710	23,496,552

Në total kontributet e skemës së qytetit për vitin 2020 rezultojnë 85,064 milionë lekë por, të destinuar për mbulimin e shpenzimeve sipas degëve janë 82,260 milionë lekë, pasi përjashtohen kontributet e degës së papunësisë për të cilat nuk programohen kontributet por vetëm realizohen pagesa.

Kontributet në total në vitin 2020 janë rritur me 431 milionë lekë, ose 0.5% krahasuar me vitin 2019 dhe me 23,497 milionë lekë ose 29% krahasuar me vitin 2015 (viti i parë i reformës).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrë lindjeje, aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale dhe kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse.

Në këto kushte kontributet e përlllogaritura që transferohen për këta përfitues nga këto degë në drejtim të degës së pensioneve janë si më poshtë:

Në mijë lekë

Transferimet e kontributeve drej degës së pensioneve NENI 8	Viti 2019	Viti 2020	Ndryshimi 2020 - 2019
Sëmundje	132,545	132,209	(336)
Barrë lindje	1,195,500	1,186,666	(8,833)
Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	4,409	4,398	(11)
TOTALI	1,332,454	1,323,273	(9,181)

Pas këtyre transferimeve të ardhurat (kontributet) sipas degëve të sigurimit rezultojnë:

Në mijë lekë

Kontributet pas transferimit	Viti 2019	Viti 2020	Ndryshimi 2020-2019
Kontribute sipas degëve	81,829,247	82,259,956	430,710
Sëmundje	804,414	802,373	(2,041)
Barrë lindje qytet	3,386,268	3,361,247	(25,021)
Pension qytet	76,706,014	77,166,152	460,138
Aksidente	932,550	930,183	(2,366)

Shpenzimet për skemën e qytetit

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
Për sëmundje	523,923,999.76	469,225,525.69
Për barrë lindje	3,265,326,440.77	3,254,390,280.52
Për pensione	101,834,626,621.55	97,704,975,443.47
Për aksidente e sëmundje profesionale	24,654,443.73	21,995,562.66
Total	105,648,531,505.82	101,450,586,812.35

Shpenzimet për skemën e qytetit (për pensione; për sëmundje; barrë lindje dhe aksidente e sëmundje profesionale) janë realizuar në shumën 101,451 milionë lekë, nga 105,649 milionë lekë që ishin programuar, ose në masën 96%, me një mosrealizim në shumën 4,198 milionë lekë.

Shpenzimet sipas degëve të sigurimit krahasuar me vitin 2020 dhe vitin 2015 si viti i parë i reformës, paraqiten si më vijon:

Në mijë lekë

Shpenzimet për degët e sigurimit të detyrueshëm	Viti 2015 (Viti I i reformës)	Viti 2019	Viti 2020	Ndryshimi 2020-2019	Ndryshimi 2020-2015
Shpenz. sipas degëve	75,679,317	99,953,938	101,449,981	1,496,649	25,771,270
Sëmundje	337,055	530,721	469,222	-61,495	132,170
Barrë lindje qytet	1,958,720	2,985,538	3,254,366	268,822	1,295,671
Pension qytet	73,371,337	96,416,369	97,704,397	1,288,006	24,333,638
Aksidente	12,205	21,310	21,995	686	9,791

Shpenzimet në total për degët e sigurimit të detyrueshëm në vitin 2020 janë rritur me 1,497 milionë lekë, ose 1.5% krahasuar me vitin 2019 dhe me 25,771 milionë lekë ose 34% krahasuar me vitin 2015 (viti i parë i reformës).

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme kontributet mbulojnë totalisht shpenzimet për degën e sëmundjes, barrë lindjes dhe aksidenteve, ndërkohë mbetet deficitare dega e pensioneve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Bazuar në nenin 68 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 4 të Ligjit nr. 88/2019 date 18.12.2019 “Për Buxhetin e Vitit 2020”, ku teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve, si më poshtë:

Në mijë lekë

Teprica që transferohen në degën e pensioneve NENI 68	Viti 2019	Viti 2020	Ndryshimi 2020 – 2019
Sëmundje	273,693	333,147	59,454
Barrë lindje	400,730	106,857	-293,873
Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	911,240	908,188	-3,052
TOTALI	1,585,664	1,348,192	-237,471

Pas këtyre veprimeve rezultati financiar i skemës së sigurimit të detyrueshëm në qytet rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

Vitet/Degët	Viti 2019	Viti 2020	Ndryshimi 2020 – 2019
Rezultati financiar sipas degëve	-18,124,691	(19,190,025)	(1,065,334)
Sëmundje	0	333,151	59,457
Barrë lindje	0	106,881	(293,849)
Pensione qyteti	-18,124,691	(20,538,245)	(827,890)
Aksidente	0	908,188	(3,052)
Deficiti / GDP	-1.08	1.22	0.14

Rezultati për skemën e qytetit krahasuar me planifikimin:

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
Për sëmundje	263,916	333,147
Për barrë lindje	42,538	106,857
Për pensione	(26,004,031)	(20,538,823)
Për aksidente e sëmundje profesionale	889,608	908,188
Total	(24,807,970)	(19,190,631)

Në mijë lekë

EMËRTIMI	PLAN	FAKT
PBB	1,793,466,00	1,572,500.00
Dega e pensioneve qytet	-1.38	-1.22

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2020 paraqitet në shumën 19.2 miliard lekë nga 24.8 miliard lekë që ishte deficit i planifikuar, pra rreth 23% më i ulët se planifikimi ndërkohë që, rezulton me rreth 6% më i lartë se viti 2019 ku deficit ishte 18.1 miliard dhe në rritje me 0.14% të PBB. Deficiti në masën 19% të shpenzimeve do të thotë që kontributet mbulojnë vetëm 81% të pensioneve mujore (për vitin 2019 kontributet mbulonin 82% të pensioneve mujore), çka tregon që masat e marra për uljen e evazionit të kontributeve dhe sidomos për uljen e numrit të të papunëve, të cilët janë një burim mjaft i rëndësishëm për skemën e Sigurimeve Shoqërore, nuk kanë dhënë ende efekte të duhura financiare për përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale të sistemit.

Arritja e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, risqet e mundshme në përmbushjen e indikatorëve të vendosur për periudhën objekt auditimi.

Qëllimi kryesor i objektivave të strategjisë kombëtare është përmbushja cilësore e misionit të ISSH-së, duke vendosur në qendër të veprimtarisë personat e siguruar dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj tyre, mbulimin e popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në atë kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave kontributive,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe i fondit rezervë.

Gjatë periudhës 2019-2020, për realizimin e objektivave në fushën e pensioneve dhe të misionit të ISSH-së, vëmendja kryesore është fokusuar në disa drejtime kryesore si:

- f. Vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve. Në këtë kontekst një ndër objektivat kryesore është rritja e cilësisë së shërbimit ndaj përfituesve dhe kontribuesve, nëpërmjet derregulimit, aplikimit dhe komunikimit on-line, përmirësimit të rregullave dhe praktikave të vlerësimit të dokumentacionit individual;
- g. Zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve, nëpërmjet indeksimit të përfitimeve të caktuara dhe të të drejtave të lindura;
- h. Realizimit të të ardhurave të planifikuara të fondit të sigurimeve shoqërore, edhe në kushtet e vështira të masave anti COVID;
- i. Përmirësimi në ngritje të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe i cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- j. Vazhdimi i punës për një bazë të plotë, të informatizuar të të dhënave, zbatimi i një sistemi të automatizuar të caktimit të përfitimeve, autorizimit të tyre për pagesë dhe të pagesave të përfitimeve;
- k. Marrëdhënia me qytetarët, plotësimi i kërkesave të tyre, lehtësimi i procedurave të përfitimeve, thjeshtimi i dokumentave që plotësohen nga qytetarët, si dhe ndërveprimi ndërmjet Institucioneve për të zbatuar standardet e administrimit të pensioneve, kanë qenë në qendër të vëmendjes së strukturave të ISSH-së.
- l. Vënies në zbatim të legjislacionit për përfitimet e personave që kanë punuar në profesione të vështira, hartimit dhe ndjekjes së miratimit të disa dispozitave ligjore në funksion të zgjidhjes së problemeve të veçanta;
- m. Përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit teknik të dosjeve, certifikimit të dokumentacionit të dosjeve të pensioneve dhe të veprimeve të rajoneve e degëve, përmirësimi i punës dhe efikasitetit të kontrollit të brendshëm, fokusimi i tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standardet e parashikuara “Për auditimin në sektorin publik” dhe mbi inspektimin financiar.
- n. Mbështetje aktive sipas dispozitave të kodit Europian të Sigurimeve Shoqërore, për shqiptarët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, për punonjësit shqiptarë që punojnë në mënyrë sezonale në vendet e tjera, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.

Në zbatim të këtyre objektivave, përmes punës së të gjitha strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në shkallë vendi, zbatimit të vendimeve të Qeverisë lidhur me politikat e pensioneve si dhe drejtimit dhe mbështetjes nga Këshilli Administrativ, janë realizuar:

- a) Marrëdhënia me qytetarët, plotësimi i kërkesave të tyre, lehtësimi i procedurave të përfitimeve, thjeshtimi i dokumentave që plotësohen nga qytetarët, si dhe ndërveprimi ndërmjet Institucioneve për të zbatuar standardet e administrimit të pensioneve, kanë qenë në qendër të vëmendjes së strukturave të ISSH-së. Më konkretisht:
 - Për vitin 2019 janë marrë 352,721 aplikime, kërkesa për shërbime, për rishqyrtim të masës së pensionit dhe ankesa. Nga këto 319,039 shërbime ose rreth 90% janë realizuar brenda afateve ligjore, 8.2% janë në përpunim dhe 1.8% e tyre ose 5,638 raste janë realizuar jashtë afatit.

Për vitin 2020 janë marrë 252 897 aplikime për shërbime dhe janë realizuar brenda vitit 217 520 shërbime. Nga këto 86 % e kërkesave janë realizuar brenda afateve ligjore, 1.2 % ose 789 kërkesa janë evidentuar me përgjigje jashtë afateve ligjore, ndërsa 12.8 % e tyre ka qenë në proces përpunimi dhe brenda afatit ligjor të përgjigjes. Krahasuar me vitin 2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

kur u konstatuan 352,721 aplikime, në vitin 2020 numri i aplikimeve për shërbime është ulur ndjeshëm dhe ulja i adresohet atyre kërkesave të qytetarëve të drejtuar kryesisht për rishqyrtim pensioni, kërkesa për informacion etj. çka vlerësohet si një tregues cilësor i rritjes së nivelit të shërbimeve dhe të komunikimit midis ISSH dhe qytetarëve. Ndër të tjera kjo vërtetohet edhe me faktin e uljes së numrit të përgjigjeve jashtë afatit e cila ka shmangur ripërsëritjen e kërkesave.

- Trajtimi i kërkesë/ankesave dhe Letrave nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes është trajtuar si një përparësi në komunikim me qytetarët. Krahas komunikimeve shkresore apo pritjeve, nëpërmjet faqes zyrtare të ISSH-së në vitin 2019 i'u është dhënë përgjigje 2,354 kërkesë-ankesave ose 7,7 % më shumë se një vit më parë.

Për vitin 2020 janë trajtuar 2,168 kërkesë/ankesa. Nga totali i rasteve të trajtuara ka rezultuar se kanë pasur nevojë për rivlerësim 211 raste rreth 13 % e tyre, duke e konsideruar këtë si një tregues që duhet të përmirësohet.

- Gjatë vitit 2019 është mundësuar realizimi i procedurave teknike dhe financiare të dhënies së shpërblimeve për 663 mijë përfitues, me një efekt financiar prej rreth 1,990 milionë lekë duke filluar nga data 25 dhjetor 2019 e në vazhdim;

Brenda muajit mars 2020, nga ana e ISSH janë realizuar të gjitha procedurat teknike të indeksimit të pensioneve për mbi 643 mijë përfitues, si dhe kalimi i efekteve financiare në portalin elektronik të pagesave. Me vendimin nr 263, datë 30.03.2020 u vendos indeksimi i pensioneve në masën 2.3% duke filluar nga data 01.04.2020, me një efekt financiar prej 2,100 milionë lekë.

- Nga ana e sektorit të *Integritetit dhe Marrëveshjeve* vazhdon të ndiqet procedura për nënshkrimin e marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe të reja në fushën e mbrojtjes shoqërore, nëpërmjet koordinimit të skemës së sigurimeve shoqërore shqiptare, me skemat evropiane, në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Rregullores 883/2004 të Bashkimit Evropian. Në zbatim të marrëveshjeve 2 palëshe për vitin 2020, janë verifikuar 844 praktika si, kërkesa për verifikim periudhash sigurimi në Shqipëri, kërkesë për pension pleqërie etj.
- Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 153 prot, datë 25.11.2019 “*Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.1.2020*” dhe Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 415, datë 12.12.2019, duke filluar nga data 1 janar 2020 kërkesat për shërbime në fushën e sigurimeve shoqërore filluan të realizohen on-line nëpërmjet portalit e-Albania duke implementuar në këtë sistem 56 shërbime, të sistemit të sigurimeve shoqërore.
- Është reduktuar dokumentacioni për përfitim pensioni që kërkohej të plotësohej nga qytetari në rreth 12 për qind pra rreth 88 për qind e dokumentacionit të domosdoshëm për përfitime sigurohet nga vetë strukturat e sigurimeve shoqërore dhe nëpërmjet sistemit SQDNE të pozicionuar në portalin e-Albania.
- Mbështetur në aktin normative Nr.11, datë 24.12.2019 për disa ndryshime në Ligjin Nr.99/2018, “Për Buxhetin E Vitit 2019”, të ndryshuar është miratuar për vitin 2019 transferta për bonusin e pensionistëve në vlerën 1 990 milionë lekë.
Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1042, datë 18.12.2020 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2020”, në masën 5,000 (pese mijë) lekë për çdo pensionist apo përfitues nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore, u realizuan procedurat teknike dhe financiare të dhënies së shpërblimeve për mbi 668 mijë përfitues, me një efekt financiar prej 3,390 milion lekë.

b) Rritje e të ardhurave të drejtpërdrejta nga kontributet e personave juridike dhe fizike

- Të ardhurat e drejtpërdrejta nga kontributet e personave juridike dhe fizike si dhe të ardhurat e tjera të Fondit të Sigurimeve Shoqërore, në vitin 2019 arritën 84,198 milionë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

lekë, me një rritje prej 6.1% ndaj vitit 2018 ose me rreth 4,858 milionë lekë më shumë se një vit më parë. Përfitimet e pensionistëve, pra transferuat në buxhetet familjare, nga fondet e sigurimeve shoqërore arritën në 128,945 milionë lekë, kundrejt 123,241 milionë lekë që ishin në vitin 2018, me një shtesë prej 5,704 milionë lekë me një rritje për 4,6 % më shumë se viti 2018.

- Të ardhurat e drejtpërdrejta nga kontributet e personave juridik dhe fizik si dhe të ardhurat e tjera të Fondit të Sigurimeve Shoqërore, në vitin 2020 arritën 83,420 milionë lekë, kundrejt 82,540 milionë lekë që ishte programi, në masën 101 %, me një tejkalim prej 880 milionë lekë. Për shkak të pandemisë dhe bllokimit të punës për periudha të caktuara kohe, këtë vit nuk u arrit të ketë rritje të të ardhurave kundrejt një viti më parë, por evidentohet një rënie me 780 milionë lekë. Natyrshëm rënia e të ardhurave është e shoqëruar edhe me rënien e numrit mesatar vjetor të kontribuesve si në bujqësi ashtu edhe në aktivitete jo bujqësore. Për periudhën raportuese numri mesatar i kontribuesve rezultoi të jetë 748 mijë persona, nga të cilët në aktivitet publik dhe jo bujqësor 642.5 mijë persona kundrejt 660.2 mijë persona që ishin një vit më parë me një rënie prej rreth 17.7 mijë persona.
- Përfitimet e pensionistëve në vitin 2019, pra transferuat në buxhetet familjare, nga fondet e sigurimeve shoqërore arritën në 128,945 milionë lekë, kundrejt 123,241 milionë lekë që ishin në vitin 2018, me një shtesë prej 5,704 milionë lekë me një rritje për 4,6 % më shumë se viti 2018.

Përfitimet e pensionistëve në vitin 2020, pra transfertat në buxhetet familjare, nga fondet e sigurimeve shoqërore arriti në 131,920 milionë lekë, kundrejt 128,945 milionë lekë që ishin në vitin 2019, me një shtesë prej 2,975 milionë lekë me një rritje për 2.3 % më shumë se viti 2019.

c) U zbatuan standarte të reja të shërbimit ndaj pensionistëve.

- Nga 38,738 pensione të reja në vitin 2019, 37,836 ose 98% janë caktuar brenda afateve ligjore, mesatarisht për 23 ditë, ndërkohë që janë caktuar jashtë afatit për arsye të ndryshme rreth 2% e kërkesave ose 902 pensione nga 4,6 % që ishte një vit më parë, duke e tejkaluar objektivin e përcaktuar për reduktim të numrit të pensioneve jashtë afatit me 30% ndaj vitit 2018.
 - Nga 38,039 pensione të reja në vitin 2020 të caktuara në zbatim të ligjit nr. 7703/1993, i ndryshuar, 36,695 ose 96 % janë lidhur brenda afateve ligjore, me një kohë mesatare 25 ditë, ndërkohë që janë caktuar jashtë afatit për arsye të ndryshme rreth 4 % ose 1,344 pensione. Këta tregues janë afërsisht në nivelin e vitit të kaluar dhe është arritur objektivi në reduktimin e kohës dhe të pensioneve jashtë afatit së paku me rreth 5 %.
- Gjatë vitit 2020, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj pensionistëve dhe shmangien e proceseve gjyqësore, nëpërmjet zgjidhjeve administrative, është përmirësuar puna e Komisioneve të Pensioneve në Degët e Përfitimeve. Nga 2,421 raste të shqyrtuara janë zgjidhur në rrugë administrative 2,063 raste për të cilat janë marrë vendime pozitive nga Degët e Përfitimeve duke eliminuar ndjekjen e procedurave gjyqësore.
- Në fushën e përfitimeve, u zbatuan standarte të reja të shërbimit ndaj pensionistëve, si nëpërmjet implementimit në tërësi të procesit të derregulimit, zgjerimit të zyrave të pritjes dhe koordinimit të saj me zyrat ADISA, ashtu edhe nëpërmjet zgjerimit hap pas hapi të sistemit të aplikimit on-line.

Si objektiva të cilat kanë paraqitur probleme në përmbushjen e plotë të indikatorëve të vendosur dhe kërkojnë fokus më të madh në kuadër të implementimit të plotë **në kuadër të strategjisë kombëtare 2019-2023 evidentojmë:**

Indikatori: Përsheptimi i ritmeve për dixhitalizimin e listëpagesave të kontributeve për periudhën 1994- 2011. Përditësimi i bazës së të dhënave për kontributet dhe periudhat e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

sigurimit të periudhës 2012 e në vazhdim dhe informimi i vazhdueshëm i organeve vendimmarrëse dhe ekzekutuese në MFE dhe DPT, për mbledhjen e borxheve kontributive të subjekteve ndaj personave të punësuar.

Risku: Mosrealizimi i dhënies së të drejtave të përfitimeve në cilësinë dhe kohën e duhur duke krijuar problematika në marrëdhëniet me qytetarët vjen edhe për shkak se ende nuk janë të dixhitalizuara periudhat kontributive 1994-2011, por edhe për shkak të mos pagesave të kontributeve dhe borxheve të kompanive, problematika që mbeten për zgjidhje në periudhën në vazhdim.

Indikatori: Zbatimi i sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe të thellimit të parimit kontributiv të sistemit. Vendosja e një shtese pensioni në rastet kur pensionistet e punësuar kanë terhequr pensionin por edhe kanë paguar kontribute.

Risku: Mos miratimi i projekt ligjit të paraqitur nga ISSH pranë Këshillit të Ministrave, për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në nenin 4 citohet “Përfituesi i pensionit të pleqërisë, kur punësohet në sektorin privat, paguan kontributet e sigurimeve shoqërore dhe njëkohësisht vazhdon të tërheqë këstin mujor të pensionit, merr shtesë mbi pension në masën 0.20% të pensionit për çdo muaj që ka paguar kontribut. Kjo shtesë jepet me kërkesë të personit të interesuar dhe llogaritet e fillon të paguhet nga data kur ndërpritet punësimi ose veprimtaria ekonomike si punëdhënës apo i vetëpunësuar.”

Indikatori: Rritja e performancës së punës në lidhje me afatet e caktimit të pensioneve të invaliditetit.

Risku: Performanca e punës në lidhje me afatet e caktimit të pensioneve të invaliditetit, ku procedurat zgjaten për pasojë të ekzaminimeve mjekësore shtesë të kërkuara nga mjekët e komisioneve, paraqitjes me vonesë në KMCAPI të të interesuarve, ashtu edhe për rastet kur komisionet rajonale nuk arrijnë të marrin vendime kolegjiale dhe dosjet kalojnë për vlerësim në KMCAPI-in Epror. Për vitin 2020 në afatet e caktimit të pensioneve të invaliditetit kanë rezultuar me vonesa, të cilat në më të shumtën i referohen pamundësisë së kryerjes së ekzaminimeve mjekësore në rast rikomisionimi. Gjatë vitit 2020 komisionet mjekësore kanë shqyrtuar 35.292 raste nga të cilat janë konsideruar të rikuperuara dhe pa grup rreth 8,6 % e tyre.

Problematikë e përhershme mbetet dialogu zyrtar midis ekspertizës mjekësore të ISSH me strukturat mjekësore, spitalore apo të poliklinikave lidhur me përcaktimin e diagnozave në fletët e drejtimit për komision, të cilat shpesh përcaktohen jo mbi bazën e ekzaminimeve përkatëse, sipas protokollit. Po kështu një problematikë dhe divergjencë e të njëjtës natyrë si më lart është edhe paraqitja e dokumentacionit mjekësor dhe rekomandimi për rifutje në skemën e përfitimeve në një afat të shkurtër pas një vendimi pa grup nga KMCAPI-i Epror, për të njëjtën patologji, duke mos u dërguar për konfirmim në KMCAPI-in Epror, të cilat së paku kanë një përbërje profesionale, elitare të fushës.

Indikatori: Ndjekja dhe evadimi i borxheve, marrja e dokumentacionit dhe evidentimi i llogarive individuale të kontribuesve është një fushë risku me impakt të madh financiar dhe social.

Risku: Nivel shumë i lartë i detyrimeve për kontribute të papaguara në subjektet juridike dhe fizike të cilat pasohen nga probleme financiare dhe sociale.

Indikatori: Vlerësimi i kërkesave dhe dokumentave të dorëzuara për përfitim, verifikimi i kërkesës me dokumentet arkivore, plotësimi i dosjes së përfitimit, caktimi i përfitimit, kthim përgjigje për problemet, zbatimi i afateve ligjore dhe objektive.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Risku: Mangësi administrative në zbatimin e përgjegjësisë të posteve tëëork-floë të konformimit dhe gjenerimit të përfitimeve për pagesë. Nuk është përlogaritur drejt baza e vlerësuar si dhe vitet e sigurimit, për shkak të mos sigurimit të dokumenteve, vonesave në proceset gjyqësore, moszbatim të koeficientëve të indeksimit, mostrajtimi i njëjtë nga ana e DRSSH-vepër probleme të njëjta përsa i përket mënyrës së llogaritjes së pensioneve.

Indikatori: Hartimi i një buxheti sa më real e i mirë studiuar me qëllim garantimin e përfitimeve në nivele të pranueshme dhe të harmonizuara me politikat dhe objektivat konkrete të Qeverisë në këtë fushë, si edhe për të mundësuar plotësimin në mënyrë të mjaftueshme të gjithë nevojave për fonde e shpenzime për funksionimin dhe kryerjen e detyrave të çdo Drejtorie Rajonale. Përmirësimi i standardeve të mbajtjes së evdientës kontabile me sistemin financiar ORACLE. Pasqyrimi i të gjitha veprimeve financiare parashikuar në rregulloren financiare dhe legjislacionin si dhe akteve administrative të nxjerra nga Këshilli Administrativ i ISSH -së nëpërputhje me Statutin e ISSH-së dhe Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Risku: Mangësi në identifikimin e numrit të ri të përfituesve për shkak të emigracionit dhe programimit të përafërt të pensioneve të pleqërisë invaliditetit dhe familjar, që mbyllen. Mangësi në identifikimin e periudhave të sigurimit dhe të pagës mesatare, për shkak të problematikave të bazës së të dhënave të periudhës deri në vitin 1991 dhe të bazës së vlerësuar në letër të periudhës 1994-2011. Kufizim të fondeve për mbulimin e nevojave të modernizimit të sistemit, sidomos të fondeve për dixhitalizimin e informacionit arkivor të periudhave të sigurimit. Fonde të kufizuara për investime, për ndërtimin e një qendre unike të caktimit, administrimit dhe gjenerimit për pagesë e kontroll të pagesave të pensioneve.

Indikatori: Verifikimi i zbatimit të Rregullores nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar për cdo pension të caktuar. Cilësia e inspektimit, përpilimi i raporteve në përputhje me legjislacionin dhe terminologjinë e audituesit.

Risku: Vonesa në inspektimin e përfitimeve (krahasuar me momentin e caktimit të përftimit) pasi për arsye të kapaciteteve inspektuese, është krijuar stoku ndër vite i dosjeve të pakontrolluara në kohë (deri në tre vite), konkluzione jo të qarta lidhur me auditimin e kryer, komunikim zyrtar jo sipas standardeve dhe rregullores së brendshme të rezultateve të auditimit, auditimi jo adekuat i masave të zbatuara si dhe risku i inefficencës së punës inspektuese.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt konstatimi Nr.6 datë 27.04.2021 i dorëzuar e protokolluar në ISSH. Në lidhje me këtë akt nuk u paraqitën vërejtje nga personat me të cilën u mbajt.

Titulli i Gjetjes	Problematicë në zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH lidhur me dërgimin e listëpagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012.
Situata	Në fund të vitit 2019 rezultojnë gjithsej 1,506,140 listëpagesa të munguara prej të cilave, 1,423,634 ose rreth 94.5% janë listëpagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznes i vogël); 78,804 ose 5.32% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,702 apo 0.25% janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Nga 1,506,140 listëpagesa të munguara gjithsej në fund të vitit 2019, në Drejtorinë Rajonale Tiranë ku siç dihet është e përqëndruar dhe pjesa më e madhe e biznesit, rezultojnë 1,293,715 listëpagesa të munguara gjithsej apo 86% të numrit të përgjithshëm të listëpagesave të munguara, në shkallë vëndi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në fund të vitit 2020 rezultojnë gjithsej 1,501,931 listëpagesa të munguara (4,209 më pak krahasuar me vitin 2019), prej të cilave 1,421,307 ose rreth **94.6%** janë listëpagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznes i vogël); 77,033 ose **5.13%** janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,591 apo **0.24%** janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Nga 1,501,931 listëpagesa të munguara gjithsej në fund të vitit 2020, në Drejtorinë Rajonale Tiranë ku siç dihet është e përqëndruar dhe pjesa më e madhe e biznesit, rezultojnë 1,290,569 listëpagesa të munguara gjithsej apo 86% të numrit të përgjithshëm të listëpagesave të munguara, në shkallë vëndi.

Strukturat përgjegjëse në ISSH kanë realizuar përditësimin e gjendjes së mungesave të listëpagesave, nëpërmjet ballafaqimit të listës së subjekteve me status pasiv (subjekte pasive të periudhës 01.01.2006 – 31.12.2012) me listën e subjekteve me mungesa të listëpagesave përgjatë viteve 2006-2012. Gjatë vitit 2019 u janë dërguar nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve, gjithsej 14,283 listëpagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012 prej të cilave, 832 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 2,106 listëpagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 11,345 listëpagesa të subjekteve biznes i vogël, pra volumin më të madh të listëpagesave të munguara e ka biznesi i vogël.

Gjatë vitit 2020 u janë dërguar nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve, gjithsej 4,209 listëpagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012 prej të cilave, konkretisht janë 111 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 1,771 listëpagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 2,327 listëpagesa të subjekteve biznes i vogël.

Këto biznese përgjithësisht janë “Të vetpunësuar të vetëm”, por një pjesë e tyre janë persona “Të vetpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë” sic janë anëtarë të tjerë të familjes që punojnë e jetojnë me të vetpunësuarin (bizneset e vogla përgjithësisht janë biznese që administrohen nga burrëgrua). Sipas marrëveshjes ISSH-DPT pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për këtë kategori biznesi do të merren si listëpagesa të mirëfillta. ISSH, ka marrë bazën analitike të pagesave që këto biznese kanë kryer. Bazuar në këto të dhëna ekziston mundësia që të krijohet një bazë të dhënash edhe pse mungojnë listëpagesat.

Kriteri

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Marrëveshja e bashkëpunimit me nr.1142, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT, etj .

Ndikimi/Efekti

Punëmarrës, të cilët në kushtet e mungesës së listëpagesave nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Rëndësia

I Lartë

Rekomandimi

ISSH të zhvillojë një program informatik, nëpërmjet të cilit të mundësojë krijimin e bazës së të dhënave për personat “Të vetpunësuar të vetëm”,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

duke përdorur informacionin e marrë zyrtarisht nga DPT, me synim zgjidhje në mbi 80% të rasteve, për këtë kategori personash, që rezultojnë me listë pagesa të munguara. Për personat “Të vetëpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë”, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, ISSH të marrë masa që të kryejë njoftime dhe në rastet pa adresë të bëjë fushatë sensibilizimi, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listë pagesave për këtë kategori

Titulli i Gjetjes

Mbi realizimin e objektivave të strategjisë dhe vlerësimi i indikatorëve të parashikuar që vënë në rrezik arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit.

Situata

Strategjia afatgjatë e sistemit të sigurimeve shoqërore e materializuar në Dokumentin e Politikave të Pensioneve të miratuara nga Qeveria, tashmë e institucionalizuar dhe e miratuar në Kuvendin e Shqipërisë me Ligjin nr.104/2014 në themel të saj ka: Respektimin e të drejtave financiare të fituara, duke i garantuar dhe zhvilluar ato; Formatimin e një sistemi pensionesh në përgjithësi dhe veçanërisht të pensioneve individuale të varura drejtpërdrejt nga kontributet e paguara, nëpërmjet të cilit standartizon dhe ruan në një shkallë të pranueshme raportin pagë/pension në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë; Një qëndrueshmëri fiskale të sistemit të përmirësuar në një periudhë afatmesme.

Gjatë periudhës objekt auditimi (2019-2020), ISSH, si institucion përgjegjës për zbatimin e objektivave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, është fokusuar në disa drejtime kryesore si: Vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve; Zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve, nëpërmjet indeksimit të përfitimeve të caktuara, indeksimit të pagave referuese për përfitimet e reja të vitit e në vazhdim, si dhe nëpërmjet zbatimit të një praktike tashmë të konsoliduar, që është bonusi (shpërblimi) vjetor i pensionistëve; Vazhdimi i punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i një sistemi të automatizuar të autorizimit dhe pagesave online, etj. Si objektiva të cilat kanë paraqitur probleme në përmbushjen e plotë të indikatorëve të vendosur dhe kërkojnë fokus më të madh në kuadër të implementimit të plotë në kuadër të strategjisë kombëtare 2019-2023 evidentojmë:

- Niveli shumë i lartë i detyrimeve për kontribute të papaguara në subjektet juridike dhe fizike të cilat pasohen nga probleme financiare dhe sociale.
- Mangësi administrative në zbatimin e përgjegjësisë të posteve të ëork-floë të konformimit dhe gjenerimit të përfitimeve për pagesë. Nuk është përlllogaritur drejt baza e vlerësuar si dhe vitet e sigurimit, për shkak të mos sigurimit të dokumenteve, vonesave në proceset gjyqësore, moszbatim të koeficientëve të indeksimit, mostrajtimi i njëjtë nga ana e DRSSH-ve për probleme të njëjta përsa i përket mënyrës së llogaritjes së pensioneve.
- Hartimi i një buxheti sa më real e i mirë studiuar me qëllim garantimin e përfitimeve në nivele të pranueshme dhe të harmonizuara me politikat dhe objektivat konkrete të Qeverisë në këtë fushë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	d) Mangësi në identifikimin e numrit të ri të përfituesve për shkak të emigracionit dhe programimit të përafërt të pensioneve të pleqërisë invaliditetit dhe familjar, që mbyllen. e) Vonesa në inspektimin e përfitimeve (krahasuar me momentin e caktimit të përfitimit). f) Vonesa në dixhitalizimin e listëpagesave të kontributeve për periudhën 1994- 2011.
Kriteri	Ligji nr.104/2014, datë 31.07.2014, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar; Ligji nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Rregullorja nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar .
Ndikimi/Efekti	Risku i mosrealizimit të objektivave strategjike në fushën e pensioneve.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse në ISSH me synim arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e indikatorëve të vendosur në plan veprimin e zbatimit të strategjisë afatmesme, me synim minimizimin e risqeve, që vëne në rrezik përmbushjen e indikatorëve të vendosur me fokus, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimin e deficitit të skemës së pensioneve duke synuar rritjen graduale, por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

III.2.B/4. Testimi i sistemeve të kontrollit lidhur me përputhshmërinë e pagesave të pensionistëve. Niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike. Çështjet gjyqësore, ndjekja e tyre dhe efektet në sigurimet shoqërore.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi.

- Marrëveshja shtesë nr 2038, datë 12.06.2014’ Për pagesën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore’
- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar etj.

Nga auditimi u konstatua:

Viti 2019

Testimi i sistemeve të kontrollit lidhur me përputhshmërinë e pagesave të pensionistëve.

Shërbimi i pagesave të pensioneve realizohet nëpërmjet Postës Shqiptare në zbatim të marrëveshjes nr.4357, datë 21.08.2008 dhe marrëveshjes shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 ‘ Për pagesën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, lidhur ndërmjet ISSH dhe Postës Shqiptare. Pagesat e pensioneve dhe kontrolli i pagesave kryesisht, kryhet nëpërmjet sistemit të informatizuar në të gjitha qendrat e pagesës në Qytete si dhe në disa qendra të banuara në fshatra, ndërsa për qendrat e painformatizuara, çdo pagesë dokumentohet me mandat pagese të plotësuar me dorë e cila shkarkohet e kontrollohet në sistem. Një ndër detyrat kryesore që lidhet me administrimin e shpenzimeve është kontrolli i plotë i të gjithë pagesave që kryhen, për çdo muaj dhe në mënyrë të veçantë gjendja e pagesave të kryera në momentin e mbylljes së një përfitimi, kryesisht për shkak të vdekjeve. Gjatë kontrolleve të kryera nga Sektori i Kontrollit të Pagesave, janë gjetur shkelje të natyrave të ndryshme si: dublim pagesash, pagesa pas vdekjes, pagesa marrë tepër ose jashtë afatit. Në të gjitha rastet për këto shkelje janë mbajtur proces-verbale, akt-konstatime ose akt-rakordime sipas natyrës përkatëse.

Nga grupi i audituesve u përzgjedh mbi bazë risku muaji dhjetor 2019, për të verifikuar saktësinë e dërgimit të evidencave të realizimit të kontrollit të pagesave nga Drejtoritë Rajonale në sektorin e kontrollit të pagesave në I.S.SH.

Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor dërguar nga 12 Rajonet përkatëse, rezulton se është përpiluar tabela përmbledhëse e realizimit të kontrollit të pagesave për muajin dhjetor 2019. Për çdo shkelje të evidentuar nga inspektorët e kontrollit të pagesave të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore është mbajtur akt konstatimi përkatës, duke evidentuar vlerën e shkeljes, si dhe natyrën e shkeljes. Për çdo rajon është paraqitur dokumentacioni i arkëtimit të debitorëve, ku pasqyrohen dokumentat bankare lidhur me arkëtimet për secilin debitor. Nga të dhënat në dispozicion rezulton se degët rajonale nuk raportojnë mbi numrin e inspektorëve që marrin pjesë në kontrollet e pagesave.

Në total, për të gjithë rajonet janë konstatuar fonde të dëmtuara në 861 raste në shumën 20,486,744 lekë, si më poshtë vijon:

Nr.	Rajonet	Nr. Raste	Zbulime Nëlekë	NGA KËTO:						Arkëtuar Nëlekë
				Dublimpagese		Tëvdekur		Pagesatëpër e jashtëafatit		
				Nr. Raste	Shuma Nëlekë	Nr. Raste	Shuma Nëlekë	Nr. Raste	Shuma Nëlekë	
1	Berat	21	631,833	-	-	5	166,262	16	465,571	631,833
2	Dibër	103	2,154,188	6	186,151	81	1,630,993	16	337,044	2,138,285
3	Durrës	94	2,507,773	43	1,047,984	51	1,459,789	-	-	2,507,773
4	Elbasan	10	113,160	-	-	10	113,160	-	-	113,160
5	Fier	157	3,794,102	2	58,578	114	2,197,833	41	1,537,691	3,794,102
6	Gjiokastër	53	1,031,179	3	64,578	49	959,160	1	7,441	907,652
7	Korçë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	Kukës	40	1,106,406	3	383,626	34	691,794	3	30,986	1,106,406
9	Lezhë	57	820,404	6	93,724	47	608,084	4	118,596	820,404
10	Shkodër	58	2,547,701	-	-	51	2,432,732	7	114,969	2,547,701
11	Tiranë	185	4,169,943	1	10,053	177	4,046,367	7	113,523	3,452,297
12	Vlorë	83	1,610,055	-	-	83	1,610,055	-	-	1,429,923



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	TOTALI	861	20,486,744	64	1,844,694	702	15,916,229	95	2,275,821	19,449,536
--	---------------	------------	-------------------	-----------	------------------	------------	-------------------	-----------	------------------	-------------------

Burimi Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Për vitin 2019 shkeljet e konstatuara sipas natyrës renditen në:

- 64 raste, ose 7% e rasteve, dublim pagese në shumën 1,844,694 lekë;
- 702 raste, ose 82% e tyre, pagesa pas vdekjes në shumën 15,916,229 lekë;
- 95 raste, ose 11% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 2,275,821 lekë.

Nga 861 raste shkeljesh të konstatuara, në 702 raste ose në 82% të tyre, shkeljet konsistojnë në pagesa të kryera pas vdekjes.

Dëmet e shkaktuara nga pagesat e kryera pas vdekjes zënë 77% të totalit të fondeve të dëmtuara gjatë vitit 2019.

Rajoni me zbulimet më të mëdha në dublim pagesash është Durrësi me 43 raste në shumën 1,047,984 lekë. Rastet e dublimit të pagesës lidhen kryesisht me pagesat në ato banka që ende nuk janë pjesë e sistemit on line, pra ku sistemi vetbllokon. Rastet e dublimeve konstatohen në muajin e ardhshëm, pasi kontrolli i pagesave realizohet duke krahasuar pagesat e gjeneruara nga baza e të dhënave me njoftimin e pagesave faktike të kryera.

ISSH ka të ndërtuar dhe tashmë zbaton një sistem rregullash dhe procedurash teknike të kalimit në sistemin on line të bankave. Ky sistem zbatohet për mbi 60 % të pagesave. Jashtë këtij sistemi janë kryesisht bankat e nivelit të dytë. Nga informacioni i disponuar rezulton se ISSH ka realizuar disa takime në të cilat është rënë parimisht dakord, që këto banka të kalojnë në sistemin on-line të pagesave të pensioneve.

Rajonet me zbulimet më të mëdha në pagesa pas vdekjes janë: Tirana me 177 raste në shumën 4,046,367 lekë dhe Fieri me 114 raste në shumën 2,197,833 lekë. Përsa i përket pagesave pas vdekjes, në plan të parë mbetet ndjekja e arkëtimeve.

Rajoni me zbulimet më të mëdha në pagesa tepër ose jashtë afatit është Fieri me 41 raste në shumën 1,537,691 lekë.

Brenda vitit 2019 është arkëtuar shuma prej 19,449,536 lekë, ose 95 % e totalit të fondeve të dëmtuara. Rajonet të cilët nuk kanë arritur, brenda vitit, të rikuperojnë fondet e dëmtuara nëpërmjet arkëtimit janë: Dibra, Gjirokastra, Tirana dhe Vlora.

Grupi i auditimit verifikoi dhe pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për fondet e dëmtuara të vitit 2019, nga ku rezultoi se kanë mbetur pa paarkëtuar gjithsej 36 raste në rajonin e Tiranës, të gjitha me autorizim ose prokurë, me shumë 534,866 lekë ose rreth 3% e tyre. *Në marrëveshjen shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare nuk parashikohet në asnjë dispozitë mënyra e rekuperimit të këtyre fondeve të paguara me prokurë në rast të vonësve në arkëtimin e tyre, si dhe nga ana e I.S.SH nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim në rekuperimin e fondeve.*

Krahasuar me një vit më parë, kur dëmet nga pagesat e tepërta ishin rreth 68 milionë lekë, konstatohet një punë më e kujdesshme dhe në korniza ligjore e të gjithë filialeve të Postës Shqiptare. Për më tepër brenda vitit është arkëtuar mbi 95 %. Në këtë çështje efekt pozitiv ka pasur kalimi në sistemin e informatizuar të të gjithë zyrave të pagesës së pensioneve.

Nga auditimi konstatohet se risku në verifikimin e dokumentacionit vlerësohet vetëm në rastet e mos deklarimit të vdekjes nga anëtarët e familjes së personave që banojnë jashtë shtetit dhe në rekuperimin e fondeve të dëmtuara për pagesat pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë.

Niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2019 paraqitet në shumën 18.1 miliard lekë, ndërkohë që deri në fund të vitit 2019 debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 12.6 mld lekë, pra **niveli i borxhit është sa 70% e deficitit të skemës së qytetit.**

Në lidhje me saktësinë dhe vërtetësinë e tabelës përmbledhëse të paraqitur nga ISSH për numrin dhe vlerën e detyrimeve për sigurimet shoqërore për vitin 2019, nga grupi I auditimit u morrën të dhënat origjinale të dërguara nga DPT në ISSH. Për shkak të volumit të madh të informacioni i dërguar nga DPT është marrë me CD nga ISSH, ku janë grupuar në 86.558 rekorde, aq sa është dhe nr i subjekteve debitoare (të detajuar me Niptet përkatëse). Ky dokument elektronik pasi vjen nga DPT, nga përgjegjesi i sektorit të mardhënieve me DPT, i dërgohet të 12 rajoneve për ta përpunuar, të cilat i dërgojnë tabelat përmbledhëse pas përpunimit te përgjegjesi i sektorit të mardhënieve me DPT, i cili nxjerr të dhënat përfundimtare të numrit të subjekteve debitoare, detyrimin sipas rajoneve etj.

Të dhënat për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat nga subjektet buxhetore, jobuxhetore, biznes i madh dhe biznes i vogël deri më datë 31.12.2019 krahasuar me numrin dhe detyrimet e tyre paraqiten si vijon:

Në mijë lekë

Nr	EMERTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet debitoare (deri me date 31.12. 2019)		Detyrimet e papaguara nga subjektet debitoare (deri me date 31.12. 2018)		Diferencat krahasuese 31.12.2019 me 31.12.2018)	
		Nr. i subjekteve debitoare	Detyrimet e prapambetura - ne mije leke	Nr. i subjekteve debitoare	Detyrimet e prapambetura - ne mije leke	Nr. i subjekteve	Detyrimet e prapambetura - ne mije leke
1	Buxhetorë	492	452,490	723	629,191	-231	- 176,701
2	Jobuxhetorë	259	413,833	253	287,530	6	126,303
3	Biznes i Madh	22,346	8,115,825	18,621	7,487,153	3,725	628,672
4	Biznes i Vogël	63,461	3,654,207	53,143	3,528,844	10,318	125,363
	SHUMA	86,558	12,636,356	72,740	11,932,717	13,818	703,639

Burimi Instituti I Sigurimeve Shoqërore

Në vitin 2019, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 86,558 ose 13,818 subjekte më shumë se në vitin 2018.

Shuma totale e debisë në vitin 2019 arriti në 12.6 miliard lekë ose 0.7 miliard lekë më shumë se në vitin 2018.

Numri i subjekteve debitorë është rritur me 19%, ndërkohë që debia është rritur në masën 5.9% krahasuar me vitin 2018.

Debitorët sipas DRT, në datë 22.01.2020 dhe sipas formës juridike paraqiten si vijon:

Në lekë

DRT	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	168,374	21,118	10,922	200,414
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	218,107	27,710	14,213	260,030
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	139,194	4,649	981	144,824
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	1,464,280	216,464	115,417	1,796,161
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	360,827	51,856	22,246	434,929
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	487,237	77,618	46,645	611,500
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	159,163	27,270	25,009	211,441
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	355,756	51,658	33,293	440,707
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	190,800	37,076	49,326	277,201
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	318,419	31,173	21,922	371,514
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	123,610	18,243	9,337	151,191
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	518,930	78,327	28,965	626,223
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	5,387,280	713,174	368,776	6,469,230
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	517,729	75,430	47,831	640,991
Total	10,409,704	1,431,768	794,884	12,636,356

Burimi Instituti I Sigurimeve Shoqërore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Borxhi prej 12.6 miliard lekë u përket 86,558 subjekteve, prej të cilave: 39,626 subjekte ose 46% e tyre janë subjekte aktive me një debi në shumën 6,4 mld lekë, ose 51% e debisë totale; 35,897 subjekte ose 41% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 5,7 mld lekë, ose 45% e debisë totale; 3 janë subjekte të crregjistruara me debi prej 7,515 lekë; 11,031 janë subjekte që kanë bërë kërkesë për crregjistrim me debi në shumën 0.5 mld lekë dhe vetëm 1 subjekt i falimentuar me debi në shumën 10,000 lekë.

Të dhëna mbi 50 Subjektet me debinë më të lartë nga secili sektor paraqiten në Aneksin nr.1.

❖ **Subjekte buxhetorë debitorë** për kontributet e sigurimeve shoqërore rezultojnë 492 subjekte me debi totale në shumën 452,490 mijë lekë, nga 723 subjekte që ishin në vitin 2018. Ka një përpjekje të subjekteve buxhetore për të shlyer detyrimet e prapambetura, por përsëri niveli i borxhit është i pajustificueshëm.

Për 50 subjektet buxhetorë me debinë më të lartë borxhi arrin në shumën 418,735 mijë lekë nga 452,490 mijë lekë që është debia totale e subjekteve buxhetore, ose 92.5% e totalit të debisë për subjektet buxhetorë.

Në 50 subjektet buxhetore debitorë me debinë më të lartë përmendim: Repartet Ushtarake: 6619, 1109; Bashkitë: Kukës, Tepelenë, Shkodër, Vau i Dejës, Rrogozhinë, Dibër; Komunitat: Ndroq, Milot, Arren, Kolsh, Kodër Thumanë, Surroj, Shishtavec, Shtiqen; Drejtoria Vendore e ASHK Tiranë Rurale 1, etj.

ISSH me shkresën nr.2933, datë 17.04.2019 ka informuar Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve në lidhje me numrin e subjekteve debitorë dhe detyrimet e prapambetura të tyre në organet tatimore deri në datë 31.12.2018.

Në vijim të informacionit të dhënë nga ISSH, MFE me shkresat nr.5964, dhe nr.5965, datë 06.09.2019 i është drejtuar Bashkive, për mbledhjen e detyrimeve të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore. Nëpërmjet këtyre shkresave MFE kërkon në mënyrë urgjente rakordimin dhe DPT dhe ISSH si dhe skedulimin e pagesave për detyrimin e evidentuar dhe planifikimin për shlyerje deri në datë 31.12.2019. Gjithashtu MFE me shkresën nr.19254, datë 25.10.2019 ka kërkuar nga Bashkitë të cilat për shkak të pamundësisë financiare nuk kanë planifikuar shlyerje detyrimi deri në datë 31.12.2019, të riskedulojnë pagesat duke planifikuar shlyerjen përgjatë vitit 2020. ***Në shkresë citohet se, në zbatim të pikës 114 të Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk do të autorizojë asnjë pagesë përveç pagave, nëse nuk respektohet skeduli i shlyerjes së stokut të detyrimeve për sigurimet shoqërore.***

Nga informacioni i disponuar rezulton se për 50 debitorët më të mëdhenj institucione buxhetore niveli i debisë paraqitet si vijon:

Detyrimi në shumën 121,559,022 lekë nga 150,872,010 lekë në fund të vitit 2019, pra është ulur me vetëm 29,312,988 lekë ose në masën 19.4%;

Gjjobat në shumën 99,689,169 lekë nga 99,315,583 lekë në fund të vitit 2019, rritur me 373,586 lekë;

Interesat në shumën 174,212,585 lekë nga 168,547,147lekë në fund të vitit 2019, rritur me 5,665,438 lekë;

Debia totale për 50 debitorët më të mëdhenj institucione buxhetore në shumën 395,460,776 lekë nga 418,734,740 lekë që rezultonte në fund të vitit 2019, ulur me vetëm 23,273,964 lekë ose në masën 5.5%.

Ulja me vetëm 5.5% të nivelit të debisë (për 50 debitorët më të mëdhenj institucione buxhetore), tregon mungesë efektiviteti në masat e marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe D.P.T për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura nga institucionet buxhetore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi i të dhënave të debitorëve, subjekte buxhetore, për vitin 2019 rezulton se:

-Në total janë 492 subjekte buxhetore debitorë për sigurimet shoqërore në shumën totale prej 452,490,615 lekë, prej të cilave, 170,968,131 lekë principali, 107,497,837 lekë gjobat dhe 174,024,647 lekë interesat;

Nga 492 subjekte buxhetore debitorë për sigurimet shoqërore, **200 subjekte ose 40.6% të subjekteve e kanë principalin 0, që do të thotë, në këto subjekte nuk ka punëmarrës të pasiguruar.**

Debia totale e këtyre 200 subjekteve buxhetore me detyrim principal 0, në shumën 59,812,656 lekë, konsiston në 23,674,741 lekë gjoba dhe 36,137,915 lekë interesa.

Në trajtimin makro që i bëhet kësaj çështje detyrimet kontributive të sektorit publik, trajtohen si detyrime të shtetit dhe fondet për mbulimin e tyre janë brenda buxhetit të ISSH.

❖ **Subjekte shtetërore jobuxhetore debitorë** për sigurimet shoqërore për vitin 2019 rezultojnë në total 259, nga 253 subjekte që ishin në vitin 2018, me debi totale në shumën 0.4 mld lekë. Ndërkohë që si numër subjektet jobuxhetore debitorë janë rritur me 6 debia rezulton e rritur në masën 44% më shumë se në vitin 2018.

Për 50 subjektet jobuxhetore me debinë më të lartë borxhi arrin në shumën 399,852 mijë lekë nga 413,833 mijë lekë që është debia totale e subjekteve jobuxhetore, ose 97% e totalit të debisë për subjektet jobuxhetore.

Në 50 subjektet jobuxhetore debitorë me debinë më të lartë përmendim: Sh.a Ujësjellës kanalizimet; Klubet e Futbollit dhe ato shumësportesh; Qendra Shëndetësore, etj

❖ **Subjekte juridike debitorë** për sigurimet shoqërore për vitin 2019 rezultojnë në total 22,346, nga 18,621 subjekte që ishin në vitin 2018, me debi totale në shumën 8.1 mld lekë. Pas 22,346, subjekteve juridike debitorë qëndrojnë individë të punësuar në këto subjekte të cilët për këtë pjesë detyrimi të palikuiduar nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Për 50 subjektet juridike me debinë më të lartë borxhi arrin në shumën 2 miliard lekë nga 8.1 miliard lekë që është debia totale e subjekteve juridike, ose 25% e totalit të debisë për subjektet juridike.

Në 50 subjektet juridike debitorë me debinë më të lartë përmendim: A, A, A, V etj...

Nga auditimi rezulton një bashkëpunim jo shumë efektiv midis I.S.SH dhe strukturave përgjegjëse në DPT dhe DRT të cilat sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 3;4 & 14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, realizojnë mbledhjen dhe transferimin në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës prej 12.6 miliard lekë, ku nga njëra anë rezultojnë të ardhura potencialisht të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Mospagesat e kontributeve nga ana e punëdhënësve për punëmarrësit e tyre, krijojnë deficit në fondin e sigurimeve shoqërore në tërësi dhe në mbulimin e shpenzimeve të programuara për pagesat e pensioneve në vecanti. Pas borxheve të subjekteve debitorë qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Viti 2020

Testimi i sistemeve të kontrollit lidhur me përputhshmërinë e pagesave të pensionistëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga grupi i audituesve u përzgjedh mbi bazë risku muaji dhjetor 2020, për të verifikuar saktësinë e dërgimit të evidencave të realizimit të kontrollit të pagesave nga Drejtoritë Rajonale në sektorin e kontrollit të pagesave në I.S.SH.

Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor dërguar nga 12 Rajonet përkatëse, rezultoi se është përpiluar tabela përmbledhëse e realizimit të kontrollit të pagesave për muajin dhjetor 2020. Për çdo shkelje të evidentuar nga inspektorët e kontrollit të pagesave të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore është mbajtur akt konstatimi përkatës, duke evidentuar vlerën e shkeljes, si dhe natyrën e shkeljes. Për çdo rajon është paraqitur dokumentacioni i arkëtimit të debitorëve, ku pasqyrohen dokumentat bankare lidhur me arkëtimet për secilin debitor.

Në total, për të gjithë rajonet janë konstatuar fonde të dëmtuara në 969 raste në shumën 18,364,470 lekë, si më poshtë vijon:

NR.	RAJONET	NR. RASTE VE	ZBULIME NE LEKE	NGA KETO:						ARKETUAR NE LEKE
				DUBLIM PAGESE		TE VDEKUR		PAGESA TEPER E JASHTË AFATIT		
				NR. RAST EVE	NE LEKE	NR. RASTEVE	NE LEKE	NR. RAST EVE	NE LEKE	
1	BERAT	12	257,576	-	-	5	151,300	7	106,276	257,576
2	DIBER	92	1,182,587	-	-	79	1,079,738	13	102,849	1,124,120
3	DURRES	59	1,061,896	16	370,153	43	691,743	-	-	1,061,896
4	ELBASAN	5	78,883	-	-	5	78,883	-	-	78,883
5	FIER	151	2,894,433	2	36,360	133	2,547,522	16	310,551	2,894,433
6	GJIROKASTER	107	1,609,969	23	247,982	76	1,337,987	8	24,000	1,610,779
7	KORCE	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	KUKES	42	610,450	1	42,371	30	529,079	11	39,000	610,450
9	LEZHE	79	1,543,803	3	77,103	76	1,466,700	-	-	1,543,803
10	SHKODER	53	2,488,885	-	-	52	2,442,973	1	45,912	2,488,885
11	TIRANE	250	4,221,885	1	64,880	245	4,128,794	4	28,211	3,354,660
12	VLORE	119	2,414,103	-	-	119	2,414,103	-	-	2,209,794
	TOTALI	969	18,364,470	46	838,849	863	16,868,822	60	656,799	17,235,279

Burimi: ISSH

Për vitin 2020 shkeljet e konstatuara sipas natyrës renditen në:

- 46 raste, ose 4.5% e rasteve, dublim pagese në shumën 838,849 lekë;
- 863 raste, ose 92% e tyre, pagesa pas vdekjes në shumën 16,868,822 lekë;
- 60 raste, ose 3.5% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 656,799 lekë.

Nga 969 raste shkeljesh të konstatuara, në 863 raste ose në 89% të tyre, shkeljet konsistojnë në pagesa të kryera pas vdekjes, ndërsa në vlerë monetare dëmet e shkaktuara nga pagesat e kryera pas vdekjes zënë 98% të totalit të fondeve të dëmtuara gjatë vitit 2020

Rajonet me zbulimet më të mëdha në pagesa pas vdekjes janë: Tirana me 245 raste në shumën 4,128,794 lekë dhe Fieri me 133 raste në shumën 2,547,522 lekë. Përsa i përket pagesave pas vdekjes, në plan të parë mbetet ndjekja e arkëtimeve.

Rajoni me zbulimet më të mëdha në pagesa tepër ose jashtë afatit është Fieri me 16 raste në shumën 310,551 lekë.

Nga informacioni i disponuar rezultoi se brenda vitit 2020 është arkëtuar shuma prej 17,235,279 lekë, ose 94% e totalit të fondeve të dëmtuara.

Arkëtimi i fondeve të dëmtuara është realizuar si vijon:

RAJONET	ARKETIMI I DEMIT			
	ARKETUAR NE LEKE	NGA KOMISIONI	ME MANDAT NE BANKE	LIKUJDUAR NGA POSTA ME XHIRIM
BERAT	257,576	61,270	144,602	51,704
DIBER	1,124,120	589,893	485,336	48,891
DURRES	1,061,896	-	370,153	691,743



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ELBASAN	78,883	28,799	50,084	-
FIER	2,894,433	-	2,894,433	-
GJIROKASTER	1,610,779	-	167,715	1,443,064
KORCE	-	-	-	-
KUKES	610,450	-	458,564	151,886
LEZHE	1,543,803	-	975,639	568,164
SHKODER	2,488,885	2,298,619	190,266	-
TIRANE	3,354,660	-	2,400,009	954,651
VLORE	2,209,794	616,694	1,593,100	-
TOTALI	17,235,279	3,595,275	9,729,901	3,910,103

Burimi: ISSH

Trendi i fondeve të dëmtuara tregon një punë më të kujdesshme të gjithë filialeve të Postës dhe Sektorit të kontrollit të pagesave, ku dëmet nga pagesat e tepërta janë ulur nga 68 milionë lekë në vitin 2018, në 19,5 milione në vitin 2019 dhe në 18,4 milionë në vitin 2020.

Grupi i auditimit verifikoi dhe pagesat e kryera deri në datën 19.04.2021 për fondet e demtuara të vitit 2020, nga ku rezultoi se janë pa arkëuar 29 raste, nga të cilët në Gjirokastrë janë 2 raste paarkëtuara në vlerë 123,527 lekë dhe në Tiranë janë 27 raste të paarkëtuara (të gjitha pagesa pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë), me shumë 593,884 lekë. *Në marrëveshjen mes ISSH dhe Postës Shqiptare nuk parashikohet në asnjë dispozitë mënyra se si këto fonde do të recuperohen në rast të vonësive në arkëtimin e tyre, si dhe nga ana e ISSH nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim në recuperimin e këtyre fondeve.*

Për vitin 2020 (si dhe për vitin 2019) problematikë mbeten pensionet që paguhen në bankë pasi nuk mund të realizohet kontrolli nga ana e strukturave për personat që vdesin deri në rinovimin e dokumentacionit një herë në 6 muaj të certifikatës së përfutësve.

Nga auditimi konstatohet se risku në verifikimin e dokumentacionit fokusohet vetëm në rastet e mos deklarimit të vdekjes nga anëtarët e familjes së personave që banojnë jashtë shtetit dhe në recuperimin e fondeve të dëmtuara për pagesat pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë.

Niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike.

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2020 paraqitet në shumën 19.2 miliard lekë, ndërkohë që deri në fund të vitit 2020 debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 14.4 miliard lekë, pra **niveli i borxhit është sa 75% e deficitit të skemës së qytetit.**

Të dhënat për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat nga subjektet buxhetore, jobuxhetore, biznes i madh dhe biznes i vogël deri më datë 31.12.2020 krahasuar me numrin dhe detyrimet e tyre paraqiten si vijon:

në mijë lekë

Nr	EMËRTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet debitore (deri më 31.12.2020)		Detyrimet e papaguara nga subjektet debitore (deri më 31.12.2019)		Diferencat krahasuese të datës 31.12.2020 me datën 31.12.2019	
		Nr. i subjekteve debitore	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve debitore	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë
1	Buxhetorë	491	385,683	492	452,490	(1)	(66,807)
2	Jobuxhetorë	296	339,582	259	413,833	37	(74,251)
3	Biznes i Madh	24,940	9,143,609	22,346	8,115,825	2,594	1,027,784
4	Biznes i Vogël	71,106	4,523,247	63,461	3,654,207	7,645	869,040
	SHUMA	96,833	14,392,121	86,558	12,636,356	10,275	1,755,765

Burimi Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në vitin 2020, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 96,833 ose 10,275 subjekte më shumë se në vitin 2019.

Shuma totale e debisë në vitin 2020 arriti në 14.4 mld lekë ose 1.8 mld lekë më shumë se në vitin 2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Numri i subjekteve debitorë është rritur me 12%, ndërkohë që debia është rritur në masën 14% krahasuar me vitin 2019.

Debitorët sipas DRT, në datë 25.01.2021 dhe sipas formës juridike paraqiten si vijon:

Në mijë lekë

Nr	RAJONET	NR. I SUBJEKT EVE SIPAS NIPT-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA
1	BERAT	2,583	192,058	23,491	12,867	228,416
2	DIBER	1,966	255,072	30,457	14,069	299,597
3	DURRES	11,002	1,431,212	207,060	106,925	1,745,198
4	ELBASAN	5,216	442,365	56,629	22,186	521,180
5	FIER	6,362	578,931	79,531	32,531	690,993
6	GJIROKASTER	1,648	151,867	27,914	22,457	202,238
7	KORCE	5,129	403,276	56,860	33,547	493,682
8	LEZHE	3,408	378,285	36,241	23,072	437,598
9	SARANDE	2,511	140,239	19,181	9,404	168,823
10	SHKODER	5,800	612,839	95,606	33,296	741,741
11	TIRANE	42,231	6,220,829	799,742	380,601	7,401,171
12	VLORE	5,709	599,064	81,239	49,721	730,023
13	KAVAJE	2,123	204,206	23,414	10,604	238,224
14	KUKES	971	134,766	30,863	32,751	198,379
	Shuma	96,659	11,745,009	1,568,226	784,030	14,097,265
15	VIP-AT	174	268,562	18,025	8,270	294,857
	TOTALI	96,833	12,013,571	1,586,251	792,301	14,392,122

Burimi Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Borxhi prej 14.4 miliard lekë u përket 96,833 subjekteve, prej të cilave: 45,818 subjekte ose 47% e tyre janë subjekte aktive me një debi në shumën 7,4 miliard lekë, ose 51% e debisë totale; 38,398 subjekte ose 40% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 6,3 miliard lekë, ose 44% e debisë totale; 3 janë subjekte të crregjistruara me debi prej 7,515 lekë; 12,613 janë subjekte që kanë bërë kërkesë për crregjistrim me debi në shumën 0.6 miliard lekë dhe vetëm 1 subjekt i falimentuar me debi në shumën 10,000 lekë.

Subjekte buxhetorë debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore rezultojnë 474 subjekte me debi totale në shumën 395,951 mijë lekë, nga 492 subjekte me debi totale në shumën 452,490 mijë lekë. Ka një përpjekje të subjekteve buxhetore për të shlyer detyrimet e prapambetura, **por përsëri niveli i borxhit është i pajustificueshëm.**

Për 50 subjektet buxhetorë me debinë më të lartë borxhi arrin në shumën 361,707 mijë lekë nga 385,683 mijë lekë që është debia totale e subjekteve buxhetore, ose 93.8% e totalit të debisë për subjektet buxhetorë.

Në 50 subjektet buxhetore debitorë me debinë më të lartë përmendim: Reparti Ushtarak 4303, Bashkia Kukës, Reparti Ushtarak 4460, Reparti Ushtarak 6619, Drejtoria Vendore E Ashk, Tirane Rurale 1, Reparti Ushtarak 4006, Komuna Ndroq etj...

ISSH me shkresën nr.509 datë 22.01.2021 ka informuar Drejtorinë e Përgjithshëm të Tatimeve në lidhje me numrin e subjekteve debitorë dhe detyrimet e prapambetura të subjekteve Ujësjellës kanalizime. Në vijim të informacionit rezultojnë se janë 41 subjekte debitorë me vlerën totale të debisë prej 242,317,962 lekë, ku situata paraqitet si vijon:

Vlera e kësaj debie shtrihet në periudha të ndryshme tatimore për të gjitha subjektet dhe përfshin detyrimin në shumën 143,868,582 lekë, gjordat në shumën 41,857,577 lekë dhe interes në vlerën 56,591,803 lekë.

Debia totale për 50 debitorët më të mëdhenj institucione buxhetore në shumën 361,706,902 lekë nga 418,734,740 lekë që rezultonte në fund të vitit 2019, ulur me vetëm 57,027,838 lekë ose në masën 13.3%.

Ulja me 13.3% të nivelit të debisë (për 50 debitorët më të mëdhenj institucione buxhetore), tregon efektivitet në masat e marra nga Ministria e Financave për mbledhjen e detyrimeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

prapambetura nga institucionet buxhetore, si dhe ndërgjegjësim nga institucionet buxhetore për pagesave e detyrimeve.

Nga analizimi i të dhënave të debitorëve, subjekte buxhetorë, për vitin 2020 rezulton se:

-Në total janë 491 subjekte buxhetore debitorë për sigurimet shoqërore në shumën totale prej 385,683,112 lekë, prej të cilave, 120,877,522 lekë principali, 98,867,909 lekë gjobat dhe 165,937,681 lekë interes. Ndërkohë si numër subjektet buxhetore debitorë janë ulur vetëm me 1 debitor.

Në trajtimin makro që i bëhet kësaj çështje, detyrimet kontributive të sektorit publik, trajtohen si detyrime të shtetit dhe fondet për mbulimin e tyre janë brenda buxhetit të ISSH.

Subjekte shtetërore jobuxhetorë debitorë për sigurimet shoqërore për vitin 2020 rezultojnë në total 296, nga 259 subjekte që ishin në vitin 2019, me debi totale në shumën 339,582 mijë lekë.

Për 50 subjektet jobuxhetorë me debinë më të lartë borxhi arrin në shumën 312,857 mijë lekë nga 339,582 mijë lekë që është debia totale e subjekteve jobuxhetore, ose 92% e totalit të debisë për subjektet jobuxhetorë, duke shënuar një rënie prej 5% në krahasim me vitin 2019.

Në 50 subjektet jobuxhetore debitorë me debinë më të lartë përmendim: Klubi I Futbollit Vllaznia, Flamurtari Football Club, Ujësjiellës Kanalizime Poliçan, Klubi I Futbollit Tirana, Klubi I Futbollit Skenderbeu, Kombinati Mekanik Polican, Kf Luftëtari, Parku Udhëtareve Shkoder ,F.K. Apollonia Sh.A. Total, Ndermarja e Ujësjiellsit Patos Total Etj...

Subjekte juridike debitorë për sigurimet shoqërore për vitin 2020 rezultojnë në total 24,940 nga 22,346 subjekte që ishin në vitin 2019, me debi totale në shumën 9,143,609 mijë lekë nga 8,115,825 mijë lekë, me një rritje prej rreth 1,027,784 mijë lekë ose rreth 12.6%. Nëse analizojmë të dhënat e tabelës rritja e debitorëve për sigurimet shoqërore nga subjektet juridike mban peshën kryesore në rritjen totale të detyrimeve për vitin 2020, e ndikuar dhe nga pandemia Covid.

Në 50 subjektet juridike debitorë me debinë më të lartë përmendim: A, A, A, V, F A, K Etj...

Titulli i Gjetjes

Rritje e nivelit të borxhit me 5.% të deficitit të skemës së pensioneve të qytetit duke kaluar nga 12.6 miliard lekë ose 70% e deficitit të skemës së pensioneve të qytetit prej 18.1 miliard lekë në vitin 2019, në 14.4 miliard lekë ose 75% të deficitit prej 19.2 miliard lekë në vitin 2020

Situata

Në fund të vitit 2019, debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 12.6 mld lekë, ndërkohë që deficit i skemës së qytetit, për vitin 2019, ka rezultuar në shumën 18.1 mld lekë, pra niveli i borxhit llogaritet sa 70% e deficitit të skemës së qytetit.

Në vitin 2019, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 86,558 ose 13,818 subjekte më shumë se në vitin 2018. Shuma totale e debisë në vitin 2019 arriti në 12.6 mld lekë ose 0.7 mld lekë më shumë se në vitin 2018. Numri i subjekteve debitorë është rritur me 19%, ndërkohë që debia është rritur në masën 5.9% krahasuar me vitin 2018. Borxhi prej 12.6 mld lekë u përket 86,558 subjekteve, prej të cilave: 39,626 subjekte ose 46% e tyre janë subjekte aktive, me një debi në shumën 6,4 mld lekë, ose 51% e debisë totale; 35,897 subjekte ose 41% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 5,7 mld lekë, ose 45% e debisë totale (diferenca prej 13% janë subjekte të cregjistruar/kërkesë për cregjistrim/falimentuar).

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2020 paraqitet në shumën 19.2 mld lekë, ndërkohë që deri në fund të vitit 2020 debitorët për sigurimet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 14.4 mld lekë, pra niveli i borxhit është sa 75% e deficitit të skemës së qytetit, me një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 96,833 ose 10,275 subjekte më shumë se në vitin 2019.

Shuma totale e debisë në vitin 2020 arriti në 14.4 mld lekë ose 1.8 mld lekë më shumë se në vitin 2019.

Numri i subjekteve debitorë është rritur me 12%, ndërkohë që debia është rritur në masën 14% krahasuar me vitin 2019.

Borxhi prej 14.4 mld lekë u përket 96,833 subjekteve, prej të cilave: 45,818 subjekte ose 47% e tyre janë subjekte aktive me një debi në shumën 7,4 miliard lekë, ose 51% e debisë totale; 38,398 subjekte ose 40% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 6,3 miliard lekë, ose 44% e debisë totale; 3 janë subjekte të crregjistruara me debi prej 7,515 lekë; 12,613 janë subjekte që kanë bërë kërkesë për crregjistrim me debi në shumën 0.6 miliard lekë.

Ndër 50 subjektet juridike debitorë me debinë më të lartë përmendim: A, A, A, V, F, A, K Etj...

Mospagesat e kontributeve nga ana e punëdhënësve për punëmarrësit e tyre, krijojnë deficit në fondin e sigurimeve shoqërore në tërësi dhe në mbulimin e shpenzimeve të programuara për pagesat e pensione në vecanti. Pas borxheve të subjekteve debitorë qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk përfitojnë, jo për fajin e tyre, nga skema e sigurimeve shoqërore.

Kriteri

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Marrëveshja e bashkëpunimit me nr.1142, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT, etj ;

Ndikimi/Efekti

Deficit në fondin e sigurimeve shoqërore dhe punëmarrës të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Rëndësia

I Lartë

Rekomandimi 1

ISSH në bashkëpunim me MFE të ndërmarrin masat e nevojshme për realizimin e pagesës dhe sistemimin e borxheve të subjekteve buxhetore dhe krahas tyre të marrin masat për sistemimin e kontributeve individuale në llogaritë e periudhave të sigurimit.

Rekomandimi 2

Nga ana e ISSH me qëllim për të zgjidhur problematikën e krijuar ndaj individëve të punësuar në subjekte juridike, gjë për të cilën, jo për fajin e tyre, nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, apo përballen me problematikën e mosnjohjes së plotë të periudhave të sigurimit, të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përfshirë, përsa është e mundur dhe e nevojshme dhe atë të inicimit të ndryshimeve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.

Nga auditimi rezulton një bashkëpunim jo shumë efektiv midis I.S.SH dhe strukturave përgjegjëse në DPT dhe DRT të cilat sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 3;4 & 14 të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, realizojnë mbledhjen dhe transferimin në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës prej 14.4 miliard lekë, me një rritje prej rreth 1.8 miliard lekë nga viti 2019, ku nga njëra anë rezultojnë të ardhura potencialisht të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Mospagesat e kontributeve nga ana e punëdhënësve për punëmarrësit e tyre, krijon deficit në fondin e sigurimeve shoqërore në tërësi dhe në mbulimin e shpenzimeve të programuara për pagesat e pensione në vecanti. Pas borxheve të subjekteve debitoare qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Të dhënat mbi 50 Subjektet me debinë më të lartë nga secili sektor paraqiten në Aneksin nr.2. Nën-pika (çështjet gjyqësore, ndjekja e tyre dhe efektet në sigurimet shoqërore) është trajtuar në pikën B.5 të projekt raportit.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt konstatimi Nr.7 datë 27.04.2021 i dorëzuar e protokolluar në ISSH. Në lidhje me këtë akt nuk u paraqitën observacione nga personat me të cilën u mbajt.

Titulli i Gjetjes	Pagesa të duplikuara si pasojë e automatizimit jo të plotë të sistemit të pagesave të pensioneve
Situata	Gjatë kontrolleve të kryera nga Sektori i Kontrollit të Pagesave, gjatë vitit 2019, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 861 raste, në shumën 20,486,744 lekë ose 66% më pak se në vitin 2018, ku dëmtimet arritën në shumën 68 milionë lekë. Në vitin 2020, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 969 raste, në shumën 18,364,470 lekë, ose 11% më pak se në vitin 2019, ku dëmtimet arritën në shumën 20,486,744 lekë. Shkeljet e konstatuara për vitin 2019 kanë rezultuar të natyrave të ndryshme si: dublim pagesash, pagesa pas vdekjes, pagesa marrë tepër ose pagesë jashtë afatit, prej të cilave, 64 raste, ose 7% e rasteve, rezultojnë dublim pagese në shumën 1,844,694 lekë; 702 raste, ose 82% e tyre, rezultojnë pagesa pas vdekjes në shumën 15,916,229 lekë dhe 95 raste, ose 11% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 2,275,821 lekë. Për vitin 2020 shkeljet e konstatuara sipas natyrës renditen në 46 raste, ose 4.5% e rasteve, dublim pagese në shumën 838,849 lekë; 863 raste, ose 92% e tyre, pagesa pas vdekjes në shumën 16,868,822 lekë; 60 raste, ose 3.5% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 656,799 lekë. Rastet e dublimit të pagesës lidhen kryesisht me pagesat në ato banka që ende nuk janë pjesë e sistemit on line. Sistemi on- line zbatohet për mbi 60 % të pagesave. Jashtë këtij sistemi janë kryesisht bankat e nivelit të dytë, BKT dhe I S B A që kanë 90 % të pensioneve of-line që paguhen në banka.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Kriteri	Problematikë për pensionet që paguhen në bankë mbetet pamundësia e realizimit të kontrollit nga ana e strukturave për personat që vdesin, kjo deri në rinovimin e dokumentacionit një herë në 6 muaj të certifikatës së gjallesës së përfituesve. <i>Gjithashtu, si risk aktual evidentohet mosdeklarimi i vdekjes nga anëtarët e familjes së personave që banojnë jashtë shtetit.</i> Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Marrëveshja nr.4357, datë 21.08.2008 lidhur ndërmjet ISSH dhe Postës Shqiptare.
Ndikimi/Efekti	Rritje e deficitit të skemës
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	ISSH të intensifikojë bashkëpunimin me BKT dhe I S B A të cilat kanë 90 % të pensioneve që paguhen në banka of line, me qëllim finalizimin e automatizimit të sistemit të pagesave të pensioneve nga këto banka (kalimin on-line), duke synuar eliminimin e pagesave të dubluara.
Titulli i Gjetjes	Mos arkëtim i fondeve të dëmtuara në shumën 534,866 lekë për vitin 2019 dhe 593,884 lekë për vitin 2020.
Situata	Nga verifikimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020 për fondet e demtuara të vitit 2019, rezultoi se kanë mbetur pa paarkëtuar gjithsej 36 raste në rajonin e Tiranës, të gjitha pagesa të pensioneve pas vdekjes së përfituesve të paguara me autorizim ose prokurë, në shumën 534,866 lekë ose rreth 3% e totalit të fondeve të dëmtuara. Për fondet e demtuara të vitit 2020, nga verifikimi i pagesave të kryera deri në datën 19.04.2021, rezultoi se janë pa arkëuar 29 raste, të gjitha pagesa pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë në shumën 593,884 lekë. <i>Në marrëveshjen shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare nuk parashikohet në asnjë dispozitë mënyra e recuperimit të këtyre fondeve të paguara me prokurë në rast të vonesave në arkëtimin e tyre, si dhe nga ana e I.S.SH nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim në recuperimin e fondeve.</i>
Kriteri	Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Marrëveshje shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare
Ndikimi/Efekti	Rritje e fondeve të dëmtuara të paarkëtuara
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi 1	ISSH të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative me qëllim arkëtimin e fondeve të dëmtuara nga pagesat e pensioneve të kryera pas vdekjes së përfituesve me autorizim ose prokurë.

III.2.B/5. Mbi funksionimin e strukturave të kontrollit. Aktiviteti i Njesisë së Inspektimit, Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

B.5.1- Aktiviteti i Njesisë së Inspektimit.

Në zbatim të pikës (5) të programit të ri-auditimit “Nr. 95/1 datë 29/01/2021”, të ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Evidenca dhe statistika të proceseve të inspektimit për vitet 2019-2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

2. Dokumentat e punës të mbajtura nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për inspektimet e kryera

Nga auditimi rezulton se:

Struktura përgjegjëse në ISSH për kontrollin dhe certifikimin e përfitimeve është Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. Njësia e Inspektimit të Përfitimeve është krijuar si strukturë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.146, datë 01.12.2010.

Detyrat dhe funksionet e kësaj njësie mbështeten në respektimin e përcaktimeve të dhëna në Rregulloren nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensionsve”, të ndryshuar, Rregulloren nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr. 25, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar dhe Rregulloren nr. 3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”, të ndryshuar, si dhe, standardeve të kontrollit të përcaktuara me ligj.

Në vitin 2018 është hartuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, e pa miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ apo Vendim/Urdhër të titullarit të institucionit, dalë për zbatim sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, në këtë rregullore janë përcaktuar hollësisht kompetencat dhe detyrat e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.

Puna e kësaj strukture fokusohet **në realizimin e kontrollit të përfitimeve afatgjata të caktuara** në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të përfitimeve suplementare të caktuara në zbatim të ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e përfitimeve suplementare, nga Degët e Përfitimeve të DRSSH-ve dhe DSSH-ve.

Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, që nga krijimi i saj si strukturë më vete, ka detyrë dhe fokus të punës së saj kontrollin në masën 100 % të të gjitha përfitimeve të caktuara nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke u bazuar dhe në përcaktimin e pikës 3 të Nenit 62 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Njësia e Inspektimit në përbërje të saj ka një staf prej 20 punonjësish me këtë përbërje:

- Kryetari i Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve;
- Sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata me 1 përgjegjës dhe 15 specialistë inspektimi;
- Sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare me 1 përgjegjës dhe 2 specialistë inspektimi.

Nga verifikimi i kualifikimeve të punonjësve pjesë e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, sipas Tabelës “*Struktura e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve për vitet 2019-2020*”, rezulton se specialistët e kësaj njësie kanë kualifikimet dhe arsimin profesional të kërkuar juridik apo ekonomik dhe vjetërsi në punë, me përjashtim të një rasti jashtë profilit, arsimuar për Shkenca Sociale, jo në përputhje me përcaktimet e “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, sipas Urdhrit nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII- Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, pika – Arsimi dhe Eksperienca.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë bazuar në Planin Vjetor të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, për hartimin e së cilit është marrë si referencë numri i përfitimeve të caktuara nga subjektet objekt kontrolli për vitet 2016-2017-2018-2019, si dhe kapacitetet njerëzore në dispozicion të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, numri i ditëve efektive të punës gjatë vitit, metodologjia e bazuar në risk, detyra apo programe të posaçme për raste të veçanta, të miratuara nga Titullari i ISSH, etj. Për planifikimin e programeve të inspektimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

sipas shpjegimeve të dhëna nga Njësia e Inspektimit është parashikuar si normë ditore inspektimi, 15 dosje përfitimi për çdo specialist inspektimi, por përcaktimi i normës ditore nuk është argumentuar me dokumentacion apo relacion, pra nuk është miratuar.

Secili nga specialistët e njësisë, ka për detyrë, pasi bën kontrollin e dosjes së përfitimit, respektimin e kushteve ligjore të përfitimit, dokumentacionin mbi të cilin është caktuar përfitimi, mënyrën e llogaritjes, bën edhe ballafaqimin me të dhënat e sistemit PCAMS për çdo dosje përfitimi, ku bën edhe komentimin përkatës. Përfitimet të cilat rezultojnë të caktuara në përputhje me dispozitat ligjore, vlerësohen të rregullta, ndërsa për përfitimet, në të cilat konstatohen gabime dhe moszbatim të dispozitave ligjore mbahet aktkonstatimi përkatës për secilin rast, e cila bëhet pjesë e dosjes së përfitimit.

Në përfundim të programit të inspektimit, lidhur me dosjet e inspektuara, si dhe për të gjitha problemet e konstatuara, janë hartuar Raporti Paraprak i Inspektimit, Raporti Përfundimtar dhe Memo drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm mbi konkluzionet e inspektimit, dëmet e konstatuara dhe rekomandimet e lënë shoqëruar me evidencën përkatëse, të gjitha këto të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

I- Viti 2019

Nga njësia e Inspektimit të Përfitimeve është hartuar planin vjetor i vitit 2019 dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.1021 prot, datë 08.02.2019, në të cilin janë planifikuar për inspektim nga sektori i përfitimeve afatgjata 5 DRSSH, në total 41378 përfitime dhe nga sektori i përfitimeve suplementare 6 DRSSH, në total 4940 përfitime. Në mbështetje të planit vjetor të miratuar për secilën Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, janë hartuar Programi i Inspektimit, ku evidentimi i numrit të përfitimeve objekt inspektimi është bërë në referencë të regjistrit themeltar të përfitimeve të caktuara në periudhën kohore që është objekt inspektimi.

I.1- Sektori i Inspektimit të përfitimeve afatgjata

Rezulton se, nga Sektori i Inspektimit të përfitimeve afatgjata gjatë vitit 2019 janë kryer inspektime në 8 DRSSH dhe DSSH, si vijon:

- DRSSH Elbasan - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2015 – 31.12.2016;
- DRSSH Kukës - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2018;
- DSSH Tropojë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2018;
- DRSSH Tiranë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2016;
- DRSSH Fier - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2018;
- DRSSH Durrës - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2017;
- DRSSH Vlorë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2017;
- DSSH Sarandë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2017.

• Nga ballafaqimi i inspektimeve të realizuara nga ato të planifikuara, rezulton se DRSSH Elbasan është raportuar për vitin 2019, inspektimi ka filluar në vitin 2018 dhe ka mbaruar në vitin 2019. DSSH Sarandë dhe Tropojë janë të përfshira përkatësisht në DRSSH Vlorë dhe Kukës, parashikuar në planin vjetor të vitit 2019 për inspektim.

Tek DRSSH Fieri është ndryshuar periudha e auditimit nga 01.01.2016 -31.12.2017, është bërë 01.01.2016 - 31.12.2018, ndërkohë që tek DSSH Tiranë nga 01.01.2016 - 31.12.2017 sipas planit, janë inspektuar përfitimet vetëm për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2016.

Ndryshimi i planit nuk është formalizuar me shkresë dhe për rrjedhim nuk ka marrë miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Kontrollet e kryera për vitin 2019, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata, janë pasqyruar në evidencën në vijim:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

REZULTATET E KONTROLLIT PER VITIN 2019									
I) RAJONET	DRSSH ELBASAN	DRSSH KUKËS	DSSH TROPOJË	DRSSH TIRANË	DRSSH FIER	DRSSH Durrës	DRSSH VLORË	DSSH SARANDË	TOTALI
II) PERJUDHA E KONTROLLUAR	01.01.2015 - 31.12.2016	01.01.2017- 31.12.2018	01.01.2017 - 31.12.2018	01.01.2016 - 31.12.2016	01.01.2016 - 31.12.2018	01.01.2016 - 31.12.2017	01.01.2016 -31.12.2017	01.01.2016 - 31.12.2017	
III) AFATI I KONTROLLIT	14.11.2018- 30.01.2019	11.02.2019 - 29.03.2019	11.02.2019 - 29.03.2019	11.02.2019 - 10.05.2019	02.05.2019 (13.05.2019) - 07.08.2019	04.09.2019 - 25.10.2019	30.10.2019 -20.12.2019	30.10.2019 - 20.12.2019	
IV) Dosje të kontrolluara	7522	802	322	9329	12724	7013	4603	2269	44584
a)Dosje te certifikuara	7043	609	269	8661	12163	6619	4386	2015	41765
b)Dosje me problematike	479	193	53	668	561	394	217	254	2,819
c) % e dosjeve me problematike	6.36%	24.00%	16.00%	7.16%	4.41%	5.62%	4.71%	11.19%	6.3%
V) Konstatime te kontrollit									
1. pezullime		6	2		8	2	1		19
2. rishqyrtime	299	75	29	556	414	245	192	231	2041
a) rishqyrtuar gjate kontrollit	240	58	22	427	263	206	115	231	1562
b) mbeten detyre per rishqyrtim	59	17	7	129	151	39	77		479
3. detyra per plotesim e verifikim	45	60	11	105	101	62	11	1	396
4. dosje me probleme mjekesore	135	52	11	7	38	85	14	22	364
5. Dosje te rezultuara debitore/pezullime (llogaritur)		3	2		5	1			11
leke		748,910	321,655		1,399,976	222,425			2,692,966
6. Dosje te rezultuara debitore/rishqyrti me/llogaritur	80	34	7	49	81	84	19	120	474
leke	3,023,122	1,281,893	88,462	1,345,380	2,455,645	3,789,920	429,503	3,617,967	16,031,892
7. DEBITORE (RISHQ+PEZ)									
a) Nr.Dosje	80	37	9	49	86	85	19	120	485
b) Leke	3,023,122	2,030,803	410,117	1,345,380	3,855,621	4,012,345	429,503	3,617,967	18,724,858
8. KREDITORE									
a) dosje te rezultuara kreditore/llogaritur	160	24	15	378	182	122	96	111	1,088
b) leke	5,180,657	391,599	374,065	21,245,122	7,388,472	5,727,965	1,319,042	4,992,475	46,619,397
VI) Nr. dosjeve te certifikuara ne perfundim te programit (=IV.a+V.2.a)	7283	667	291	9,088	12426	6825	4501	2246	43327
% e dosjeve te certifikuara ne perfundim	96%	82.75%	90.37%	96.41%	97.36%	97.32%	97.78%	98.99%	97.2%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

VI) Nr. dosjeve të lëna me rekomandime (=V.1+V.2.b+V.3+V.4)	239	135	31	241	298	188	102	23	1257
% e dosjeve me rekomandime	3.18%	16.83%	9.63%	2.58%	2.34%	2.68%	2.22%	1.01%	2.82%
VII) nr. i dosjeve me efekte financiare të llogaritura (V.7.a+V.7.a)	240	61	24	427	268	207	115	231	1573
Totali i efektit financiar									
Dosje	240	61	24	427	268	207	115	231	1573
% e dosjeve me efekte	3.19%	7.61%	7.45%	4.58%	2.11%	2.95%	2.50%	10.18%	3.53%
Efekti Debitorë në lekë	3,023,122	2,030,803	410,117	1,345,380	3,855,621	4,012,345	429,503	3,617,967	18,724,858
Efekti Kreditorë në lekë	5,180,657	391,599	374,065	21,245,122	7,388,472	5,727,965	1,319,042	4,992,475	46,619,397

Sa më sipër **rezulton se dosje të kontrolluara gjatë vitit 2019 janë gjithsej 44584**, prej të cilave **të certifikuar 41763 dosje** dhe evidentuar me probleme 2819 dosje, ose 6.3% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 2819 dosje të evidentuara me probleme vetëm 1573 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 3.5% e totalit të dosjeve të inspektuara, ndërkohë që dosjet e tjera kanë pasur problematika si moszbatim korrekt i procedurave dhe afateve të përcaktuara, mangësi në dokumentacionin, rishqyrtime të shpeshta të përfitimeve të reja dhe vonesa në caktimin e përfitimeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i vonesave në verifikimin e periudhave të punës, nga Dega e Arkivës, qëndrime jo të unifikuara në lidhje me njohjen e periudhave të sigurimit të pasqyruara në librezën e punës etj. Në total kanë rezultuar 485 dosje debitorë, me efekt financiar në shumën 18,724,858 lekë dhe 1088 dosje kreditorë, me efekt financiar në shumën 46,619,397 lekë.

Gjithashtu në të gjitha programet e inspektimit, si pikë e veçantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme. Nga 6409 dosje përfitimesh me rekomandime, janë kontrolluar 6111 dosje, 298 janë pa kontrolluar nga të cilat 214 janë aktive dhe 84 janë mbyllur. Nga 6111 dosje përfitimi të kontrolluara, për 5844 dosje përfitimi ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 1313 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitorë dhe kreditorë. Nga këto, 659 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 34,427,171 lekë, ndërsa 654 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 24,566,978 lekë.

- Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2019 janë inspektuar 44584 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë rikontrolluar 6111 dosje përfitimi zbatim rekomandimesh, në total janë kontrolluar 50695 dosje të përfitimeve afatgjata, të caktuara në mbështetje të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga këto në total kanë rezultuar 1144 dosje debitorë me efekt financiar në shumën 53,152,029 lekë dhe 1742 dosje kreditorë me efekt financiar në shumën 71,186,375 lekë.*

Gjatë vitit 2019 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuar 479 dosje nga 2041 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 23% e tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

I.2- Sektori i Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta

Nga Sektori i Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta gjatë vitit 2019 janë realizuar 5 inspektime në DRSSH, si vijon:

- DRSSH Tiranë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2018;
- DRSSH Gjirokastrë- Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2018;
- DRSSH Korçë- Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 30.06.2019;
- DRSSH Shkodër - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 30.06.2019;
- DRSSH Lezhë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 – 30.06.2019.

Nga plani i vjetor i miratuar nuk është realizuar vetëm DSSH Kukës. Tek DRSSH Korçë është ndryshuar periudha e auditimit nga 01.01.2017 -31.12.2018, është bërë 01.01.2017 - 30.06.2019, tek DRSSH Shkodër nga 01.01.2017 - 31.12.2018 sipas planit, janë inspektuar përfitimet për periudhën 01.01.2017 – 30.06.2019 dhe tek DRSSH Lezhë nga 01.01.2018- 31.12.2018 sipas planit, janë inspektuar përfitimet për periudhën 01.01.2017– 30.06.2019.

Ndryshimet që janë bërë në planin e auditimeve si për subjektet e audituara ashtu për periudhën e auditimit, nuk janë miratuar me shkresë nga titullari i institucionit.

Gjatë vitit 2019, filloi zbatimin ligji nr. 29, datë 23.5.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Sipas programeve të Inspektimit të miratuara, mbështetur në metodën e kontrollit “kontroll para faktit”, është kryer kontrolli i trajtimeve financiare, suplementare të caktuara në zbatim të ligjit 29/2019, për 1379 dosje përfitimi, të cilat ishin bërë gati për pagesë.

Kontrolli i tillë është kryer në:

- DRSSH Tiranë, sipas programit nr.7780, datë 14.11.2019 gjatë të cilit janë inspektuar **697 përfitime**;
 - DRSSH Fier, sipas programit nr.7779, datë 14.11.2019 gjatë të cilit janë inspektuar **355 përfitime**;
 - DRSSH Vlorë, sipas programit nr.7777, datë 14.11.2019 gjatë të cilit janë inspektuar **173 përfitime**;
 - DSSH Sarandë, sipas programit nr.7778, datë 14.11.2019 gjatë të cilit janë inspektuar janë inspektuar **154 përfitime**.
- Nga ky Sektor gjatë periudhës së ushtrimit të këtyre inspektimeve të realizuara, lidhur me zbatimin e Ligjit nr.29/2019 në përfitimet e caktuara, janë plotësuar, sipas rastit, me dokumentacion praktikat dhe janë saktësuar gabimet e konstatuara në llogaritjen e përfitimeve, përpara se masa e llogaritur e përfitimit të kalojë për pagesë, duke shmangur në këtë mënyrë dëmtimin e fondeve financiare. Nga njësia e Inspektimit nuk administrohet dokumentacion apo relacion paraprak për përzgjedhjen e ketyrë subjekteve për inspektim dhe përfitimeve të inspektuara.

Kontrollet e kryera për vitin 2019, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, janë pasqyruar në evidencën në vijim:

REZULTATE TË KONTROLLIT PËR VITIN 2019						
RAJONET	DRSSH TIRANË	DRSSH GJIROKASTËR	DRSSH KORÇË	DRSSH SHKODËR	DRSSH LEZHË	TOTALI
I) PERJUDHA E KONTROLLUAR	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2017 -31.12.2018	01.01.2017-30.06.2019	01.01.2017-30.06.2019	01.01.2018 -30.06.2019	
II) AFATI I KONTROLLIT	07.01.2019 -14.06.2019	24.06.2019 -09.07.2019	02.09.2019 -02.10.2019	07.10.2019 -18.10.2019	24.10.2019 -01.11.2019	
III) Dosje te paraqitura	3443	210	598	337	168	4,756
IV) Dosje te kontrolluara	3443	210	598	337	168	4756



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

a) Dosje të rregullta	2946	193	545	311	144	4139
b) Dosje me probleme	497	17	53	26	24	617
% e dosjeve me prob.	14.40%	8.10%	8.86%	7.72%	14.29%	12.97 %
V) Konstatime te kontrollit						
1. pezullime	4	1	2	0	0	7
2. rishqyrtime	279	16	43	24	13	375
a) rishq. gjate kontrollit	221	14	37	14	13	299
b) mbeten detyre per rishq.	58	2	6	10	0	76
3. detyra plotesim/verifikim	214	0	8	2	11	235
a) plotesuar gjate programit	214	0	6	2	4	226
b) mbeten detyre	0	0	2	0	7	9
4. dosje te rezultuara debitore/pezullime/llogaritur	3	1	0	0	0	4
a) leke	635,687	16,208	0	0	0	651,895
5. dosje te rezultuara debitore/rishqyrtime/llogaritur	141	5	18	9	5	178
a) leke	18,204,415	89,453	1,338,788	606,433	870,602	21,109,691
6. Total debi (pezullime+rishqyrtimet/llogaritur						
a) nr dosje (=V.4+V.5)	144	6	18	9	5	182
b) leke (=V.4.a+V.5.a)	18,840,102	105,661	1,338,788	606,433	870,602	21,761,586
7. dosje te rezultuara kreditore	80	9	19	5	8	121
a) leke	2,297,413	239,623	862,548	142,912	80,978	3,623,474
8. Nr. i dosjeve te certifikuara ne perfundim te programit (=IV.a+V.2.a+V.3.a)	3.381	207	588	327	161	4664
% e dosjeve te certifikuara ne perfundim	98.20%	98.6%	98.3%	97%	96%	98%
9. Dosje te mbetura per plotesim apo rishqyrtim	58	2	8	10	7	85
% e dosjeve te mbetyra rekomandim	1.7%	1%	1.3%	3%	4.2%	1.8%
10. nr. total i dosjeve me efekte financiare te llogaritura (V.6.a+V.7)	224	15	37	14	13	303
% e dosjeve me efekte te llogaritura	6.5%	7%	6.2%	4%	7.7%	6.3%
Totali i efektit financiar						
Nr. dosje me efekt	224	15	37	14	13	303
% e dosjeve me efekte te llogaritura	6.5%	7%	6.2%	4%	7.7%	6.3%
Efekti Debitorë në lekë	18,840,102	105,661	1,338,788	606,433	870,602	21,761,586
Efekti Kreditorë në lekë	2,297,413	239,623	862,548	142,912	80,978	3,623,474

Nga 4756 dosje të inspektuara gjithsej janë certifikuar 4664 dosje ose 98% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 4756 dosje të inspektuara vetëm 303 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 6.4% e totalit të dosjeve të inspektuara nga të cilat 182 dosje kanë rezultuar debitore me efekt financiar në shumën 21,761,586 lekë dhe 121 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 3,623,474 lekë.

Gjithashtu në programet e inspektimit, si pikë e vecantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme. Kështu, janë kontrolluar 389 dosje përfitimi, për të cilat ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga këto, janë rishqyrtuar 120 dosje përfitimi, duke rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore, si dhe 6 dosje përfitimi nga zbatimi i rekomandimeve janë pezulluar. Nga pezullimi i përfitimeve ka rezultuar efekti financiar në shumën 9,136,821 lekë, ndërsa nga rishqyrtimet e 75 dosjeve të përfitimeve ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 13,095,166 lekë, ndërsa nga rishqyrtimi i 45 dosjeve të përfitimeve ka rezultuar efekt financiar kreditor në shumën 2,696,296 lekë.

- Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2019 Sektori i Përfitimeve Suplementare, ka inspektuar 4756 dosje të përfitimeve suplementare, si dhe janë rikontrolluar 389 dosje të përfitimeve suplementare nga rekomandimet e mëparshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjithashtu, janë kontrolluar 1,379 dosje përfitimi të caktuara sipas ligjit 29/2019. Në total, kanë kaluar në proces inspektimi 6524 dosje të përfitimeve suplementare.

Nga këto në total kanë rezultuar 257 dosje debitore me efekt financiar në shumën 34,856,752 lekë dhe 166 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 6,319,770 lekë, si dhe një efekt financiar debitor 9,136,821 lekë nga pezullimet.

Gjatë vitit 2019 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 76 dosje nga 375 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 20% e tyre.

- Në përfundim të programeve të inspektimit nga të dy sektorët është konstatuar ndryshim si në objektet e inspektimit, periudhën e inspektimit ashtu edhe në numër dosjesh krahasuar kjo me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Për Sektorin e Përfitimeve Afatgjata ishin planifikuar 5 DRSSH me 41378 dosje në total, ndërkohë që janë inspektuar 8 DRSSH dhe 44584 dosje të reja.

Për Sektorin e Përfitimeve Suplementare ishin planifikuar 6 DRSSH me 4940 dosje në total, ndërkohë që janë inspektuar 5 DRSSH dhe 4756 dosje të reja.

Ndryshimi i planit nuk është formalizuar me shkresë dhe për rrjedhim nuk ka marrë miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

- Në total për vitin 2019 nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve janë inspektuar 57219, nga këto 50719 dosje përfitimi objekt inspektimi, 6500 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total kanë rezultuar 1401 dosje debitore me efekt financiar në shumën 88,088,781 lekë dhe 1908 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 77,506,145 lekë, si dhe një efekt financiar debitor 9,136,821 lekë nga pezullimet për 6 dosje.

Gjatë vitit 2019 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 555 dosje nga 2416 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 22.9 % e tyre.

Gjatë vitit 2019 nga Njësia e Inspektimit janë rekomanduar 10 masa disiplinore sipas tabelës më poshtë:

Rekomandimet për masa disiplinore ndaj punonjësve								viti 2019
DRSSH	VITI	Totali i masave	Lloji i masave të rekomanduara/sipas rregullores					
			Largim nga puna	Kalimi në një detyrë të një kategorie apo klasë më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në 1 vit	Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në 2 vjet	Vërejtje me paralajmërim	Vërejtje me shkrim	Tërheqje vëmendje
ELBASAN	2019	5					1	4
KUKËS	2019	3		1			2	
TROPOJË	2019	1						1
KORÇË	2019	1					1	
Gjithsej		10		1			4	5

* Nga rekomandimet e sipërshënuara, vetëm rekomandimi i dhënë në DRSSH Korçë “vërejtje me shkrim”, është rekomanduar nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajttimeve të Veçanta. Pjesa tjetër është rekomanduar nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata.

- Nga analiza e treguesve për dosjet me problematika të paraqitura në tabelën për Sektorin Inspektimeve të Përfitimeve Afatgjata 2019, rezulton se subjektet që kanë numrin më të lartë dosjeve me problematika janë DRSSH Kukës, Tropjë dhe Sarandë, ndërkohë që masa disiplinore janë propozuar vetëm për DRSSH Kukës, Tropojë, Elbasan dhe nuk është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

propozuar për DRSSH Sarandë megjithëse ka përqindje më të lartë të dosjeve me problematika se sa DRSSH Elbasan.

- Në rastin e DRSSH Tiranë sipas Raportit Përfundimtar janë konstatuar mangësi dhe shkelje për 21 Inspektor dhe nuk është propozuar asnjë masë disiplinore.

Nga *Sektori Inspektive të Përfitimeve Suplementare* dhe të veçanta për vitin 2019 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Korçë dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 14.29% dhe DRSSH Tiranë me 14.30 %, të cilat kanë përqindjen më të lartë të dosjeve me problematika. Në rastin e DRSSH Tiranë janë konstatuar 497 dosje me probleme, nga të cilat 224 me efekt financiar në shumën 18,840,102 debitor dhe 2,297,413 kreditor.

II- Viti 2020

Nga njësia e Inspektimit të Përfitimeve është hartuar planin vjetor i vitit 2020 dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr. 612 prot, datë 24.01.2020, në të cilin janë planifikuar për inspektim nga sektori i përfitimeve afatgjata 8 DRSSH, në total 50741 përfitime dhe nga sektori i përfitimeve suplementare 10 DRSSH/DRSSH, në total 8154 përfitime. Në mbështetje të planit vjetor të miratuar për secilën Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rezultojnë të jetë hartuar Programi i Inspektimit, ku evidentimi i numrit të përfitimeve objekt inspektimi është bërë në referencë të regjistrimit themeltar të përfitimeve të caktuara në periudhën kohore që është objekt inspektimi.

II.1- Sektori i Inspektimit të përfitimeve afatgjata

Rezultojnë se, nga Sektori i Inspektimit të përfitimeve afatgjata gjatë vitit 2020 janë kryer inspektime në 7 DRSSH, si vijon:

- DRSSH Berat - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 – 31.12.2017;
- DRSSH Dibër - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 - 31.12.2017;
- DRSSH Gjirokastrë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2016 - 31.12.2017;
- DRSSH Tiranë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 - 31.12.2018;
- DRSSH Shkodër - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 - 31.12.2018;
- DRSSH Lezhë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017- 31.12.2018;
- DRSSH Korçë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 - 31.12.2018.
- Nga plani i vjetor i miratuar për këtë sektor nuk është realizuar inspektimi në DRSSH Elbasan.

Kontrollet e kryera për vitin 2020, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata, janë pasqyruar në evidencën në vijim:

REZULTATE TË KONTROLLIT PËR VITIN 2020								
I) RAJONET	DRSSH DIBËR	DRSSH BERAT	DRSSH GJIROKASTËR	DRSSH TIRANË	DRSSH SHKODËR	DRSSH LEZHË	DRSSH KORÇË	TOTALI
II) PERJUDHA E KONTROLLUAR	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2017-31.12.2018	
III) AFATI I KONTROLLIT	08.01.2020-11.03.2020	08.01.2020-05.03.2020	08.01.2020-05.03.2020	09.03.2020-30.09.2020	05.10.2020-15.01.2021	05.10.2020-19.01.2021	05.10.2020-19.01.2021	
IV) DOSJE PER KONTROLL	2428	3672	3009	20081	5509	3221	7355	45275
1. Dosje te kontrolluara	2295	3597	2966	18822	5478	3208	7303	43669
2. Dosje te pa paraqitura	133	75	43	1259	31	13	52	1606
a) (me pr. mjek.+kqa)			27					27
b) transferuar (mbyllur, kal.pens.tje)	94	59		934	28	10	38	1163
c) Aktive ne sistem	39	16	16	325	3	3	14	416
3. Dosje te certifikuara	2102	3274	2744	18045	5376	2884	7046	41471
4.Dosje me problematike	193	323	222	777	102	324	257	2198
% e dosjeve me problematike	8.40%	8.98%	7.48%	4.13%	1.86%	10.10%	3.50%	5.00%
V) Konstatime te kontrollit								
1. pezullime	1	2		4		10		17
2. rishqyrtime	158	281	207	644	61	208	142	1701
a) rishqyrtuar gjate kontrollit	155	273	178	477	55	107	118	1363



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

b) mbeten detyre për rishqyrtim	3	8	29	167	6	101	24	338
3. mbeten detyre për plotësim	34	15	14	82	2	89	6	242
4. dosje me probleme mjekesore		25	1	47	39	16	109	237
5. totali i dosjeve të mbetura me detyra (V.2.b+V.3+V.4)	37	48	44	296	47	206	139	817
6. dosje të rezultuara debitore/pezullime (llogaritur)	1	1						2
a) demi financiar	499,755	254,377						754,132
7. dosje të rezultuara debitore/rishqyrtime	80	58	73	152	16	77	36	492
a) demi financiar	3,748,596	2,510,780	2,083,967	8,037,142	450,866	2,611,275	451,206	19,893,832
8. totali i dosjeve me pezullime+ rishqyrtime	81	59	73	152	16	77	36	494
a) demi financiar total (V.6.a+V.7.a)	4,248,351	2,765,157	2,083,967	8,037,142	450,866	2,611,275	451,206	20,647,964
9. dosje të rezultuara kreditore	75	215	105	325	39	30	82	871
a) leke	4,081,081	4,224,231	1,316,955	9,971,086	667,311	849,341	3,133,330	24,243,335
VI) Nr. dosjeve të certifikuara në perfundim të programit (IV.3+V2.a)	2257	3547	2922	18522	5431	2991	7164	42834
% e dosjeve të certifikuara në perfundim	98%	98.61%	98.52%	98.41%	99.14%	93.24%	98%	98%
Totali i efektit financiar								
Nr. dosje me efekt	156	274	178	477	55	107	118	1365
Efekt i Debitorë në lekë	4,248,351	2,765,157	2,083,967	8,037,142	450,866	2,611,275	451,206	20,647,964
Efekt i Kreditorë në lekë	4,081,081	4,224,231	1,316,955	9,971,086	667,311	849,341	3,133,330	24,243,335

Shënim: Të dhënat për DRSSH Tiranë, Shkodër, Lezhë, Korçë janë raportuar deri në nivelin e raportit paraprak, pasi brenda vitit 2020 nuk është arritur të përmbyllet cikli i plotë i procedurave të inspektimit.

Sa më sipër **rezulton se dosje të kontrolluara gjatë vitit 2019 janë gjithsej 43669** prej të cilave **të certifikuara 42834 dosje apo 98 % të dosjeve të kontrolluara**. Janë evidentuar me probleme 2198 dosje, ose 5 % e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 2819 dosje të evidentuara me probleme vetëm 1365 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 48 % e totalit të dosjeve të inspektuara. Në total kanë rezultuar 494 dosje debitore, me efekt financiar në shumën 20,647,964 lekë dhe 871 dosje kreditore, me efekt financiar në shumën 24,243,335 lekë.

Gjithashtu në programet e inspektimit, si pikë e veçantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme. Nga 1468 dosje përfitimesh me rekomandime, janë kontrolluar 1305 dosje, 163 janë pa kontrolluar nga të cilat 125 janë aktive dhe 38 janë mbyllur. Nga 1305 dosje përfitimi të kontrolluara, për 1281 dosje përfitimi ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 291 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore. Nga këto, 118 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 12,822,409 lekë, ndërsa 173 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 9,893,906 lekë.

- Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2020 janë inspektuar 43669 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë rikontrolluar 1305 dosje përfitimi zbatim rekomandimesh, në total janë kontrolluar 44974 dosje të përfitimeve afatgjata, të caktuara në mbështetje të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga këto në total kanë rezultuar 612 dosje debitore me efekt financiar në shumën 33,470,373 lekë dhe 1044 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 34,137,241 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjatë vitit 2020 kanë mbetur për rishqyrtim dhe të pa certifikuara 338 dosje nga 1701 dosje të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 19.8 % e tyre.

II.2- Sektori i Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta

Nga Sektori i Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 inspekte në DRSSH/DSSH, si vijon:

- DRSSH Berat - Përfitimet e caktuara sipas ligjit 29/2019 (Gjithsej 501 dosje përfitimi).
- DRSSH Gjirokastrë - Përfitimet e caktuara sipas ligjit 29/2019 (Gjithsej 250 dosje përfitimi).
- DRSSH Shkodër - Përfitimet sipas ligjit 29/2019;
- DRSSH Dibër - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2019;
- DRSSH Lezhë - Përfitimet sipas ligjit 29/2019, të caktuara deri në datën 30.06.2020;
- DRSSH Kukës - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 – 30.06.2020;
- DSSH Tropojë - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 – 30.06.2020;
- DRSSH Durrës - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2019;
- DRSSH Fier - Me përzgjedhje, 470 dosje përfitimi të caktuara sipas ligjit 29/2019.

• Nga plani i vjetor i miratuar nuk është realizuar inspektimi në DRSSH Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe DSSH Sarandë, ndërkohë që janë realizuar jashtë planit vjetor të miratuar DRSSH Berat, Gjirokastrë dhe Lezhë. Gjithashtu dhe në subjektet e inspektuara të cilat kanë qenë parashikuar në planin vjetor, DRSSH Shkodër dhe Fier, objekti i inspektimit nuk është i njëjtë me atë të miratuar në planin vjetor. Në DSSH Tropojë dhe Kukës periudha e auditimit ka ndryshuar nga 01.01.2018-31.12.2019 sipas planit, në 01.01.2018-31.06.2020.

Ndryshimi i planit si për subjektet që do të auditohen ashtu dhe për objektin e programit të inspektimit nuk është formalizuar me shkresë dhe për rrjedhim nuk ka marrë miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Kontrollet e kryera për vitin 2020, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, janë pasqyruar në evidencën në vijim:

REZULTATE TË KONTROLLIT PËR VITIN 2020										
I) RAJONET	DRSSH BERAT	DRSSH GJIROKASTËR	DRSSH SHKODËR	DRSSH DIBËR	DRSSH LEZHË	DRSSH KUKËS	DSSH TROPOJË	DRSSH DURRËS	DRSSH FIER	TOTALI
II) PERJUDHA E KONTROLLUAR	Perfitimet sipas ligjit 29/2019, 501 dosje	Perfitimet sipas ligjit 29/2019, 250 dosje	Perfitimet sipas ligjit 29/2019	01.01.2018-31.12.2019	Perf e 1.29/2019 cakt. Deri 30.06.2020	01.01.2018 - 30.06.2020	01.01.2018 - 30.06.2020	01.01.2018 - 31.12.2019	Me përzgjedhje 470 dosje	
III) AFATI I KONTROLLIT	08.01.2020 - 05.03.2020	08.01.2020 - 05.03.2020	06.01.2020 - 22.01.2020	24.02.2020 - 30.06.2020	08.07.2020 - 11.09.2020	28.09.2020 - 06.11.2020	28.09.2020 - 06.11.2020	9.11.2020 - 7.12.2020; 28.12.2020 - 8.1.2021	8.12.2020 - 25.12.2020	
IV) Dosje të kontrolluara	501	250	544	1548	1136	722	234	805	470	6210
a. dosje të rregullta	489	249	477	1336	961	655	221	733	423	5544
b. dosje me problematike	12	1	67	212	175	67	13	72	47	666
% e dosjeve me prob.	2.3%	0.4%	12.32%	13.70%	15.40%	9.14%	5.56%	8.94%	10%	10.7%
V) Konstatime të kontrollit										
1. pezullime			4	7	9	8		1		29
2. rishqyrtime		1	33	130	122	27	10	46	6	375
a) rish. gjate programit		1	25	89	72	22	9	42		260
b) mbeten detyre per rishq.			8	41	50	5	1	4	6	115



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

3. detyra per plot./verifikim	12		30	75	44	32	3	25	41	262
a) plot. gjate programit	0		20	35	1	28	0	10	18	112
b) mbeten detyra	12		10	40	43	4	3	15	23	140
4. dosje te rezultuara debitore/pezulli me/llogaritur			3	7	9	3		1		23
a) leke			28,911	385,679	345,957	107,642		90,690		958,879
5. dosje te rezultuara debitore/rishqyrt ime te llogaritur		1	4	46	29	8	5	22		117
a)leke		32,546	17,431	533,155	349,131	939,248	132,162	682,920		2,686,593
6. Total debi (pezull.+rishq./te llogaritur										
a) nr. dosje (V.4+V.5)		1	7	53	38	11	5	23		140
b) leke (V.4.a+V.5.a)		32,546	46,342	918,834	695,088	1,046,890	132,162	773,610		3,645,472
7. Dosje te rezultuara kreditore			21	43	43	14	4	20		143
a) leke			69,863	609,236	515,308	93,464	36,319	267,749		1,591,939
VI) Nr. i dosjeve te certifikuara ne perfundim te programit (IV.a+V.2.a+V.3.a)	489	250	522	1460	1034	713	230	785	441	5925
% e dosjeve te certifikuara ne perfundim	97.6%	100%	95.96%	94.32%	91.02%	98.7%	98.29%	97.5%	93.83%	95.4%
VII) Dosje te mbetura per plotesim apo rishqyrtim	12		18	81	93	9	4	19	29	265
% e dosjeve te mbetura me rekomandime	2.4%		3.3%	5.2%	8.1%	1.2%	1.7%	2.3%	6.1%	4.26%
VII) Totali i dosjeve me efekte financiare te llogaritura (V.6.a+V.7.a)		1	28	96	81	25	9	43		283
% e dosjeve me efekte te llogaritura		0.4%	5.1%	6.2%	7.1%	3.4%	3.8%	5.3%		4.5%
Efekt Debitorë në lekë		32,546	46,342	918,834	695,088	1,046,890	132,162	773,610		3,645,472
Efekt Kreditorë në lekë			69,863	609,236	515,308	93,464	36,319	267,749		1,591,939

Shënim: Për DRSSH Fier dhe Durrës të dhënat e rezultateve të inspektimit janë raportuar deri në nivelin e raportit paraprak, pasi brenda vitit 2020 nuk është arritur të përmbyllet cikli i plotë i procedurave të inspektimit.

Gjithashtu nuk janë të përfshira në të dhënat përfundimtare të inspektimit, rezultatet e inspektimit të kryera në DRSSH Korçë, inspektim i cili u krye për periudhën 05.10.2020 - 29.01.2021 dhe që ishin planifikuar të inspektoheshin gjithsej 7355 dosje përfitimi, si dhe të kontrollohej zbatimi i rekomandimeve për 185 dosje përfitimi.

Nga 6210 dosje të inspektuara gjithsej janë certifikuar 5925 dosje ose 95% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 6210 dosje të inspektuara vetëm 283 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 4.5 % e totalit të dosjeve të inspektuara nga të cilat 140 dosje kanë rezultuar debitore me efekt financiar në shumën 3,645,472 lekë dhe 143 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 1,591,939 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjithashtu në programet e inspektimit, si pikë e veçantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme. Kështu, janë kontrolluar 231 dosje përfitimi, nga të cilat për 217 dosje ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme, duke rezultuar me efekte financiare debitorë dhe kreditorë.

Efektet financiarë debitor nga zbatimi i rekomandimeve është në vlerën 41,819,702 lekë, ndërsa efektet financiarë kreditor është në vlerën 696,600 lekë.

• Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2020 Sektori i Përfitimeve Suplementare, ka inspektuar 6210 dosje të përfitimeve suplementare nga të cilat 5641 përfitime të reja, 569 përfitime të rishqyrtuara sipas Vkm nr.657 dhe nr.658, datë 10.10.2019, si dhe janë rikontrolluar 231 të përfitimeve suplementare nga rekomandimet e mëparshme. Në total, kanë kaluar në proces inspektimi 6441 të përfitimeve suplementare. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 45,465,174 lekë dhe efekt financiar kreditor në shumën 2,288,539 lekë.

Gjatë vitit 2020 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 115 dosje nga 375 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 30 % e tyre.

• Në përfundim të programeve të inspektimit nga të dy sektorët është konstatuar ndryshim si në objektet e inspektimit, periudhën e inspektimit ashtu edhe në numër dosjesh krahasuar kjo me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

-Për Sektorin e Përfitimeve Afatgjata ishin planifikuar 8 DRSSH me 50741 dosje në total, ndërkohë që janë inspektuar 7 DRSSH dhe 44974 dosje përfitimesh.

-Për Sektorin e Përfitimeve Suplementare ishin planifikuar 10 DRSSH/DSSH me 8154 dosje në total, ndërkohë që nuk është realizuar inspektimi për 4 subjekte DRSSH Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe DSSH Sarandë, si dhe janë realizuar jashtë planit vjetor të miratuar DRSSH Berat, Gjirokastrë dhe Lezhë. Gjithashtu dhe në subjektet e inspektuara të cilat kanë qenë parashikuar në planin vjetor, DRSSH Shkodër dhe Fier, objekti i inspektimit nuk është i njëjtë me atë të miratuar në planin vjetor. Në DSSH Tropojë dhe Kukës periudha e auditimit ka ndryshuar nga 01.01.2018-31.12.2019 sipas planit, në 01.01.2018-31.06.2020. Në përfundim janë inspektuar 6441 dosje përfitimesh, nga 8154 të parashikuara.

Ndryshimi i planit nuk është formalizuar me shkresë dhe për rrjedhim nuk ka marrë miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

• Në total për vitin 2020 nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve janë inspektuar 51415 përfitime, nga këto 49879 dosje përfitimi objekt inspektimi, 1536 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 78,935,547 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 36,425,780 lekë.

Gjatë vitit 2020 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 453 dosje nga 2076 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 21.8 % e tyre.

Gjatë vitit 2020 nga Njësia e Inspektimit janë rekomanduar **19 masa disiplinore** sipas tabelës më poshtë:

Rekomandimet për masa disiplinore ndaj punonjësve								viti 2020
DRSSH	VITI	Totali i masave	Lloji i masave të rekomanduara/sipas rregullores					
			Largim nga puna	Kalimi në një detyrë të një kategorie apo klasë më të ulët, për një periudhë nga 30	Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në 2 vjet	Vërejtje me paralajmërim	Vërejtje me shkrim	Tërheqje vëmendje



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

				ditë deri në 1 vit				
DIBËR	2020	5					1	4
BERAT	2020	3						3
GJIROKASTËR	2020	4						4
TIRANË	2020	7						7
Gjithsej		19					1	18

* Nga rekomandimet e sipërhënuara, vetëm 1 rekomandim i dhënë në DRSSH Dibër “tërheqje vëmendje”, është rekomanduar nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajtimeve të Veçanta. Pjesa tjetër është rekomanduar nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata.

- Nga analiza e treguesve për dosjet me problematika të paraqitura nga Sektori Inspektive të Përfitimeve Suplementare dhe të veçanta për vitin 2020 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Dibër dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 15.4% dosje me problematika dhe DRSSH Shkodër me 12.32 % dosje me problematika.

- Në përfundim për vitet 2019-2020, në disa raste në Raportet e Përfundimtare të Inspektimit nuk janë identifikuar dhe ngarkuar me përgjegjësi Inspektorët e të vetpunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësit e konstatuara në dosjet e përfitimit, përmendim këtu DRSSH Kukës dhe Elbasan për vitin 2019, por vetëm janë adresuar sipas Komunave apo Njësive dhe nuk ka të dhëna për ecurinë e zbatimit të tyre.

- Niveli i masave disiplinore në raport me mangësit dhe shkeljet e konstatuara në DRSSH-t, nuk është i drejtë dhe nuk është zbatuar i njëjti standard nga njëri subjekt inspektimi në tjetrin. Përgjithësisht janë dhënë masa nga “Tërheqje vëmendje” deri në “Vërejtje me shkrim” dhe vetëm në një rast masa “Kalimi në një detyrë të një kategorie apo klasë më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në 1 vit”.

- Në Raportet e Auditimit nuk janë trajtuar si mangësi dhe shkelje mosrespektimi i afateve nga momenti i kërkesës për pension deri në lidhjen e pensionit, nuk ka evidence për çdo subjekt të inspektuar, e cila duhet të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar.

- Në total për vitet 2019-2020 numri i subjekteve debitore që janë akoma në proces arkëtimi është 81 me një vlerë totale debitore 25,377,547 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 4,709,362 lekë dhe kanë mbetur pa arkëtuar 20,668,185 lekë, më hollësisht trajtuar sipas tabelës “Lista e subjekteve debitore në proces arkëtimi për vitet 2019-2020”, Kreu V-Aneksë. Gjithashtu nuk janë futur në proces arkëtimi 11 përfitues debitor me vlerë 1,990,346 lekë, trajtuar sipas tabelës “Lista e subjekteve debitore që nuk janë futur në proces arkëtimi 2019-2020”, Kreu V-Aneksë.

III. Evidenca e dosjeve të kontrolluara nga Njësia e Inspektimit në vitet 2019-2020

1. Përfitime të reja të lidhura në periudhat objekt kontrolli e deri në datën 31.12.2020:

Pensione plegerie, invaliditeti dhe familjare													
Nr.	DRSSH	Afati i kontrollit	Periudha e kontrolluar	Pa kontrolluar	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali	Totali kontrolluar	Gjendja Pa kontrolluar
1	Fier	02.05.2019-07.08.2019	01.01.2016-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020		4228	3849	4471	4311	4932	21791	12548	9243
2	Vlorë	30.10.2019-20.12.2019	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2018-31.12.2020		3639	3209	3657	3628	3482	17615	6848	10767
3	Durrës	04.09.2019-25.10.2019	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2018-31.12.2020		3294	3565	3460	3445	3480	17244	6859	10385
4	Tiranë	11.02.2019 - 10.05.2019; 09.03.2020 - 30.09.2020	01.01.2016-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020		9094	8632	9028	9915	8815	45484	26754	18730



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

5	Berat	08.01.2020-05.03.2020	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2018-31.12.2020		1916	1,661	2082	2188	2282	10129	3577	6552
6	Gjirokastrë	08.01.2020 - 05.03.2020	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2018-31.12.2020		1641	1465	1475	1577	1518	7676	3106	4570
7	Dibër	08.01.2020 - 11.03.2020	01.01.2016-31.12.2017	01.01.2018-31.12.2020		1181	1182	1135	1167	1,230	5895	2363	3532
8	Shkodër	05.10.2020 - 15.01.2021	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020			2521	2724	2,736	2838	10819	5245	5574
9	Korçë	05.10.2020-19.01.2021	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020			3547	3549	3984	3608	14688	7096	7592
10	Kukës	11.02.2019 - 29.03.2019	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020			591	520	623	658	2392	1111	1281
11	Lezhe	05.10.2020-19.01.2021	01.01.2017-31.12.2018	01.01.2019-31.12.2020			1471	1475	1616	1606	6168	2946	3222
12	Elbasan	14.11.2018-30.01.2019	01.01.2015-31.12.2016	01.01.2017-31.12.2020	3971	3554	3079	3227	3547	3590	20968	7525	13443
	Totali				3971	28547	34772	36803	38737	38039	180869	85978	94891

Nga të dhënat e administruara nga ISSH dhe regjistrat themeltarë rezulton se gjatë viteve 2019-2020, Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve afatgjata, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2015-31.12.2018. Gjatë periudhës 01.01.2015-31.12.2020, janë lëshuar 180869 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 85978 përfitime suplementare afatgjata, apo 47.5 %, **dhe kanë mbetur pa inspektuar 94891, gati më shumë se gjysma e përfitimeve.**

- Gjithashtu në 5 subjekte DRSSH Vlorë, Durrës, Berat, Gjirokastrë, Dibër periudha e pa kontrolluar rezulton që nga 01.01.2018, ndërkohë në DRSSH Elbasan që nga data 01.01.2017, çka do të përbente risk për mos evidentimin e shumave të përfituara tepër për shkak të kalimit të afatit ligjor 3 vite nga marrja e përfitimit në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, Neni 62 ligjit nr Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera citohet: *E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.*

Përfitime nga skema e pensioneve suplementare dhe trajtimeve të veçanta

Nr.	DRSSH	Afati i kontrollit	Periudha e kontrolluar	Pa kontrolluar	2017	2018	2019	2020	Totali	Totali kontrolluar	Gjendja pa kontrolluar
1	Fier	18.11.2019-27.12.2019; 08.12.2020-25.12.2020	355 perfitime nga ligji 29 (kontroll para faktit); Me perzgjedhje 470 perfitime nga ligji 29	01.07.18-31.12.2020		89	552	4478	5119	825	4294
2	Vlore	18.11.2019-18.12.2019	173 ligji 29 ne vl + 154 ne sr (kontroll para faktit)	01.07.18-31.12.2020		163	493	1854	2510	327	2183
3	Durres	9.11.2020-7.12.2020; 28.12.2020 - 8.1.2021	01.01.2018-31.12.2019+vkm 657+658	01.01.2020-31.12.2020		208	346	1085	1639	554	1085
4	Tirana	07.01.2019 - 14.06.2019; 18.11.2019--27.12.2019	01.01.2017-31.12.2018; 697 perfitime nga 29 (kontroll para faktit)	01.01.2019-31.12.2020	1725	1718	2766	4975	11184	4140	7044
5	Berat	08.01.2020 - 05.03.2020	501 dosje nga ligji 29	01.07.2018-31.12.2020		35	463	608	1106	501	605
6	Gjirokaster	24.06.2019 - 09.07.2019; 08.01.2020 - 05.03.2020	01.01.2017 - 31.12.2018; 250 dosje nga ligji 29	01.01.2019-31.12.2020	94	116	377	673	1260	460	800
7	Diber	24.02.2020 - 30.06.2020	01.01.2018-31.12.2019 +vkm 657+658	01.01.2020-31.12.2020		125	1430	543	2098	1,555	543



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

8	Shkoder	07.10.2019 - 18.10.2019; 06.01.2020 - 22.01.2020	01.01.2017-30.06.2019; perfitime te caktuara nga ligji 29 deri ne daten 22.1.20+rivleresimet nga vkm 657+658	01.07.2019-31.12.2020	121	156	532	398	1207	717	490
9	Korca	02.09.2019 - 02.10.2019	01.01.2017-30.06.2019	01.07.2019-31.12.2020	236	227	764	2190	3417	598	2819
10	Kukes	28.09.2020 - 06.11.2020	01.01.2018-30.06.2020+vkm657+658	01.07.2020-31.12.2020		43	395	614	1052	668	384
11	Lezhe	24.10.2019 - 01.11.2019; 08.07.2020 - 11.09.2020	01.01.2018 - 30.06.2019; perfitime nga ligji 29 te caktuara deri ne 30.06.2020+rivleresim vkm 657+658	01.07.2019-31.12.2020		103	805	617	1525	1,269	256
12	Elbasan			01.07.2018-31.12.2020		26	692	1318	2036	0	2036
	Totali					3009	9615	19353	34153	11614	22539

VO: Numri i përfituesve të rinj të pasqyruar në tabelë për vitin 2018 në DRSSH: Fier, Vlorë, Berat dhe Elbasan, nuk i përket numrit total të përfitimeve të reja të caktuara në këto drejtori, por është numri i dosjeve të mbetura pa inspektuara për këtë vit.

Nga të dhënat e administruara nga ISSH dhe regjistrat themeltarë rezultojnë se gjatë viteve 2019-2020, Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve suplementare, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2017-31.12.2019. Gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2020, janë lëshuar 34153 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 11614 përfitime suplementare afatgjata, apo 34 %, dhe kanë mbetur pa inspektuar 22539.

➤ Zbatimi i afateve në procedurat e inspektimit

Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Programi	Afati i Inspektimit	Projekti	Kthimi i observacioneve pas PRA	Shkresa përcjellëse e dërgimit të Raportit Përfundimtar	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga mbajtja e Projekt Raportit deri në dërgimin e Raportit Perfundimtar	Shënime të audituesve të KLSH
	Nr.		Raporti					
	datë							
I.A. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA VITI 2019								
DRSSH ELBASAN	Nr. 7815; 7815/3	14.11.2018-08.02.2019	Nr. 7815/3	Datë 01.04.2019	Nr. 7815/5	29 dite kalendarike	84 dite kalendarike	
	Datë 13.11.2018;29.01.2019		Datë 06.03.2019		Datë 29.05.2019			
DRSSH KUKES	Nr. 1020	11.02.2019-29.03.2019	Nr. 1020/2	Datë 03.05.2019	Nr. 1020/11	17 dite kalendarike	71 dite kalendarike	
	Datë 08.02.2019		Datë 16.04.2019		Datë 26.06.2019			
DSSH TROPOJE	Nr. 1020	11.02.2019-29.03.2019	Nr. 1020/3	Datë 09.05.2019	Nr. 1020/9	11 dite kalendarike	68 dite kalendarike	
	Datë 08.02.2019		Datë 10.04.2019		Datë 17.06.2019			
DRSSH TIRANE	Nr. 1055	11.02.2019-10.05.2019	Nr. 1055/2	Datë 22.08.2019	Nr. 1055/6	32 dite kalendarike	106 dite kalendarike	
	Datë 08.02.2019		Datë 11.06.2019		Datë 25.09.2019			
DRSSH FIER	Nr. 3177; 3177/2	02.05.2019-07.08.2019	Nr. 3177/5	Datë 24.10.2019	Nr. -	47 dite kalendarike	x	
	Datë 26.04.2019; 10.05.2019		Datë 23.09.2019		Datë -			
DRSSH DURRES	Nr. 6033	04.09.2019-25.10.2019	Nr. 6033/2	Datë 09.01.2020	Nr. 6033/5	26 dite kalendarike	80 dite kalendarike	
	Datë 28.08.2019		Datë 21.11.2019		Datë 12.03.2020			
DRSSH VLORE	Nr. 7316; 7316/4	30.10.2019-20.12.2019	Nr. 7316/5	Datë 09.03.2020	Nr. 7316/7	38 dite kalendarike	146 dite kalendarike	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Datë 24.10.2019; 17.12.2019		Datë 27.01.2020		Datë 22.06.2020			
DSSH SARANDE	Nr. 7315; 7316/2 Datë 24.10.2019; 17.12.2019	30.10.2019- 20.12.2019	Nr. 7315/2 Datë 17.01.2020	Datë 27.01.2020	Nr. 7315/5 Datë 20.02.2020	28 dite kalendarike	34 dite kalendarike	
I.B. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA VITI 2020								
DRSSH DIBER	Nr. 46; 46/2 Datë 06.01.2020; 12.03.2020	08.01.2020- 11.03.2020	Nr. 46/4 Datë 27.04.2020	Datë 04.05.2020	Nr. 46/6 Datë 18.05.2020	47 dite kalendarike	21 dite kalendarike	
DRSSH BERAT	Nr. 45 Datë 06.01.2020	08.01.2020- 05.03.2020	Nr. 45/4 Datë 27.04.2020	Datë 14.05.2020	Nr. 45/7 Datë 02.07.2020	53 dite kalendarike	66 dite kalendarike	
DRSSH GJIROKASTER	Nr. 44 Datë 06.01.2020	08.01.2020- 05.03.2020	Nr. 44/2 Datë 05.05.2020	Datë 14.05.2020	Nr. 44/4 Datë 04.06.2020	60 dite kalendarike	30 dite kalendarike	
DRSSH TIRANE	Nr. 1644; 3768 Datë 06.03.2020; 01.07.2020	09.03.2020- 30.09.2020	Nr. 1644/2 Datë 17.11.2020	Datë 16.12.2020	Nr. 1644/4 Datë 24.02.2021	48 dite kalendarike	68 dite kalendarike	
DRSSH SHKODER	Nr. 5666 Datë 23.09.2020	05.10.2020- 15.01.2021	Nr. 5666/1 Datë 29.01.2021	Datë 15.02.2021	Nr. - Datë -	14 dite kalendarike	x	
DRSSH LEZHE	Nr. 5665 Datë 23.09.2020	05.10.2020- 19.01.2021	Nr. 5665/1 Datë 17.02.2021	Datë 12.03.2021	X X	29 dite kalendarike	x	
DRSSH KORCE	Nr. 5664 Datë 23.09.2020	05.10.2020- 29.01.2021	Nr. 5664/1 Datë 24.02.2021	Datë 16.03.2021	X X	26 dite kalendarike	x	
II.A. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA VITI 2019								
DRSSH TIRANE	Nr. 68 Datë 04.01.2019	07.01.2019- 14.06.2019	Nr. 68/2 Datë 05.08.2019	Datë 22.08.2019	Nr. 68/6 Datë 22.10.2019	52 dite kalendarike	76 dite kalendarike	
DRSSH GJIROKASTER	Nr. 4509 Datë 19.06.2019	24.06.2019- 09.07.2019	Nr. 4509/2 Datë 22.07.2019	Datë 25.07.2019	Nr. 4509/4 Datë 22.08.2019	13 dite kalendarike	30 dite kalendarike	
DRSSH KORCE	Nr. 6034 Datë 28.08.2019	02.09.2019- 02.10.2019	Nr. 6034/2 Datë 04.11.2019	Datë 20.11.2019	Nr. 6034/4 Datë 12.12.2019	32 dite kalendarike	38 dite kalendarike	
DRSSH SHKODER	Nr. 6804 Datë 04.10.2019	07.10.2019- 18.10.2019	Nr. 6804/2 Datë 12.11.2019	Datë 20.11.2019	Nr. 6804/5 Datë 17.12.2019	24 dite kalendarike	35 dite kalendarike	
DRSSH LEZHE	Nr. 7238 Datë 22.10.2019	24.10.2019- 01.11.2019	Nr. 7238/2 Datë 25.11.2019	Datë 13.12.2019	Nr. 7238/4 Datë 28.01.2020	24 dite kalendarike	63 dite kalendarike	
II.B. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA VITI 2020								
DRSSH SHKODER	Nr. 8595 Datë 27.12.2019	06.01.2020- 22.01.2020	Nr. 8595/2 Datë 25.02.2020	Datë 09.03.2020	Nr. 8595/5 Datë 04.05.2020	33 dite kalendarike	68 dite kalendarike	
DRSSH DIBER	Nr. 1191; 1191/2 Datë 18.02.2020; 04.05.2020	24.02.2020- 30.06.2020	Nr. 1191/4 Datë 01.09.2020	Datë 10.09.2020	Nr. 1191/6 Datë 18.09.2020	62 dite kalendarike	17 dite kalendarike	
DRSSH LEZHE	Nr. 3857; 3857/2	08.07.2020- 18.09.2020	Nr. 3857/3	Datë 12.11.2020	Nr. 3857/5	39 dite kalendarike	45 dite kalendarike	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Datë 06.07.2020; 15.09.2020		Datë 27.10.2020		Datë 11.12.2020			
DRSSH KUKES	Nr. 5695	28.09.2020- 06.11.2020	Nr. 5695/1	Datë 12.01.2021	Nr. 5695/7	19 dite kalendarike	56 dite kalendarike	
	Datë 24.09.2020		Datë 25.11.2020		Datë 21.01.2021			
DSSH TROPOJE	Nr. 5695	28.09.2020- 06.11.2020	Nr. 5695/2	Datë 21.12.2020	Nr. 5695/4	19 dite kalendarike	30 dite kalendarike	
	Datë 24.09.2020		Datë 01.12.2020		Datë 31.12.2020			
DRSSH DURRE	Nr. 6861; 6861/2	09.11.2020- 07.12.2020; 28.12.2020- 08.01.2021	Nr. 6861/3	X	X	37 dite kalendarike	x	
	Datë 05.11.2020; 03.12.2020		Datë 15.02.2021		X			
DRSSH FIER	Nr. 7512	07.12.2020- 22.12.2020	Nr. 7512/1	Datë 11.03.2021	Nr. 7512/3	40 dite kalendarike	69 dite kalendarike	
	Datë 03.12.2020		Datë 03.02.2021		Datë 13.04.2021			

- Në asnjë prej rregulloreve të administruara në ISSH, si dhe në “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi i inspektimit në terren, mbajtja e akt konstatimeve, hartimi i Raportit Paraprak, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i Raportit Përfundimtar dhe evadimi i materialeve.

Nga Inspektimet e ushtruara në vitin 2019-2020, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, afatet nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak, nuk janë të njëjta dhe variojnë nga 11 ditë deri në 62 ditë, ndërsa nga moment i hartimit të Raportit Paraprak deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar **variojnë nga 17 ditë deri në 146 ditë.**

Gjithashtu nga raporti i afateve të shfrytëzuara për secilin inspektim me volumin e punës apo numrin e dosjeve të inspektuara nuk ka një shpërndarje të drejtë dhe njëtrajtshme, rezulton se për periudha më të shkurta kohore janë inspektuar një numër më i lartë dosjesh dhe anasjelltas, çka tregon një shfrytëzim jo eficient të kohës së punës sipas subjekteve dhe mosrespektim të afate për evadimin e materialeve, më hollësisht trajtuar sipas tabelave më poshtë :

I.A. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA VITI 2019					
Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Afati inspektimit ne terren	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga mbajtja e Projekt Raportit deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar	Afati ne total	Numri i dosjeve te kontrolluara
DRSSH ELBASAN	14.11.2018-08.02.2019	29 dite kalendarike	84 dite kalendarike	113	7522
DRSSH KUKES	11.02.2019-29.03.2019	17 dite kalendarike	71 dite kalendarike	88	802
DSSH TROPOJE	11.02.2019-29.03.2019	11 dite kalendarike	68 dite kalendarike	79	322
DRSSH TIRANE	11.02.2019-10.05.2019	32 dite kalendarike	106 dite kalendarike	138	9329
DRSSH FIER	02.05.2019-07.08.2019	47 dite kalendarike	x	47	12724
DRSSH DURRE	04.09.2019-25.10.2019	26 dite kalendarike	80 dite kalendarike	106	7013
DRSSH VLORE	30.10.2019-20.12.2019	38 dite kalendarike	146 dite kalendarike	184	4603
DSSH SARANDE	30.10.2019-20.12.2019	28 dite kalendarike	34 dite kalendarike	62	2269

I.B. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA VITI 2020					
Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Afati inspektimit ne terren	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga mbajtja e Projekt Raportit deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar	Afati ne total	Numri i dosjeve te kontrolluara
DRSSH DIBER	08.01.2020-11.03.2020	43 dite kalendarike	21 dite kalendarike	64	2295
DRSSH BERAT	08.01.2020-05.03.2020	53 dite kalendarike	66 dite kalendarike	119	3597
DRSSH GJIROKASTER	08.01.2020-05.03.2020	60 dite kalendarike	30 dite kalendarike	90	2966
DRSSH TIRANE	09.03.2020-30.09.2020	48 dite kalendarike	68 dite kalendarike	116	18822
DRSSH SHKODER	05.10.2020-15.01.2021	14 dite kalendarike	x	x	5478
DRSSH LEZHE	05.10.2020-19.01.2021	29 dite kalendarike	x	x	3208
DRSSH KORCE	05.10.2020-29.01.2021	26 dite kalendarike	x	x	7303

I.A. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA VITI 2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Afati inspektimit ne terren	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga mbajtja e Projekt Raportit deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar	Afati ne total	Numri i dosjeve te kontrolluara
DRSSH TIRANE	07.01.2019-14.06.2019	52 dite kalendarike	76 dite kalendarike	128	3343
DRSSH GJIROKASTER	24.06.2019-09.07.2019	13 dite kalendarike	30 dite kalendarike	43	210
DRSSH KORCE	02.09.2019-02.10.2019	32 dite kalendarike	38 dite kalendarike	70	598
DRSSH SHKODER	07.10.2019-18.10.2019	24 dite kalendarike	35 dite kalendarike	59	337
DRSSH LEZHE	24.10.2019-01.11.2019	24 dite kalendarike	63 dite kalendarike	87	168

I.A. SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA VITI 2020					
Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Afati inspektimit ne terren	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga mbajtja e Projekt Raportit deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar	Afati ne total	Numri i dosjeve te kontrolluara
DRSSH SHKODER	06.01.2020-22.01.2020	33 dite kalendarike	68 dite kalendarike	101	544
DRSSH DIBER	24.02.2020-30.06.2020	62 dite kalendarike	17 dite kalendarike	79	1548
DRSSH LEZHE	08.07.2020-18.09.2020	39 dite kalendarike	45 dite kalendarike	84	1136
DRSSH KUKES	28.09.2020-06.11.2020	19 dite kalendarike	56 dite kalendarike	75	722
DSSH TROPOJE	28.09.2020-06.11.2020	19 dite kalendarike	30 dite kalendarike	49	234
DRSSH DURRES	09.11.2020-07.12.2020; 28.12.2020-08.01.2021	37 dite kalendarike	x	x	805
DRSSH FIER	07.12.2020-22.12.2020	40 dite kalendarike	69 dite kalendarike	109	470

Konkluzione

- Numri i dosjeve të përfitimit të kontrolluara për një vit nga kjo Njësi ka pësuar rënie nga viti 2019 ishin 50695 dosje, ndërsa në vitin 2020 janë kontrolluar 44974 dosje, **pra 5721 dosje më pak.**

- Nga të dhënat mbi inspektimet e ushtruara nga Njësia e Inspektimit për vitet 2019-2020, trajtuar hollësisht në tabelat Nr. 1, 2, 3 dhe 4, bashkangjitur akt-konstatimit, vërehet se për periodha të njëjta auditimi, shpërndarja e volumit të punës për secilin inspektor nuk është e njëjtë në raport me numrin total të dosjeve të inspektuara për subjektin përkatës.

Gjithashtu nga verifikimi i evidencave mbi inspektimet e kryera për vitet 2019-2020, rezulton se planifikimi i shpërndarjes së inspektorëve sipas programeve të inspektimit për subjektet e inspektuara dhe numrit total të dosjeve të planifikuara për kontroll nuk është bërë në raport të drejtë, në subjekte që ka një numër më të vogël dosjesh përfitimi janë caktuar i njëjtë numër inspektorësh me ato subjekte që kanë volum më të madhë dosjesh, më hollësisht sipas tabelave më poshtë:

Sektori i Inspektimeve të përfitimeve afatgjata

Nr	Viti 2019	Numri dosjeve të planifikuara për kontroll	Numri dosjeve të kontrolluara	Numri Inspektorëve sipas porgramit	Numri dosjeve për inspektor mesatarisht
1	Elbasan	10352	10204	13	796
2	Tiranë	10477	9802	13	805
3	Fier	14468	14362	14	1033
4	Durrës	7841	7657	13	603

Nr	Viti 2020	Numri dosjeve të planifikuara për kontroll	Numri Dosjeve të kontrolluara	Numri Inspektorëve sipas porgramit	Numri dosjeve për inspektor mesatarisht
1	Berat	3774	3695	6	629
2	Gjirokastrë	3115	3068	5	623
3	Shkodër	5528	5496	5	1105
4	Korçë	7540	7486	6	1256

- Nga inspektimet e ushtruara nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta, për vitet 2019-2020, rezulton se 5 prej tyre DRSSH Vlorë, Sarandë, Fier, Berat dhe Gjirokastrë janë kryer në bashkëpunim me sektorin e Inspektimeve të përfitimeve afatgjata, me një numër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

më të lartë inspektorësh, por numri dosjeve është më i vogël se sa subjektet e tjera të inspektuara gjatë viteve 2019-2020, të cilat kanë numër më të lartë të dosjeve të përfitimit, më hollësisht sipas tabelave më poshtë:

Nr.	Viti 2019	Vlorë	Sarandë	Tiranë	Korçë	Shkodër	Lezhë	Tiranë	Fier
1	Numri dosjeve të planifikuara për kontroll	173	154	3624	668	333	214	687	355
2	Numri inspektorëve sipas programit	8	5	3	3	3	3	2	2

Nr.	Viti 2020	Durrës	Berat	Gjirokastrë	Dibër	Shkodër	Lezhë
1	Numri dosjeve të planifikuara për kontroll	805	501	544	1548	544	1136
2	Numri inspektorëve sipas programit	3	7	5	3	3	3

- Gjithashtu në inspektimet e kryera nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta rezulton se nga 18 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 14 prej tyre ka marrë pjesë si anëtare grupi dhe Përgjegjësi e Sektorit, ndërsa në Sektorin e Inspektimeve Afatgjata nga 15 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 2 prej tyre ka marrë pjesë si anëtar grupi dhe Përgjegjësi i Sektorit. Në përshkrimet e bëra mbi përgjegjësit dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit sipas “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, nuk është parashikuar përfshirja e Përgjegjësit të Sektorit në programet e inspektimit.

- Referuar numrit total të dosjeve të inspektuara për vitin 2019 nga *Sektori i Inspektimeve Afatgjata*, 50695 dosje përfitimi, çdo inspektor duhet të inspektojë mesatarisht 3379 dosje në vit, ndërkohë për vitin 2020 referuar numrit total të dosjeve të inspektuara nga Sektori i Inspektimeve Afatgjata, 44974 dosje përfitimi, çdo inspektor duhet të inspektojë mesatarisht 2998 dosje në vit.

- Nëse do të marrim për referencë vitin 2019, që ka dhe rezultate me të larta, ku një specialist duhet të inspektojë mesatarisht 3379 dosje në vit, në total nga 15 inspektorë duhet të inspektohen afërsisht 50600 dosje në vit, ndërkohë referuar numrit total të dosjeve të përfitimit që kanë mbetur pa kontrolluar për periudhën nga 01.01.2017-31.12.2020, gjithësej **94891, do të mbetet sërish një numër i lartë i dosjeve të pakontrolluara rreth 44291, apo 46 % çka do të përbente risk për tejkalimin e afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht dhe për pasojë do të sillte efekte financiare për ISSH.**

- Referuar numrit total të dosjeve të inspektuara nga *Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta*, 6524 dosje përfitimi për vitin 2019 dhe 6441 dosje përfitimi për vitin 2020, çdo inspektor duhet të inspektojë mesatarisht 3262 dosje në vit, pa marrë parasysh këtu që nga 18 inspektime të kryera në vitet 2019-2020, 5 prej tyre DRSSH Vlorë, Sarandë, Fier Berat dhe Gjirokastrë janë kryer në bashkëpunim me sektorin e Inspektimeve të përfitimeve afatgjata, si dhe përfshirjen në inspektime të Përgjegjëses së të Sektorit.

Në total nga 2 inspektorë duhet të inspektohen afërsisht 6500 dosje në vit, ndërkohë referuar numrit total të dosjeve të përfitimit që kanë mbetur pa kontrolluar për periudhën nga 01.07.2018-31.12.2020, gjithësej **22539, do të mbetet një numër i lartë i dosjeve të pakontrolluara rreth 16039 apo 71 % i totalit çka do të përbente risk për tejkalimin e afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht, dhe për pasojë do të sillte efekte financiare për ISSH.**

- Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta, në inspektimet e kryera për vitin 2019-2020, për dosjet e përfituara nga Ligjit nr. 29/2019 apo rivlersimet sipas VKM Nr. 657, datë 10.10.2019 dhe VKM Nr. 658, datë 10.10.2019, nuk ka të dokumentuar dhe argumentuar mënyrën se si janë pëzgjedhur dosjet për inspektim, në materialet e administruara në dosje Raport Paraprak dhe Raport Përfundimtar, shprehet se janë inspektuar dosjet e paraqitura nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

subjekti, mungon relacion apo memo. Në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ISSH nuk ka asnjë përcaktim për këto raste.

- Në dosje nuk administrohen informacione periodike për raportimin e ecures së inspektimit nga Specialistët, po ashtu dhe nga Përgjegjësit e Sektorit në kundërshtim me përcaktimet bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, pika 1.7.2 dhe 1.7.3. Në Rregullore nuk është parashikuar periudha periodike e raportimit.

Gjithashtu në asnjë prej rregulloreve mbi të cilat ushtron veprimtarinë Njësia e Inspektimit të Përfitimeve nuk janë përcaktuar afatet për evadimin e materialeve të inspektimit.

Në këtë rregullore ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit, pasi në Kreun X- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Prezantimi Detyrave/ për Auditues, ndër të tjera citohet se:

- *Kontrollon respektimin e standartëve të cilësisë për administrimin e shërbimeve*

- për përfitimet afatshkurtra dhe afatgjata: Kontrollon respektimin e rregullave të dhënies së të drejtës, vërtetësisë së dokumentave justifikuese dhe llogaritjen e përfitimeve.

Në këtë pikë në kompetencat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është përfshirë dhe kontrolli i përfitimeve afatgjata që është kompetencë e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.

- Nga analiza e të gjithë treguesve më sipër rezulton se Njësia e Inspektimit nuk ka menaxhuar siç duhet burimet njëzëre në dispozicion, sipas përcaktimeve të bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, pika 1.7.1, Detyra të përgjithshme, Menaxhimi Stafit, Përgjegjësit dhe detyrat. Gjithashtu ISSH duhet të marrë masa të shtojë burimet njëzëre për këtë Njësi me qëllim shmangjen e efekteve financiare për ISSH dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

Për mangësit të trajtuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. A A me detyrë Kryetare e Njesisë së Inspektimit, z. A K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Përfitimeve Afatgjata, zj. E Y me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Përfitimeve Suplementare dhe të veçanta, si dhe Drejtori i Përgjithshëm z. A H.

Për sa trajtuar më sipër mbahet akt konstatim nr. 4, datë 27.04.2021.

Në lidhje me akt-konstatimin nr. 4, datë 27.04.2021, janë paraqitur sqarimet me shkresën nr. 2848/1 prot, datë 04.05.2021, administruar në KLSH me nr. 95/4 prot, datë 06.05.2021, nga znj. A A me detyrë Kryetare e Njesisë së Inspektimit të përfitimeve, z. A K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata dhe znj. E Y me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe të veçanta, të cilët sqarojnë se:

Në lidhje me konstatimet për hartimin e planit vjetor dhe ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, sqarojnë se planifikimi vjetor i punës është një instrument për të bërë të mundur planifikimin e punës, por dinamika dhe problematikat e ndryshme kanë qenë shkaqet që janë bërë ndryshime si në subjekte dhe në periudhën e auditimit, si dhe të gjithë programet janë miratuar nga Drejtori i përgjithshëm. ***Qendrimi i Grupit të Auditimit:*** Në lidhje me sqarimet tuaja për ndryshimet në programin vjetor, Grupi i Auditimit ka konstatuar mos formalizimin me shkrim të ndryshimeve të ndodhura në planin vjetor, si dhe publikimin e planit të ndryshuar.

- Në lidhje me auditimet e ushtruara në kuadrin e VKM nr. 29/2019, këto kontrole janë kryer mbështetur në parimin e kontroleve para faktit dhe të gjitha përfitimet e inspektuara janë paraqitur në Raportet Përfundimtare të Inspektimit. ***Qendrimi i Grupit të Auditimit:*** Nga auditimi është konstatuar se nuk ka dokumentacion apo relacion paraprak për përzgjedhjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ketyrë subjekteve për inspektim, për të argumentuar përzgjedhjen e subjekteve për inspektim të përfitimeve.

- Në lidhje me konstatimet për masat disiplinore sqarojnë së masat janë propozuar duke marrë parasysh problematikat e konstatuara në dosjet e përfitimit si dhe zbatimin e akteve ligjore. Pavarsisht ndryshimit të numrit të problematikave të konstatuara nga një DRSSH në krahasim me një DRSSH tjetër, masat disiplinore gjithmonë kanë qenë të argumentuara. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi janë konstatuar se në disa raste në subjektet që kanë numrin më të lartë të dosjeve me problematika nuk janë dhënë masa disiplinore dhe në disa të tjera ku numri i problematikave është më i ulët janë dhënë masa disiplinore, rasti i DRSSH Tiranë sipas Raportit Përfundimtar janë konstatuar mangësi dhe shkelje për 21 Inspektor dhe nuk është propozuar asnjë masë disiplinore apo DRSSH Lezhë. Për DSSH Sarandë nuk është paraqitur dokumentacion që vërteton marrjen e masave disiplinore, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me konstatimin se nuk janë përcaktuar afatet për procedurat e auditimit, sqarojnë se në shkresat bashkalidhur raporteve paraprake ashtu dhe ato përfundimtare janë evidentuar afatet brenda të cilave subjekti i audituar duhet të bëjë miratimin e dokumentit. Zgjatja e afateve të mbylljes së materialeve për vitin 2020 ka ardhur dhe për shkak të situatës pandemike Covid 19. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ISSH si dhe në rregulloret e tjera, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, nuk ka përcaktim për afatet e procedurave të inspektimit, nga faza e kontrollit në terren deri në evadimin e materialeve përfundimtare. Afati i përmendur nga ju në sqarimin që keni bërë, ka lidhje vetëm me kthim përgjigjen e subjektit të inspektuar për raportet paraprake dhe përfundimtare, por nuk ka përcaktim për afatet e procedurave të tjera të inspektimit.

Numri i dosjeve për vitin 2020 është më i vogël se në vitin 2019, për shkak të situatës pandemike, ndërkohë që volumi i punës për secilin specialist është shpërndarë në mënyrë të njëjtë për të gjithë, në ato raste kur ka ndryshim të madhë brenda një programi inspektimi kjo ka ardhur për shkak të marrjes së lejes vjetore. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Përveç sqarimeve të bëra nga ju për shkaqet që kanë çuar në shpërndarjen jo të njëjtë të volumit dosjeve për inspektim, nga auditimi ka rezultuar se për periudha të njëjta inspektimi, në disa subjekte, shpërndarja e volumit të punës për secilin inspektor nuk është e njëjtë në raport me numrin total të dosjeve të inspektuara për subjektin përkatës. Gjithashtu nga verifikimi i evidencave mbi inspektimet e kryera për vitet 2019-2020, rezulton se planifikimi i shpërndarjes së inspektorëve sipas programeve të inspektimit për subjektet e inspektuara dhe numrit total të dosjeve të planifikuara për kontroll nuk është bërë në raport të drejtë, në subjekte që ka një numër më të vogël dosjesh përfitimi janë caktuar i njëjtë numër inspektorësh me ato subjekte që kanë volum më të madhë dosjesh.

- Në lidhje me inspektimet për përfitimet e dhena në bazë të ligjit 29/2019, si dhe VKM 657/658, datë 10.10.2019, nuk ka ndonjë mënyrë të veçantë për përzgjedhjen e dosjeve për inspektim, pasi të gjitha përfitimet janë objekt i inspektimit të radhës dhe merret për bazë regjistri themeltar i përfitimeve. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ISSH dhe dosjet e inspektimit, nuk është e dokumentuar se si janë përzgjedhur subjektet e para për inspektim, si dhe në ato raste kur inspektimi i përfitimeve është bërë më zgjedhje, mungon relacion apo memo, trajtuar hollësisht në material. Sqarimet tuaja nuk janë të argumentuara me dokumentacion justifikues.

Gjetja

Nivel i lartë i dosjeve të painspektuara dhe të pacertifikuara nga Njësia e Inspektimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Situata

Në përfundim të inspektimeve të kryera gjatë vitit 2019, nga sektori i përfitimeve afatgjata kanë rezultuar: Dosje të inspektuara 44584, si dhe janë rikontrolluar 6111 dosje përfitimi zbatim rekomandimesh, në total janë kontrolluar 50695 dosje të përfitimeve afatgjata, të caktuara në mbështetje të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga këto në total kanë rezultuar 1144 dosje debitore me efekt financiar në shumën 53,152,029 lekë dhe 1742 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 71,186,375 lekë.

-Sektori i Përfitimeve Suplementare gjatë viti 2019, ka inspektuar 4756 dosje të përfitimeve suplementare, si dhe janë rikontrolluar 389 dosje të përfitimeve suplementare nga rekomandimet e mëparshme. Gjithashtu, janë kontrolluar 1,379 dosje përfitimi të caktuara sipas ligjit 29/2019. Në total, kanë kaluar në proces inspektimi 6524 dosje të përfitimeve suplementare.

Nga këto në total kanë rezultuar 257 dosje debitore me efekt financiar në shumën 34,856,752 lekë dhe 166 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 6,319,770 lekë, si dhe një efekt financiar debitor 9,136,821 lekë nga pezullimet.

Në total për vitin 2019 nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, nga të dy sektorët, janë inspektuar 57219, nga këto 50719 dosje përfitimi objekt inspektimi, 6500 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total kanë rezultuar 1401 dosje debitore me efekt financiar në shumën 88,088,781 lekë dhe 1908 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 77,506,145 lekë, si dhe një efekt financiar debitor 9,136,821 lekë nga pezullimet për 6 dosje.

- **Për vitin 2020** në përfundim të inspektimeve të kryera nga sektori i përfitimeve afatgjata kanë rezultuar: Inspektuar 43669 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë rikontrolluar 1305 dosje përfitimi zbatim rekomandimesh, në total janë kontrolluar 44974 dosje të përfitimeve afatgjata, të caktuara në mbështetje të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga këto në total kanë rezultuar 612 dosje debitore me efekt financiar në shumën 33,470,373 lekë dhe 1044 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 34,137,241 lekë.

-Sektori i Përfitimeve Suplementare gjatë vitit 2020, ka inspektuar 6210 dosje të përfitimeve suplementare nga të cilat 5641 përfitime të reja, 569 përfitime të rishqyrtuara sipas Vkm nr.657 dhe nr.658, datë 10.10.2019, si dhe janë rikontrolluar 231 të përfitimeve suplementare nga rekomandimet e mëparshme. Në total, kanë kaluar në proces inspektimi 6441 të përfitimeve suplementare. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 45,465,174 lekë dhe efekt financiar kreditor në shumën 2,288,539 lekë.

Në total për vitin 2020 nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, nga të dy sektorët, janë inspektuar 51415 përfitime, nga këto 49879 dosje përfitimi objekt inspektimi, 1536 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 78,935,547 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 36,425,780 lekë.

- Si përfundim rezulton se gjatë viteve 2019-2020, Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve afatgjata, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2015-31.12.2018. Gjatë periudhës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	01.01.2015-31.12.2020, janë lëshuar 180869 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 85978 përfitime suplementare afatgjata, apo 47.5 %, dhe kanë mbetur pa inspektuar 94891, gati më shumë se gjysma e përfitimeve. Gjithashtu në 5 subjekte DRSSH Vlorë, Durrës, Berat, Gjirokastrë, Dibër periudha e pa kontrolluar rezulton që nga 01.01.2018, ndërkohë në DRSSH Elbasan që nga data 01.01.2017, çka do të përbente risk për mos evidentimin e shumave të përfituara tepër për shkak të kalimit të afatit ligjor 3 vite nga marrja e përfitimit në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, Neni 62 ligjit nr Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera citohet: E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit. - Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve suplementare, rezulton se gjatë viteve 2019-2020, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2017-31.12.2019. Gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2020, janë lëshuar 34153 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 11614 përfitime suplementare afatgjata, apo 34 %, dhe kanë mbetur pa inspektuar 22539.
Kriteri	Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Rregullorja nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar; Rregullorja nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.25, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar; Rregullorja nr.3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Impakt financiar si në rastin e përfituesve dhe të ISSH në varësi të konstatimeve të inspektimit të debitorëve dhe kreditorëve.
Rëndësia Rekomandimi nr. 1	I Lartë Njësia e Inspektimit të Përfitimeve me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve, të marrë masa që planifikimi i inspektimeve të kryehet brenda një viti nga data e lidhjes së pensioneve dhe të përfundojë inspektimin dhe certifikimin e dosjeve të lidhura nga viti 2017 e në vazhdimësi.
Rekomandimi nr. 2	Nga ISSH të merret në konsideratë ndryshimi i strukturës organike, duke plotësuar me staf Njësinë e Inspektimit, me qëllim inspektimin dhe certifikimin e pensioneve të përfituara brenda afatit ligjor 3 vjeçar.
Gjetja	Nga auditimi janë konstatuar 81 raste të përtifuesve debitor që janë akoma në proces arkëtimi dhe 11 subjekte përfitues debitor që nuk janë futur në proces arkëtimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Situata	Në fund të periudhës 2019-2020, nga totali i dosjeve të rezultuara me efekt financiar debitor nga Njësia e Inspektimit, janë konstatuar përfitues debitor që nuk janë futur ende në proces arkëtimi apo që nuk janë arkëtuar plotësisht, konkretisht për vitet 2019-2020 numri i përfituesve debitorë që janë akoma në proces arkëtimi është 81 me një vlerë totale debitorë 25,377,547 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 4,709,362 lekë dhe kanë mbetur pa arkëtuar 20,668,185 lekë, më hollësisht trajtuar sipas tabelës “<i>Lista e subjekteve debitorë në proces arkëtimi për vitet 2019-2020</i>”, Kreu V-Anekse, gjithashtu nuk janë futur në proces arkëtimi 11 përfitues debitor me vlerë 1,990,346 lekë, trajtuar sipas tabelës “<i>Lista e subjekteve debitorë që nuk janë futur në proces arkëtimi 2019-2020</i>”, Kreu V-Anekse.
Kriteri	Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Rregullorja nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar; Rregullorja nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.25, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar; Rregullorja nr.3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Impakt financiar për ISSH nga mosarkëtimi i shumave të përfituara padrejtësisht
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi 2	ISSH të marrë masa të fillojë procesin e arkëtimit për 11 subjekte në vlerën 1,990,346 lekë si dhe të ndjekë në vazhdimësi procesin e arkëtimit për 81 subjekte në vlerën e mbetur 20,668,185 lekë.
Gjetja	Niveli i masave disiplinore në raport me mangësit dhe shkeljet e konstatuara në DRSSH-t, nuk është i njëjtë nga njëri subjekt inspektimi në tjetrin.
Situata	Nga analiza e treguesve për dosjet me problematika të paraqitura në tabelën për <i>Sektorin Inspektive të Përfitimeve Afatgjata 2019</i>, rezulton se subjektet që kanë numrin më të lartë dosjeve me problematika janë DRSSH Kukës, Tropjë dhe Sarandë, ndërkohë që masa disiplinore janë propozuar vetëm për DRSSH Kukës, Tropojë, Elbasan dhe nuk është propozuar për DSSH Sarandë megjithëse ka përqindje më të lartë të dosjeve me problematika se sa DRSSH Elbasan. Në rastin e DRSSH Tiranë sipas Raportit Përfundimtar janë konstatuar mangësi dhe shkelje për 21 Inspektor dhe nuk është propozuar asnjë masë disiplinore. Nga <i>Sektori Inspektive të Përfitimeve Suplementare</i> dhe të veçanta për vitin 2019 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Korçë dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 14.29% dhe DRSSH Tiranë me 14.3 %, të cilat kanë përqindjen më të lartë të dosjeve me problematika. Në rastin e DRSSH Tiranë janë konstatuar 497 dosje me probleme, nga të cilat 224 me efekt financiar në shumën 18,840,102 debitor dhe 2,297,413 kreditor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga *Sektori Inspektiveve të Përfitimeve Suplementare* dhe të veçanta për vitin 2020 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Dibër dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 15.4% dosje me problematika dhe DRSSH Shkodër me 12.32 % dosje me problematika.

Në përfundim për vitet 2019-2020, në disa raste në Raportet e Përfundimtare të Inspektimit nuk janë identifikuar dhe ngarkuar me përgjegjësi Inspektorët e të vetepunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësit e konstatuara në dosjet e përfitimit, përmendim këtu DRSSH Kukës dhe Elbasan për vitin 2019, por vetëm janë adresuar sipas Komunave apo Njësive dhe nuk ka të dhëna për ecurinë e zbatimit të tyre.

Niveli i masave disiplinore në raport me mangësit dhe shkeljet e konstatuara në DRSSH-t, nuk është i njëjtë nga njëri subjekt inspektimi në tjetrin. Përgjithësisht janë dhënë masa nga “Tërheqje vemendje” deri në “Vërejtje me shkrim” dhe vetëm në një rast masa “Kalimi në një detyrë të një kategorie apo klasë më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në 1 vit”.

Kriteri Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Rregullorja nr.3/2, datë 26.02.2008 “Për miratimin e rregullores “Për personelin e ISSH-së”, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 14.08.2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren Nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së”.

Ndikimi/Efekti Mos evidentimi i përgjegjësive në raport me shkeljet dhe mangësit e konstatuara.

Rëndësia I Lartë

Rekomandimi ISSH/Njësia e Inspektimit të Përfitimeve në vazhdimësi të rekomandojë marrjen e masave disiplinore në raport me mangësit dhe shkeljet e konstatuara duke zbatuar të njëjtin standard për çdo subjekt të inspektuar, gjithashtu të identifikojë në vijimësi Inspektorët përgjegjës e të vetepunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësit e konstatuara në dosjet e përfitimit.

Gjetja Nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, afatet për evadimin e materialeve, ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

Situata Nga auditimi rezultoi se në asnjë prej rregulloreve të administruara në ISSH nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi inspektimit në terren, mbajtja e akt konstatimeve, hartimi i Raportit Paraprak, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i Raportit Përfundimtar dhe evadimi i materialeve të inspektimit.

Nga Inspektimet e ushtruara në vitin 2019-2020, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, afatet nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak, nuk janë të njëjta dhe variojnë nga 11 ditë deri në 62 ditë, ndërsa nga moment i hartimit të Raportit Paraprak deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar variojnë nga 17 ditë deri në 146 ditë.

Në dosje nuk administrohen informacione periodike për raportimin e ecurisë së inspektimit nga Specialistët dhe nga Përgjegjësit e Sektorit në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	kundërshtim me përcaktimet bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, pika 1.7.2 dhe 1.7.3, gjithashtu në Rregullore nuk është parashikuar periudha periodike e raportimit. Në rregullore ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, pasi në Kreun X-Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Prezantimi Detyrave/ për Auditues, ndër të tjera citohet se: - <i>Kontrollon respektimin e standartëve të cilësisë për administrimin e sherbimeve</i> - <i>për përfitimet afatshkurtra dhe afatgjata: Kontrollon respektimin e rregullave të dhënies së të drejtës, vërtetësisë së dokumentave justifikuese dhe llogaritjen e përfitimeve.</i> Në këtë pikë në kompetencat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është përfshirë dhe kontrolli i përfitimeve afatgjata që është kompetencë e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve. Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018. - Rregullorja nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar; - Rregullorja nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.25, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar; - Rregullorja nr.3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”, të ndryshuar.
Kriteri	
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i afateve në procedurat e inspektimit, mungesa e raportimit periodik, mbivendosje kompetencash
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	ISSH të marri masa të bëjë ndryshime në rregulloret mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj, duke përcaktuar qartësisht afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi i inspektimit në terren deri tek evadimi i materialeve të inspektimit, afatin për raportimin periodik nga çdo inspektor dhe Përgjegjësi i Sektorit. Gjithashtu të bëjë ndryshimet përkatëse në “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, me qëllim shmangjen e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.
Gjetja	Njësia e Inspektimit nuk ka menaxhuar siç duhet burimet njërëzore në dispozicion, si dhe konstatohet shfrytëzim jo eficient të kohës së punës sipas subjekteve të inspektuara.
Situata	Nga Inspektimet e ushtruara në vitin 2019-2020, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, rezulton se nga raporti i afateve të shfrytëzuara për secilin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

inspektim me volumin e punës apo numrin e dosjeve të inspektuara nuk ka një shpërndarje të drejtë dhe njëtrajtshme, rezulton se për periudha më të shkurta kohore janë inspektuar një numër më i lartë dosjesh dhe anasjelltas, çka tregon një shfrytëzim jo eficient të kohës së punës sipas subjekteve. Nga të dhënat mbi inspektimet e ushtruara nga Njësia e Inspektimit për vitet 2019-2020, vërehet se për periudha të njëjta auditimi, shpërndarja e volumit të punës për secilin inspektor nuk është e njëjtë në raport me numrin total të dosjeve të inspektuara për subjektin përkatës.

Gjithashtu nga verifikimi i evidencave mbi inspektimet e kryera për vitet 2019-2020, rezulton se planifikimi i shpërndarjes së inspektorëve sipas programeve të inspektimit për subjektet e inspektuara dhe numrit total të dosjeve të planifikuara për kontroll nuk është bërë në raport të drejtë, në subjekte që ka një numër më të vogël dosjesh përfitimi janë caktuar i njëjtë numër inspektorësh me ato subjekte që kanë volum më të madhë dosjesh.

Ndërkohë nga inspektimet e ushtruara nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta, për vitet 2019-2020, rezulton se 5 prej tyre DRSSH Vlorë, Sarandë, Fier, Berat dhe Gjirokastrë janë kryer në bashkëpunim me sektorin e Inspektimeve të përfitimeve afatgjata, me një numër më të lartë inspektorësh, por numri dosjeve të inspektuara është më i vogël se sa subjektet e tjera të inspektuara gjatë viteve 2019-2020.

Gjithashtu në inspektimet e kryera nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta rezulton se nga 18 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 14 prej tyre ka marrë pjesë si anëtar grupi dhe Përgjegjësi i Sektorit, ndërsa në Sektorin e Inspektimeve Afatgjata nga 15 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 2 prej tyre ka marrë pjesë si anëtar grupi dhe Përgjegjësi i Sektorit. Në përshkrimet e bëra mbi përgjegjësit dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit sipas “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore”, Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, nuk është parashikuar përfshirja e Përgjegjësit të Sektorit në programet e inspektimit.

Kriteri

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018.

- Rregullorja nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar;

- Rregullorja nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.25, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar;

- Rregullorja nr.3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”, të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti

Shfrytëzim jo eficient i burimeve njerëzore, tejkalimi i afatit ligjor 3 vjeçar për inspektimin e përfitimeve

Rëndësia

I mesëm

Rekomandimi

ISSH të marrë masa në vazhdimësi për menaxhimin me efektivitet të burimet njerëzore në dispozicion, sipas përcaktimeve të bëra në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

“Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Gjithashtu ISSH duhet të marrë masa të shtojë burimet njërëzore për këtë Njësi me qëllim shmangjen e efekteve financiare për ISSH dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepcave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

B.5.2- Aktiviteti i Drejtorisë Juridike.

Në zbatim të pikës (4) të programit të ri-auditimit “Nr. 95/1 datë 29/01/2021”, i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Evidenca dhe statistika të proceseve gjyqësore
2. Relacion për ecurinë e proceseve gjyqësore dhe veprimtarinë e Drejtorisë Juridike
3. Evidenca mbi shpenzimet gjyqësore dhe përmbarimore të proceseve gjyqësore

Bazuar në përcaktimet e Rregullores “Për Organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhrit nr. 2115, datë 15.03.2018, Drejtoria Juridike është e organizuar në dy sektorë përkatësisht:

I- Sektori i Legjislacioneve dhe Rregulloreve i cili përbëhet nga një Përgjegjës sektori dhe dy specialistë

II- Sektori i Ndjekjes së Procedurave Gjyqësore dhe Ankimimit i cili përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe aktualisht 4 specialistë.

I- Sektori i Legjislacioneve dhe Rregulloreve

Një nga drejtimet e veprimtarisë së strukture juridike në ISSH, përveç ndjekjes së procedurave gjyqësore dhe ankimimit është zbatimi e politikave të ISSH-së bazuar në legjislacionin në fuqi, veprimtari që kryhet nga Sektori i Legjislacionit dhe Rregulloreve. Ky sektor ka trajtuar në vijimësi:

- kërkesat për interpretim të ardhura nga institucionet shtetërore, drejtoritë rajonale, drejtoritë e brendshme të ISSH-së.

- kërkesat dhe problematikat e qytetarëve, të përcjella nga vetë ata ose nëpërmjet institucioneve si; Avokati i Popullit, Komisionerit Anti-Diskrimin, organizatave të ndryshme jo qeveritare.

Gjatë vitit 2019 si pjesë e Drejtorisë Juridike, Sektori i legjislacionit dhe Rregulloreve ka dhënë mendime dhe bashkëpunuar në hartimin projekteve ligjor/nënligjor të ardhura nga Kuvendi, Kryeministria, MFE etj, si më poshtë:

- Ligj nr. 29/2019, datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

- Ligj nr. 67/2019, datë 03.10.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”;

- Ligj nr. 81/2019, datë 05.12.2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 27.03.2019 “Për indeksimin e pensioneve”; - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 04.04.2019 “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për llogaritjen e pensioneve”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 03.10.2019 “Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 16.06.2019 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të pasurisë së paluajtshme shtetërore nr. 10/46, ish-Materniteti Sarandë, në zonën kadastrale 8641”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 10.10.2019 “Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, ‘Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 01.06.2019 “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensionit”, të ndryshuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 11.12.2019 “Për përcaktimin e kritereve dhe të masës së shpërblimit financiar mujor të familjeve të dëshmorëve të atdheut”.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 janë përgatitur dhe miratuar në Këshillin Administrativ disa projekt-vendime, të cilat janë shqyrtuar në Këshillin e Ministrave, si dhe akte të tjera si:

- Vendim nr. 11, datë 18.02.2019 “Për miratimin e projekt VKA “Disa Shtesa e ndryshime në Rregulloren Nr. 1, Datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Pensioneve”;
- Vendim nr. 15, datë 28.03.2019 “Për miratimin e projekt VKM për koeficientet e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”;
- Vendim nr. 16, datë 28.03.2019 “Për miratimin e projekt VKM për indeksimin e pensioneve”;
- Vendim nr. 18, datë 31.07.2019 Për miratimin e projekt VKM “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar”;
- Vendim nr. 19, datë 31.07.2019 “Për miratimin e projekt VKM “Për një shtesë në Vendimin nr. 409, datë 1.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensionit ”;
- Vendim nr. 20, datë 31.07.2019 “Për miratimin e projekt VKM “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”;
- Vendim nr. 21, datë 31.07.2019 “Për miratimin e projekt VKM. “Për zbatimin e Ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Vendim nr. 22, datë 31.07.2019 “Për transferimin e përfitimeve për përfituesit me vendbanim jashtë territori të Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjes dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore.”;
- Vendim nr. 23, datë 31.07.2019 “Për Miratimin e rregullores për caktimin administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntoke të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;
- Vendim nr. 24, datë 06.12.2019 “Për miratimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, duke i propozuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që përqindja e kontributit të sigurimeve shoqërore suplementare për subjektet e këtij ligji të jetë 8 %”;
- Vendim nr.25, datë 06.12.2019 Për miratimin e rezultatit financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2018” dhe të Raportit të Komisioni të Kontroll Revizionit “Për bilancin dhe rezultatin financiar të vitit 2018”;
- Vendim nr. 26, datë 06.12.2019 “Për miratimin e projekt VKA për buxhetin e Drejtorive Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2020”;
- Vendim nr. 27, datë 06.12.2019 “Për miratimin e projekt VKA për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikantë”.

Gjatë **vitit 2020** Sektori i legjislacionit dhe Rregulloreve ka dhënë mendime dhe bashkëpunuar në hartimin projekt akteve ligjor/nënligjor të ardhura nga Kuvendi, Kryeministria, MFE etj, si më poshtë:

1. Aktet ligjore dhe nënligjore të miratuar gjatë vitit 2020 të cilat kanë si objekt sigurimet shoqërore

- Ligj nr. 65/2020, datë 21.05.2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 156/2020, datë 17.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016”;
- Ligj nr. 165/2020, datë 23.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 167/2020, datë 23.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”;
- Ligj nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;
- Akt normativ i KM nr. 33, datë 11.12.2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Gjatë vitit 2020 janë miratuar VKM të mëposhtme të cilat kanë objekt sigurimet shoqërore, si:

- VKM nr. 262, datë 30.03.2020 “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve”;
- VKM nr. 263, datë 30.03.2020 “Për indeksimin e pensioneve”;
- VKM nr. 447, datë 3.06.2020 “Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftës-jellës dhe gazsjellës”;

- VKM nr. 448, datë 3.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”;

- VKM nr. 720, datë 16.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar”;

- VKM nr. 1042, datë 18.12.2020 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2020”.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 janë miratuar në Këshillin Administrativ vendimet e mëposhtme:

- Vendim qarkullues nr. 1, datë 27.03.2020 “Për miratimin e projekt VKM “Për indeksimin e pensioneve” dhe “Për miratimin e projekt VKM “Për koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve”;

- Vendim Nr. 2, datë 28.05.2020 “Për funksionimin e komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë të invalidëve në kushtet e pandemisë Covid-19”;

- Vendim nr. 3, datë 28.05.2020 “Për caktimin e afatit të dorëzimit të deklaratës “Për konfirmimin e kreditimit të llogarisë dhe rregullshmërinë e pagesave, në bankat e nivelit të dytë”, për shkak të zbatimit të masave në kushtet e pandemisë nga covid-19”;

- Vendim nr. 5, datë 14.08.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”;

- Vendim nr. 6, datë 27.11.2020 “Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2019”;

- Vendim nr. 8, datë 30.12.2020 “Për buxhetin e Drejtorive Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021”.

II- Sektori i Ndjekjes së Procedurave Gjyqësore dhe Ankimimit

Veprimtaria e Drejtorisë Juridike, ndër të tjera është e lidhur në mënyrë direkte me proceset gjyqësore si dhe drejtimin e këtij procesi në të gjithë strukturat rajonale. Një nga hallkat kryesore të këtij procesi është unifikimi dhe ndjekja në mënyrë të vazhdueshme e ecurisë së proceseve gjyqësore, përmirësimi i vazhdueshëm i parashtrimeve, pretendimeve, kërkesave ankimore, rekurseve me qëllim rritjen e performances së përfaqësimit të ISSH-së në Gjykatë për 12-të Drejtoritë dhe 2 Degët, veprimtari kjo që ushtrohet nga Sektori i Ndjekjes së Procedurave Gjyqësore dhe Ankimimit.

DRSSH-të lidhin pensionet, duke marrë për bazë vitet e sigurimit të evidentuara në Librezat e Punës, të cilat administrohen nga qytetarët dhe dokumente të tjerë si regjistrat e vjetërsisë në punë, borderotë apo listëpagesat, indekset e punonjësve të ndërmarrjeve apo ish-kooperativave bujqësore, libra page, të cilat administrohen nga sigurimet shoqërore, institucione apo ndërmarrje shtetërore dhe private. Shpesh këto dokumente rezultojnë të mos jenë të plota, me të dhëna përfundimtare, ose me të dhëna që nuk janë të sakta dhe për këtë arsye degët e Përfitimeve i kanë refuzuar kërkesat për pension, ose i kanë caktuar pensione të pjesshme dhe me pas, për këtë arsye qytetarët i janë drejtuar gjykatave.

Në të gjitha gjykatat vërehet një numër relativisht i lartë i proceseve gjyqësore veçanërisht në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë, kjo për shkak të mangësisë së dokumentacionit të vjetërsisë në punë i cili është i djegur apo është i pa plotë. Ky dokumentacion u trashëguar nga fond krijuesit, i cili përveç paplotshmërisë ka edhe problem të ndërhyrjeve dhe falsifikimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

II.1-Në gjyqet e deklaruara, vetë ISSH për vitin 2019, ka marrë pjesë në 181 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative me objekt “Kundërshtim Akti”, të cilat kanë përfunduar si më poshtë:

- Është rrëzuar padia për 68 çështje;
- Është pranuar padia për 91 çështje;
- Për 22 çështje është pranuar pjesërisht padia.

Për vitin 2020, ISSH ka marrë pjesë në 151 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të cilat kanë përfunduar si më poshtë:

- Eshtë rrëzuar padia për 48 çështje,
- Eshtë pranuar padia për 91 çështje,
- Eshtë pranuar pjesërisht padia për 12 çështje
- Ankimuar 48 çështje
- Kanë ngelur ne proçes 43 çështje

II.2- Gjyqet e zhvilluara nga DRSSH dhe DSSH sipas viteve

II.2.1- Viti 2019

1-Në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë gjatë vitit 2019, në të gjitha rajonet kanë përfunduar gjykimin 3,024 procese nga të cilat:

- Për 312 çështje është rrëzuar padia;
- Për 497 çështje është pranuar pjesërisht padia;
- Për 2,215 çështje është pranuar padia;
- Ankimuar 443 çështje.

Numrin më të lartë të gjyqeve, për vitin 2019 janë Durrësi, Fieri, Korça, Vlora, Saranda, Tirana, ndërsa rajonet me numrin më të ulët të gjyqeve janë Elbasani, Kukësi dhe Gjirokastra.

Nga 3,024 procese gjyqësore, 1,845 janë për vërtetim fakti, 643 procese janë për njohje vjetërsie në punë, 515 procese janë për saktësim dokumentacioni (identiteti), 7 procese janë për kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe 14 procese janë për dëmshpërblim page, më hollësisht trajtuar sipas tabelës “Përmbledhëse e proceseve gjyqësore Gjykata e Rrethit sipas DRSSH-ve për vitin 2019”, bashkangjitur akt-konstatimit. Proceset për dëmshpërblim page zënë 0.5% të totalit të proceseve. Numri i lartë i proceseve gjyqësore në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë, është për shkak të mangësisë së dokumentacionit të vjetërsisë në punë i cili është i djegur apo është i paplotë.

-Gjatë vitit 2019 kanë qenë në proces gjykimi në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë 884 procese, nga të cilat Tirana me 309 procese dhe Korca me 147 procese.

Rajonet	OBJEKTET								Gjithesëj
	Vertetim Fakti / Shtet		Njohje vjetërsie pune		Vertetesi Dokumenti / Saktësim Identiteti	Kundershtim Veprimesh Permbarimore	Padi per vjeljen e detyrimit	Demshperblim page	
	Shtet	Kooperativ e	Shtet	Kooperative					
Berat	5	12	2	10	2	0	3	0	34
Diber	1	22	3	4	10	0	0	0	40
Durres	25	30	10	7	9	0	2	0	83
Elbasan	3	5	1	2	2	0	0	1	14
Fier	59	28	13	14	13	0	0	0	97
Gjirokastr	10	5	4	15	15	0	0	0	49
Korce	22	65	0	0	59	1	0	0	147
Kukes	0	0	2	1	2	0	0	0	5
Lezhe	3	7	1	1	1	0	0	0	13
Tirane	47	64	61	37	96	0	4	0	309
Shkoder	2	7	4	11	2	0	0	0	26
Vlore	9	19	0	0	0	0	0	0	28
Tropoje	0	0	8	7	2	0	0	0	17



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Sarande	13	11	0	0	0	0	0	0	24
Totali	199	275	109	109	213	1	9	1	884

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

2) Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për vitin 2019, DRSSH –të, Degët Rajonale, kanë qenë pale ndërgjyqëse në 587 procese gjyqësore të përfunduara për të cilat:

- Për 214 çështje është rrëzuar padia;
- Për 354 çështje është pranuar padia;
- Për 19 çështje është pranuar pjesërisht padia.
- Ankimuar 139 çështje.

Fluksin më të madhë të gjyqeve në këtë gjykatë e kanë rajonet Tiranë, Vlorë.

Rajonet	OBJEKTET																								Gjithsej	
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA					Minatore					Ushtarake					Diferenca pensioni					Funksionar kushtetues					
	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj		A
Berat	11	4	5	2	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	1	0	2	0	0	0	0	0	14
Diber	12	7	5	0	7	9	2	7	0	2	2	2	0	0	2	2	1	1	0	1	0	0	0	0	0	25
Durres	31	13	17	1	4	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	33
Elbasan	13	6	7	0	2	0	0	0	0	0	4	3	1	0	3	15	9	6	0	4	0	0	0	0	0	32
Fier	25	21	4	0	21	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26
Gjirokastr	3	3	0	0	3	2	2	0	0	2	2	1	1	0	1	2	2	0	0	2	0	0	0	0	0	9
Korce	33	20	10	3	0	9	2	7	0	0	11	9	2	0	0	10	8	2	0	0	0	0	0	0	0	63
Kukes	2	1	1	0	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	1	0	0	0	0	0	0	0	5
Lezhe	11	8	3	0	6	6	4	2	0	3	2	0	2	0	0	3	2	1	0	1	0	0	0	0	0	22
Tirane	115	70	41	4	19	30	21	9	0	9	10	1	9	0	1	36	25	11	0	4	10	10	0	0	7	201
Shkoder	29	8	19	2	7	6	3	3	0	3	11	10	0	1	10	4	0	3	1	0	0	0	0	0	0	50
Vlore	101	69	27	5	14	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	101
Tropoje	2	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Sarande	3	1	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	1	4
Totali	391	232	142	17	89	63	35	28	0	19	45	26	18	1	17	77	50	26	1	14	11	11	0	0	8	587

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Nga 587 procese, 391 procese janë për kundërshtim akti administrative, 63 procese për minatorët, 45 për ushtarakët, 77 për diferencë pensioni dhe 11 funksionar kushtetues.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për vitin 2019 kanë qenë në proces 306 procese gjyqësore ku numrin më të lartë e ka Tirana me 106 procese.

Rajonet	OBJEKTET					Gjithsej
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA	Minatore	Ushtarake	Diferenca pensioni	Funksionar kushtetues	
Berat	4	0	0	2	0	6
Diber	10	2	1	0	0	13
Durres	37	0	1	0	0	38
Elbasan	4	5	1	17	1	28
Fier	24	1	1	5	31	62
Gjirokastr	3	2	2	2	0	9
Korce	20	3	2	0	0	25
Kukes	1	0	0	0	0	1
Lezhe	3	0	1	1	0	5
Tirane	71	6	3	22	4	106
Shkoder	0	0	0	0	0	0
Vlore	8	0	0	0	0	8
Tropoje	2	1	0	0	0	3
Sarande	2	0	0	0	0	2
Totali	189	20	12	49	36	306

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

3)- Gjyqe të përfunduara në Gjykatën e Apelit për vitin 2019 janë 352, nga të cilët:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Për 299 çështje është rrëzuar padia;
- Për 53 çështje është pranuar padia;
- Ankimuar 38 çështje.

Në Gjykatën e Apelit për vitin 2019 kanë qenë në proces 481 procese gjyqësore ku numrin më të lartë e ka Shkodra me 260 procese.

Rajonet	OBJEKTET								Gjithsej
	Vertetim Fakti		Njohje vjetërsie pune		Vertetesi Dokumenti/ Saktesim Identiteti	Kundershtim Veprimesh Permbarimore	Padi per vjeljen e detyrimit	Demshperblim page	
	Shtet	Kooperative	Shtet	Kooperative					
Berat	4	5	2	1	3	1	2	2	20
Diber	0	2	2	0	0	0	0	0	4
Durres	10	2	5	0	10	1	2	1	31
Elbasan	1	1	9	0	3	2	0	10	25
Fier	15	4	0	0	10	0	0	0	29
Gjirokaster	0	0	14	0	2	0	0	0	16
Korce	0	0	0	0	1	1	0	0	2
Kukes	1	2	5	2	2	0	0	0	12
Lezhe	7	11	4	3	7	0	0	0	32
Tirane	1	2	13	1	6	0	0	0	23
Shkoder	9	20	31	192	3	0	5	0	260
Vlore	5	16	0	0	0	0	0	0	21
Tropoje	0	0	4	2	0	0	0	0	6
Sarande	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	53	65	89	201	47	5	9	13	481

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

4)- Gjyqe të përfunduara në Gjykatën Administrative të Apelit për vitin 2019 janë 250, nga të cilët:

- Për 146 çështje është rrëzuar padia;
- Për 104 çështje është pranuar padia; Ankimuar 60 çështje.

Rajonet	OBJEKTET																												Gjithsej			
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA						Minatore						Ushtarake						Diferenca pensioni						Funksionar kushtetues							
	Gj	H	F	P j	K	A	Gj	H	F	P j	K	A	Gj	H	F	Pj	K	A	Gj	H	F	P j	K	A	G j	H	F	P j		K	A	
Berat	3	2	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	3	1	2	0	0	0	1	1	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	7
Diber	13	9	4	0	0	9	7	5	2	0	0	4	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	21
Durres	7	4	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8
Elbasan	10	10	0	0	0	1	2	1	1	0	0	1	6	3	3	0	0	3	13	13	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	31
Fier	13	12	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	16
Gjirokastrë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Korce	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Kukes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Lezhe	5	2	1	0	2	1	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	1	3	3	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	9
Tirane	26	21	5	0	0	0	26	22	4	0	0	0	47	5	42	0	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	99
Shkoder	23	15	5	1	2	12	2	0	2	0	0	0	6	1	4	0	1	1	1	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	32
Vlore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	4	3	0	0	4	10	9	1	0	0	9	0	0	0	0	0	0	0	17
Tropoje	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Sarandë	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8
Totali	105	75	25	1	4	24	38	29	9	0	0	5	77	15	60	1	1	15	30	27	3	0	0	16	0	0	0	0	0	0	0	250

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Në Gjykatën Administrative të Apelit për vitin 2019 kanë qenë në proces 433 procese gjyqësore, ku numrin më të lartë e ka Shkodra me 192 procese.

Rajonet	OBJEKTET					Gjithsej
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA	Minatore	Ushtarake	Diferenca pensioni	Funksionar kushtetues	
Berat	6	0	5	2	0	13
Diber	0	0	0	0	0	0
Durres	44	2	7	0	1	54



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Elbasan	3	4	7	30	1	65
Fier	17	0	0	0	0	17
Gjirokastr	3	2	1	2	8	16
Korce	0	0	0	0	0	0
Kukes	1	0	0	1	2	4
Lezhe	15	0	0	2	17	34
Tirane	12	4	6	2	0	24
Shkoder	66	4	23	3	96	192
Vlore	12	0	0	0	0	12
Tropoje	2	0	0	0	0	2
Sarande	0	0	0	0	0	0
Totali	181	16	49	42	125	433

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Në gjykatat administrative kryesisht, çështjet kanë të bëjnë me kundërshtim të aktit administrativ por brenda themelit janë njohje të vjetërsisë në punë, apo probleme të tjera lidhur me periudha të sigurimit. Krahësuar me një vit më parë rezultojnë një ulje e numrit të gjyqeve në gjykatën Administrative.

5)-Në Gjykatën e Lartë janë ndjekur 1178 procese nga të cilat: 20 procese të përfunduara, ku në 10 procese është vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, në 1 proces është vendosur pushimi i padisë, në 9 procese është vendosur kthimi për rigjykim në Gjykatën e Apelit, 1076 procese të mbartura dhe 102 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi.

Rajonet	Menyra e përfundimit						Gjithsej
	Te Përfunduara	Lenien ne fuqi	Pushuar	Kthim	Te bartura	Proces	
Berat	0	0	0	0	17	8	25
Diber	0	0	0	0	0	23	23
Durres	12	2	1	9	36	0	36
Elbasan	0	0	0	0	8	14	22
Fier	7	7	0	0	4	0	4
Gjirokastr	0	0	0	0	15	19	34
Korce	0	0	0	0	9	0	9
Kukes	0	0	0	0	4	0	4
Lezhe	0	0	0	0	11	5	16
Tirane	0	0	0	0	690	5	695
Shkoder	0	0	0	0	262	15	277
Vlore	0	0	0	0	16	13	29
Tropoje	1	1	0	0	1	0	1
Sarande	0	0	0	0	3	0	3
Totali	20	10	1	9	1076	102	1178

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

II.2.2-Viti 2020

1)Në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë, gjatë vitit 2020 strukturat qendrore dhe rajonale kanë qenë palë në 3294 çështje civile të zhvilluara, nga të cilat janë ende të papërfunduara 1054 çështje.

Kanë përfunduar gjykimin 2240 çështje nga të cilat:

- Për 276 çështje është rrëzuar padia;
- Për 1638 çështje është pranuar padia;
- Për 326 çështje është pranuar pjesërisht padia.

Nga 3294 procese gjyqësore, 1,462 janë për vërtetim fakti, 479 procese janë për njohje vjetërsie në punë, 289 procese janë për saktësim dokumentacioni (identiteti), 5 procese janë për kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe 5 procese janë për dëmshpërblim page.

Numri i lartë i proceseve gjyqësore në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë, është për shkak të mangësisë së dokumentacionit të vjetërsisë në punë i cili është i djegur apo është i paplotë, më hollësisht trajtuar sipas Tabelës “Përmbledhëse e proceseve gjyqësore Gjykata e Rrethit, sipas DRSSH-ve për vitin 2020”, bashkangjitur akt-konstatimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjatë vitit 2020 kanë qenë në proces gjykimi në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë 1054 procese, ku numrin më të lartë e ka Fieri me 267 procese dhe Tirana me 228 precese.

Rajonet	OBJEKTET								Gjithesëj
	Vërtetim Fakti / Shtet		Njohje Vjetërsie pune		Vertetesi Dokumenti/ Saktesim Identiteti	Kundershtim Veprimesh Permbarimore	Padi per vjeljen e detyrimit	Demshperblim page	
	Shtet	Kooperative	Shtet	Kooperative					
Berat	17	42	8	24	9	0	0	1	103
Diber	7	40	5	0	11	1	1	0	65
Durres	12	15	7	3	5	0	0	0	42
Elbasan	2	8	1	4	7	1	0	0	23
Fier	52	65	60	75	14	0	0	1	267
Gjirokaster	13	7	5	10	2	0	0	3	40
Korce	18	45	0	0	71	0	0	0	134
Kukes	0	2	4	0	2	0	0	0	8
Lezhe	3	15	1	2	7	2	6	0	36
Tirane	20	61	22	34	70	4	17	0	228
Shkoder	1	6	5	34	3	0	0	1	50
Vlore	7	10	0	0	0	0	0	0	17
Tropoje	0	0	5	3	1	0	0	0	9
Sarande	19	15	0	0	0	0	0	0	34
Totali	171	331	123	189	202	8	24	6	1,054

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

2) Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, për vitin 2020 në këtë gjykatë kanë përfunduar gjykimin 402 çështje nga të cilat:

- Për 130 çështje është rrëzuar padia;
- Për 267 çështje është pranuar padia;
- Për 5 çështje është pranuar pjesërisht padia.

Fluksin më të madhë të gjyqeve në këtë gjykatë e kanë rajonet Tiranë dhe Korçë.

Rajonet	OBJEKTET																								Gjithsej	
	KundershtimAktiAdmin istrativ/ KRA KQA					Minatore					Ushtarake					Diferencapensiononi					Funksionarkushtetues					
	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj	A	Gj	H	F	Pj		A
Berat	11	4	7	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	13
Diber	21	9	11	0	7	8	4	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	29
Durres	24	12	12	0	3	2	0	2	0	0	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	29
Elbasan	6	1	5	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	1	12	6	6	0	5	0	0	0	0	0	19
Fier	18	5	13	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18
Gjirokastr	3	3	0	0	3	3	3	0	0	3	2	1	1	0	1	2	2	0	0	2	0	0	0	0	0	10
Korce	21	14	6	1	6	11	3	7	1	3	21	20	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	53
Kukes	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	1	2	1	0	0	0	0	0	5
Lezhe	21	17	4	0	13	3	2	1	0	1	1	0	1	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	26
Tirane	65	51	14	0	8	14	10	4	0	6	0	0	0	0	0	17	17	0	0	7	12	12	0	0	12	108
Shkoder	20	13	7	0	10	4	2	2	0	2	9	9	0	0	9	8	8	0	0	7	0	0	0	0	0	41
Vlore	41	29	12	0	4	1	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	42
Tropoje	5	2	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
Sarande	4	3	1	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Totali	261	164	94	2	63	46	25	20	1	20	37	31	6	0	11	46	35	9	2	22	12	12	0	0	12	402

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Nga 402 procese, 261 procese janë për kundërshtim akti administrative, 46 procese për minatorët, 37 për ushtarakët, 46 për diferencë pensioni dhe 12 funksionar kushtetues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për vitin 2020 kanë qenë në proces 238 procese gjyqësore ku numrin më të lartë e ka Tirana me 96 procese.

Rajonet	OBJEKTET					Gjithsej
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA	Minatore	Ushtarake	Diferenca pensioni	Funksionar kushtetues	
Berat	8	0	0	3	0	11
Diber	7	0	0	1	0	8
Durres	30	0	0	0	0	30
Elbasan	1	2	0	8	1	12
Fier	13	0	0	0	0	13
Gjirokaster	8	5	8	0	0	21
Korce	12	4	6	0	0	22
Kukes	0	0	0	0	0	0
Lezhe	5	1	0	1	0	7
Tirane	64	7	0	19	6	96
Shkoder	1	0	0	0	0	1
Vlore	14	0	0	0	0	14
Tropoje	2	0	0	0	0	2
Sarande	1	0	0	0	0	1
Totali	166	19	14	32	7	238

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

3) Në Gjykatën e Apelit kanë përfunduar 237 çështje nga të cilat:

- Për 21 çështje është rrëzuar padia;
- Për 210 çështje është pranuar padia;
- Për 2 çështje është pranuar pjesërisht padia
- Kthim për rigjykim 5 çështje
- Nga këto janë Rekursuar në Gjykate të Lartë 14 çështje.

Më hollësisht sipas Tabelës “Përmbledhëse e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Civil sipas DRSSH-ve përvitin 2020”, bashkangjitur akt-konstatimit.

Në Gjykatën e Apelit për vitin 2019 kanë qenë në proces 599 procese gjyqësore ku numrin më të lartë e ka Shkodra me 335 procese.

Rajonet	OBJEKTET								Gjithsej
	Vertetim Fakti		Njohje vjetërsie pune		Vertetesi Dokumenti/ Saktësim Identiteti	Kundershtim Veprimesh Permbarimore	Padi per vjeljen e detyrimit	Demshperblim page	
	Shtet	Kooperative	Shtet	Kooperative					
Berat	5	6	1	1	4	1	1	1	20
Diber	0	0	2	1	2	0	0	0	5
Durres	4	1	3	0	3	0	2	1	14
Elbasan	0	2	7	2	3	2	0	11	27
Fier	6	10	4	15	0	0	0	0	35
Gjirokaster	10	8	5	6	2	0	0	0	31
Korce	0	0	0	0	1	1	0	0	2
Kukes	1	1	1	3	6	0	0	0	12
Lezhe	7	18	9	5	9	0	0	0	48
Tirane	10	3	21	2	9	5	0	0	50
Shkoder	12	27	45	243	5	0	3	0	335
Vlore	9	2	0	0	0	0	0	0	11
Tropoje	0	0	5	4	0	0	0	0	9
Sarande	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	64	78	103	282	44	9	6	13	599

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

4) Në Gjykatën Administrative të Apelit, gjatë vitit 2020 kanë përfunduar 79 procese gjyqësore, për të cilat:

- Për 27 çështje është rrëzuar padia;
- Për 46 çështje është pranuar padia;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Për 1 çështje është pranuar pjesërisht padia.
- Kthim për rigjykim 5 çështje

Rajonet	OBJEKTET																												Gjithsej		
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA						Minatore						Ushtarake						Diferenca pensioni						Funksionar kushtetues						
	Gj	H	F	Pj	K	A	Gj	H	F	Pj	K	A	Gj	H	F	Pj	K	A	Gj	H	F	Pj	K	A	Gj	H	F	Pj		K	A
Berat	2	1	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Diber	11	6	5	0	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	13
Durres	7	4	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8
Elbasan	3	2	1	0	0	1	2	1	1	0	0	1	1	1	0	0	0	1	5	4	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	11
Fier	8	1	3	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8
Gjirokastr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korce	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kukes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhe	2	1	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0	0	4	1	3	0	0	1	0	0	0	0	0	0	8
Tirane	7	5	2	0	0	0	4	4	0	0	0	0	4	4	0	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	17
Shkoder	6	4	1	0	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
Vlore	5	4	1	0	0	4	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
Tropoje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Sarande	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	51	28	18	0	5	16	6	5	1	0	0	1	9	5	4	0	0	1	13	8	4	1	0	3	0	0	0	0	0	0	79

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Në Gjykatën Administrative të Apelit për vitin 2020 kanë qenë në proces 346 procese gjyqësore, ku numrin më të lartë e ka Shkodra me 111 procese.

Rajonet	OBJEKTET					Gjithsej
	Kundershtim Akti Administrativ/ KRA KQA	Minatore	Ushtarake	Diferenca pensioni	Funksionar kushtetues	
Berat	9	0	4	2	0	15
Diber	11	0	0	0	0	11
Durres	42	1	2	0	0	45
Elbasan	3	3	7	32	0	45
Fier	31	4	5	1	0	41
Gjirokastr	0	0	0	0	0	0
Korce	0	0	0	0	0	0
Kukes	3	0	0	2	0	5
Lezhe	22	0	0	2	0	24
Tirane	18	6	11	4	0	39
Shkoder	67	6	28	10	0	111
Vlore	1	1	0	4	0	6
Tropoje	2	1	0	1	0	4
Sarande	0	0	0	0	0	0
Totali	209	22	57	58	0	346

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

5)-Në Gjykatën e Lartë janë ndjekur 1221 procese nga të cilat: 17 procese të përfunduara, ku në 5 procese është vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, në 1 proces është vendosur pushimi i padisë, në 11 procese është vendosur kthimi për rigjykim në Gjykatën e Apelit, 1185 procese të mbartura dhe 36 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi.

Rajonet	Menyra e përfundimit						Gjithsej
	Te Përfunduara	Lenien ne fuqi	Pushuar	Kthim	Te mbartura	Proces	
Berat	0	0	0	0	31	3	34
Diber	1	1	0	0	0	10	10
Durres	12	2	1	9	36	0	36
Elbasan	0	0	0	0	97	9	106
Fier	2	0	0	0	0	0	0
Gjirokastr	0	0	0	0	7	0	7
Korce	0	0	0	0	4	0	4
Kukes	0	0	0	0	3	2	5



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Lezhe	0	0	0	0	33	2	35
Tirane	2	0	0	2	690	0	690
Shkoder	0	0	0	0	262	6	268
Vlore	0	0	0	0	16	4	20
Tropoje	0	0	0	0	3	0	3
Sarande	0	0	0	0	3	0	3
Totali	17	3	1	11	1185	36	1221

Burimi: Drejtoria e Juridike në ISSH

Për shkak të mosfunksionimit normal të kësaj gjykate janë 1221 procese gjyqësore të mbartura ndër vite të cilat përbejnë kosto si për individin ashtu dhe për institucionin.

- Nëpërmjet shkresave të Grupit të Menaxhimit Strategjik shkresës nr. 7502 prot, datë 04.11.2019, shkresës nr. 7459. prot datë 31.10.2019, janë udhëzuar juristët të evidentojnë çështjet gjyqësore në të tre nivelet e gjyqësorit ose të kërkojnë pushimin e çështjeve gjyqësore, që kanë të bëjnë me përmbajtjen VKM nr. 660, dhe VKM nr. 657, dt 10.10.2019.

- Nëpërmjet shkresave “Dërgim vendimi”, vendimet e shpalluara nga Gjykatat e të dërguara në ISSH, u janë përcjellë DRSSH-ve, duke i kërkuar juristit në rajon të marrë masa për procedim të mtejshëm (sipas rastit të ankimeve ose jo vendimin, të përpiloj relacionin për ekzekutimin e vendimit nga Dega e Përfitimeve në Rajon në zbatim të detyrave funksionale si dhe shkresave udhëzuese nr 7585/1 prot datë 10.11.2015, shkresës nr. 6041 prot, datë 14.07.2016, shkresës nr. 6041/1 prot, datë 11.10.2016, shkresës nr. 6667 prot, 13.10.2014)

- Ne zbatim të vendimeve të ndërmjetme të gjykatave për kërkimin e provave nga Drejtoria Juridike i është kërkuar DRSSH –vë të dergoj provat brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata si dhe dërgimin e provave në ISSH për rastet kur kjo e fundit ka qënë palë në proces dhe nuk e ka deleguar përfaqësimin (shkresa nr. 2112 prot.2019).

Veprimtari e përbashkët e dy sektorëve të Drejtorisë

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Informacionit Drejtoria Juridike:

- ka kthyer përgjigje për informacionet e kërkuara nga institucione publike, si ILDKPI, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Prokuroria, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Operacioni Forca e Ligjit etj.

- ka dhënë mendime dhe bashkëpunuar në hartimin projekt-akteve ligjore/ nënligjore të ardhura nga deputetë, Kuvendi, Kyeminstria, MFE etj

Më konkretisht gjatë vitit 2019-2020, në kuadër të reformës në drejtësi nga institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të vetingut janë kërkuar informacione për burimin e të ardhurave të personave subjekt të procesit të vetingut. Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Burimeve të Informacionit ka kthyer përgjigje 323 shkresave të ILDKPI, 562 shkresave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 75 shkresave të Komisionit i Jashtëm të Vlerësimit.

Gjithashtu janë kërkuar informacione në lidhje me burimin e të ardhura të personave subjekt të procedimit penal në kuadër të luftës ndaj krimit ekonomik nga Prokuroritë, OFL dhe Drejtoritë Vendore të Policisë shtetit. Në përgjigje të këtyre shkresave nga Drejtoria Juridike janë hartuar dhe kthyer përgjigje për 834 shkresa. Gjatë 2019-2020 janë kthyer përgjigje institucioneve, strukturave rajonale të varësise si dhe ankesave të qytetarëve nëpërmjet 279 shkresave.

Në total nga Drejtoria Juridike gjatë vitit 2019 janë trajtuar 1190 shkresave dhe gjatë vitit 2020, 833 shkresave.

▪ **Drejtoria Juridike nuk ka mbajtur evidencë më vete të ankesave dhe shkresave të trajtuara ndër vite dhe gjatë periudhës së auditimit 01.01.2019-31.12.2020, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Në kushtet e mungesës së evidencës analitike me të dhënat përkatëse nuk mund të shprehemi në lidhje me respektimin e afateve në kthimin e përgjigjeve.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

III- Nismat e marra nga ISSH dhe ndryshimet ligjore për zvogëlimin e numrit të proceseve gjyqësore

Për minimizimin e çështjeve në gjykatë janë marrë disa nisma ligjore, si vijon:

- Me hyrjen në fuqi VKM nr. 482, date 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni” ju dha zgjidhje:
- njohjes si vjetërsi pune për efekt pensioni të periudhave të punës të kryera nga personat e punësuar në ish ndërmarrjet shtetërore dhe vitet e punës të ish- anëtarëve të kooperativave bujqësore, sipas dokumentimit në regjistrat e vjetërsisë në punë, në rastet kur të gjitha fletët e regjistrit ose vite pune të veçanta në të gjitha fletët e regjistrit janë të dokumentuara me laps;
- rasteve ku strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore mund të marrin në konsideratë të dhëna të tjera dokumentare, të prodhuara nga organe shtetërore, të cilat indirekt i shërbejnë vërtetimit dhe plotësimit të periudhës së sigurimit, si p.sh. vendime emërimi, largimi, si dhe dokumente të tjera të dosjeve personale të kuadrit etj, si dhe shkresat përgjithësuese të nxjerra nga ISSH-ja për zgjidhjen administrativisht.

Në zbatim të Vendimit nr. 482, datë 29.06.2016, të Këshillit të Ministrave vendimet gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Civile apo Administrative, me objekt:

- a. Vërtetimi faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune dhe/ose korrigjimi i gabimit në aktet zyrtare, me bazë ligjore nenin 388, të Kodit të Pr. Civile;
- b. Njohje e vjetërsisë në punë të ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, kur fletet e regjistrit ose vite të veçanta të punës në të gjitha fletët e regjistrit janë shënuar me laps, me bazë ligjore nenin 32, të Kodit të Pr. Civile;
- c. Njohje e vërtetësisë dhe/apo pavërtetësisë së shënimeve të bëra në librezat e punës, fletët e regjistrave, bordero apo dokumenta të tjerë të vjetërsisë në punë, me bazë ligjore nenin 32, të Kodit të Pr. Civile;
- d. Saktesimi i identitetit në dokumentacionin e vjetërsisë në punë, (vërtetësi dhe pavërtetësi dokumenti për gjeneralitetet), me bazë ligjore nenin 32, të Kodit të Pr. Civile;
- e. Të gjitha vendimet gjyqësore me objekt anulim/shfuqizim/kundërshtim akti administrativ, por që në themel kanë një nga objektet e përcaktuara në pikën b, c dhe d, për të gjitha këto raste të cituara më sipër kur nuk ka prova të qëndrueshme apo prova që të provojnë të kundërtën e përcaktimeve në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, nuk apelohehen dhe në rast se janë apeluar, ankimimi tërhiqet zvrtarisht me kërkesë të titullarit.

Me shkresat nr.6014, datë 14.07.2016; nr. 6014/1, datë 11.10.2016 për zbatim të VKM nr. 482, date 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”, shkresën me nr.8158 datë 11.10.2016 “Mbi date fillimin e pagesës së pensioneve”, janë udhëzuar të gjitha DRSSH për zbatimin e këtyre vendimeve.

- Me shkresë nr. 6014/1 prot., datë 11.10.2016 të ISSH-së, janë të autorizuar që për të gjitha proceset gjyqësore që përfshihen në udhëzimin e ISSH-së germat a, b, c, d, juristi rajonal të përgatit një relacion sqarues për titullarin, për argumentimin e provave të paraqitura gjatë gjykimit në shkallën e parë të gjyqësorit, si dhe duke dhënë mendimin e tij për mosankimimin e vendimit në Gjykatën e Apelit si dhe nëse çështja përputhet me kriteret e pikës 5, të VKM nr. 482, datë 29.06.2016. Ky relacion duhet të nënshkruhet edhe nga Kryetari i Degës së Arkivës.

- Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave”, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, ju dha zgjidhje njohjes si periudha sigurimi të gjitha periudhave nga data 01.10.1993 deri në 31.12.2014, për të cilat nga personat e vetëpunësuar në bujqësi janë paguar kontributet e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

sigurimit të detyrueshëm shoqëror, pavarësisht vendbanimit të tyre sipas regjistrit të gjendjes civile në atë periudhë të mbuluar me sigurim shoqëror, me kusht që sigurimet të jenë paguar deri më datën 31.03.2015.

Me shkresë nr.7502. prot. 04.11.2019 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, janë udhëzuar të gjitha DRSSH për zbatimin e këtyre vendimeve.

➤ Me hyrjen në fuqi të VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr. 793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura” ju dha zgjidhje ushtarakëve që kanë përfituar tokë sipas Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe ushtrojnë aktivitet si persona të vetpunësuar në bujqësi, duke i zgjidhur në rrugë administrative dhe duke ulur numrin e kërkesë padive në Gjykatë me këtë objekt.

Në zbatim të rregullimeve të bëra nga VKM-të e sipërcituara është eliminuar ankimimi për 2755 raste në total për vitin 2019, nga të cilat 2263 raste për Gjykatën e Rrethit, 267 raste në Gjykatën e Apelit, 171 raste në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe 74 raste në Gjykatën e Apelit Administrativ, më hollësisht sipas tabelës më poshtë:

Tabela “Ecuria e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët për vitin 2019”

Nr	Gjykata	Procese Gjyqësore gjithsej	Në proces	Fituar	Pa të drejtë ankimimi	Humbur	Ankimuar	Rekursuar	Mos Ankimuar VKM 482/2016	Mos Ankimuar VKM 660/2019
1	Gjykata e Rrethit	3908	886	312	-	2710	443	-	2263	4
2	Gjykata e Apelit	832	481	39	-	312	-	45	267	0
3	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	893	306	214	52	373	148	-	171	2
4	Gjykata Administrative e Apelit	683	433	102	14	148	-	60	74	0
	TOTAL	6316	2106	667	66	3543	591	105	2775	6

Për vitin 2020 është eliminuar ankimimi për 1987 raste në total, nga të cilat 1671 raste për Gjykatën e Rrethit, 197 raste në Gjykatën e Apelit, 92 raste në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe 27 raste në Gjykatën e Apelit Administrativ, më hollësisht sipas tabelës më poshtë:

Tabela “Ecuria e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët për vitin 2020”

Nr	Gjykata	Procese Gjyqësore gjithsej	Në proces	Fituar	Pa të drejtë ankimimi	Humbur	Ankimuar	Rekursuar	Mos Ankimuar VKM 482/2016	Mos Ankimuar VKM 660/2019
1	Gjykata e Rrethit	3294	1056	276	-	1962	291	-	1671	0
2	Gjykata e Apelit	836	599	21	-	216	-	18	197	1
3	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	640	238	127	51	275	131	-	92	1
4	Gjykata Administrative e Apelit	425	346	28	2	51	-	21	27	1
	TOTAL	5195	2239	452	53	2504	422	39	1987	3

▪ Nga ana e ISSH përveç raportimeve dhe evidencave statistikore nga DRSSH dhe DSSH për periudhën objekt auditimi 2019-2020, nuk ka të dhëna të tjera mbi ecurin e zbatimit të këtyre VKM-ve dhe efektet e tyre të shtrira në kohë, që nga viti 2016 kur ka filluar zbatimi.

▪ Nga Grupi i auditimit u morën kampione për relacionet e mbajtura nga DRSSH-t për heqjen dorë nga ankimimi në zbatim të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, “Për disa Cështje të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

dokumentimin të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, nga 6 Drejtori, përkatësisht DRSSH Korçë, Fier dhe Vlorë për vitin 2019 dhe DRSSH Tiranë, Durrës dhe Shkodër për vitin 2020. Përzgjedhja e kampionit u bazua në ato drejtori, që kishin numrin më të madh të rasteve për mos ankimimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në zbatim të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, duke përzgjedhur një muaj brënda vitit që kishte numrin më të lartë të mos ankimimeve për çdo DRSSH.

Nga verifikimi i relacioneve të paraqitura rezulton se, pjesa më e madhe e gjyqeve ka pasur si objekt vërtetimin e faktit juridik të qënies në marrëdhënie pune dhe të vjetërsisë në punë. Relacionet janë përmbledhje e shkurtuar e vendimit të gjykatës, provave dhe dokumenteve të paraqitura në proceset gjyqësore.

Në mungesë të dosjeve, vendimeve të gjykatave dhe dokumentacionit të administruar për çdo dosje përfitimi, të cilat administrohen në DRSSH dhe DSSH nuk mund të shprehemi për zbatimin e kriterëve të VKM nr. 482, datë 29.06.2016 vetëm nëpërmjet relacioneve.

Ajo që konstatohet nga krahasimi i relacioneve të mbajtura nga një DRSSH në tjetrën është mënyra e hartimit të tyre, pasi në disa prej tyre relacionet janë hartuar, duke bërë një përshkrim të fakteve dhe rrethanëve të trajtuara në proceset gjyqësore dhe janë shoqëruar nga vendimi i titullarit bashkangjitur relacionit të juristit të DRSSH-së, ndërkohë në disa të tjera si rasti i DRSSH Durrës dhe DRSSH Fier, relacionet janë mbajtur shkurtimisht dhe formalisht dhe ka shumë pak të dhëna nga hetimi gjyqësor.

▪ Sipas shkresës nr. 6014/1 prot, datë 11.10.2016 të titullarit të ISSH, mbi zbatimin e VKM nr. 482, datë 29.06.2016, “Për disa Cështje të dokumentimin të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni” paragrafi fundit, është përcaktuar si struktura përgjegjëse, për auditimin dhe inspektimin e të gjitha vendimeve të gjykatave, që janë ankimuar, nuk janë ankimuar apo është tërhequr ankimimi, si dhe zbatimin e procedurave, Auditimi Brendshëm dhe Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.

Ndërkohë sipas Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, përcaktohet se:

- *Njësia e Inspektimit të Përfitimeve* ka si objekt të punës së saj kontrollin e të gjitha përfitimeve që administron sistemi i sigurimeve shoqërore, përfitimet afatgjata dhe ato suplementare, pra certifikon pensionet.

- *Drejtoria e Auditimit të Brendshëm* ka si objekt të punës së saj kryesisht kontrollin financiar, certifikon llogaritë, si dhe për përfitimet afatshkurtra dhe afatgjata: kontrollon respektimin e rregullave të dhënies së të drejtës, vërtetësisë së dokumentave justifikuese dhe llogaritjen e përfitimeve.

- *Drejtoria Juridike/ Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve* ka si objekt të punës së saj:

1- Përfaqësimin e ISSH në proceset gjyqësore; për përmirësimin e aftësive profesionale, kryrjen e trajnimeve, vlerësimin e performancës së punës.

2- Koordinimi hirearkik: lidhet me drejtorin për të përmirësuar koordinimin me Drejtoritë Rajonale për unifikimin e praktikave gjyqësore (aspekte ligjore, administrative dhe procedurale, kriterë për lindjen e së drejtës, qëndrueshmëri financiare); bashkëvepron me drejtorin, lidhur me evidentimin e mosndjekjes së procedurave ligjore nga Drejtoritë Rajonale dhe informon për proceset gjyqësore, si dhe statusin e tyre ankimimet mosankimimet, kallzimet penale etj dhe i raporton drejtorit, supervisorëve të tjerë hierarkikë dhe Drejtorit të Përgjithshëm;

3- Koordinimi: bashkëpunon me stafin në ISSH dhe DRSSH për monitorimin dhe zgjidhjen në kohë të problemeve gjyqësore, përmbarimore dhe me prokurorinë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

4- Bashkëpunimi me të gjitha Drejtoritë e ISSH dhe DRSSH-së për të zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi për sa i përket çështjeve të proceseve gjyqësore, zyra të përmbartimit etj.

5- Dhënja ndihmë dhe kontrolli i performancës së juristëve të DRSSH që kanë të bëjnë me proceset gjyqësore dhe problemet e ngritura nga ata si dhe paraqitja e tyre tek Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori i Drejtorisë;

6- Analizimi i punës së çdo specialisti në sektor dhe performancës së juristëve në rajone, mat dhe krahason proceset gjyqësore analoge, nxjerr konkluzione, ngre probleme për zgjidhje;

7- Ndjekja e performancës së juristëve në DRSSH lidhur me: administrimin e rasteve të ankimeve, të kallzimeve, mbrojtjen në seancat gjyqësore të të gjitha niveleve, zbatimin e afateve kohore sipas legjislacioneve, zbatimin të vendimeve të formës së prerë të gjykatës etj.

▪ Sa sipër nga përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të parashikuara sipas Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, ndjekja dhe kontrolli mbi ecurinë e proceseve gjyqësore është kompetencë e Drejtorisë Juridike/ Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve.

Nga dy sektorët e tjerë, nuk ka të dhëna, analiza apo raporte vjetore për ecurinë e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, “Për disa Çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pension” efektet ndër vite, si dhe kontrollin e rasteve për të cilat është hequr dorë nga ankimimi, në zbatim të detyrave të ngarkuara nga titullari i Institucionit sipas shkresës nr. 6014/1 prot, datë 11.10.2016.

Ka munguar koordinimi ndërmjet sektorëve Drejtorisë Juridike/ Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, për të mbikqyrur punën e juristëve DRSSH dhe DSSH, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në zbatim të VKM-ve.

- Në Rregulloren e brendshme të Institucionit, nuk janë të përcaktuara qartë linjat e komunikimit dhe raportimit, në disa drejtime, ndërmjet DAB, Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Bordit të Drejtorëve, Këshillit Administrativ, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.

Gjithashtu **sistemet e kontrollit të brendshëm nuk janë plotësisht efektive**, mungon bashkëpunimi ndërmjet sektorëve Njesisë së Inspektimit, DAB dhe Drejtorisë Juridike.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. P B me detyrë Drejtor i Auditimit të Brendshëm, znj. M G me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. F Sh me detyrë Përgjegjës i Sektorit të ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve, znj. A A me detyrë Kryetar i Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve dhe z. A H me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i ISSH. Për periudhën Tetor-Dhjetor 2020, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike është emëruar znj. L Sh.

▪ Nga të dhënat e administruara nga subjekti, rezulton se ISSH **nuk ka krijuar një database të mirfilltë, të plotë dhe gjithpërfshirës të vendimeve gjyqësore** të ISSH dhe DRSSH-ve, ndër vite, ndjekjen dhe ecurinë e tyre. Të dhënat e administruara janë në kryesisht në formën e të dhënave statistikore. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të gjykojë në lidhje me respektimin e procedurave dhe afateve ligjore të apelimit nga DRSSH-të.

▪ Duke analizuar numrin e proceseve gjyqësore për vitin 2019 dhe 2020 konstatojmë se nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënë numri i proceseve gjyqësore nga 6316 në 5195 procese, gjithashtu ka rënë dhe numri i proceseve gjyqësore që janë humbur nga 3543 në 2504 procese, si dhe numri i proceseve gjyqësore që nuk janë ankimuar për shkak të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, nga 2775 në 1987 procese. Nga të gjithë çështjet në gjykata në dy shkallët e para, **rreth 84 % e tyre kanë kaluar në favor të kërkuesve**, shumica e këtyre proceseve, rreth 60%, të cilat rezultojnë të humbura, janë me objekt “Vërtetim fakti juridik”, me bazë ligjore nenin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

388, të Kodit të Procedurës Civile, ku DRSSH-të kanë qenë palë e tretë. Këto gjyqe kanë karakter njohjeje.

▪ Duke qënë së natyra e gjyqeve në sigurime ka karakter njohës, në vendimet gjyqësore përcaktohet detyrimi i DRSSH-së përkatëse të llogarisë në dhënien e përfitimit duke marrë parasysh periudhat e njohura gjyqësisht. Nisur nga numri i lartë i gjyqeve të kësaj natyre (afërsisht 5000 gjyqe të përfunduara vetëm gjatë 2019-2020), është e vështirë të llogaritet vlera kreditore pasi, në rastet kur kërkuesi është përfitues këto vendime depozitohen në dosjen e përfituesit duke zëvendësuar dokumentacionin e munguar apo të kontestuar nga arkivat e ISSH-së dhe në rastet kur kërkuesit nuk i ka lindur e drejta për përfitim vlera kreditore e periudhave të njohura gjyqësisht llogaritet kur lind e drejta për përfitim. Efekti i këtyre vendimeve lind bazuar në periudhat e sigurimit të çdo personi dhe janë pjesë e përdorimit të përvitshëm të Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

IV- Nga Drejtoria Juridike/Spektori i Ndjekjes së Procedurave Gjyqësore dhe Ankimimit, bazuar në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” e ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 14.08.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, janë propozuar 9 masa disiplinore nga “Tërheqje vëmendje” deri në “Vërejtje me Shkrim”, të gjitha masat janë për vitin 2019, ndërkohë për vitin 2020 nuk është propozuar asnjë masë disiplinore, më hollësisht sipas tabelës më poshtë:

Rekomandimet për masa disiplinore ndaj punonjësve								viti 2019		
DRSSH	VITI	Totali i masave	Lloji i masave të rekomanduara/sipas rregullores							
			Largim nga puna	Kalimi në një detyrë të një kategorie apo klasë më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në 1 vit	Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në 2 vjet	Vërejtje me paralajmërim	Vërejtje me shkrim	Tërheqje vëmendje	Nr prot, datë	Motivacioni
TIRANE	2019	3					2	1	1. Nr.3165 prot, dt.25.04.2019; 2 .Nr.4716 prot, dt.28.06.2019 3. Nr.2659 prot, dt.09.04.2019	1.Mospermishje detyrash funksionale 2. Mospermishje detyrash funksionale 3. Mospjesëmarrje ne proces gjyqësore
DURRES	2019	2						2	1.Nr.5212 prot, dt.17.07.2019; 2. Nr.7677prot, dt,12.11.2019	1.Mospjesëmarrje ne proces gjyqësor; 2.Mospjesëmarrje ne proces gjyqësor;
ELBASAN	2019	2						2	1.Nr.3308 prot, dt.06.05.2019; 2. Nr.7920 prot, dt.25.11.2019	1.Mos ekzekutim vullnetar te vendimit te gjykates; 2.Mospjesëmarrje ne proces gjyqësor
LEZHE	2019	1						1	NR.5211 prot, dt.17.07,2019	Mospjesëmarrje ne proces gjyqësor
GJIROKASTER	2019	1					1		Nr.5456 prot, dt.25.07.2019	Mospjesëmarrjene proces gjyqësor ne menyre te perseritur
Gjithsej		9					3	6		

V- Kallëzime penale

Puna e ISSH-së për pastrimin e skemës së sigurimeve shoqërore nga falsiteti e mashtrimi ka filluar që në vitin 2008, kur u krijuan mundësitë për marrjen nga arkivi i shtetit të dokumenteve arkivore që lidhen me periudhat e sigurimit si dhe kur gjendja civile filloj punën dhe ndërtoi regjistrin e shtetasve. Gjatë vitit 2019-2020 Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka marrë disa iniciativa në drejtim të pastrimit të skemës nga informaliteti, si në fushën e të ardhurave, ashtu



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

edhe në fushën e përfitimeve. Kjo është arritur nëpërmjet zbatimit të programeve informatike, krijimi i bazës së të dhënave të përfituesve dhe të periudhave kontributive; lidhja e tyre me Regjistrin e Gjendjes Civile dhe database-at e sistemeve të tjera; përditësimi i të dhënave, vënia në dispozicion të inspektorëve të të dhënave të numëruara, të regjistrave të vjetërsisë në punë në ish-kooperativat dhe ish-ndërmarrjet shtetërore; përmirësimi i punës së Komisioneve të Çertifikimit të të dhënave, të gjitha këto do të shërbejnë për të krijuar një mjet efikas për ISSH për evidentimin e rasteve të mashtrimit, falsifikimit dhe përfitimet e pamerituara, për pastrimin e skemës nga informaliteti.

Në vitet 2019 – 2020, si rezultat i kontrolleve për çështje të caktuara, dosjeve të konstatuara me shkelje nga Auditi, nga Komisioni AD-Hoch nga vetë Degët e përfitimeve në DRSSH, për shkak të falsifikimit të datëlindjeve apo dokumenteve të vjetërsisë në punë janë kryer gjithsej 56 kallëzime penale të detajuara sipas tabelës sipas viteve.

1- Viti 2019

Gjatë vitit 2019 janë bërë 26 kallëzime penale për të cilat për 8 kallëzime prokuroria ka vendosur pushim çështje, 11 çështje janë në proces, për 4 çështje janë dënuar dhe për 3 është vendosur mosfillim procedimi. Më hollësisht trajtuar sipas tabelës bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit.

2- Viti 2020

Gjatë vitit 2020 janë bërë 30 kallëzime penale, për të cilat për të cilat për 4 kallëzime prokuroria ka vendosur pushim çështje, 23 çështje janë në proces si dhe për 3 çështje janë dënuar, Më hollësisht trajtuar sipas tabelës bashkelidhur Raportit Përfundimtar te Auditimit.

Pushimi çështjes nga gjykatat është bërë për rastet kur vepra penale është parashkruar bazuar në nenin 66 të kodit Penal, për vepra penale mashtrim në sigurime dhe falsifikim dokumentash, apo në rastet kur personi kundër të cilit është bërë kallëzimi nuk rezulton të ketë kryer figurë të veprës penale. Për të gjithë këto raste, nëse personat janë shpallur debitor u mbahet vlera debitorë sipas nenit 62/3 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, edhe pse çështja është pushuar vazhdojnë të jenë në kushte përfitimi. Përfundimi bëhet vetëm në rastet kur për këta persona ka një vendim gjykatë të formës së prerë në të cilin kanë njohur periudhën e punës së refuzuar nga ISSH dhe kanë hequr masën debitorë.

VI- Efektet financiare të procesve gjyqësore për vitet 2019 dhe 2020, sipas DRSSH/Degët Rajonale dhe DSSH.

VI.1- Evidenca e shpenzimeve gjyqësore për marrëdhëniet e punës.

Për vitin 2019 janë 27 procese gjyqësore për marrëdhënie pune, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 20,380,966 lekë dhe nga këto në 7 raste me shpenzime përmbarimore në vlerën 480,699 lekë, më hollësisht paraqiten sipas tabelave më poshtë:

RAJONET	Shpenzimet gjyqësore		Shpenzimet përmbarimore	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	1	762,492	1	98,316
DIBER	-	-	-	-
DURRES	1	508,086	-	-
ELBASAN	4	1,670,428	-	-
FIER	1	286,000	-	-
GJIROKASTER	1	1,911,291	1	114,391
KORCE	5	2,036,784	-	-
KUKES	2	1,835,290	-	-
LEZHE	3	2,949,889	2	6,116
SHKODER	3	473,700	1	7,200



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

TIRANE	1	2,329,636	-	-
VLORA	2	852,480	-	-
DAQ	2	2,021,347	2	254,676
BUXHETI BRENDSEHEM	1	2,743,543	-	-
TOTALI	27	20,380,966	7	480,699

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Finances në ISSH

VITI 2019

RAJONET	Urdhër ekzekutimi zyre permbarimore			
	Lajmerim Vullnetar		Ekz. i detyrueshem	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	-	-	1	98,316
DIBER	-	-	-	-
DURRES	-	-	-	-
ELBASAN	-	-	-	-
FIER	-	-	-	-
GJIROKASTER	1	114,391	-	-
KORCE	-	-	-	-
KUKES	-	-	-	-
LEZHE	2	6,116	-	-
SHKODER	1	7,200	-	-
TIRANE	-	-	-	-
VLORA	-	-	-	-
DAQ	-	-	2	254,676
BUXHETI BRENDSEHEM	-	-	-	-
TOTALI	4	127,707	3	352,992

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Finances në ISSH

Gjatë vitit 2019, 7 vendime gjyqësore janë ekzekutuar me përmbartim me vlerë të shpenzimeve përmbartime 480,699 lekë, nga të cilat 4 raste në vlerën 127,707 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 3 raste në vlerën 352,992 lekë ekzekutim i detyrueshem.

Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore e ka DRSSH Korce, Lezhë, Tiranë dhe ISSH.

Për vitin 2020 rezulton si më poshtë vijon:

VITI 2020

RAJONET	Shpenzimet gjyqësore		Shpenzimet permbarimore	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	1	934,278	1	96,000
DIBER	1	276,470	1	106,664
DURRES	1	1,226,922	-	-
ELBASAN	2	1,048,878	-	-
SHKODER	2	60,000	-	-
BRENDSEHEM	2	2,544,178	-	-
TOTALI	9	6,090,726	2	202,664

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Finances në ISSH

VITI 2020

RAJONET	Urdhër ekzekutimi zyre permbarimore			
	Lajmerim Vullnetar		Ekz. i detyrueshem	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	1	96,000	-	-
DIBER	1	106,664	-	-
TOTALI	2	202,664	-	-

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Finances në ISSH

Për vitin 2020 janë 9 procese gjyqësore për marrëdhënie pune, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 6,090,726 lekë dhe nga këto në 2 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 202,664 lekë, të dyja me ekzekutim vullnetar. Nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënie të numrit të proceseve gjyqësore për marrëdhëniet e punës si dhe të shpenzimeve gjyqësore e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përmbartimore. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore e ka DRSSH Durrës, Elbasan dhe ISSH.

VI.2- Evidenca e shpenzimeve gjyqësore për pensionet sipas DRSSH/Degët Rajonale dhe DSSH për vitet 2019-2020.

Viti 2019

Për vitin 2019 janë 370 procese gjyqësore për pensionet me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 19,209,413 lekë dhe nga këto në 151 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 10,295,780 lekë, më hollësisht paraqiten sipas tabelave më poshtë:

VITI 2019				
RAJONET	Shpenzimet gjyqësore		Shpenzimet përmbartimore	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	1	98,316	1	96,240
DIBER	1	1,240,190	1	84,800
DURRES	13	617,500	7	1,017,070
ELBASAN	9	407,400	3	324,300
FIER	6	353,160	4	369,600
GJIROKASTER	5	367,201	-	-
KORCE	35	2,551,556	23	2,160,937
KUKES	1	30,000	1	56,400
LEZHE	3	189,220	2	165,600
SHKODER	13	344,588	4	176,869
TIRANE	273	13,072,122	105	5,196,464
VLORA	10	585,660	-	-
DAQ	-	-	-	-
BUXHETI BRENDSEHEM				
TOTALI	370	19,856,913	151	10,295,780

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Financës në ISSH

Gjatë vitit 2019, 151 vendime gjyqësore janë ekzekutuar me përmbartim me vlerë të shpenzimeve përmbartimore 10,295,780 lekë, nga të cilat 134 raste në vlerën 7,848,010 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 17 raste në vlerën 1,800,270 lekë ekzekutim i detyrueshëm. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore dhe përmbartimore e ka DRSSH Korçë, Durrës dhe Tiranë.

RAJONET	Urdhër ekzekutimi zyre përmbartimore			
	Lajmerim Vullnetar		Ekz. i detyrueshëm	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	1	96,240	-	-
DIBER	1	84,800	-	-
DURRES	-	-	7	1,017,070
ELBASAN	3	324,300	-	-
FIER	-	-	4	369,600
GJIROKASTER	-	-	-	-
KORCE	19	1,912,937	4	248,000
KUKES	1	56,400	-	-
LEZHE	-	-	2	165,600
SHKODER	4	176,869	-	-
TIRANE	105	5,196,464	-	-
VLORA	-	-	-	-
DAQ	-	-	-	-
BUXHETI BRENDSEHEM	-	-	-	-
TOTALI	134	7,848,010	17	1,800,270

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Financës në ISSH

Viti 2020

Për vitin 2020 janë 218 procese gjyqësore për pensionet, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 10,454,219 lekë, gjithashtu 104 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 8,456,292 lekë, më hollësisht paraqiten sipas tabelave më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

VITI 2020

RAJONET	Shpenzimet gjyqësore		Shpenzimet permbarimore	Vlere
	Nr	Vlere	Nr	
BERAT	-	-	-	-
DIBER	1	42,283	-	-
DURRES	5	332,400	3	655,800
ELBASAN	8	350,000	2	509,100
FIER	3	196,280	1	18,000
GJIROKASTER	3	81,197	3	30,300
KORCE	24	1,043,249	12	618,000
KUKES	2	27,400	-	-
LEZHE	4	240,110	3	181,001
SHKODER	4	133,400	1	93,600
TIRANE	160	7,681,721	78	6,176,628
VLORA	4	326,179	1	173,863
VLORA	-	-	-	-
BUXHETI BRENDSEHEM				
TOTALI	218	10,454,219	104	8,456,292

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Financës në ISSH

Gjatë vitit 2020, 104 vendime gjyqësore janë ekzekutuar me përmbardim me vlerë të shpenzimeve përmbardimore 8,456,292 lekë, nga të cilat 95 raste në vlerën 7,352,291 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 9 raste në vlerën 1,104,001 lekë ekzekutim i detyrueshëm. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore dhe përmbardimore e ka DRSSH Korçë, Durrës dhe Tiranë.

RAJONET	Urdhër ekzekutimi zyre permbarimore			
	Lajmerim Vullnetar		Ekz. i detyrueshem	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
BERAT	-	-	-	-
DIBER	-	-	-	-
DURRES	-	-	3	655,800
ELBASAN	1	374,500	1	134,600
FIER	-	-	1	18,000
GJIROKASTER	3	30,300	-	-
KORCE	10	503,400	2	114,600
KUKES	-	-	-	-
LEZHE	-	-	3	181,001
SHKODER	1	93,600	-	-
TIRANE	78	6,176,628	-	-
VLORA	1	173,863	-	-
DAQ	-	-	-	-
BUXHETI BRENDSEHEM	-	-	-	-
TOTALI	94	7,352,291	10	1,104,001

Burimi: Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Financës në ISSH

Gjate vitit 2019-2020 nuk janë ekzekutuar 45 vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilat janë trajtuar më hollësisht në tabelën baskëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. më poshtë:

Në total për vitet 2019 dhe 2020, janë **588 raste** me shpenzime gjyqësore në vlerën **29,663,632 lekë**, **255 raste** me shpenzime përmbardimore në vlerën **18,752,062 lekë**, nga të cilat **228 raste** me shpenzime përmbardimore vullnetare në vlerën **15,200,301 lekë** dhe **26 raste** me shpenzime përmbardimore të detyrueshme në vlerën **2,904,271 lekë**.

Nga Grupi i auditimi u kërkuan të dhëna mbi evidencën për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, si dhe për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbardim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, por të dhënat e paraqitura sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

DRSSH-ve, përmbajnë pasaktësi dhe mungesa në plotësimin e rubrikave, përveç DRRSH Tiranë dhe Korçë, çka e bën të vështirë që Grupi i Auditimit të shprehet për respektimin e afateve ligjore në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si dhe masat e marra nga DRSSH-t për shmangjen e shpenzimeve përmbartimore.

Nga analiza e kufizuar të të dhënave të administruara për DRRSH Tiranë dhe Korçë, për të cilat janë paraqitura të dhëna më të plota në krahasim me DRSSH e tjera, rezulton se vonesat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga DRSSH shkonë nga 1 muaj deri në 8 muaj. Në DRSSH Korçë nga 66 raste të shpenzimeve gjyqësore për vitet 2019-2020, 41 raste janë ekzekutuar me përmbartim në vlerën 3,062,699 lekë, ndërsa në DRSSH Tiranë nga 187 raste të shpenzimeve gjyqësore për vitet 2019-2020, 185 raste janë ekzekutuar me përmbartim në vlerën 5,450,480 lekë.

▪ Drejtoria Juridike nuk ka mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, si dhe për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbartim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, nuk ka relacione për ndjekjen dhe raportimin e tyre.

Veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhrit nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu- Detyrat dhe Përgjegjësit, ku ndër të tjera përcaktohet:

- *Koordinimi hirearkik: lidhet me drejtorin për të përmirësuar koordinimin me Drejtoritë Rajonale për unifikimin e praktikave gjyqësore (aspekte ligjore, administrative dhe procedurale, kritere për lindjen e së drejtës, qëndrueshmëri financiare); bashkëvepron me drejtorin lidhur me evidentimin e mosndjekjes së procedurave ligjore nga Drejtoritë Rajonale dhe informon për proceset gjyqësore si dhe statusin e tyre ankimimet mosankimimet, kallzimet penale etj dhe i raporton drejtorit, supervisorëve të tjerë hierarkikë dhe Drejtorit të Përgjithshëm;*

- *Koordinimi: bashkëpunon me stafin në ISSH dhe DRSSH për monitorimin dhe zgjidhjen në kohë të problemeve gjyqësore, përmbartimore dhe me prokurorinë.*

- *Bashkëpunimi me të gjitha Drejtoritë e ISSH dhe DRSSH-së për të zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi për sa i përket çështjeve të proceseve gjyqësore, zyrave të përmbartimit etj.*

- *Analizimi i punës së çdo specialisti në sektor dhe performancës së juristëve në rajone, mat dhe krahason proceset gjyqësore analoge, nxjerr konkluzione, ngrre probleme për zgjidhje;*

- *Ndjekja e performancës së juristëve në DRSSH lidhur me: administrimin e rasteve të ankimeve, të kallzimeve, mbrojtjen në seancat gjyqësore të të gjitha niveleve, zbatimin e afateve kohore sipas legjislacioneve, zbatimin të vendimeve të formës së prerë të gjykatës etj.*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. M G me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. F Sh me detyrë Përgjegjës i Sektorit të ndjekjes së procedurave dhe ankimeve. Për periudhën Tetor-Dhjetor 2020, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike është emëruar znj. L Sh.

Në lidhje me akt-konstatimin nr. 3, datë 27.04.2021, janë paraqitur sqarimet me shkresën nr. 2843/1 prot, datë 04.05.2021, administruar në KLSH me nr. 95/4 prot, datë 06.05.2021, nga znj. L Sh me detyrë Drejtor Juridik, znj. F Sh me detyrë Përgjegjëse Sektori, z. P B me detyrë Drejtor i Auditimit të Brendshëm dhe znj. A A me detyrë Kryetare e Njesisë së Inspektimit të përfitimeve, të cilët sqarojnë se:

- *Për sa i përketet mungesës së evidencës së ankesave dhe shkresave të trajtuara gjatë viteve, në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ISSH nuk është parashikuar mbajtja e evidencës, Kërkesat e administruara lidhen kryesisht me interpretime ligjore, dhe një pjese e ankesave të marra në shqyrtim nga Drejtoria Juridike janë trajtuar në bashkëpunim me*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Drejtori të tjera. **Sqarimi i Grupit të Auditimit:** Nga Drejtoria Juridike nuk administrohet një database ndër vite për evidentimin e ankesave dhe shkresave të trajtuar nga kjo Drejtoria, për ecurinë trajtimin të tyre, kthimin e përgjigjeve si dhe respektimin e afateve për kthim përgjigje, pretendimet tuaja nuk janë të argumentuara.

- Zbatimi i VKM nr. 482, datë 29.06.2016, ka qenë objekt kontrolli nga Auditimi Brendshëm dhe Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. Nuk ka munguar rakordimi i Drejtorisë Juridike me Auditimin e Brendshëm dhe Njësien e Inspektimit të Përfitimeve por nga këto struktura nuk janë raportuar në Drejtorinë Juridike raste të mosankimimit. Vendimarrja për mosankimimin e tyre merret në mënyrë kolegjiale nga strukturat kompetente të DRSSH-ve. **Sqarimi i Grupit të Auditimit:** Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë pasi janë të pargumentuara dhe pambështetura në dokumentacion justifikues. Nga asnjë prej strukturave të ngarkuara për kontrollin e ecurisë së zbatimit të VKM-së, nuk administrohen të dhëna, dokumentacion apo relacion për kontrollet e ushtruara, pra ka munguar rakordimi ndërmjet këtyre tre strukturave.

- Në lidhje me ndjekjen dhe ecurinë e proceseve gjyqësore, sqarojnë se sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ISSH nuk është përcaktuar kryerja e kontrollit periodik fizik pranë zyrave juridike të ISSH. Drejtoria Juridike për përmbushjen e detyrave funksionale të përcaktuara në rregullren e sipërcituar, ka kryer kontrolle vetëm për raste specifike me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe në bashkëpunim me specialistë të Njesisë së Inspektimit apo Auditit Brendshëm. **Sqarimi i Grupit të Auditimit:** Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë pasi sipas përcaktimeve të rregullores për organizimin dhe funksionimin sipas urdhër nr. 2115, datë 15.03.2018, trajtuar hollësisht në material, Drejtoria Juridike nuk përjashtohet nga përgjegjësia për ndjekjen, ecurinë dhe monitorimin e proceseve gjyqësore nga DRSSH-t, si dhe mungesën e bashkëpunimit me Auditin e Brendshëm dhe Njësien e Inspektimit të Përfitimeve për kontrollin fizik pranë zyrave juridike të ISSH.

Gjetja

Mungesë e një databaze të plotë dhe gjithpërfshirëse të vendimeve gjyqësore të ISSH dhe DRSSH-ve, mungesë e evidencës dhe të dhënave analitike për çdo DRSSH, për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbarim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, ndjekjen dhe raportimin e tyre.

Situata

Nga auditimi rezulton se ISSH nuk ka krijuar një databaze të mirfilltë, të plotë dhe gjithpërfshirëse të vendimeve gjyqësore të ISSH dhe DRSSH-ve, ndër vite, ndjekjen dhe ecurinë e tyre. Të dhënat e administruara janë kryesisht në formën e të dhënave statistikore. Nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënë numri i proceseve gjyqësore nga 6316 në 5195 procese, gjithashtu ka rënë dhe numri i proceseve gjyqësore që janë humbur nga 3543 në 2504 procese, si dhe numri i proceseve gjyqësore që nuk janë ankimuar për shkak të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, dhe VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, nga 2781 në 1990 procese. Nga të gjithë çështjet në gjykata në dy shkallët e para, rreth 84 % e tyre kanë kaluar në favor të kërkuësve, shumica e këtyre proceseve, të cilat rezultojnë të humbura, janë me objekt “Vërtetim fakti juridik”, me bazë ligjore nenin 388, të Kodit të Procedurës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Civile, ku DRSSH-të kanë qenë palë e tretë. Këto gjyqe kanë karakter njohjeje.

Në Gjykatën e Lartë për vitin 2019 janë ndjekur 1178 procese nga të cilat: 20 procese të përfunduara, ku në 10 procese është vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, në 1 proces është vendosur pushimi i padisë, në 9 procese është vendosur kthimi për rigjykim në Gjykatën e Apelit, 1076 procese të mbartura dhe 102 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi.

Ndërkohë për vitin 2020 janë ndjekur 1221 procese nga të cilat: 17 procese të përfunduara, ku në 5 procese është vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, në 1 proces është vendosur pushimi i padisë, në 11 procese është vendosur kthimi për rigjykim në Gjykatën e Apelit, 1185 procese të mbartura dhe 36 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi. Për shkak të mosfunksionimit normal të kësaj gjykate aktualisht janë 1221 procese gjyqësore të mbartura ndër vite të cilat përbejnë kosto si për individin ashtu dhe për institucionin.

Për vitin 2019 janë 27 procese gjyqësore për marrëdhënie pune, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 20,380,966 lekë dhe nga këto në 7 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 480,699 lekë, nga të cilat 4 raste në vlerën 127,707 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 3 raste në vlerën 352,992 lekë ekzekutim i detyrueshëm. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore e ka DRSSH Korçë, Lezhë, Tiranë dhe ISSH. Për vitin 2020 janë 9 procese gjyqësore për marrëdhënie pune, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 6,090,726 lekë dhe nga këto në 2 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 202,664 lekë, të dyja me ekzekutim vullnetar. Nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënie të numrit të proceseve gjyqësore për marrëdhëniet e punës si dhe të shpenzimeve gjyqësore e përmbartimore. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore e ka DRSSH Durrës, Elbasan dhe ISSH.

- Për vitin 2019 nga ISSH raportohen janë 370 procese gjyqësore për pensionet me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 19,209,413 lekë dhe nga këto në 151 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 10,295,780 lekë, nga të cilat 134 raste në vlerën 7,848,010 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 17 raste në vlerën 1,800,270 lekë ekzekutim i detyrueshëm. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore dhe përmbartimore e ka DRSSH Korçë, Durrës dhe Tiranë. Për vitin 2020 nga ISSH raportohen 218 procese gjyqësore për pensionet, me një vlerë të shpenzimeve gjyqësore 10,454,219 lekë, gjithashtu 104 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 8,456,292 lekë, nga të cilat 95 raste në vlerën 7,352,291 lekë me ekzekutim vullnetar dhe 9 raste në vlerën 1,104,001 lekë ekzekutim i detyrueshëm. Numrin më të lartë të shpenzimeve gjyqësore dhe përmbartimore e ka DRSSH Korçë, Durrës dhe Tiranë.

Në total për vitet 2019 dhe 2020, raportohen 588 raste me shpenzime gjyqësore në vlerën 29,663,632 lekë, 255 raste me shpenzime përmbartimore në vlerën 18,752,062 lekë, nga të cilat 228 raste me shpenzime përmbartimore vullnetare në vlerën 15,200,301 lekë dhe 26 raste me shpenzime përmbartimore të detyrueshme në vlerën 2,904,271 lekë. Nga analiza e kufizuar të të dhënave të administruara për DRSSH Tiranë dhe Korçë, për të cilat janë paraqitura të dhëna më të plota në krahasim me DRSSH e tjera, rezulton se vonesat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	të formës së prerë nga DRSSH shkonë nga 1 muaj deri në 8 muaj. Në DRSSH Korçë nga 66 raste të shpenzimeve gjyqësore për vitet 2019-2020, 41 raste janë ekzekutuar me përmbarim në vlerën 3,062,699 lekë, ndërsa në DRSSH Tiranë nga 187 raste të shpenzimeve gjyqësore për vitet 2019-2020, 185 raste janë ekzekutuar me përmbarim në vlerën 5,450,480 lekë. Drejtoria Juridike nuk ka mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, si dhe për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbarim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, nuk ka relacione për ndjekjen dhe raportimin e tyre. Veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu- Detyrat dhe Përgjegjësit.
Kriteri	-Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar. -Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; -Ligji nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; -VKM nr.482, datë 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”; -VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; -VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”. -Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018.
Ndikimi/Efekti	Pamundësi nga ana e menaxhimit e ndjekjes, analizës dhe vlerësimit të ecurisë së proceseve gjyqësore. Mungesa e monitorimit për zbatimin e afateve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rritja e shpenzimeve e përmbarimore.
Rëndësia Rekomandimi nr. 1	I Lartë Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të hartojnë një data base të plotë të vendimeve gjyqësore, për të gjitha shkallët e gjyqësorit, për t'i mundësuar menaxhimit monitorimin, analizën dhe vlerësimin e ecurisë së proceseve në tërësinë e tyre.
Rekomandimi nr. 2	Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të evidentojë shenzimet e vendimeve gjyqësore, duke mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbarim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, ndjekjen dhe raportimin e tyre, të marrë masa që në vijimësi të zbatohen afatet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke shmangur rritjen e shpenzimeve përmbarimore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjetja

Mungesë monitorimi dhe kontrolli për zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në proceset gjyqësore në rastin e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, VKM nr. 660, datë 10.10.2019 dhe VKM nr.657, datë 10.10.2019, si dhe efektet e tyre të shtrira në kohë që nga viti 2016 kur ka filluar zbatimi, mungesë koordinimi ndërmjet sektorëve Drejtorisë Juridike/Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, për të mbikqyrur punën e juristëve DRSSH dhe DSSH, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në zbatim të këtyre VKM-ve.

Situata

Nga ana e ISSH përveç raportimeve dhe evidencave statistikore nga DRSSH dhe DSSH për periudhën objekt auditimi 2019-2020, **nuk ka të dhëna të tjera mbi zbatimin** e VKM nr. 482, datë 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni” si dhe VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, **mbi impaktin dhe efektet e tyre të shtrira në kohë që nga viti 2016 kur ka filluar zbatimi, evidentimin e mangësive apo risqeve, respektimin e procedurave ligjore në tërheqjen e ankimimeve nga DRSSH.** Nga verifikimi i relacioneve të mbajtura nga DRSSH-t për heqjen dorë nga ankimi në zbatim të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, rezulton se pjesa më e madhe e gjyqeve ka pasur si objekt vërtetimin e faktit juridik të qënies në marrëdhënie pune dhe të vjetërsisë në punë. Relacionet janë përmbledhje e shkurtuar e vendimit të gjykatës, provave dhe dokumenteve të paraqitura në proceset gjyqësore. Ajo që konstatohet nga **krahasimi i relacioneve të mbajtura nga një DRSSH në tjetrën është mënyra e hartimit të tyre, pasi në disa prej tyre relacionet janë hartuar** duke bërë një përshkrim të fakteve dhe rrethanëve të trajtuara në proceset gjyqësore dhe janë shoqëruar nga vendimi i titullarit bashkangjitur relacionit të juristit të DRSSH-së, ndërkohë në disa të tjera si rasti i DRSSH Durrës dhe DRSSH Fier, relacionet janë mbajtur shkurtimisht dhe formalisht dhe ka shumë pak të dhëna nga hetimi gjyqësor si dhe argumentimin për heqjen dorë nga ankimi.

Sipas shkresës nr. 6014/1 prot, datë 11.10.2016 të titullarit të ISSH, mbi zbatimin e VKM nr. 482, datë 29.06.2016, “Për disa Çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni” paragrafi fundit, është përcaktuar si struktura përgjegjëse, për auditimin dhe inspektimin e të gjitha vendimeve të gjykatave që janë ankimuar, nuk janë ankimuar apo është tërhequr ankimi, si dhe zbatimin e procedurave, Auditimi Brendshëm dhe Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. Ndërkohë sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Urdhrit nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, ndjekja dhe kontrolli mbi ecurinë e proceseve gjyqësore është kompetencë e Drejtorisë Juridike/Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve. Nga dy sektorët e tjerë, nuk ka të dhëna, analiza apo raporte vjetore për ecurinë e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, “Për disa Çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pension” efektet ndër vite, si dhe kontrollin e rasteve për të cilat është hequr dorë nga ankimimi, në zbatim të detyrave të ngarkuara nga titullari i Institucionit sipas shkresës nr. 6014/1 prot, datë 11.10.2016. Si përfundim ka munguar koordinimi ndërmjet sektorëve Drejtorisë Juridike/Sektori i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Njësisë së Inspektimit të Përfitimeve, për të mbikqyrur punën e juristëve DRSSH dhe DSSH, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në zbatim të VKM-ve. Sistemet e kontrollit të brendshëm nuk janë plotësisht efektive, mungon bashkëpunimi ndërmjet sektorëve.
Kriteri	Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr.482, datë 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”; VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”. Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018
Ndikimi/Efekti	Mungesa e kontrollit mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në zbatim të VKM-ve.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	ISSH të marrë masa të menjëhershme të përcaktojë strukturën përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në proceset gjyqësore në rastin e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”; VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”.

B.5.3- Aktiviteti i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të pikes 5 të programit të auditimit: “Mbi funksionimin e strukturave të kontrollit . Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi i kryer mbi organizimin dhe funksionimin e NJAB të ISSH, rezultoi se :

➤ **Organizimi dhe Funksionimi:**

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, është ngritur në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM-së nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, është organizuar dhe funksionon në nivel Drejtorie brenda strukturës organizative të I.S.SH.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka varësi direkte e raporton në mënyrë të drejtpërdrejt tek Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e saj emërohen prej tij. Kjo varësi është e përcaktuar në nenin 12, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1022, datë 09.07.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.161, datë 11.04.1994 të Këshillit të Ministrave” Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Organika e DAB-së është miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”, e përbërë prej 9 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor, 1 Kryetar Dege dhe 7 Specialist auditues. Të gjithë punonjësit e DAB janë të certifikuar “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe rezultojnë të kenë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme prej 40 orësh në vit. DAB në ISSH ka marrë pjesë në të gjitha trajnimet që organizon NJQAB dhe në ISSH nga sektori i trajnimeve çdo vit planifikohet trajnim i DAB për problematikat e ndryshimeve ligjore dhe organizative të ISSH-së. 7 nga audituesit janë me formim në shkencat ekonomike dhe 1 në ekonomike dhe juridike dhe 1 në shkencat juridike. 3 auditues janë me vjetërsi në auditim deri në 5 vjet dhe 6 auditues me vjetërsi në auditim nga 7-18 vjet. Struktura dhe organika e AB miratuar nuk ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2019-2020, por për vitin 2020 në fakt ka funksionuar me një personel prej 8 vetash me një auditues më pak, pasi është larguar një specialist-auditues, duke lënë të paplotësuar një vend në strukturë.

NR	TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM							TRAJNIME NE FUSHEN E AB	
	EMËR MBIEMËR	Pozicioni		Niveli i Diplomës	Eksperiencia e Punës				
					Vitet e Punës Gjithsej	Vitet e Punës në AB		I certifi kuar në vitin	Trajnime nga ISSH dhe DHAB
		Arsimi Bazë							
1	Petrit BREGASI	DREJTOR	FAK. EKONOMIK	MASTER	37	5	2019	40 orë në vit	-
2	Ali BRAHAJ	K/DEGE	FAK. EKONOMIK	MASTER	34	9	2008	40 orë në vit	Univ. Epoka
3	Fatbardha HASANAJ	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	35	18	2009	40 orë në vit	-
4	Marjeta TERPOLLARI	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	14	7	2009	40 orë në vit	-
5	Shefki BARA	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	19	7	Në proces	40 orë në vit	-
6	Gerti BODE	AUDITUES	FAK. EK. e JURID	MASTER	12	7	2012	40 orë në vit	-
7	Orkida ISUFAJ	SP. RISKU	FAK. EKONOMIK	MASTER	6	5	2013	40 orë në vit	-
8	Vera GJANA	SP. RAPORT	FAK. JURIDIK	MASTER	35	10	2011	rë në vit	-

Konkuzion: Nga auditimi i detyrave dhe përgjegjësi në Rregulloren e Brendshme të ISSH konstatohet se në Rregullore nuk janë përcaktuar:

- Statusi organizativ i kësaj strukture, (pavarësia funksionale e organizative, siç është përcaktuar në Kartën e Auditimit të Brendshëm).
- Kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, për **a)** përgjegjësitë e drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm, përcaktuar në nenin 14 të ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikën 2.6.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe **b)** të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm, përcaktuar në nenin 15 dhe 16 të Ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikën 2.6.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Drejtori i NJAB ngarkohet me detyrë t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm argumenta për masat disiplinore, që do ndërmarrë ndaj nëpunësve në rast të mos respektimit të rregullave organizative të brendshme në përputhje me Rregulloren e Brendshme, detyrë kjo në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16, të ligjit nr. 114/2015, i cili nuk i jep të drejtë dhe kompetencë audituesve për dhënien e masave disiplinore.

- Kriteret e diplomës, të përvojës së punës në profesion dhe në fushën e auditimit të brendshëm si për Drejtuesin e NjAB, ashtu edhe për Specialistët janë vendosur në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 të ligjit nr. 114/2015. ***Ka gjetur zbatim standardi 1000-qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, por ka nevojë për përmirësim të Rregullores lidhur me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm.***

Nga auditimi rezulton se, nga ana e DAB është përgatitur relacioni për përditësimin e Rregullores në të cilin janë evidentuar çështjet që duhet ti shtohen Rregullores lidhur me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm, por ndryshimet në rregullore ende nuk janë miratuar.

➤ **Komiteti i Auditimit të Brendshëm:** Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit, pasi për ISSH këtë rol e luan Komiteti i Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i cili është organ epror për këtë institucion, bazuar në nenin 13 pika 2 të ligjit 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" në Kreu II, pika 2 përcaktohet se: "Njësitë publike, të cilat kanë varësi funksionale nga një organ epror dhe kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm nuk krijojnë komitet, por mbikëqyren nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm i organit epror."

NJAB në ISSH ka korespondence të rregullt me Komitetin e AB në MFE për

- planin strategjik e vjetor 2020(shkresa nr 22/2 date 09.10.2020)

- raportin e veprimtarisë A.B për vitet 2019 dhe 2020 me vendimet perkatese nr.5 datë 30.01.2020, dhe nr 8 date 25.01.2021.

➤ **Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në ISSH dhe e ka përditësuar atë, gjë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.7671, datë 12.11.2019.

➤ **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2019 me shkresën nr. 6435, datë 16.10.2018 është miratuar plani strategjik për vitet 2019 – 2021, dhe plani vjetor për vitin 2019

Nga auditimi rezulton se për vitin 2019 ndryshimi i planit vjetor të auditimeve nuk është materializuar me shkresë dhe nuk është i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Ligjit 114/2015, ndërkohë që të gjitha programet individuale rezultojnë të miratuara nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2020 me shkresën nr.6690/3, datë 20.11.2019 është miratuar plani strategjik për vitet 2020 – 2022 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2020

Për vitin 2020 është bërë ndryshim plani i cili është miratuar dhe dërguar DHAB me shkresën nr.6618 datë 28.10.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Në këto plane Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar objektivat e saj, që janë:

- Siguridhënia objektivave ndaj titullarit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore se zbatimi i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomi në përmbushje të objektivave të përcaktuara;
- Zhvillimi i një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit;
- Shtimi i vlerës dhe përmirësimi i veprimtarisë së I.S.SH;
- Kryerja e auditimeve të vazhdueshme, duke siguruar që çdo DRSSH dhe degë të mos mbetet pa u kontrolluar për një periudhë më shumë se dy vjet, me qëllim shmangien e risqeve që mund të kërcënojnë skemën e sigurimeve shoqërore, aktivitetin e njësive vartëse të ISSH si dhe vetë aktivitetin e ISSH-së në tërësi.

Realizimi i angazhimeve sipas planeve vjetore:

Për vitin 2019 janë planifikuar gjithsej 11 misione auditimi:

- 9 misione auditimi të kombinuara e të plota (*zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko financiare*)
- 1 mision auditimi financiar (*zbatimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe vlerësimi i raportit financiar për vitin 2018 në ISSH*)
- 1 mision auditimi përputhshmërie

Në fakt janë realizuar 15 misione auditimi, sipas llojit të auditimit si më poshtë:

- 11 auditime të plota (*zbatimi i ligjëshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko financiare*) në DRSSH-të Durrës, Gjirokastrë, Vlorë, Sarandë, Kukës, Tropojë, Lezhë, Berat, DAQ Lundër, Elbasan, Tiranë
- 1 auditim tematik në DRSSH-të Dibër, Shkodër, Korçë, Fier, Elbasan, Durrës, Tiranë dhe ISSH (Drejtoria e Financës)
- 2 auditime performance në DRSSH Lezhë, DRSSH Berat
- 1 auditim përputhshmërie mbi rezultatin financiar dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të ISSH-së për vitin 2018. (Drejtoria e Financës).

Realizimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekte të audituara ngs NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit Viti 2019									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazh. të përfunduara	Angazh në proces
			Të përputhshmërisë	Të performancës	Financiare	Teknologjia Informatike	Të kombinuara				
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	DRSSH Dibër Tematik	1		-	-	-	-	-	1	1	-
2	DRSSH Durrës	1					1			1	
3	DRSSH Gjirokastrë	1	-	-		-	1			1	
4	DRSSH Vlorë	1	-	-		-	1			1	
5	DRSSH Sarandë	1	-	-		-	1			1	
6	DRSSH Kukës	1	-	-		-	1			1	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

7	DSSH Tropojë	1	-	-	-	1		1	
8	DRSSH Lezhe	2		1	1	-		2	
9	DRSSH Berat	2	-	1	1	-		2	
10	ISSH Drejtoria e finances	1	1	-	-	-		1	
11	DAQ	1	-	-	-	1		1	
12	DRSSH Elbasan	1	-	-	-	1		1	
13	DRSSH TIRANE	1	-	-	-	1			1
	TOTALI	15							

Për vitin 2020 janë planifikuar gjithsej 12 misione auditimi, nga të cilat:

- 10 misione auditimi të kombinuara e të plota (zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare)
- 1 mision auditimi financiar (zbatimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe vlerësimi i raportit financiar për vitin 2019 në ISSH)
- 1 mision auditimi performance.

Në planin vjetor të miratuar është bërë një ndryshim, duke u futur me prioritet programi nr. 296 datë 15.01.2020 me urdhërin e titullarit nr.218, datë.10.01.2020 "Për auditimin e faljeve të realizuara sipas ligjit 72/2017 "Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë", të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfutimit të pensionit ", auditim përputhshmerie, ku është ushtruar në të gjitha Drejtorite Rajonale.

Në zbatim të Nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike", të Ligjit nr.114/2015,si dhe Manualit të A.B në sektorin publik kapitulli III pika 3.5. për shkak të situatës së fatkeqësisë natyrore të shpallur me VKM nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", është bërë rishikimi i planit vjetor të veprimtarisë së DAB në ISSH, për vitin 2020". Për periudhën 12.03.2020 deri 01.06.2020 nga NjAB është kryer rishikimi i planit të auditimeve për vitin 2020, duke u bazuar në analizën e riskut dhe periudha që nuk është ushtruar auditim, duke u miratuar ndryshimet si me poshtë:

- Janë hequr nga nga planifikuimi vjetor fillestar i vitit 2020 auditimi në dy subjekte;
- Drejtoria e Arkivit Qendror, si subjekt me më pak risk , e cila është audituar për periudhën deri në 30.06.2019,
- Drejtoria e Përfitimeve në ISSH, e cila është nën auditim nga KLSH për vitin 2019 në kuadër të auditimit të aktivitetit për vitin 2019 të ISSH. Realizimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2020 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekte të audituara ngs NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbim Këshi llimi	Angazhi me kërkesë të titullarit	Angazh të përfunduara	Angazh në proces
			Të përputhshmërisë	Të performancës	Financiare	Teknologjia Informatike	Të kombinuara				
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	DRSSH TIRANE	1		-	-	-	1	-		1	-
2	Të gjitha Drejtoritë (12 drejtori)	1	1						1	1	
3	DRSSH Fier	1	-	-		-	1			1	
4	DRSSH Dibër	1	-	-		-	1			1	
5	DRSSH Korçë	1	-	-		-	1			1	
6	DRSSH Shkodër	1	-	-		-	1			1	
7	ISSH Drejtoria e finances	1	1	-		-				1	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

8	DRSSH Vlorë	1	-	-	-	1			1	
9	DSSH Sarandë	1	-	-	-	1			1	
10	DRSSH Gjirokastrë	1	-	-	-	1			1	
11	DRSSH Durrës	1	-	-	-	1			1	
	Totali	11	2		0	9	0	1	11	

Nga auditimi rezulton se ndryshimi i planit vjetor të auditimeve nuk është materializuar me shkresë dhe nuk është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të Ligjit 114/2015, ndërkohë që të gjitha programet individuale rezultojnë të miratuara nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm.

➤ **Raportimi:** Nga korespondenca e vënë në dispozicion rezulton se për veprimtarinë e NJAB në ISSH për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike, titullarit të ISSH me memo për çdo angazhim auditimi. Është raportuar nga Drejtuesi i NJAB Këshillit Administrativ organit me të lartë në ISSH mbi veprimtarinë audituese për vitin 2019 dhe periudhës 9/mujore të vitit 2020. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2019 me shkresën nr. 238 prot. datë 14.02.2020, për vitin 2020 me shkresën nr. 383/2 prot. datë 15.02.2021.

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**
Nga auditimi i detajuar i auditimeve të kryera në të gjitha subjektet në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për :

- a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;
- b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;
- c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se :

Për vitin 2019 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të 10 dosjeve të përzgjedhura (DRSSH Gjirokastrë, DRSSH Kukës, DSSH Tropojë, DRSSH Lezhë, DRSSH Berat, DRSSH Tiranë, DRSSH Dibër) e konstatua se audituesit e brendshëm kanë treguar kujdesin e duhur profesional për respektimin e të gjitha fazave të procesit të auditimit. por jo në të gjitha rastet janë respektuar afatet përkatëse të tyre, konform përcaktimeve të Manualit të AB.

Më konkretisht:

Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Nr.datë	Afati i Auditimit		Kthimi i observacioneve pas PRA	Shkresa përcjellëse e dërgimit të Raportit Përfundimtar	Shënime të audituesve të KLSH
DRSSH Durrës	Nr. 926 Datë 06.02.2019	07.02.2019- 15.03.2019	Nr. 926/1 Datë 26.03.2019	Datë 05.04.2019	Nr. 926/3 Datë 02.05.2019	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 12 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
DRSSH Vlorë	Nr.3144 Datë 25.04.2019	30.04.2019- 30.05.2019	Nr. 3144/2 Datë 10.06.2019	Datë 26.06.2019	Nr. 3144/5 Datë 22.07.2019	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 10 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
DSSH Sarandë	Nr.3144 Datë 25.04.2019	30.04.2019- 30.05.2019	Nr. 3144/2 Dt.10.06.2019	Datë 26.06.2019	Nr. 3144/5 Datë 22.07.2019	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 10 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
DRSSH Kukës	Nr.4138 Datë 05.06.2019	06.06.2019- 05.07.2019	Nr. 4138/1 Dt 17.07.2019	Datë 29.07.2019	Nr. 4138/4 Datë 22.08.2019	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 11 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
DSSH Tropojë	Nr. 4138 Datë 05.06.2019	06.06.2019- 05.07.2019	Nr. 4138/1 Dt 17.07.2019	Datë 26.07.2019	Nr. 4138/5 Datë 22.08.2019	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 12 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
DRSSH Lezhë (Financiar)	Nr. 4969 Datë 10.07.2019	11.07.2019- 16.08.2019	Nr. 4969/1 Dt 04.09.2019	Datë 23.09.2019	Nr. 4969/3 Datë 14.10.2019	Dërgimi i Projekt Raportit 3 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor dhe dërgimi i Raportit Përfundimtar 7 ditë pune në tejkallim të afatit
DRSSH Lezhë (Performancë)	Nr. 4970 Datë 10.07.2019	11.07.2019- 16.08.2019	Nr. 4970/1 Dt 04.09.2019	Datë 01.10.2019	Nr. 4970/3 Datë 14.10.2019	Dërgimi i Projekt Raportit 3 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

DRSSH Elbasan	Nr. 7317 Datë 24.10.2019	04.11.2019- 27.11.2019	Nr. 7317/1 Dt.23.12.2019	Datë 07.01.2020	Nr. 7317/3 Datë22.02.2020	Dërgimi i Projekt Raportit 6 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor dhe dërgimi i Raportit Përfundimtar 26 ditë pune në tejkallim të afatit
---------------	-----------------------------	---------------------------	-----------------------------	--------------------	------------------------------	---

Burimi: Njësia e Inspektimit në ISSH

Kështu në 8 raste nuk janë respektuar afatet si:

- Nuk është respektuar afati ditor (10 ditë pune) i përcjelljes së projekt raportit njësisë së audituar pas përfundimit të angazhimit të auditimit (dosjet e vlerësuara: DRSSH Lezhë auditim financiar e përputhshmëri dhe DRSSH Elbasan), veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 4.1.12 të Kapitullit IV të MAB.

- Nuk është respektuar afati ditor (7 ditë pune) i dërgimit të raportit përfundimtar njësisë së audituar pas marrjes së observacioneve (dosjet e vlerësuara: DRSSH Durrës, Vlorë, DSSH Sarandë, DRSSH Kukës, DSSH Tropojë, DRSSH Lezhë (Financiar) dhe DRSSH Elbasan), veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 4.1.12 të Kapitullit IV të MAB.

-Raportet nuk kanë strukturën formale sipas përcaktimeve në pikën 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i planveprimit nga njësia e audituar” të MAB;

-Raportet nuk janë konçize, ka përshkrime të gjata, të tepërta, të detajuara, të pa nevojshme dhe të parëndësishme që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinionit apo vlerësimi përfundimtar.

Raportet nuk reflektojnë lidhjen organike gjetje-konkluzion-rekomandim;

- Gjetjet në një pjesë të rasteve janë të karakterit të përgjithshëm si dhe jo të gjitha gjetjet janë shoqëruar me rekomandim

-Rekomandimet e lëna kanë përcaktuar afatin e zbatimit të tyre por jo nivelin e rëndësisë së tyre (I lartë, I mesëm dhe I lartë).

-Në shkresat përcjellëse të Projekt Raporteve subjekteve të audituara DAB është shprehur :...*Më pas materialit të nënshkruhet prej tyre brenda 5 ditëve, duke zbatuar afatet e përcaktuara në Ligjin nr.114, datë 22/10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*. Referenca e përcaktimit të afatit dhe koha e tij është paraqitur gabim nga DAB, pasi në bazë të kërkesave të Kapitullit IV, pika 4.1.12 të Manualit të AB, subjekti i audituar duhet të konfirmojë gjetjet e projektraportit dhe rekomandimet, brenda afatit 10 ditor (ditë pune) nga marrja e projektit;

-Në shkresat përcjellëse të Raporteve Finale subjekteve të audituara DAB është shprehur:...*Më pas nga ana e titullarit, të bëhet konfirmimi i raportit dhe miratimi i plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Afati i konfirmimit të raportit 15 ditë nga dita e marrjes së njoftimit. Afati i evadimit të raportit të auditimit 30 ditë*. Referenca e përshkrimit të detyrimeve të palës së audituar dhe afatet kohore janë përcaktuar gabim nga DAB, pasi subjekti i audituar nuk ka detyrim ligjor për konfirmim të Raportit Final. Mbështetur në shkronjën “d”, të nenit 12, të ligjit nr.114, datë 22/10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, *subjekti i audituar duhet të hartojë dhe të dërgojë në DAB, Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të miratuar, brenda periudhës 30 ditore nga marrja e Raportit si dhe raportimin në mënyrë periodike, jo më vonë se 10 ditë nga plotësimi i afateve të zbatimit të rekomandimeve*.

- Në 5 raste (DRSSH Gjirokastrë, DRSSH Durrës, DRSSH Lezhë, DRSSH Tropoje, DRSSH Kukës, DRSSH Vlorë dhe DSSH Sarandë) mungojnë në dosje formatet standart si: Autorizimi për fillim angazhimi, njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit. Plan-veprimi për masat e marra për realizimin e rekomandimeve i miratuar nga titullari i subjektit të audituar i përcjellë me shkresë pranë ISSH.

Procedurat e ndjekura: Në takimin fillestar janë prezantuar objektivat e përgjithshme, sistemet/proceset të cilat do të auditohen, prezantim i shkurtër i procesit të auditimit, grupi i auditimit dhe kohëzgjatja e misionit si dhe përcaktimi i informacionit që kërkohet nga grupi i auditimit. Në takimin përmbyllës janë diskutuar çështjet/gjetjet e rëndësishme nga auditimi. Të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

dy këto takime janë të dokumentuara dhe janë pjesë e secilës dosje. Nga dosjet e shqyrtuara për vlerësim u evidentua se çdo grup auditimi ka grumbulluar informacionin e nevojshëm, të mjaftueshëm, të besueshëm, për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit kanë analizuar të gjithë informacionin e grumbulluar nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit gjenden të administruara letrat e punës dhe evidencat e përshtatshme, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar. Në përfundim të procedurave të auditimit çdo grup auditimi, ka bërë sistemin, klasifikimin dhe mbylljen e dokumenteve në dosjen e auditimit dhe arkivimin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore. Procesi i sigurimit të cilësisë, është i dokumentuar dhe është kryer vetëm nga përgjegjësi i grupit dhe jo nga Drejtori i DAB, duke hartuar raportin përkatës të kontrollit të cilësisë.

Për vitin 2020 nga auditimi i 6 dosjeve të angazhimeve të auditimit (DRSSH Durrës, DRSSH Fier, DRSSH Dibër, DRSSH Korçë, DRSSH Vlorë DRSSH Sarandë DRSSH Shkodër dhe DRSSH Tiranë) rezultoi se:

Raportet e auditimit për vitin 2020 duke filluar nga data 1 shtator janë hartuar të strukturuar sipas ndryshimeve të manualit të A.B bërë me urdher të MFE nr.4 date 10.01.2020.

Për çdo dosje janë hartuar dhe inventarizuar këto dokumente: 1. Autorizim për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit. 2. Njoftim paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit. 5. Program i angazhimit të auditimit. 3. Ndarja e detyrave. 6. Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit. 7. Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesit dhe dokumentet që merren nga palët e treta në lidhje me auditimin e brendshëm si ajo për reagimin mbi misionin e auditimit (feedback), por në të gjitha rastet rezultoi e paplotësuar. 9. Projekt raporti i auditimit të brendshëm me shkresën përcjellëse. 10. Raporti përfundimtar i auditimit të brendshëm sipas formatit tip. 11. Plani i veprimit i sugjeruar nga grupi i auditimit për zbatimin e rekomandimeve subjektit të audituar. 12. Memo dërguar Drejtorit të përgjithshëm të ISSH nga grupi i auditimit për informim me përmbledhjen e raportit të auditimit sëbashku me opinionin.

Në këto dosje u konstatuan këto mangësi:

1. Në 7 raste nuk janë respektuar afatet ligjore të fazave të procesit të auditimit, nga këto:

- Në 3 raste (DRSSH Tirane, DRSSH Diber, DRSSH Korce) nuk është respektuar afati ditor (10 dite pune) i përcjelljes së projekt raportit njësisë së audituar pas përfundimit të angazhimit të auditimit veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikes 4.1.12 të Kapitullit IV të manualit të A.B.

- Në 4 raste (DRSSH Fier, DRSSH Shkodër, DRSSH Vlorë, DRSSH Korce) është respektuar afati ditor (7 dite pune) i përcjelljes të raportit përfundimtar njësisë së audituar pas marrjes së observacioneve, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikes 4.1.12 të Kapitullit IV të manualit të A.B. Më konkretisht rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI	Programi i auditit		Periudha e auditimit	Projekt raporti		Konfirmimi i Projekt raportit		Raporti Final		
		NR	DATE		NR	DATE	NR	DATE	NR	DATE	
1	DRSSH TIRANE	8114	05.12.2019	09.12.2019-10.01.2020.	8114	29.01.2020	888/1	11.02.2020	8114/3	20.02.2020	Dërgimi i Projekt Raportit 7 ditë pune në tejkallim të afatit
2	DRSSH FIER	1096	17.02.2020	24.02.2020-20.03.2020	1096/2	15.06.2020	1907/3	25.06.2020	1096/4	16.07.2020	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 8 ditë pune në tejkallim të afatit ligjor
3	DRSSH DIBER	3309	11.06.2020	15.06.2020-10.07.2020	3309/1	29.07.2020	4248	10.08.2020	3309/3	27.08.2020	Dërgimi i Projekt Raportit 5 ditë pune në tejkallim të afatit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

4	DRSSH KORCE	4073	15.07.2020	20.07.2020-14.08.2020	4073/1	03.09.2020	7663	14.09.2020	4073/3	01.10.2020	Dërgimi i Projekt Raportit 3 ditë pune në tejkalim të afatit Dërgimi i Projekt dhe dërgimi i Raportit Përfundimtar 7 ditë pune në tejkalim të afatit
5	DRSSH SHKODER	5156	02.09.2020	03.09.2020-25.09.2020	5156/1	08.10.2020	4611/3	19.10.2020	5156/3	09.11.2020	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 9 ditë pune në tejkalim të afatit
6	DRSSH VLORE	5907	01.10.2020	05.10.2020-30.10.2020	5907/1	09.11.2020	11975/1	19.11.2020	5907/4	09.12.2020	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 8 ditë pune në tejkalim të afatit

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të vëna në dispozicion rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” të ndryshuar me Urdhrin e Ministrisë MFE nr.4 datë 10.01.2020, kapitulli IV pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi auditimi”; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 4.1.12. Hapi 11: Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm” pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”. Kështu:

- Në të gjitha dosjet e auditimit **mungon Memo e planifikimit**, pra projekt-drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit.
- Mungon vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NjAB, i cili kryhet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik.
- Dokumenti takimit të takimit fillestar me njësinë që do të auditohet dhe dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës.
- Mungon plan-veprimi për masat e marra për realizimin e rekomandimeve të miratuar nga titullari i subjektit të audituar i përcjellë me shkresë pranë ISSH. Ndërsa ekziston Plan-veprimi i dakortësuar për realizimin e rekomandimeve të hartuar nga grupi i auditimit, por mungon firma e subjektit të audituar.
- Në dosjet nuk ka informacion nga subjektet e audituara për shkallën e realizimit të rekomandimeve në fund të afateve të përcaktuara për realizim të tyre.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku gjetjet dhe rekomandimet më kryesore nga auditimet lidhen kryesisht me:

- organizmin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- zbatimin e Marrëveshjes me Postën Shqiptare sh.a;
- zbatimin e Kodit të Punës;
- rregullshmërinë e pagesave të përfitimeve të shpenzimeve të varrimit dhe diferencave të pensione;
- rregullshmërinë e caktimit dhe pagesave për përfitimet afatshkurtra.

Për vitin 2019 në raportet e auditimit janë evidentuar 234 gjetje, prej të cilave, 25 gjetje i përkasin sistemit të pagesave të raporteve dhe shpërblimve të barrëindjeve dhe 209 gjetje janë klasifikuar në grupin të tjera, nga ku gjetje me shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

rezultojnë në shumën 272,200 lekë. Si rezultat i një administrimi më të mirë për vitin 2019 numri i gjetjeve është përgjysmuar në krahasim me gjetjet e një viti më parë.

Në përfundim të auditimeve nga 234 gjetje të evidentuara janë dhënë 220 rekomandime, nga të cilat 5 rekomandime për përmirësime të sistemeve të programeve, 204 rekomandime me karakter organizativ, 7 rekomandime për masa zhdëmtimi dhe 4 rekomandime të tjera. Të 220 rekomandimet e dhëna rezultojnë të pranuar nga menaxhimi.

Nga 220 rekomandime të lëna dhe të pranuar, rezultojnë të realizuara plotësisht 192 rekomandime ose 87% e rekomandimeve gjithsej dhe në proces 28 rekomandime ose 13% e rekomandimeve. Rekomandimet për masa zhdëmtimi rezultojnë të realizuara në masën 100%, ndërsa 28 rekomandimet në proces i përkasin masave organizative dhe përmirësimit të sistemeve (kane të bëjnë me hartimin, përmirësimin rregullor të proceseve të punës, të lëvisjes së dokumentacioneve, përmirësim programe pagesash kryesisht për pagesat e perfitimeve afashkurtera). Si afat për realizimin e një pjese të rekomandimeve është përcaktuar viti 2020 dhe për të tjerat afati është përcaktuar në vijimësi. Nga auditimi rezulton se jo për të gjitha gjetjet janë lënë rekomandime.

Për vitin 2020 Nga auditimet të evaduar janë konstatuar 171 gjetje dhe janë dhënë 171 rekomandime, nga të cilat 4 rekomandime për përmirësime të sistemeve të programeve, 138 rekomandime me karakter organizativ, 7 rekomandime për arkëtim në vlerën 190,240 lekë, dhe 22 rekomandime të tjera.

Nga 171 rekomandime të dhëna gjatë vitit janë pranuar në masën 100% nga subjektet e audituara, zbatuar 95.3% e tyre dhe janë në proces zbatimi 4.7 % pasi janë lënë afate për realizim në vitin 2020. Pra 8 rekomandime të pa zbatuara deri në fund të vitit 2020 janë lënë për tu zbatuar në vitin 2021 nga këto ; -5 rekomandime për tu realizuar me afat të përcaktuar në vitin 2021. -3 rekomandime janë me karakter organizativ, ku kanë të bëjnë me hartimin, përmirësimin rregullor të proceseve të punës, të lëvisjes së dokumentacioneve, përmirësim programe pagesash kryesisht për pagesat e perfitimeve afashkurtera) Këto rekomandime janë të njëjta për disa drejtori, dhe janë lënë me afat në vijimësi pasi kërkojnë rakordimin me Drejtoritë në Qëndër (në ISSH).

Ndjekja e zbatimit i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të AB. NJAB u ka dërguar shkresa njëjse të audituara për informuar mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.

Njesia e Auditimit të Brendshëm është audituar nga Drejtoria e Harmonizimit të A.B në MFE në vitin 2019 për aktivitetin e kësaj njësie për vitin 2018 duke bërë vlerësimin e jashtëm të kësaj njësie. Mbështetur në shkresën nr.15961/1, datë 06.09.2019 “Program për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së njësisë së auditimit të brendshëm në I.S.SH” opinion I dhënë nga Drejtoria e Harmonizimit të A.B në M.F.E për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së veprimtarisë audituese të D.A.B. në ISSH për Vitin 2018 është :

Vlerësimi i Standarteve kryesore	
Standarti 1100 Pavarësia dhe objektiviteti	e gjelbër, përputhje e plotë me standardin;
Standarti 1200 Aftësia dhe kujdesi i duhur profesional	e verdhë, përputhje e pjesshme me standardin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
Standarti 2000 Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm	e verdhë, përputhje e pjesshme me standardin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
Standarti 2200 Planifikimi i angazhimit	portokalli, përputhje me standardin por në disa fusha kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme);
Standarti 2300 Kryerja e angazhimit	e gjelbër, përputhje e plotë me standardin;
Vlerësimi Standarteve dytësore	
Standarti 1000 Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia	e gjelbër, përputhje e plotë me standardin;
Standarti 1300 Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit	e kuqe, mospërputhje e plotë me standardin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Standarti 2100 Natyra e Punës	e verdhë, përputhje e pjesshme me standartin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
Standarti 2400 Komunikimi i rezultateve	e verdhë, përputhje e pjesshme me standartin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
Standarti 2500 Monitorimi i progresit	e verdhë, përputhje e pjesshme me standartin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
Standarti 2600 Komunikimi i pranimi të riskut	e kuqe, mospërputhje e plotë me standartin.
Vlerësimi final	e verdhë, përputhje e pjesshme me standartin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;

Drejtorja e AB ka reflektuar dhe përmirësuar praktikën audituese nga rekomandimet e dhëna nga NJQHAB nga muaji nëntor 2019, këtë fakt e konfirmon dhe plan veprimi i këtij auditimi dhe komunikimi me këtë njesi qëndrore.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatim nr. 9, datë 27.04.2021.

Gjetja

Pasaktësi në përcaktimet e Rregullores së Brendshme të Institucionit në lidhje me statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat dhe përgjegjësitë si për drejtuesin e njësisë dhe audituesit e brendshëm, si dhe mosrespektim i afateve në hartimin e dokumenteve të auditimit.

Situata

Nga auditimi i veprimtarisë së DAB është konstatuar se: Në Rregulloren e Brendshme të ISSH konstatohet se nuk janë përcaktuar:

-Statusi organizativ i kësaj strukture, (pavarësia funksionale e organizative, siç është përcaktuar në Kartën e Auditimit të Brendshëm).

-Kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, për a) përgjegjësitë e drejtuesit e njësisë së auditimit të brendshëm, përcaktuar në nenin 14 të Ligjit 114, datë 22.10.2015”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikën 2.6.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe b) të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm, përcaktuar në nenin 15 dhe 16 të Ligjit 114, datë 22.10.2015”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikën 2.6.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

-Nuk përjashton stafin e auditimit të brendshëm nga aktivitetet operacionale, duke u shprehur në mënyrë specifike tek përshkrimi i punës së Drejtorit të Drejtorisë, në rubrikën “Marrja e vendimit”:

“... nis dhe përgatit në bashkëpunim me Drejtoritë e ISSH, ligje, nënligje, udhëzime dhe rregullore për përmirësimin e veprimtarisë së ISSH bazuar në raportet e auditimit”, detyrë kjo në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të Ligjit 114/2015, në të cilin shprehimisht citohet:

“Audituesve të brendshëm u ndalohet të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese”.

Njësia e auditimit të brendshëm, në përmbushje të përgjegjësisë së veta, nuk autorizohet të hartojë dhe të vendosë procedura, të nxjerrë urdhëra, udhëzime, të përgatisë dokumente dhe informacione, ose të përfshihet në veprimtari që normalisht do të auditohen, por nëpërmjet rekomandimeve ndihmon titullarin e njësisë publike për të përmirësuar veprimtarinë dhe sistemet e kontroleve të brendshme.

- Drejtori i NJAB ngarkohet me detyrë t’i propozojë Drejtori i Përgjithshëm argumenta për masat disiplinore ndërmarrë ndaj nëpunësve në rast të mos respektimit të rregullave organizative të brendshme në përputhje me Rregulloren e Brendshme....., detyrë kjo në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16, të Ligjit nr.114/2015, i cili nuk i jep të drejtë dhe kompetencë audituesve për dhënien e masave disiplinore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Kriteret e diplomës, të përvojës së punës në profesion dhe në fushën e auditimit të brendshmëm si për Drejtuesin e NjAB ashtu edhe për Specialistët janë vendosur në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 të Ligjit nr.114/2015.***Ka gjetur zbatim standardi 1000- qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, por ka nevojë për përmirësim të Rregullores lidhur me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm.***

- Nuk janë përcaktuar qartë linjat e komunikimit dhe raportimi, në disa drejtime, ndërmjet DAB, Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Bordit të Drejtorëve, Këshillit Administrativ, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi rezulton se nga ana e DAB është përgatitur relacioni për përditësimin e Rregullores në të cilin janë evidentuar çështjet që duhet ti shtohen Rregullores lidhur me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm, por deri në datën e mbajtjes së këtij akt konstatimi ndryshimet në rregullore ende nuk janë miratuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në 8 dosjet e përzgjedhura u vlerësua e konstatua se ana e audituesve është treguar kujdesi i duhur profesional për respektimin e të gjitha fazave të procesit të auditimit, por jo në të gjitha rastet janë respektuar afatet përkatëse të tyre, konform përcaktimeve të Manualit të AB, si vijon:

-Nuk është respektuar afati ditor (10 ditë pune) i përcjelljes së projekt raportit njësisë së audituar pas përfundimit të angazhimit të auditimit (dosjet e vlerësuara: për vitin 2019 DRSSH Lezhë auditim financiar +përputhshmëri DRSSH Elbasan dhe për vitin 2020 DRSSH Tirane, Diber, Korce), veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 4.1.12 të Kapitullit IV të MAB.

-Nuk është respektuar afati ditor (7 ditë pune) i dërgimit të raportit përfundimtar njësisë së audituar pas marrjes së observacioneve (dosjet e vlerësuara: për vitin 2019 DRSSH Durrës, Vlorë, DSSH Sarandë, DRSSH Kukës, DSSH Tropojë, DRSSH Lezhë (Financiar) dhe DRSSH Elbasan

-Raportet nuk janë të strukturuar mire, ato paraqiten pa dhe për vitin 2020 DRSSH Fier, Shkodër, Vlorë, Korce), veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 4.1.12 të Kapitullit IV të MAB. Ka gjetur zbatim standardi 2200-Planifikimi i angazhimit, por ka nevojë për përmirësim në drejtim të respektimit të afateve të hartimit të dokumenteve të auditimit, përkatësisht projekt raportit dhe raportit përfundimtar të auditimit sipas kërkesave të MAB.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të Raporteve, evidenton dhe konstaton se:

-Raportet nuk kanë strukturën formale sipas përcaktimeve në pikën 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i planveprimit nga njësia e audituar” të MAB;

hyrje, pa përmbledhje ekzekutive;

-Nuk ka një ndarje të drejtimeve të auditimit gjatë shkrimit të raporteve;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Nuk ka një përcaktim të faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kriterëve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët);
- Raportet nuk janë konçize, ka përsëkrime të gjata, të tepërta, të detajuara, të pa nevojshme dhe të parëndësishme që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinionit apo vlerësimi përfundimtar.
- Raportet nuk reflektojnë lidhjen organike gjetje-konkluzion-rekomandim;
- Jo të gjitha gjetjet janë shoqëruar me rekomandim;
- Rekomandimet e lëna kanë përcaktuar afatin e zbatimit të tyre por jo nivelin e rëndësisë së tyre (I lartë, I mesëm dhe I lartë).

Referuar kuadrit rregullator në fuqi, janë konstatuar parregullsi në përcaktimin e afateve dhe detyrimeve ndaj subjektit të audituar, konkretisht:

-Në shkresat përcjellëse të Projekt Raporteve subjekteve të audituara DAB është shprehur :...*Më pas materiali të nënshkruhet prej tyre brenda 5 ditëve, duke zbatuar afatet e përcaktuara në Ligjin nr.114, datë 22/10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*. Referenca e përcaktimit të afatit dhe koha e tij është paraqitur gabim nga DAB, pasi në bazë të kërkesave të Kapitullit IV, pika 4.1.12 të Manualit të AB, subjekti i audituar duhet të konfirmojë gjetjet e projektraportit dhe rekomandimet, brenda afatit 10 ditor (ditë pune) nga marrja e projektit;

- Në shkresat përcjellëse të Raporteve Finale subjekteve të audituara DAB është shprehur:...*Më pas nga ana e titullarit, të bëhet konfirmimi i raportit dhe miratimi i plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Afati i konfirmimit të raportit 15 ditë nga dita e marrjes së njoftimit. Afati i evadimit të raportit të auditimit 30 ditë*. Referenca e përsëkrimit të detyrimeve të palës së audituar dhe afatet kohore janë përcaktuar gabim nga DAB, pasi subjekti i audituar nuk ka detyrim ligjor për konfirmim të Raportit Final. Mbështetur në shkronjën “d”, të nenit 12, të ligjit nr.114, datë 22/10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, *subjekti i audituar duhet të hartojë dhe të dërgojë në DAB, Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të miratuar, brenda periudhës 30 ditore nga marrja e Raportit si dhe raportimin në mënyrë periodike, jo më vonë se 10 ditë nga plotësimi i afateve të zbatimit të rekomandimeve*.

Kriteri

Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

Manuali i Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndyshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020,;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Ndikimi/Efekti

Cënimi i objektivitetit, kompetencës dhe paanësisë së audituesve.

Rëndësia

I Lartë

Rekomandimi 1

ISSH të marrë masa për të finalizuar procesin e rishikimit të përmbajtjes së Rregullores së brendshme të funksionimit të saj, në lidhje me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm si për drejtuesin e njësisë dhe audituesit e brendshëm, si dhe mos përfshirjen e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

DAB në veprimtari operationale me qëllim mos cënimin e objektivitetit, kompetencën dhe paanësinë e audituesve.

Rekomandimi 2 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të respektojë dhe ti përmbahet kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në drejtim të respektimit të afateve të hartimit të dokumenteve të auditimit, përkatësisht projekt raportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.

B.6. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë e shërbime, si dhe ankande të realizuara nga entiteti. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përlogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave për mallra, punë e shërbime. Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimeve publike dhe zbatimi i kontratave. Auditim i blerjeve të vogla dhe shpenzimeve të natyrës operative.

Në zbatim të pikës (6) të programit të auditimit “Nr. 95/1 datë 29/01/2021”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri realizimeve dhe parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019 dhe 2020.
2. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
3. Aksesimi në sistemin e prokurimeve publike në faqen e APP (<http://ëëë.app.gov.al/>).
4. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.

ISSH për vitet 2019-2020, në cilësinë e autoritetit kontraktor, në bazë të kërkesave për punë, mall dhe shërbime çdo fillim viti kalendarik ka miratuar buxhetin e saj, si dhe ka hartuar regjistrimin e parashikimit të prokurimit publik dhe e ka dërguar atë pranë Agjensisë së Prokurimit Publik në përputhje me kërkesat që përcakton neni 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Për periudhën objekt auditimi 2019-2020, sipas regjistrave të dërguara me shkresë nga ISSH, janë parashikuar të realizohen 37 procedura blerje me vlerë të vogël me fond limit 14,397,000 lekë pa TVSH dhe janë realizuar 30 procedura blerje me vlerë të vogël në shumën 10,415,027 lekë sipas vlerës së kontratës, si vijon:

- Për vitin 2019, sipas regjistrit të parashikimeve miratuar me shkresën nr. 247 prot, datë 10.01.2019, janë parashikuar të realizohen 19 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 6,167,000 lekë pa TVSH. Sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve miratuar me shkresën nr. 247/1 prot, datë 23.01.2019, janë realizuar 19 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në shumën 6,305,866 lekë sipas vlerës së kontratës.

Gjithashtu janë parashikuar të realizohen 5 procedura prokurimi me vlerë mbi 800,000 lekë, me fond limit 12,375,000 lekë pa TVSH dhe është realizuar vetëm një procedurë në shumën 2,000,000 lekë sipas vlerës së kontratës.

- Për vitin 2020, sipas regjistrit të parashikimeve miratuar me shkresën nr. 8542 prot, datë 26.12.2019, janë parashikuar të realizohen 18 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 8,230,000 lekë pa TVSH. Sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve miratuar me shkresën nr. 247/1 prot, datë 23.01.2019, janë realizuar 11 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në shumën 4,109,161 lekë pa TVSH.

Gjithashtu janë parashikuar të realizohen 4 procedura prokurimi me vlerë mbi 800,000 lekë, me fond limit 13,991,666 lekë pa TVSH dhe është realizuar vetëm një procedurë në shumën 7,736,220 lekë sipas vlerës së kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Ndërkohë nga publikimi i bërë në APP i regjistrave përfundimtar të parashikimit dhe realizimit, për vitet respektive, rezulton se për periudhën objekt auditimi 2019-2020, janë parashikuar të realizohen 52 procedura prokurimi me fond limit 44,113,256 lekë pa TVSH, përkatësisht për vitin 2019 janë parashikuar 29 procedura në shumën 20,482,990 lekë pa TVSH dhe për vitin 2020 janë parashikuar 23 procedura në shumën 23,630,266 lekë pa TVSH.

Nga regjistri i realizimeve rezulton se për vitet 2019-2020, janë realizuar 35 procedura prokurimi me vlerë të kontratës 20,283,174 lekë pa TVSH, nga të cilat 21 procedura për vitin 2019 me vlerë të kontratës 8,243,793 pa TVSH dhe 14 procedura për vitin 2019 me vlerë të kontratës 12,039,381 lekë pa TVSH.

Nga këto rezulton se për periudhën objekt auditimi 2019-2020, janë parashikuar të realizohen 45 procedura blerje me vlerë të vogël me fond limit 20,096,266 lekë pa TVSH, përkatësisht për vitin 2019 janë parashikuar 25 procedura me vlerë të vogël në shumën 9,357,990 lekë pa TVSH dhe për vitin 2020 janë parashikuar 20 procedura me vlerë të vogël në shumën 10,738,600 lekë pa TVSH.

Nga këto janë realizuar 33 procedura në shumën 10,546,954 lekë pa TVSH sipas vlerës së kontratës, përkatësisht 20 procedura për vitin 2019 në shumën 6,243,793 lekë dhe 13 procedura për vitin 2020 me vlerë 4,303,161 lekë pa TVSH.

Mos realizimi i procedurave parashikuara tregon një planifikim jo të mirë midis të ardhurave që krijon institucioni apo pritshmërive që ajo ka për nevojat reale për punë, mallra e shërbime. Gjatë auditimit u kontrolluan procedura prokurimi më përzgjedhje rastësore dhe përzgjedhje mbi bazë risku ato procedura që kanë riskun më të lartë dhe përgjithësisht me vlera më të larta, konkretisht për vitin 2019 janë audituar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe procedura “Bileta - Avioni 2019” që përfshin në vetevete 7 procedura prokurimi me vlerë të vogël, ndërkohë që për vitin 2020 janë audituar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël, pra në total janë audituar 25 procedura prokurimi, apo 76 % e totalit të realizuar.

I- Nga u auditimi i procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogla u konstatua si më poshtë:

- Me Urdhër të titullarit të ISSH nr. 486 prot, datë 21.01.2019, është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël për vitin 2019, i përbërë nga z. Emil Pulla Kryetar, znj. Nevila Celiku anëtar dhe z. Besmir Durdia anëtar.

- Me Urdhër të titullarit të ISSH nr. 619 prot, datë 27.01.2020, është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël për vitin 2020, i përbërë nga z. Emil Pulla Kryetar, znj. Nevila Celiku anëtar dhe z. Besmir Durdia anëtar.

- Me Urdhër të titullarit të ISSH nr. 180 prot, datë 09.01.2020, është ngritur Komisioni i pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019, i përbërë nga z. Oljan Allka Kryetar, z. Klevis Përleka anëtar dhe znj. Alketa Shima anëtar.

- Me Urdhër të titullarit të ISSH nr. 619/1 prot, datë 09.01.2020, është ngritur Komisioni i pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2020, i përbërë nga zj. Mimoza Zeqaj Kryetar, z. Klevis Përleka anëtar dhe znj. Rozeta Parapani anëtar.

Viti 2019

1) Procedura: Furnizimi i dispenserave me ujë të pishëm për ISSH-në, u konstatua:

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Informacion datë 22.01.2019, për furnizimin me ujë të pishëm dhe nevojat për vitin 2019. Me datë 23.01.2019 është mbajtur procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit. Përlllogaritja e fondit limit në vlerën 195,840 lekë është bazuar në kontratën e një viti më parë 2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Me shkresën nr. 545 prot, datë 24.01.2019, nënshkruar nga titullari është bërë miratimi i shtesës së fondit dhe ndryshimi në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 2019, ndërkohë që regjistri i parashikimeve është miratuar me nr. 247 prot, datë 10.01.2019, pra nevojitet një bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet sektorëve në mënyrë që regjistri i parashikimeve të prokurimeve të jetë i bazuar në nevojat reale të autoritetit kontraktor.
- Me shkresën nr. 575 prot, datë 24.01.2019 është miratuar nga titullari kërkesa për furnizimin me ujë të pishëm, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit Erlin Shyti.
- Në Ftesën për Ofertë datë 29.01.2019, përcaktohet se: *“Operatori ekonomik i renditur i pari, para se të shpallet fitues duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentat si më poshtë: - Licencë profesionale për perpunim dhe ambalazhim të ujit; - Fletë analizë bakteriologjike nga organet kompetente shtetëror të muajit të fundit; - Çertifikatë cilësie për aparatet e ujit, bidonat dhe tapat; - Miratim të etiketës së ujit nga AKU. Për dokumentat e mësipërme në rastin kur operatori është distributor të paraqitet kontrata me prodhuesin (e vlefshme).*
- Sa sipër rezulton se dokumentet e paraqitura Autorizim, Licensë, Raport Analizë dhe certifikatat e cilësisë janë fotokopje.
- Operatori ekonomik i shpallur fitues Muhamet Lako me oferte 192,000 lekë pa TVSH, është distributor i autorizuar nga kompania “Blu Imperial” Sh.p.k. Autorizimi i paraqitur është fotokopje dhe nuk ka asnjë përcaktim në lidhje periudhën e vlefshmërisë.
- Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, fituesi është shpallur me datë 30.01.2019, ndërkohë që fletë analiza bakteriologjike mban datën 20.02.2019, pra pas lidhjes së kontratës në kundërshtim me përcaktimet e bera në Ftesën për Ofertë datë 29.01.2019, ku citohet *“Fletë analiza bakteriologjike nga organet kompetente shtetërore të muajit të fundit”*.
- Nuk administrohet miratimi etiketës së ujit nga AKU, certifikata e cilësisë është në gjuhë të huaj dhe nuk është përkthyer në gjuhën shqip në të cilën është zhvilluar procedura e prokurimit. Për mangësit e cituara më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit
- Në dosje nuk administrohet procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit dhe plotësimin e specifikimeve teknike. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i pranimit të artikujve të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

2) Procedura: Mirëmbajtje e faqes zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
- Me shkresën nr. 694 prot, datë 29.01.2019, drejtuar Njesisë së Prokurimeve, nënshkruar nga Drejtori i Marrëdhënieve me publikun z. A B, është bërë kërkesa për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH. Me urdhër nr. 694/1 prot, datë 30.01.2019, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e fondit limit të përbërë nga z. E D kryetar, znj. R Daka anëtar dhe z. K P anëtar. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 694/2, datë 01.02.2019.
- Procesverbal datë 01.02.2019, për llogaritjen e fondit limit bazuar në tre oferta të marra nga tregu.
- Me procesverbalin nr. 1, datë 06.02.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik F është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.
- Me procesverbalin nr. 2, datë 07.02.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik J G është renditur i dyti, por pas njoftimit paraqiti njoftim për tërheqje nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

gara për arsye pamjaftueshmërie të burimeve njerëzore. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 3, datë 08.02.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik X S është renditur i tretë, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 4, datë 13.02.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik “K” është renditur i katërti, është paraqitur duke dorëzuar dokumentacionin që plotëson kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me nr. 694/3, datë 13.02.2019, me vlerë 297,000 lekë pa Tvsh, ose 356,400 lekë me Tvsh.

Procesverbali për marrjen në dorëzim datë 06.06.2020, është nënshkruar nga znj. M Z, me detyrë Specialiste e Marrëdhënieve me publikun, sipas përcaktimit të bërë në kontratë. Duke parë natyrën e shërbimit të ofruar, ISSH duhet të kishte caktuar Grup për marrjen në dorëzim , në përbërje të të cilit të kishte specialistë me njohuri informatike.

3) Procedura: Materiale publicitare të sigurimit të vetpunësuarve në bujqësi

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 5528 prot, datë 37.01.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për materiale publicitare. Me procesverbal datë 31.07.2019, është bërë përlllogaritja e fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 5528/1, datë 31.07.2019,

- Në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik me datë 31.07.2019 nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik fitues. Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Me procesverbal nr. 1, datë 05.08.2019, është shpallur fitues operatori ekonomik Dh K me ofertë 77,777 lekë pa TVSH.

4) Procedura: Materiale publicitare të sigurimit të vullnetar

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 35 prot, datë 04.09.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për materiale publicitare. Me procesverbal datë 09.09.2019, është bërë përlllogaritja e fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, në vlerën 150,000 lekë pa TVSH. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 35/1, datë 17.09.2019.

- Në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik me datë 17.09.2019 nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik fitues. Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 20.09.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik T është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 23.09.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik C P është renditur i dyti, është paraqitur. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me vlerë 102,916 lekë pa Tvsh.

- Me procesverbal datë 05.10.2019 i janë dorëzuar në ISSH, operatorit ekonomik fitues, modele të fletë palosjeve dhe posterave sipas përcaktimeve të bëra në ofertë.

Fatura tatimore me nr. 260, datë 07.10.2019 është firmosur vetëm nga 2 anëtarë të Njesisë së Prokurimit.

5) Procedura: Raport vjetor 2018

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 3761 prot, datë 21.05.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/ Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për botimin e Raportit Vjetor 2018 dhe Libri i Statistikave 2018. Me procesverbal datë 23.05.2019, është bërë përllogaritja e fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, në vlerën 190,000 lekë pa TVSH. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 4287, datë 11.06.2019.

Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Nga raporti i gjeneruar nga sistemi elektronik, operatori ekonomik K.KH me ofertë 188,000 leke pa TVSH është oferta me vlerë më të ulët dhe për pasojë është shpallur fituese. Në dosje nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël për këtë fazë të procedurës së prokurimit si dhe për shpalljen e fituesit.

Fatura tatimore nr. 283, datë 09.07.2019, është nënshkruar nga znj. VL me detyrë magazinierë dhe jo nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

6) Procedura: Sigurimi Kasko i Automjeteve dhe TPL viti 2019

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 427 prot, datë 18.01.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/ Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për Sigurimi Kasko i Automjeteve dhe TPL viti 2019. Me procesverbal datë 18.01.2019, është bërë përllogaritja e fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, në vlerën 600,000 lekë pa TVSH. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 427/1, datë 21.01.2019.

- Nga raporti i gjeneruar nga sistemi elektronik, operatori ekonomik I V I Group me ofertë 598,958 lekë pa TVSH është oferta me vlerë më të ulët dhe oferta e vetme e paraqitur dhe për pasojë është shpallur fituese. Në dosje nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël për këtë fazë të procedurës së prokurimit si dhe për shpalljen e fituesit.

7) Procedura: Blerje Kancelarie për ISSH

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 3950 prot, datë 28.05.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për artikuj kancelarie. Me procesverbal datë 03.06.2019, është bërë përllogaritja e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, në vlerën 450,000 lekë pa TVSH. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 3950/2, datë 17.06.2019.

- Në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik me datë 17.06.2019, nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të plotësojë dhe dorëzojë operatori ekonomik fitues. Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 21.06.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik S T është renditur i pari, por pas njoftimit ka dorëzuar deklaratën për tërheqjen nga procedura e prokurimit për shkak përlllogaritjes gabim të çmimeve, por njoftimi nuk administrohet në rrugë elektronik printuar nga sistemi E-Prokurime. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 24.06.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik I S O është renditur i dyti, është paraqitur duke dorëzuar dhe një monstër për çdo artikull të kërkuar. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me vlerë 231,000 lekë pa Tvsh.

8) Procedura: Rinovimi i licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 5376 prot, datë 23.07.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për rinovimin e licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019.

- Me Urdhër nr. 5376/1 prot, datë 23.07.2019, është ngritur Komisioni për hartimin e termave të referencës, kapacitetin teknik dhe fondin limit. Sipas procesverbalit datë 23.07.2019, janë hartuar specifikimet teknike, kapaciteti teknik dhe dokumentacioni që duhet të plotësojë operatori ekonomik fitues, si dhe janë marrë tre oferta nga tregu për hartimin e fondit limit. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 5376/3, datë 05.08.2019.

- Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Sipas të dhënave nga sistemi E-Prokurime.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 08.08.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik J G është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesë për tërheqjen nga procedura e prokurimit. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 09.08.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik K N është renditur i dyti, është paraqitur duke dorëzuar dhe një monstër për çdo artikull të kërkuar. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me vlerë 231,000 lekë pa Tvsh.

- Me procesverbal datë 09.08.2019 është bërë aktivizimi i licensës për 1100 përdorues dhe të gjitha moduleve të programit për një periudhë një vjeçare, nënshkruar nga znj. R D, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Bazës së të Dhënave dhe z. E D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Administrimit.

- Në dosjen e prokurimit nuk administrohet deklarata për sigurimin e vazhdimësisë pa ndërprerje dhe pa ndërhyrje nga ana e institucionit për ndërfaqen e menaxhimit dhe përditësimit të licensave të Mail Serverit si dhe deklarata për sigurimin e vazhdimësisë pa ndërprerje dhe pa ndërhyrje nga ana e institucionit për sigurinë e sistemit (SSL) në kundërshtim me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përcaktimet e bëra në ftesën për ofertë në lidhje me plotësimin e kriterëve nga operatori ekonomik fitues. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

9) Procedura: Rinovimi i licensës së programit të antivirusit

Me shkresën nr. 6605 prot., datë 26.09.2019 është miratuar nga titullari kërkesa për rinovimin e licensës së programit të antivirusit hartuar nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit E D. Me urdhër nr. 6605/1 prot, datë 02.10.2019, është ngritur komisioni për hartimin e termave të referencës. Me procesverbal datë 03.01.2019 janë hartuar specifikimet teknike dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues.

- Në hartimin e specifikimeve teknike nuk është parashikuar si kusht deklarata nga operatori ekonomik fitues për garantimin e sigurisë së sistemit, të dhënave të administruara si dhe vazhdimin e punës pa ndërprerje.

- Me procesverbal datë 03.10.2019 është përcaktuar fondi limit me vlerë 420,000 lekë pa TVSH, bazuar në kontratën e viteve të mëparshme. Urdhër prokurimi nr. 6605/2, datë 03.10.2019. Data e zhvillimit 07.10.2019.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 08.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik B V është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 09.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A M është renditur i dyti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 3, datë 10.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik R B është renditur i treti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 4, datë 11.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik “J G është renditur i katërti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH duke dërguar njoftimin e tërheqjes nga kjo procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e pestë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 5, datë 14.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik “F” shpk është renditur i pesti, i cili pas njoftimit është paraqitur pranë ambienteve të ISSH duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe mori përsipër realizimin e kësaj procedure. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me nr. 6605/3 prot., datë 14.10.2019, me vlerë 380,000 lekë pa TVSH, ose 456,000 lekë me TVSH.

10) Procedura: Procedura prokurimi Bileta –Avioni 2019

- Dosjet e procedurave janë inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

10.1- Blerje Bilete Avioni Tiranë-Londër-Tiranë

Urdhër nr. 2069 prot, datë 18.03.2019, për pjesëmarrjen në konferencën e kontributeve të caktuara në fushën e mbrojtjes shoqërore në Londër. Kërkesë për bilete avioni nr. 2069/1 prot, datë 19.04.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 2069/2, datë 19.04.2019. Data e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

zhvillimit 19.04.2019. Shpallur fitues operatori ekonomik A “D” V T Operator me ofertë me vlerë 134,700 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës së bashku me programin e konferencës, administruar nga ISSH me numër protokolli.

10.2- Blerje Bilet Avioni Tiranë-Bruksel-Tiranë

Urdhër nr. 1620 prot, datë 01.03.2019, për pjesëmarrjen në Takimin shpjegues për kapitullin 2 “Lëvizja e lirë e punonjësve”. Kërkesë për bilete avioni nr. 1620/1 prot, datë 04.03.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 1620/3, datë 05.03.2019. Shpallur fitues operatori ekonomik A A me ofertë me vlerë 96,472 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës, së bashku me programin e konferencës si dhe rezervimi i biletës sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.

10.3- Blerje Bilet Avioni Tiranë-Varshavë-Tiranë

Urdhër nr. 7898 prot, datë 22.11.2019, për pjesëmarrjen në Seminarin Teknik të Rrjetit European të ISSA-s mbi parashikimi e nevojave në zhvillim të një popullsie në plakje. Takimin shpjegues për kapitullin 2 “Lëvizja e lirë e punonjësve”. Kërkesë për bilet avioni nr. 7898/2 prot, datë 22.11.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 7898/3, datë 25.11.2019. Shpallur fitues operatori ekonomik A A me ofertë me vlerë 96,472 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 25.11.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik E T&T është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesë për tërheqjen nga procedura e prokurimit. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 25.11.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A & L T –B T Operator është renditur i dyti, është paraqitur duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me vlerë 168,880 lekë pa Tvsh. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e seminarit.

10.4- Blerje Bilete Avioni Tiranë-Bruksel-Tiranë

Urdhër nr. 2118 prot, datë 20.03.2019, për pjesëmarrjen në takimin shpjegues Screenings për kapitullin 19 në Bruksel në datat 3-5 Prill 2019. Kërkesë për bilet avioni nr. 2118/2 prot, datë 26.03.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 2118/3, datë 28.03.2019. Data e zhvillimit të procedurës 28.03.2019. Shpallur fitues operatori ekonomik A A me ofertë me vlerë 96,472 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës. Shpallur fitues operatori ekonomik A T T me ofertë me vlerë 155,625 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e seminarit së bashku me programin si dhe rezervimi i biletës sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.

10.5- Blerje Bilet Avioni Tiranë-Baku-Tiranë

Urdhër nr. 3375 prot, datë 07.05.2019, për pjesëmarrjen në Forumin Rajonal të Sigurimeve Shoqërore për Europën. Kërkesë për bilet avioni nr. 3375/2 prot, datë 09.05.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 3375/3, datë 09.05.2019. Data e zhvillimit të procedurës 09.05.2019. Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Shpallur fitues operatori ekonomik A D V T Operator me ofertë me vlerë 199,500 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e takimit sëbashku me programin si dhe rezervimi i biletës sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.

10.6- Blerje Bilet Avioni Tiranë-Sofje-Tiranë

Urdhër nr. 7274/1 prot, datë 24.10.2019, për pjesëmarrjen në bisedimet për marrëveshjen për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë. Kërkesë për bilet avioni nr. 7274/3 prot, datë 24.10.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 7274/4, datë 25.10.2019. Data e zhvillimit të procedurës 25.10.2019. Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 25.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik E T&T është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesë për tërheqjen nga procedura e prokurimit. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 25.10.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A T T është renditur i dyti, është paraqitur duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me vlerë 115,128 lekë pa Tvsh. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e seminarit.

10.7- Blerje Bilet Avioni Tiranë-Bruksel-Tiranë

Urdhër nr. 6898 prot, datë 09.10.2019, për pjesëmarrjen në Forumin Botëror të Sigurimeve Shoqërore. Kërkesë për bilet avioni nr. 6898/2 prot, datë 09.10.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 6898/3, datë 10.10.2019. Data e zhvillimit të procedurës 10.10.2019.

Shpallur fitues operatori ekonomik A T T me ofertë me vlerë 159,990 lekë pa TVSH. Në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e takimit sëbashku me programin si dhe rezervimi i biletës sipas përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë.

11) Procedura: “Blerje artikuj me logon e ISSH-së”

- Dosjet e procedurave janë inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Me shkresën nr. 7747 prot., datë 13.11.2019 është miratuar nga titullari kërkesa për realizimin e blerjes së artikujve të kancelarisë me logon e ISSH. Procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike, pa datë, nënshkruar nga personat kompetent.

- Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 15.11.2019, në vlerën 495,000 lekë pa TVSH mbështetur në çmimet e magazinës sipas kontratës së një viti më parë.

- Urdhër prokurimi nr. 7747/1, datë 19.11.2019, data e zhvillimit të procedurës 20.11.2020.

- Me procesverbalin nr. 1 datë 21.11.2019 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik J G është renditur i pari por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH duke dërguar njoftimin e tërheqjes nga kjo procedurë. Si rrjedhojë, komisioni në bazë të udhëzimit të APP nr. 3 datë 09.01.2018, ka vazhduar me njoftimin e operatori ekonomik O T shpk të renditur në vendin e dytë, i cili pas njoftimit është paraqitur pranë ambienteve të ISSH duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe mori përsipër realizimin e kësaj procedure, oferta me vlerë 460,000 lekë pa TVSH.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në dosje nuk administrohet procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit dhe plotësimin e specifikimeve teknike. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i pranimit të artikujve të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

12) Procedura: Upgrade i modulit softëare për regjistrimin e përfitimeve afatgjata, në bazë të datës së pagesës dhe përfitimeve që merren me prokurë.

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me shkresën nr. 1575/2 prot, datë 19.03.2019, nga Drejtoria e Burimeve Njerzore është bërë kërkesa për disa ndryshime në funksionimin e portalit të pagesave bazuar dhe në shkresën nr. 582 prot, datë 25.02.2019 të Postës Shqiptare SH.A.

- Me urdhër nr. 1575/3 prot, datë 21.03.2019 është ngritur Komisioni për hartimin e termave të referencës, kapacitetin teknik dhe fondin limit, përbërë nga zj. N H Kryetar, znj. R D anëtar dhe z. K P Anëtar.

- Me procesverbal datë 27.03.2019, janë hartuar specifikimet teknike.

- Me shkresën datë 27.03.2019, drejtuar Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit, në vlerën 780,000 lekë, bazuar në tre oferta të marra nga tregu, dhe nga këto ofertën me çmimin më të ulët.

- Urdhër prokurimi nr. 2455, datë 02.04.2019, data e zhvillimit të procedurës 04.04.2019. Është shpallur fitues operatori i vetëm i paraqitur Intech+, me ofertë me vlerë 760,000 lekë pa TVSH, lidhur kontrata me nr. 2455/2, datë 16.04.2019.

- Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve që duhet të plotësoj operatori ekonomik fitues nuk është përcaktuar dorëzimi i listëpagesave, me qëllim evidentimin e personave që janë në marrëdhënie pune me operatorin ekonomik dhe që plotësojnë kualifikimet profesionale të përcaktuara për kualifikim.

- Si periudhë implementimi është parashikuar 30 ditë nga lidhja e kontratës sipas pikës 2.2, Neni 2 të kontratës. Nga verifikimi urdhër shpenzimeve për likuidimin, si dhe dokumentacionit shoqërues për marrjen në dorëzim të shërbimit rezulton se është hartuar dokumenti teknik pa datë dhe jo Raporti Përfundimtar për zbatimin e kontratës, shoqëruar nga shkresa e Drejtorit të Burimeve të Informacionit, pa datë dhe numër protokolli. Likuidimi është bërë sipas faturës tatimore nr. 1007/9, datë 17.07.2019, nëshkruar vetëm nga znj. L A, ndërkohë që në dokumentin teknik kanë nënshkruar znj. L A me detyrë Drejtor e Burimeve të Informacionit, znj. R D specialiste, znj. N H Specialiste dhe z. E D Specialist IT. Për mos përcaktimin e datës së marrjes në dorëzim të shërbimit në dokumentin teknik ngarkohen me përgjegjësi personat që kanë nënshkruar atë, znj. L A me detyrë Drejtor e Burimeve të Informacionit, znj. R D specialiste, znj. N H Specialiste dhe z. E D Specialist IT.

Sipas përcaktimeve të Nenit 13 të kontratës, personat përgjegjës për ecurine e zbatimit të kontratës nga ISSH janë znj. L A me detyrë Drejtor e Burimeve të Informacionit, znj. G H specialiste, znj. F D Specialiste.

13) Procedura: Shërbim printim për ISSH viti 2019

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 2894 prot, datë 16.04.2019, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për shërbim printimi dhe fotokopjimi, 440,000 kopje.

- Me procesverbal datë 19.04.2020, janë hartuar specifikimet teknike dhe dokumentacioni që duhet të plotësohet nga operatori ekonomik fitues, nënshkruar nga Komisioni për hartimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

termave të referencës, kapacitetin teknik, përbërë nga z. E D Kryetar, znj. R D anëtar dhe z. K P Anëtar, komisioni i ngritur me urdhër nr. 2894/1 prot, datë 17.04.2019.

- Me procesverbal datë 19.04.2019, është bërë përlogaritja e fondit limit në vlerën 484,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë procedura e zhvilluar vitin e kaluar për këtë prokurim, sasia e parashikuar në këtë vit dhe çmimi mesatar i pesë ofertave të marra, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues për vitin 2018 sipas përcaktimeve të Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Udhër prokurimi nr. 2894/2 prot, datë 23.05.2019, data e zhvillimit të procedurës 27.05.2019. Është shpallur fitues operatori ekonomik që ka ofruar vlerën më të ulët “I S O”, duke u lidhur kontrata me nr. 2894/3, datë 30.05.2019, me vlerë 317,720 lekë pa TVSH dhe 381,264 lekë me TVSH.

- Në hartimin e kriterëve që duhet të plotësoj operatori ekonomik fitues *nuk është përcaktuar dorëzimi i listëpagesave, me qëllim evidentimin e personave që janë në marrëdhënie pune me operatorin ekonomik dhe që plotësojnë kualifikimet profesionale të përcaktuara për kualifikim. Listëpagesat nuk janë dorëzuar nga operatori, por vetëm diplomat e noterizuara.*

- Gjithashtu përcaktimi si kriter: punësimi minimalisht i dy personave të diplomuar si inxhinier (IT, makatronik, elektronik etj), *nuk është në raport të drejtë në krahasim me natyrën e shërbimit që do të kryhet*, pra i pargumentuar, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, neni 62 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për hartimin e termave të referencës, për hartimin e tyre, si dhe Njësia e Prokurimit që nuk ka kontrolluar mospërputhshmërinë e këtyre kriterëve me përcaktimet e nenit 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 61 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II- Procedura prokurimi me vlerë të vogël viti 2020

1) Procedura: Sistemit të kondicionimit të ISSH-së-Mirëmbajtja

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 5348 prot, datë 10.09.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për shërbimin për një periudhë 12 mujore.

- Sipas procesverbalit datë 15.09.2020, është bërë llogaritja e fondit limit në vlerën 620,500 lekë pa TVSH, bazuar në testimin e tregut shoqëruar me 3 oferta nga operatorët ekonomik. Të tre oferta e paraqitura nuk përmbajnë datën e lëshimit. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 5348/1, datë 15.09.2020.

- Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Sipas të dhënave nga sistemi E-Prokurime.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 21.09.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik Klimateknika TB2 është renditur i pari, duke u paraqitur për realizimin e procedurës. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me nr. 5348/2 prot., datë 09.10.2020, me vlerë 595,300 lekë pa TVSH, ose 714,360 lekë me TVSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Hartimi i fondit limit është bazuar në testimin e tregut, por në dosje nuk administrohet një relacion apo procesverbal i mbajtur nga sektori përkatës/Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm, ku të përcaktohet në mënyrë të detajuar nevojat që ka institucioni për këto shërbime referuar gjendjes aktuale, duke sqaruar hollësisht secilin zë të shërbimeve të parashikuara në hartimin e fondit limit. Disa zëra të shërbimeve të parashikuara në hartimin e fondit limi janë të njëjtat si një vit më parë, si – Pakete elektronike e njësive të brendshme (2 cop); - Monitor ventilatori njësi e jashtme (2 cop); - Pakete elektronike e njësive të jashtme (2 cop), gjithashtu nuk janë shoqëruar me relacion teknik që përcakton gjendjen e tyre dhe nevojën për zëvendësimin e tyre.

- Hartimi i specifikimeve teknike sipas Ftesës për Ofertë

Hartimi i specifikimeve teknike nuk është bërë në mënyrë objektive, pasi kërkesat e parashikuara në ftesën për ofertë nuk janë në raport të drejtë me natyrën e shërbimeve që do të kryen jo në përputhje me përcaktimet e pikës 2, neni 62 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konkretisht kriteret:

- Minimumi 1(një) Inxhinier mekanik (Drejtues Teknik të identifikuar në Licensën e kompanisë)

- Minimumi 1 punonjës saldator

- Certifikatat ISO

- Me urdhër transfertë datë 09.02.2021, faturë tatimore nr. 2, datë 05.02.2021, është likuajduar shërbimi. Procesverbali për dorëzimin e shërbimeve, bashkangjitur dokumentacionit të likujdimit është nënshkruar vetëm nga z. Rakip Nexhi me detyrë Specialist i Sektorit të Administratës, nga ISSH nuk është ngritur Grup për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera.

2) Procedura: Mirëmbajtje e faqes zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me shkresën nr. 898 prot, datë 06.02.2020, drejtuar Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, nënshkruar nga Drejtori i Marrëdhënieve me publikun, është bërë kërkesa për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH. Me urdhër nr. 898/1 prot, datë 06.02.2020, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e fondit limit të përbërë nga z. E D kryetar, znj. R D anëtar dhe z. K P anëtar. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 898/2, datë 07.02.2020. Specifikimet teknike dhe kriteret që duhet të plotësojë operatori ekonomik të përcaktuara sipas procesverbalit për hartimin e specifikimeve teknike datë 07.02.2020, nuk kanë asnjë ndryshim me ato të një viti më parë 2019, nuk ka relacion për ecurinë e zbatimit të kontratës, mangësitë dhe nevojat për ndryshime në funksion të përmirësimit të shërbimit të ofruar.

- Procesverbal datë 07.02.2020, për llogaritjen e fondit limit në vlerën 277,000 lekë pa TVSH, bazuar në tre oferta të marra nga tregu.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 12.02.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A T D është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 13.02.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik I.A është renditur i dyti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.

- Me procesverbalin nr. 3, datë 14.02.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik K është renditur i tretë, është paraqitur duke dorëzuar dokumentacionin që plotëson kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë është lidhur kontrata me nr. 898/4, datë 17.02.2020, me vlerë 270,000 lekë pa Tvsh, ose 356,400 lekë me Tvsh.

Procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit bashkangjitur dokumentacionit të likuidimit, nuk përmban datë, dhe është nënshkruar nga znj. M Z me detyrë Specialiste në Drejtorin e Marrëdhënieve me Publikun, si personi përfaqësues i ISSH sipas nenit 15 të kontratës. *Duke parë natyrën e shërbimit të kryer ISSH duhe të të kishte caktuar persona kompetentë me njohuri informatike për marrjen në dorëzim të shërbimit të kryer.*

3) Procedura: Riparim Automjetit tip Volkswagen Tiguan me targë AA 592 PM, viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me shkresën nr. 8068 prot, datë 23.12.2020, drejtuar Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, është bërë kërkesa për riparim automjeti.

- Procesverbal datë 23.12.2020 për llogaritjen e fondit limit me vlerë 120,000 lekë. Fondi limit është llogaritur bazuar vetëm në një ofertë të marrë nga tregu *në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

- Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 8068/1, datë 23.12.2020. Data e zhvillimit të procedurës 29.12.2020. - Procedura e prokurimit përveç dokumentacionit të administruar nga sistemi elektronik që gjendet i printuar në dosje, nuk gjendet e pasqyruar në sistemin elektronik të APP-së.

- *Mungon relacioni apo procesverbali paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së shërbimeve, mbajtur nga personat kompetent.*

- Me procesverbalin datë 30.12.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik L S është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë.

- Me procesverbalin datë 31.12.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik N është renditur i dyti, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë.

- Me procesverbalin datë 06.01.2021 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik S & C C është renditur i tretë, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt.

- Me procesverbalin datë 11.01.2021 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik B M është renditur i katërti, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje për mungesë stafi për realizimin e kontratës. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e pestë O M me vlerë 98,000 lekë pa TVSH, cili ka pranuar realizimin e shërbimit duke dorëzuar deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike.

- Nuk është dorëzuar deklarata sipas të cilës operatori ekonomik fitues konfirmon se pjesët e përdorura janë origjinale, *në kundërshtim me përcaktimet e Ftesës për ofertë, pika 2.*

Për këtë kontratë nuk është bërë asnjë likuidim gjatë vitit 2020, gjithashtu në dosje nuk administrohet procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

4) Procedura: Sigurimi Kasko i Automjeteve dhe TPL viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 101 prot, datë 08.01.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për Sigurim Kasko i Automjeteve dhe TPL viti 2020, pa nënshkruar nga Drejtori Administrimit të Përgjithshëm. Me procesverbal datë 08.01.2020, është bërë përllogaritja e fondit limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, në vlerën 570,000 lekë pa TVSH, por vlera sigurimit kasko nuk është marrë në masën 3 % e vlerës së automjetit, po në marzhin 3.2-3.3 %. Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 101/1, datë 08.01.2020, data e zhvillimit të procedurës 10.02.2020.

- Nga raporti i gjeneruar nga sistemi elektronik, operatori ekonomik S I V I G me ofertë 569,861 leke pa TVSH është oferta me vlerë më të ulët, që ka marrë përsipër të realizojë shërbimin dhe për pasojë është shpallur fituese.

Në dosje nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël për këtë fazë të procedurës së prokurimit si dhe për shpalljen e fituesit.

5) Procedura: Blerja Gomash për automjetet e ISSH, viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 8069 prot, datë 23.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për goma për 3 makina në pronësi të ISSH.

- *Mungon relacioni apo procesverbali paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së shërbimeve, mbajtur nga personat kompetent apo nga një komision i ngritur nga titullari i autoritet kontraktor.* - Me procesverbal datë 23.12.2020, është bërë përllogaritja e fondit limit në vlerën 200,000 lekë pa TVSH. - *Në ftesën për ofertë nuk është vendosur asnjë kusht, kriter apo dokumentacion që duhet të plotësojë apo dorëzojë operatori ekonomik fitues, për të vërtetuar kapacitet për ofrimin e shërbimit të kërkuar.*

- Është nxjerrë urdhër prokurimi nr. 8069/1, datë 24.12.2020, data e zhvillimit të procedurës 29.12.2020. - Me procesverbalin datë 30.12.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik “K” është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë.

- Me procesverbalin datë 31.12.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik L S është renditur i dyti, ka paraqitur njoftimin për tërheqje, si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë.

- Me procesverbalin datë 05.01.2021 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik N është renditur i treti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt.

- Me procesverbalin datë 06.01.2021 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik S & C C është renditur i katërti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e pestë.

- Me procesverbalin datë 07.01.2021 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik K-R C është renditur i pesti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e gjashtë A M me vlerë 136,000 lekë pa TVSH, cili ka pranuar realizimin e shërbimit. Për këtë kontratë nuk është bërë asnjë likuidim.

6) Procedura: Materiale për pastrimin e ISSH, viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 1439 prot, datë 26.02.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, bazuar në konsumin për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, dhe nevojës urgjente është bërë kërkesa për materiale pastrimi dhe dezinfektimi.

- Me procesverbal datë 04.03.2020, është bërë përlllogaritja e fondit limit në vlerën 680,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë çmimet e magazinës së vitit të kaluar tek fituesi, pra kontrata e vitit të mëparshëm.

Udhër prokurimi nr. 1439/1 prot, datë 04.03.2020, data e zhvillimit të procedurë 06.03.2020.

- Me procesverbalin nr. 1, datë 06.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik “O H” është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje për arsye shëndetësore. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë.

- Me procesverbalin nr. 2, datë 10.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik B K është renditur i dyti, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje.

- Me procesverbalin nr. 3, datë 11.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik V B është renditur i treti, por pas njoftimit nuk ka paraqitur kërkesën për tërheqje, si rrjedhojë komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt.

- Me procesverbalin nr. 4, datë 12.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik E M 2010 është renditur i katërti, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje, si rrjedhojë komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e pestë.

- Me procesverbalin nr. 5, datë 18.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik N është renditur i pesti, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje, si rrjedhojë komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e gjashtë.

- Me procesverbalin nr. 6, datë 19.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik H është renditur i gjashti, pas njoftimit ka marrë përsipër realizimin e kontratës, duke u lidhur kontrata në vlerën 570,000 lekë pa TVSH.

- Në dosje nuk administrohet dokumentacion apo procesverbal që vërteton procedurën e dorëzimit të mostrave dhe përmbushjen e specifikimeve teknike, në kundërshtim me kërkesat sipas ftesës për ofertë.

Fatura tatimore nr. 50, datë 06.03.2020, nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit, sipas përcaktimeve të pikës 3 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

7) Procedura: Shërbim printim për ISSH-n, viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me kërkesën nr. 6749 prot, datë 03.11.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit, është bërë kërkesa për shërbim printimi dhe fotokopjimi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Me procesverbal datë 03.11.2020, janë hartuar specifikimet teknike dhe dokumentacioni që duhet të plotësohet nga operatori ekonomik fitues, nënshkruar nga z. E D specialist, z. K P specialist, znj. R D specialiste, miratuar nga znj. L A me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve të Informacionit.

- Me procesverbal datë 14.12.2020, është bërë përlllogaritja e fondit limit në vlerën 535,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë procedura e zhvilluar vitin e kaluar për këtë prokurim, çmimi mesatar i tre ofertat e ofruara, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues I S me vlerë 317,720 lekë pa TVSH dhe 381,264 me TVSH, ku llogaritet 0.72 leke/ faqe dhe jo 0.88 lekë/faqe siç është miratuar, me një diferencë prej $0.16 \text{ leke/faqe} \times 440000 \text{ kopje} = 70,400 \text{ lekë}$ llogaritur më tepër fondi limit në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Njësia e Prokurimit z. E P, z. N C dhe z. B D.

Udhër prokurimi nr. 6749/2 prot, datë 18.12.2020, data e zhvillimit të procedurës 22.12.2020. Është shpallur fitues operatori ekonomik që ka ofruar vlerën më të ulët “TE Electronics”, duke u lidhur kontrata me nr. 6749/3, datë 28.12.2020, me vlerë 482,000 lekë pa TVSH dhe 578,400 lekë me TVSH.

Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kriter punësimi minimalisht i dy personave të diplomuar si inxhinier (IT, makatronik, elektronik etj). *Vendosja e këtij kriteri nuk është i argumentuar e në raport të drejtë në krahasim me natyrën e shërbimit që do të kryhet, dhe për më tepër personat e punësuar nga operatori ekonomik fitues janë të dy të diplomuar për inxhinier mekanik, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, neni 62 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komsioni për hartimin e termave të referencës si dhe Njësia e Prokurimit.*

8) Procedura: Rinovimi i licensës së programit të antivirusit

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me shkresën nr. 6137 prot., datë 09.10.2020 është miratuar nga titullari kërkesa për rinovimin e liçensës së programit të antivirusit hartuar nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit D.

- Me procesverbal datë 09.10.2020 janë hartuar specifikimet teknike dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, mungon urdhër nga titullari i autoritet kontraktor për ngritjen e grupit për hartimin e specifikimeve teknike.

- *Në hartimin e specifikimeve teknike nuk është parashikuar si kusht deklarata nga operatori ekonomik fitues për garantimin e sigorisë së sistemit, të dhënave të administruara si dhe vazhdimin e punës pa ndërprerje.*

- Me procesverbal datë 09.10.2020 është përcaktuar fondi limit me vlerë 380,000 lekë pa TVSH, bazuar në kontratën e viteve të mëparshme. Urdhër prokurimi nr. 6137/1, datë 09.10.2020. Data e zhvillimit të procedurës 13.10.2020.

- Me procesverbalin datë 14.10.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik PC S është renditur i pari, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Me procesverbalin datë 15.10.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik O T është renditur i dyti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e tretë.
- Me procesverbalin datë 16.10.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik E H është renditur i treti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e katërt.
- Me procesverbalin datë 19.10.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A D është renditur i katërti, por pas njoftimit nuk është paraqitur pranë ambienteve të ISSH, si dhe nuk dërgoi justifikimin e mosparaqitjes në këtë procedurë. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e pestë F, i cili ka pranuar të ofrojë shërbimin me ofertën 375,000 lekë pa TVSH.
- *Në dosje nuk administrohet listë pagesa që vërteton se punonjësi G C, i certifikuar nga kompania prodhuese B G, është punonjës i operatorit ekonomik fitues F, për pasojë nuk plotësohet njëri nga kushtet e përcaktuara në ftesën për ofertë.*
- Me procesverbalin datë 21.10.2020 është bërë dorëzimi i shërbimit, pra aktivizimi i licensës për një vit për 300 përdorues, në prani dhe të përfaqësuesve të ISSH, nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Teknologjise së Informacionit z. Ervin Dauti.

9) Procedura: Blerje Bilete Avioni Tiranë-Vjenë-Tiranë

- Urdhër nr. 790/2 prot, datë 04.03.2020, për pjesëmarrjen në takimin rreth ecures së marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, bazuar në ftesën e administruar me nr. 790 prot, datë 03.02.2020.
- Kërkesë për biletë avioni nr. 790/3 prot, datë 04.03.2020, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm/Sektorit të Prokurimeve, nënshkruar nga titullari i institucionit. Urdhër prokurimi nr. 790/4, datë 05.03.2020. Data e zhvillimit të procedurës 05.03.2020.
- *Sipas të dhënave nga sistemi elektronik, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.*
- Me procesverbalin nr. 1, datë 05.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik A “D”- V është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesë për tërheqjen nga procedura e prokurimit. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë në bazë të udhëzimit të APP nr. 3, datë 09.01.2018.
- Kërkesë për hedhje shorti datë 05.03.2020, pasi janë paraqitur dy operatorë me ofertë të njëjtë.
- Me procesverbalin nr. 2, datë 05.03.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik D K që ka paraqitur ofertë me vlerë të njëjtë me A-L T B T, ka paraqitur kërkesën për tërheqje dhe për pasojë është shpallur fitues operatori A-L T B T me vlerë 152,00 lekë pa Tvsh. - Në dosje nuk administrohet rezervimi biletës sipas specifikimeve të ftesës për ofertë.

10) Procedura: Furnizimi me ujë të pijshëm për ISSH-në, viti 2020

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
- Kërkesë nr. 1194 prot, datë 19.02.2020, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe nevojat për vitin 2020, nënshkruar nga titullari i autoritetit kontraktor. Me datë 19.02.2020 është mbajtur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

procesverballi për përllogaritjen e fondit limit, në vlerën 250,000 lekë pa TVSH, bazuar në kontratën e një viti më parë 2019, ku vlera për një bidon ujë është 384 lekë.

Urdhër prokurimi nr. 1194/1 prot, datë 20.02.2020, data e zhvillimit të procedurës 25.02.2020.

- Është shpallur fitues operatori ekonomik me ofertën me vlerë më të ulët, M L me oferte 240,000 lekë pa TVSH. Lidhur kontrata me nr. 1194/2, datë 28.02.2020.

- *Certifikata e cilësisë është në gjuhë të huaj dhe nuk është përkthyer në gjuhën shqip në të cilën është zhvilluar procedura e prokurimit.*

Faturat tatimore nr. 1835, datë 29.10.2020, nr. 1846, datë 09.11.2020, nr. 1517, datë 30.06.2020, janë nënshkruar nga magazinierja, por nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit, sipas përcaktimeve të pikës 3 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

11) Procedura: Krijimi i Ëeb- Service të dedikuar për organet gjyqësore dhe strukturat e Vettingut

- Dosja e procedurës është inventarizuar, por dokumentacioni i administruar në dosje nuk është shënuar me numër rendor progresiv sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Me shkresën nr. 7781 prot, datë 15.12.2020 është bërë kërkesa nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, për krijimin e Ëeb-service të dedikuar për Organet Gjyqësore dhe Strukturat e Vettingut.

- Kjo procedurë nuk është parashikuar në regjistrimin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2020. Me shkresën nr. 7781/2 prot, datë 17.02.2020, nënshkruar nga titullari është bërë miratimi i shtesës së fondit dhe ndryshimi në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2020.

- Urdhër nr. 7781/1 prot, datë 16.12.2020, për krijimin e komisionit mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.

- Me procesverbal datë 16.12.2020, janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit nga komisioni përkatës.

- Me procesverbal datë 17.12.2020, është miratuar fondi limit në vlerën 720,000 lekë pa TVSH, bazuar në 3 oferta të marra nga tregu në datë 16.12.2020. Në këtë rast për përcaktimin e fondit limit është marrë për bazë oferta që ka vlerën më të ulët.

- Urdhër prokurimi nr. 7781/3, datë 21.12.2020, data e zhvillimit të procedurës 23.12.2020.

- Me procesverbalin datë 24.12.2020 të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël operatori ekonomik X S me ofertë me vlerë 690,000 lekë pa TVSH është renditur i pari, por pas njoftimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje, në dosje nuk administrohet dokumenti gjeneruar nga sistemi elektronik i APP-së. Si rrjedhojë, komisioni vazhdoi me operatorin e renditur në vendin e dytë D L, me ofertën me vlerë 699,000 lekë pa TVSH, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

- Është lidhur kontrata me nr. 8103/1, datë 29.12.2020 me vlerë 699,000 lekë pa TVSH dhe 838,800 lekë me TVSH.

- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore është paraqitur vetëm për muajin Tetor 2020, ndërkohë që mungon listëpagesa për muajin Nëntor 2020 për të vërtetuar punësimin e personave të certifikuar, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë. Në dosje nuk administrohet procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit dhe plotësimin e specifikimeve teknike. *Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.*

12) Procedura: Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit hidraulik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Urdhër Transfertë datë 24.09.2020, me vlerë 48,000 lekë, përfitues operatori ekonomik Tak-Fak, nënshkruar nga titullari i autoritetit kontraktor dhe specialisja e sektorit të buxhetit. Faturë tatimore nr. 191, datë 31.08.2020.
- Me shkresën nr. 5082 prot, datë 27.08.2020, është bërë kërkesa për zëvendësimin e pompës nga Drejtori i Adminisrimit të Përgjithshëm, nënshkruar nga titullari i Autoriteti Kontraktor.
- Mungon procesverbal konstatues për prishjen e pompës dhe nevojës për zëvendësim, nënshkruar nga personat e pranishëm.
- Është mbajtur procesverbal datë 31.08.2020, për zëvendësimin e pompës, nënshkruar nga Administratori Godinës z. R N dhe Punonjësi i dezurnit z. V P.
- Nga Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla nuk është mbajtur procesverbal sipas formularit standard nr. 4, si dhe fatura tatimore nr. 191, datë 31.08.2020 nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 dhe 18 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Konkluzione

- Inventarët e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk janë plotësuar me numër rendor progresiv, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36.
- Nga Autoriteti Kontraktor për procedurat e zhvilluara nuk është dokumentuar me procesverbal procedura e verifikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nëse operatori ekonomik ofertues ka në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 14 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- Nga Autoriteti Kontraktor nuk është zbatuar i njëjti standard për hartimin e fondit limit, në ato raste ku është marrë si referencë kontrata e vitit të mëparshëm, pasi në disa procedura i referohet ofertës më vlerë më të ulët ndërsa në disa raste është marrë për bazë çmimi mesatar i tre ofertave të marra nga tregu, jo sipas përcaktimeve të Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
- Në 9 raste sipas të dhënave nga sistemi elektronik i APP-së, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 apo 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- Në realizimin e procedurave të prokurimit blerje “Bileta –Avioni”, në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës, seminareve apo trajnimeve, shoqëruar nga programi përkatës.
- Në 5 raste në procedurat si vijon “Furnizimi i dispenserave me ujë të pishëm për ISSH-në, 2019”; “Rinovimi i licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019”; “Riparim Automjetit tip Volsëagen Tiguan me targë AA 592 PM, viti 2020”; “Rinovimi i licensës së programit të antivirusit, viti 2020”; “Krijimi i Web- Service të dedikuar për organet gjyqësore dhe strukturat e Vetingut”, nuk janë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 7 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Në 5 raste në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik fitues, ku për shkak të natyrës së shërbimit, mallit apo punës që do të kryhet është e nevojshme dorëzimi i dokumentacionit që provon kapacitet e operatorit ekonomik në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, kërkesat e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Në 1 rast në zhvillimin e procedurës “Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit hidraulik” viti 2020, nga Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla nuk është mbajtur procesverbal sipas formularit standard nr. 4, si dhe fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 18 të Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- Në 3 raste mungon relacioni apo procesverbali paraprak konstatues për nevojën për mallra, punë dhe shërbime, mbajtur nga personat kompetent apo nga një komision i ngritur nga titullari i autoritet kontraktor, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- Në 9 raste janë konstatuar mangësi në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve, pasi mungon procesverbali për marrjen në dorëzim, faturat tatimore janë firmosur nga magazinierja dhe jo nga anëtarët Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël, si dhe rastet kur nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët Komisionit, nuk janë ngritur grupe për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluar, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 45, 47, 52 dhe pika 54, Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3.
- Në 2 raste në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për shpalljen e fituesit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 13, 15, 16 dhe 17.
- Në 3 raste përcaktimi i kriterëve për kualifikim në ftesën për ofertë, nga Njësia e Prokurimit, nuk është i argumentuar dhe në raport të drejtë në krahasim me natyrën e shërbimit që do të kryhet, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, neni 62 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
- Në 1 rast në procedurën e prokurimit “Shërbim printim për ISSH-n, viti 2020” është bërë përllogaritja e fondit limit në vlerën 535,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë procedura e zhvilluar vitin e kaluar për këtë prokurim, çmimi mesatar i tre ofertat e ofruara, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues I S me vlerë 317,720 lekë pa TVSH dhe 381,264 me TVSH, ku llogaritet 0.72 leke/ faqe dhe jo 0.88 lekë/faqe siç është miratuar, me një diferencë prej 0.16 leke/faqe * 440000 kopje = 70,400 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ilogaritur më tepër fondi limit në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II- Procedura prokurimi me vlera mbi 800,000 lekë.

Procedura me objekt: "Blerje Karburanti" është kryer nga ISSH që prej hyrjes në fuqi e Ligjit të Prokurimit Publik, ndërsa Procedura me objekt: "Sigurimi i Aseteve të ISSH", është kryer nga ISSH prej vitit 2015 e në vazhdim.

Oragnizimi i procedurave të Prokurimit Publik përveç Ligjit të Prokurimit Publik, VKM-së për Miratimin e Rregullave, Udhëzimeve të App-së, Instituti i Sigurimeve Shoqërore operon bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.161, datë 11.04.1994 “Për Miratimin e Statusit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Kreu I- Krijimi dhe Vendi, ku thuhet:

Neni 1.

"Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që më poshtë do të quhet ISSH, është Institucion Publik Shtetëror i Pavarur. Veprimtaria e tij rregullohet me Ligjin nr.7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqërore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.

Kreu II- Fondet themelore, burimet e formimit dhe përdorimi i tyre, Neni 3

Issh administron fondin e sigurimeve shoqërore ne menyre te pavarur. Te ardhurat realizohen dhe shpenzimet kryhen sipas Ligjit 7703, date 11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqërore ne Republiken e Shqiperise".

1- Procedura e Prokurimit “Sigurimi i asetëve të ISSH, DAQ, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore”

Urdhër prokurimi Nr 834, datë 03.02.2020	Njësia Prokurimi N C E P B D	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Fondi limit 7 816 350 lekë pa TVSH		Urdhër nr. 834/2 datë 7.02.2020
Procedura e prokurimit Kërkesë për Propozim		M G Dr Juridike F Sh sp Dr Juridik E D Sp Administrate
Burimi i Financimit: Buxheti i ISSH		Diferenca nga Fondi limit 80,130 ose 6.9%
Datë e publikimit Datë 10.02.2020 ora 08.00 Datë e hapjes së tenderit Date 21.02.2020 ora 11.00	Fitues: “I V I G” sh.p.k	Lidhja e kontratës Nr. 834/6, datë 10.03.2020
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar 0 OE	Miratimi i Raportit Përmledhës: Me shkresën nr. 834/3 prot., datë 05.03.2020.	Vlera e kontratës 7,736,220 lekë pa tvsh dhe 7,736,220 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës	Titullar i AK – Astrit Hado

Me urdhrin nr. 8116 prot, datë 05.12.2019, të titullarit të institucionit, është ngritur Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës për “Sigurimin e Aseteve të ISSH-së, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve”, i përbërë nga znj. L Gj, Kryetar, E D anëtar, M Z anëtar, E D anëtar, P R anëtar. Komisioni ka hartuar termat e referencës shoqëruar nga akti përkatës, nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, por nuk ka datë. Vlera e asetëve që kërkohet të sigurohet është bërë sipas inventarit kontabël të datës 30.12.2019.

Gjithashtu në Termat e Referencës është përcaktuar se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që me mbylljen e bilancit ekonomik për vitin 2019 të rishikojë vlerën e asetëve të siguruara dhe për çdo ndryshim të njoftojë kontraktorin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Me shkresën nr. 834/1 prot, datë 07.02.2020, është bërë publikimi i njoftimit të kontratës.

a- Hartimi i fondit limit:

Njësia e Prokurimit me datë 29.01.2020 ka kërkuar oferta nëpërmjet e-mail tre shoqërive sigurimi dhe konkretisht A, I dhe A. Me procesverbal datë 31.01.2020, nga Njësia e Prokurimit është hartuar fondi limit, për një periudhë 1 vjeçare, bazuar në tre oferta të marra nga tregu përkatësisht - A 7,820,000 lekë; - A 7,819,000 lekë; - I 7,810,000 lekë, duke u referuar tek masatarja matematike e tre ofertave të paraqitura, konkretisht në vlerën 7,816,350 lekë pa TVSH.

Në mbështetje të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu VII, neni 58, është firmosur urdhëri i prokurimit nr. 834 datë 03.02.2020.

b- Hartimi i kriterëve:

Me procesverbal datë 03.02.2020, nga Njësia e Prokurimit, janë hartuar dokumentat e standarte të tenderit (DST) dhe njoftimi i kontratës është shpallur me datë 10.02.2020 në faqen e internetit të APP, njoftimi i publikimit të së cilës është botuar në Buletin e Njoftimeve Publike me nr.06 datë 17.02.2020 (faqe 65,66) të APP-së. Data e zhvillimit të tenderit u caktua data 21.02.2020 ora 11.00.

Lidhur me kriteret e DST rezulton se vendosja e tyre përgjithësisht është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit të kërkuar, nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, dhe të argumentuara sipas përcaktimeve të nenit 61- “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, të VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Nenit 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar.

c- Zhvillimi i procedurës

Në datë 10.02.2020 është bërë njoftimi për pjesëmarrje 5 operatorëve ekonomik. Procedura është hapur me datë 21.02.2020, sipas afateve.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.02.2020. Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm shoqëria “Intersig Vienna Insurance Grup” me ofertë ekonomike 7,736,220 lekë pa TVSh.

Nga anëtarët e KVO, me datë 04.03.2020, është mbajtur Raporti Përmbledhës, pa numër protokolli. Raporti Përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr. 834/3 prot, datë 05.03.2020.

KVO në përfundim të vlerësimit të dokumentacionit teknik/ligjorë të OE pjesëmarrës, ka vlerësuar se shoqëria “Intersig Vienna Insurance Grup” plotëson kriteret për tu shpallur fitues, dokumentuar kjo me procesverbalin datë 06.03.2020 (datë e dorëzimit të dokumentacionit nga fituesi në ISSH) nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 834/1, datë 07.02.2019.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 834/4, datë 05.03.2020.

Formulari i njoftimit fituesit, shpallur në buletin APP me nr. 9, datë 09.03.2020.

Ndërmjet ISSH dhe shoqërisë fituese I V I G, është lidhur kontrata nr. 834/6, datë 10.03.2020 deri me datë 10.03.2021 nga data e lidhjes së kontratës për vlerën 7,736,220 lekë pa TVSh.

d- Auditimi i procedurës.

- Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjektit mbi vlerësimin e procedurës për shpalljen fitues të shoqërisë I V I G, konstatohet se OE ka përmbushur kriteret e DST, përveç përcaktimit të kontratës së risigurimit, pasi sipas letër konfirmimi datë 06.01.2020, kontrata e risigurimit për shoqërinë I V I G mbulon vetëm vitin 2020, ndërkohë që në kriteret për kualifikim është përcaktuar se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.

Kontrata e sigurimit të aseteve është lidhur për një periudhë 1 vjecare nga data 10.03.2020-09.03.2021, pra periudha e kontratës për vitin 2021 nuk është e mbuluar me kontratë risigurimi sipas përcaktimeve të DST. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO, përbërë nga znj. M G, znj. F Sh, znj. E D.

- Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar veçorit apo karakteristikat për objektet e ndërtimet edhe konstruksionet shoqëruara me foto, skica apo planimetri, gjëndjen teknike të tyre, gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214- Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218 inventatin ekonomik.

- Në termat e referencës është përfshirë dhe siguri për rastet:- *Përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij; - Rrëshqitjes së Tokës.* Për këto raste nuk ka asnjë të dhënë, relacion apo studim risku nëse këto ngjarje kanë ndodhur në të kaluarën dhe mundësia e ndodhjes së tyre.

Mangësit në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut, duke mos respektuar përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 59- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar”. *Për mangësit më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës, i përbërë nga znj. L Gj, Kryetar, E D anëtar, M Z anëtar, E D anëtar, P R anëtar.*

- Është bërë likuidimi i vlerës sipas urdhër transfertë nr. 19, datë 31.03.2020, faturë tatimore nr. 122, datë 10.03.2020 në vlerën 7,736,220 lekë, nënshkruar nga pjestarët e Njesisë së Prokurimit.

2- Procedura prokurimit publik me objekt “Blerje karburant për ISSH-në”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. Nr 3988/1 date 11.06.2019	NJHDT N C	KVO me urdhrin nr. 3988/3 date 12.06.2019
Fondi limit: 1,880,000 lekë	E P	R M – kryetar
Procedura e prokurimit – Kerkese per Propozim	B D	M G – anëtar
Burimi i Financimit: Buxheti i ISSH	Fitues: “K”sh.p.k	E D - anëtar
Datë e hapjes së tenderit 02.07.2019 ora 10:00		Vlera fituese me marzh fitimi 6.9%
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 0 OE		Kontrata Nr 3988/5 datë19.07.2019
	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 3988/4 prot., datë 17.07.2019	Vlera e kontratës 1,880,000 lekë pa tvsh dhe 2,256,000 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës nga data e nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të sasisë së karburantit sipas nevojave të AK.	Titullar i AK – Astrit Hado

Me shkresën nr. 3988/2 prot, datë 12.06.2020, është bërë publikimi i njoftimit të kontratës.

Me shkresën nr. 3988 port, datë 29.05.2019, është bërë kërkesa për blerje karburanti për vitin 2019 nga Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm, nënshkruar nga znj. V L me detyrë magazinierë, znj. R M me detyrë Drejtor, miratuar nga titullari i institucionit. Kërkesa është shoqëruar nga tabela e konsumit për vitin 2018 dhe periudhën Janar-Maj 2019.

a- Hartimi i fondit limit:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Me procesverbal datë 07.06.2019, nga Njësia e prokurimit, është përlllogaritur fondi limit. referuar çmimit të bursës i publikuar nga faqja e APP-së në Buletinin Nr. 22, datë 03 Qershor 2019 (çmimi i marrë dt. 24.05.2019, është 610 USD/ton) duke përcaktuar fondin limit në vlerën prej 1,880,000 lekë pa tvsh.

- Nga auditimi konstatohet se, nga autoriteti kontraktor (Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm) dhe Njësia e Prokurimit nuk disponohet asnjë dokument për përlllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për 100 km, të çdo automjeti.

- Në parashikimin e normës prej 13000 litra, janë përfshira dhe Gjenerator 2 me 300 litra dhe Lundër me 2000 litra, por nuk ka asnjë dokument apo relacion mbi gjëndjen teknike të gjeneratorit, përdorimin e tij gjatë vitit si dhe normën e konsumit.

- Sipas kontratës së lidhur Nr 3988/5 datë 19.07.2019, Neni 6- Afatet dhe mënyra e furnizimit, pika 6.2, në automjetet që do furnizohen me karburant, janë përfshirë vetëm 5 automjete nga 7 që janë llogaritur në tabelën e konsumit, mungojnë automjetet TR8765R dhe TR8763R. Mbi bazën e kësaj table është bërë përlllogaritja e sasisë së karburantit për hartimin e fondit limit. Gjithashtu sipas inventarit kontabël 31.12.2019, rezulton se automjetet me Targa TR8765R dhe TR8763R, janë bërë dalje nga ISSH duke i kaluar DRSSH-ve, përkatësisht automjeti me targa TR8765 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 8, datë 30.01.2019, automjeti me targa TR 8763 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 15, datë 13.02.2019, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në datë 02.07.2019.

Në këto kushte, konstatohet se përlllogaritja e nevojave të AK për sasinë prej 13,000 litra karburant nuk është e saktë, e konfirmuar edhe nga fakti se kjo kontratë vazhdon të shërbejë dhe për vitin 2020.

Për veprimet më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. V L me detyrë magazinierë, znj. R M me detyrë ish-Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm, për hartimin e pasaktë të nevojave si dhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. N Ce, z. E P dhe z. B D që ka përlllogaritur fondin limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 59- Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës.

b. Dokumentet e tenderit.

Sipas sugjerimeve të APP-së, administruara me email datë 14.06.2019, janë bërë ndryshimet në DST, kriteret e kualifikimit.

Nga auditimi i hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit reuizton:

Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore, për xhiron e realizuar në dy vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**” bie në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 27, pika 5, germa a ku citohet “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet.”

Për kapacitetin teknik:

- kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit” bie në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 27, pika 4, ku citohet “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- kriteri: “Operatori ekonomik duhet të sigurojë furnizim të vazhdueshëm për 24 orë në ditë, në çdo ditë të javës në çdo pikë furnizimi dhe sipas cilësisë së kërkuar në të gjitha rrethet e territorit të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria fituese duhet të ketë minimalisht 3 pika karburanti në Tirane”, është vendosur në mënyrë të paargumentuar me volume pune në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 2 paragrafi 2.

Për veprimet më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësinë e hartimit të dokumenteve të tenderit e përbërë nga N C, E P dhe B D.

c. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant për ISSH-në”, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 4 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh) marzh fitimi	Vlerësimi i KVO-së
1	“K” sh.p.k.	6.9 %	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	G C G” shpk	7.1 %	Kualifikuar
3	“D O” sh.p.k & “E” sh.a	7.5 %	Kualifikuar
4	“AT” sh.a & “O” sh.p.k	7.89	Kualifikuar

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE “K” sh.p.k. me me marzh fitimi 6.9%, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst.

Likujdimet

- Urdhër transfertë datë 26.07.2019, faturë tatimorë nr. 19, datë 19.07.2019, për sasinë 3000 litra, vlera 474,926 lekë me TVSH, fletë hyrje në magazinë me nr. 5, datë 19.07.2019, shoqëruar nga dokumentacionit për llogaritjen e cmimit.

- Urdhër transfertë datë 19.11.2019, faturë tatimorë nr. 21, datë 30.10.2019, për sasinë 3000 litra, vlera 483,768 lekë me TVSH, fletë hyrje në magazinë me nr. 11, datë 30.10.2019, shoqëruar nga dokumentacionit për llogaritjen e cmimit.

- Urdhër transfertë datë 16.07.2020, faturë tatimorë nr. 96, datë 15.06.2020, për sasinë 3000 litra, vlera 391,284 lekë me TVSH, fletë hyrje në magazinë me nr. 5, datë 15.06.2020, shoqëruar nga dokumentacionit për llogaritjen e çmimit. Fatura tatimore është nënshkruar nga punonjësa e magazinës znj. V L.

Urdhër transfertë datë 11.11.2020, faturë tatimorë nr. 82, datë 29.10.2020, për sasinë 3000 litra, vlera 385,311 lekë me TVSH, fletë hyrje në magazinë me nr. 12, datë 30.10.2020, shoqëruar nga dokumentacionit për llogaritjen e çmimit. Fatura tatimore është nënshkruar nga punonjësa e magazinës znj. V L. Në total janë lëvruar 12000 litra në vlerën 1,735,289 lekë.

Për vitin 2019 referuar treguesve të monitorimit, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative paraqitet sipas tabelës “Analiza e klases 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” Viti 2019 (buxheti i brendshëm, administrata)”, ndodhur në seksionin Anekse. Për periudhën raportuese 2019 janë alokuar fonde në llog (602) për shpenzime operative në shumën totale 336,694 mijë lekë, nga të cilat shihet se realizimi 12-mujorit në vlerën 82.73%, duke shfaqur një tendencë positive në planifikimin dhe realizimin e saktë të llogaritjes 602 në përgjithësi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi i shpenzimeve operative në lidhje me shpenzimet e udhëtimit (llog 6024) konstatohet se kemi një realizim 100 % të planifikimit fillestar të tyre si për udhëtimet e brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu, një realizim 100% të planifikimit fillestar vihet re edhe në shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Përqindja me e ulët e realizmit të planit vjetor konstatohet llogarinë (llog6020) e cila ka një realizim 34%.

Për vitin 2020 referuar treguesve të monitorimit, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative paraqitet sipas tabelës “Analiza e klases 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” Viti 2020 (buxheti i brendshëm, administrata)”, ndodhur në seksionin Anekse. Për periudhën raportuese 2020 janë alokuar fonde në llog (602) për shpenzime operative në shumën totale 358,003 mijë lekë, nga të cilat shihet se realizmi 12-mujorit në vlerën 94.21%, duke shfaqur një tendencë pozitive në planifikimin dhe realizimin e saktë të llogarisë 602 në përgjithësi. Llogaria 602 është realizuar në masën 89.9%. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit (llog 6024) konstatohet se kemi një realizim 97 % të planifikimit fillestar të tyre ku udhëtimet e brendshme ka një realizim 100%, ndërsa udhëtime të jashtme janë realizuar 50%. Gjithashtu, ka një realizim 108.7 % të planifikimit fillestar edhe në shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Përqindja me e ulët e realizmit të planit vjetor konstatohet në llogarinë (llog6024) (udhëtime të jashtme) e cila ka një realizim 50%, dhe në llogarinë 6023-Shpenzime transporti e cila ka një realizim 52.4 %.

Për mangësit dhe shkeljet e konstatuara, rast pas rasti, ngarkohen me përgjegjësi personat **si më poshtë:**

-znj. R M, me detyrë Kryetar i KVO-së, -znj. N C, me detyrë anëtar i Njesisë së Prokurimit, -z. E P, me detyrë kryetar i Njesisë së Prokurimit, -z. B D, me detyrë anëtar i Njesisë së Prokurimit, -znj. M G, me detyrë anëtar KVO-së, -znj. F Sh, me detyrë anëtar KVO-së, -znj. E D, me detyrë anëtar KVO-së dhe anëtar Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës, -znj. V L, me detyrë magazinierë, -z. E D, në cilësin e anëtarit të Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit dhe anëtar Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës, -Znj. R D, në cilësin e anëtarit të Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit, -z. K P, në cilësin e anëtarit të Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit dhe anëtarit të Komisioni i pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019 dhe 2020, -z. O A, në cilësin e kryetarit të Komisionit të pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019, -znj. A Sh, në cilësin e të Komisioni i pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019, -zj. M Z, në cilësin e kryetarit të Komisionit të pranimit të artikujve në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019, dhe anëtar Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës, -znj. R Pa anëtar, -znj. L A, me detyrë Drejtor e Burimeve të Informacionit, -znj. N H, Specialiste, -znj. L Gj, Kryetar, me detyrë anëtar Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës, -znj. P R, me detyrë anëtar Komisioni për pregatitjen e Termave të Referencës

Observacion me nr. 2842/1 prot, datë 04.05.2021, administruar në KLSH me nr. 95/4 prot, datë 06.05.2021, nga Njësia e Prokurimit, për akt-konstatimin nr. 2, të paraqitura nga Njësia e Prokurimit, të cilët sqarojnë se:

- Për procedurën nr. 1 dhe nr. 5, sipas observacionit, nuk është mbajtur procesverbali për shpalljen e operatorit ekonomik fitues pasi autoriteti kontraktor ka administruar klasifikimin përfundimtar të gjeneruar nga sistemi elektronik dhe operatori i shpallur fitues ka qenë konkurenti i vetëm në garë.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Në cdo rast autoriteti kontraktor përveç dokumentacionit të gjeneruar nga sistemi elektronik për shpalljen e fituesit dhe klasifikimin përfundimtar të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

cituar në osbervacion duhet të administrojë në dosje dhe procesverbalin për shpalljen fitues në përfundim të procedurës në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

- Për procedurën “Rinovimi i licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019”, në dosje administrohet deklarata nr. 5970 prot, datë 09.08.2019, ku citohet se përmbushen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në termat e referencës, pra konstatimi i KLSH nuk qëndron.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: *Observacioni juaj nuk qëndron pasi në ftesën për ofertë të publikuar në sistemin elektronik, përvec deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, kërkohet plotësimi i dy kriterëve konkretisht: Sigurimi e vazhdimësisë pa ndërprerje dhe pa ndërhyrje nga ana e institucionit për ndërfaqen e menaxhimit dhe përditësimit të liçensave të Mail Serverit; si dhe deklarata për sigurimin e vazhdimësisë pa ndërprerje dhe pa ndërhyrje nga ana e institucionit për sigurinë e sistemit (SSL).*

- Për procedurën nr. 3, sipas observacionit, në lidhje me konstatimin se nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit, sqarojnë se me urdhër nr. 180 prot, datë 09.01.2019, është ngritur Komisioni për pranimin e artikujve të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, bashkangjitur observacionit.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: *Urdhri i përmendur në observacion nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nuk administrohej si në dosjet e procedurave të prokurimit ashtu edhe në dokumentacionin financiar. Ky urdhër është i specifikuar vetëm për artikujt e prokuruar dhe jo për rastin e procedurave të prokurimit për shërbime apo punë. Observacioni juaj do të merret pjesërisht në konsideratë dhe do të pasqyrohet në Projekt Raport, për ato procedura që kanë lidhje me pranimin e artikujve.*

- Për procedurën e prokurimit “Shërbim printim për ISSH viti 2019”, llogaritja e fondit limit është bazuar në mesataren aritmetike të pesë ofertave të paraqitura për procedurën e realizuar në vitin 2018.

Sa i përket përcaktimit të kriterëve Njësia e Prokurimit i është referuar relacionit të Komisionit të ngritur me urdhër nr. 2894/1 prot, datë 17.04.2019, për hartimin e termave të referencës.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: *Observacioni juaj në lidhje me pikën për hartimin e fondit limit nuk merret në konsideratë pasi nuk është i mbështetur në argumenta ligjorë, si dhe për llogaritja e fondit limit për këtë procedurë është bërë duke u marrë për bazë çmimi mesatar i pesë ofertave të marra, sipas procedurës së zhvilluar në vitin 2018, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues për vitin 2018 sipas përcaktimeve të Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika b- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; Në lidhje me hartimin e termave të referencës përvec përgjegjësisë të komision të hartimit të referencave, Njësia e Prokurimit si struktura kryesore përgjegjëse për mbarrëvajtjen e procedurës së prokurimit, nuk përjashtohet nga përgjegjësia për kontrollin e përputhmërisë së termave dhe specifikimeve teknike me parimet ligjit të sigurimeve dhe konkretisht përcaktimet e nenit 1 dhe 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 61 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

- Për procedurën “Riparim Automjetit tip Volkswagen Tiguan me targë AA 592 PM, viti 2020”, në lidhje me mungesën e procesverbalit parapak konstatues, argumentojnë se në dosje administrohet një formular për difektimin e mjetit të kryer nga servis M.

Për mungesën e procesverbalit të marrjes në dorëzim, nga Njësia e Prokurimit nuk është mbajtur procesverbal pasi natyra e objektit të kryer nuk është mall por shërbim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Observacioni juaj nuk qëndron pasi është i pambështetur në argumenta dhe dokumentacion justifikues, formulari për difektimin e mjetit që përmendet në observacion nuk është mbajtur nga një komision apo persona kompetent, deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike nuk justifikon mungesën e procesverbalit për marrjen në dorëzim të shërbimit, për për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- Për procedurën e prokurimit “Blerja Gomash për automjetet e ISSH, viti 2020”, në dosje nuk administrohen tre ofertat origjinale të marra në treg, por vetëm treguesit e cmimeve të tyre kjo bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 19.02.2018, për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018. Në lidhje me konstatimin se procedura nuk gjendet e pasyruar në sistemin elektronik, kjo procedurë është e pasqyruar tek skedari arkiva bashkë me procedurat e tjera të përfunduara. Në lidhje me konstatimin për mungesën e procesverbalit për tërheqjen nga gara, sqarojnë se në dosjen e prokurimit gjendet njoftimi tërheqjes gjeneruar nga sistemi elektronik.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Observacioni juaj do të merret në konsideratë bazuar në përcaktimet ligjore të bëra në Udhëzimin nr. 7, datë 19.02.2018, për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, si dhe dokumentacionit të dorëzuar me observacionin dhe verifikuar në sistemin elektronik. Ndryshimet do të pasqyrohen në pjesën takuese në Projekt Raport.

- Për procedurën “Shërbim printim për ISSH-n, viti 2020”, në lidhje me konstatimin se procedura nuk gjendet e pasyruar në sistemin elektronik, kjo procedurë është e pasqyruar tek skedari arkiva bashkë me procedurat e tjera të përfunduara. Në lidhje me konstatimin për fondin limit, sqarojnë se hartimi i fondit limit është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore, gjithashtu hartimi kriterëve për kualifikim është përgatitur nga komisioni përkatës.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Për sa i përket pasqyrimit në sistemin elektronik të procedurës, observacioni juaj do të merret në konsideratë pas verifikimit në seksionin përkatës në SPE si dhe dokumentacionit bashkangjitur observacionit. - Për sa i përket pretendimit tuaj për hartimin e fondit limit, nuk qëndron pasi është i pa bazuar në argumenta dhe dokumentacion provues, si dhe janë konstatuar mangësi të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në material. Për sa i përket pretendimit tuaj për hartimin e kriterëve sqarojmë se Njësia e Prokurimit bazuar dhe në përcaktimet ligjore të trajtuara më sipër nuk përjashtohet nga përgjegjësia për kontrollin e zbatimeve të parimeve dhe përcaktimeve ligjore e nënligjore për procedurat e prokurimit.

- Për procedurën “Blerje Bilet Avioni”, në lidhje me konstatimin se mungon certifikata AITA, sqarojnë se kjo certifikatë është dorëzuar, bashkangjitur observacionit. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Observacioni juaj do të merret në konsideratë për këtë kriter bazuar në certifikatën AITA të dorëzuar, bashkangjitur observacionit.

- Për procedurën “Krijimi i Web- Service të dedikuar për organet gjyqësore dhe strukturat e Vetingut”, sqarojnë se në lidhje me konstatimin për mungesën e procesverbalit të tërheqjes nga gara të operatorit të renditur i pari, njoftimi i tërheqjes i gjeneruar nga sistemi elektronik administrohet në dosje, bashkëlidhur observacionit. Për sa i përket procesverbalit të marrjes në dorëzim, sqarojnë se duhet të nënshkruhet nga personi i kontaktit dhe është bashkangjitur faturës tatimore.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Për sa i përket pretendimit tuaj për mungesën e dokumentacionit për tërheqjen nga gara, observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi nuk është dorëzuar dokumentacioni për tërheqjen nga gara gjeneruar nga sistemi, bashkangjitur observacionit. Gjithashtu nga dokumentacioni i administruar nuk disponohet procesverbal i marrjes në dorëzim bashkangjitur faturës tatimore, observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi është i pa mbështetur në dokumentacion justifikues.

- Në lidhje me konstatimin se ftesa për pjesëmarrje nuk është dërguar 5 operatorëve ekonomik por më pak, sqarojnë se ftesa për pjesëmarrje mund të dërgohet 5 operatorëve kur kjo është e mundur, pra nuk është e detyrueshme. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Pretendimet tuaja nuk



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

qëndrojnë pasi janë të pambështetura në argumente, njoftimi i të paktën 5 operatorëve bën të mundur pjesëmarrje më të lartë dhe rritjen e konkurrencës kjo dhe sipas përcaktimeve ligjore të cituara në material.

- Për procedurën “Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit hidraulik”, në lidhje me konstatimin se nuk është mbajtur formulari standard nr. 4, sqarojnë se ky konstatim nuk qëndron pasi nuk jemi në kushtet e emergjencës dhe nuk është mbi limitin 100,000 lekë duke mos ju nënshtruar procedruave të prokurimit. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë pasi janë të pambështetura në argumente dhe përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 18, ku në rastin e situatave të parashikuara autoriteti kontraktor mund të përdor procedurën shkresore në një vlerë deri në 100,000 leke gjatë vitit. Në rastin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të përcaktuara në pikën 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, atehere këto objekte duhet të pasqyroheshin në regjistrat e parashikimit dhe te realizimit, konkretisht citohet: “Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik”, ndërsa në këtë rast jemi përpara një ngjarje të paparashikuar, për pasojë pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

- Në lidhje me verifikimin e fushës së veprimtarisë në QKR me objektin e prokurimit për operatorët ekonomik, sqarojnë se mbahet procesverbal për ato raste kur skualifikohet operatori ekonomik. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Autoriteti kontraktor në përputhje dhe me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 3, datë 8.01.2018, duhet të dokumentojë të gjitha fazat e procedurës së prokurimit me anë të procesverbalit.

- Për procedurën e prokurimit “Materiale pastrimi ISSH, viti 2020”, në lidhje me konstatimin për mungesën e procesverbalit për tërheqjen nga gara, sqarojnë se në dosjen e prokurimit gjëndet njoftimi tërheqjes gjeneruar nga sistemi elektronik. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Observacioni juaj do të merret në konsideratë bazuar në dokumentacionin e dorëzuar me observacionin si dhe verifikimeve të kryera në sistemin elektronik. Ndryshimet do të pasqyrohen në pjesën takuese në Projekt Raport.

- Për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti viti 2019”, sqarojnë se njësia e prokurimit nuk përgjigjet për llogaritjen e normës së harxhimit, gjithashtu përcaktimi kriterëve është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore. **Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Observacioni juaj nuk qëndron pasi Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për hartimin e fondit limit dhe verifikimit të dokumentacionit shoqërues ku është bazuar për hartimin e fondit limit. Ndërkohë në lidhje me pretendimin për hartimin e kriterëve, argumentat tuaja janë të pambështetura pasi hartimi i tyre nuk është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore trajtuar hollësisht në material, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Gjetja

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në zhvillimin e procedurave për blerjet me vlerë të vogël

Situata

Nga auditimi për blerjet me vlerë të vogël është konstatuar se:

- Inventarët e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk janë plotësuar me numër rendor progresiv;
- Nuk është dokumentuar me procesverbal procedura e verifikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nëse operatori ekonomik ofertues ka në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet;
- Nuk është zbatuar i njëjti standard për hartimin e fondit limit, në ato raste ku është marrë si referencë kontrata e vitit të mëparshëm, pasi në disa



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

procedura i referohet ofertës më vlerë më të ulët ndërsa në disa raste është marrë për bazë çmimi mesatar i tre ofertave të marra nga tregu;

- Në 9 raste sipas të dhënave nga sistemi elektronik i APP-së, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 apo 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve;

- Në realizimin e procedurave të prokurimit blerje “Bileta –Avioni”, në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës, seminareve apo trajnimeve, shoqëruar nga programi përkatës.

- Në 5 raste në procedurat si vijon “Furnizimi i dispenserave me ujë të pishëm për ISSH-në, 2019”; “Rinovimi i licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019”; “Riparim Automjetit tip Volkswagen Tiguan me targë AA 592 PM, viti 2020”; “Rinovimi i licensës së programit të antivirusit, viti 2020”; “Krijimi i Web- Service të dedikuar për organet gjyqësore dhe strukturat e Vetingut”, nuk janë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë;

- Në 5 raste në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik fitues, ku për shkak të natyrës së shërbimit, mallit apo punës që do të kryhet është e nevojshme dorëzimi i dokumentacionit që provon kapacitet e operatorit ekonomik;

- Në 1 rast në zhvillimin e procedurës “Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit hidraulik” viti 2020, nga Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla nuk është mbajtur procesverbal sipas formularit standard nr. 4, si dhe fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit,

- Në 3 raste mungon relacioni apo procesverbali paraprak konstatues për nevojën për mallra, punë dhe shërbime, mbajtur nga personat kompetent apo nga një komision i ngritur nga titullari i autoritet kontraktor;

- Në 9 raste janë konstatuar mangësi në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve, pasi mungon procesverbali për marrjen në dorëzim, faturat tatimore janë firmosur nga magazinierja dhe jo nga anëtarët Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël, si dhe rastet kur nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët Komisionit, nuk janë ngritur grupe për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara;

- Në 2 raste në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për shpalljen e fituesit;

- Në 3 raste përcaktimi i kriterëve për kualifikim në ftesën për ofertë, nga Njësia e Prokurimit, nuk është i argumentuar dhe në raport të drejtë në krahasim me natyrën e shërbimit që do të kryhet;

- Në 1 rast në procedurën e prokurimit “Shërbim printim për ISSH-n, viti 2020” është bërë përllogaritja e fondit limit në vlerën 535,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë procedura e zhvilluar vitin e kaluar për këtë prokurim, çmimi mesatar i tre ofertat e ofruara, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues I S me vlerë 317,720 lekë pa TVSH dhe 381,264 me TVSH, ku llogaritet 0.72 leke/ faqe dhe jo 0.88 lekë/faqe siç është miratuar, me një diferencë prej 0.16 leke/faqe * 440000 kopje = 70,400 lekë llogaritur më tepër fondi limit *në kundërshtim*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Kriteri	<i>me përcaktimet e Nenit 59 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.</i> Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar”; - Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenin 4/26; - Ligji nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat”; - Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Nenit 59, 61, pika 2 e nenit 62, Kreu IX, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4; - Udhëzimi i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36, 42, 43, 45, 47, 52 dhe 54; - Udhëzimi Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3, 7, 9, 14, 15, 16, 17 dhe 18.
Impakti	Mos argumentim në hartimin e fondit limit, mangësi në administrimin e dokumentacionit të procedurave, marrjes në dorëzim e mallit, mosplotësim të kriterëve përcaktuar në ftesën për ofertë dhe mospërdorimi me efektivitet i fondeve të institucionit.
Shkaku	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	ISSH të marrë të gjitha masat që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël që zhvillon, të argumentojë hartimin e fondit limit, hartimin e kriterëve për kualifikimin, të administrohet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, të punëve apo shërbimeve, procesverbali konstatues paraparak për ato rastet kur nevojitet, ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara; të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas kriterëve të përcaktuar në ftesën për ofertë.
Gjetja	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e termave të referencës dhe argumentimin e fondit limit si dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues.
Situata	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2020 konkretisht në procedurën me objekt “<i>Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore</i>” zhvilluar në 2020, me fond limit 7 816 350 lekë, u konstatua se: Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar veçorit apo karakteristikat për objektet e ndërtimet edhe konstruksionet shoqëruara me foto, skica apo planimetri, gjëndjen teknike të tyre, gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214- Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218 inventarin ekonomik. - Në termat e referencës është përfshirë dhe sigurimi për rastet:- <i>Përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij; - Rrëshqitjes së Tokës.</i> Për këto raste nuk ka asnjë të dhënë, relacion apo studim risku nëse këto ngjarje kanë ndodhur në të kaluarën dhe mundësia e ndodhjes së tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	Mangësit në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. - Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjektit mbi vlerësimin e procedurës për shpalljen fitues të shoqërisë “Intersig Vienna Insurance Grup”, konstatohet se OE ka përmbushur kriteret e DST, përveç përcaktimit të kontratës së risigurimit, pasi sipas letër konfirmimi datë 06.01.2020, kontrata e risigurimit për shoqërinë “Intersig Vienna Insurance Grup” mbulon vetëm vitin 2020, ndërkohë që në kriteret për kualifikim është përcaktuar se: <i>Ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.</i> Kontrata e sigurimit të aseteve është lidhur për një periudhë 1 vjecare nga data 10.03.2020-09.03.2021, <i>pra periudha e kontratës për vitin 2021 nuk është e mbuluar me kontratë risigurimi sipas përcaktimeve të DST. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO.</i>
Kriteri	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59- Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, neni 66-Shqyrtimi dhe Vlersimi i ofertave, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar”.
Impakti	Mos argumentim në hartimin e fondit limit si dhe mospërdorimi me efektivitet i fondeve të institucionit
Shkaku	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi 1	ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë që për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, argumentimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcaktojnë nevojën për punë, shërbime dhe mallra. ISSH, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.
Rekomandimi 2	ISSH të marrë masa të analizojë rast pas rasti mangësit e konstatuara në procedurat e prokurimit, të nxjerrë përgjegjësit, si dhe të inicioj kontrolle në vijimësi për respektimin e procedurave.
Gjetja	Përlllogaritja e nevojave të AK për sasinë karburantit për vitin 2019 është e paargumentuar dhe nuk është e saktë.
Situata	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2019 konkretisht në procedurën me objekt “Blerje karburant për ISSH-në” zhvilluar në 2019, me fond limit 1,880,000 lekë, u konstatua se: nga autoriteti kontraktor (Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm) dhe Njësia e Prokurimit nuk disponohet asnjë dokument për përlllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për 100 km, të çdo automjeti. - Në parashikimin e normës prej 13000 litra, janë përfshira dhe Gjenerator 2 me 300 litra dhe Lundër me 2000 litra, por nuk ka asnjë dokument apo relacion mbi gjëndjen teknike të gjeneratorit, përdorimin e tij gjatë vitit si dhe normën e konsumit. Sipas kontratës së lidhur Nr 3988/5 datë 19.07.2019,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Neni 6- Afatet dhe mënyra e furnizimit, pika 6.2, në automjetet që do furnizohen me karburant, janë përfshirë vetëm 5 automjete nga 7 që janë llogaritur në tabelën e konsumit, mungojnë automjetet TR8765R dhe TR8763R. Mbi bazën e kësaj tablele është bërë përllogaritja e sasisë së karburantit për hartimin e fondit limit. Gjithashtu sipas inventarit kontabël 31.12.2019, rezulton se automjetet me Targa TR8765R dhe TR8763R, janë bërë dalje nga ISSH duke i kaluar DRSSH-ve, përkatësisht automjeti me targa TR8765 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 8, datë 30.01.2019, automjeti me targa TR 8763 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 15, datë 13.02.2019, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në datë 02.07.2019.

Në këto kushte, konstatohet se përllogaritja e nevojave të AK për sasinë prej 13,000 litra karburant nuk është e saktë, e konfirmuar edhe nga fakti se kjo kontratë vazhdon të shërbejë dhe për vitin 2020.

Kriteri	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës.
Impakti	Mos argumentim në hartimin e fondit limit
Shkaku	Mungesa e dokumentacionit justifikues për nevojën për karburant
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	ISSH të marrë të gjitha masat që në vijimësi në përllogaritjen e nevojave për karburant të bazohet në dokumentacion justifikues, tabelën e konsumit të karburantit, procesverbalin për përllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për çdo automjet dhe pajisje, të mbajtur nga komisioni përkatës.

Gjetja	Mos argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit
Situata	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2019 konkretisht në procedurën me objekt “Blerje karburant për ISSH-në” zhvilluar në 2019, me fond limit 1,880,000 lekë, u konstatua se: hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit që lidhen me kapacitetin ekonomik financiar, teknik si dhe aftësin zbatuese të operatorit ekonomik janë vendosur në mënyrë të paargumentuar.

Kriteri	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 2, paragrafi 2, Neni 27, pika 4.
Impakti	Mos plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve.
Shkaku	Mos mbajtja e procesverbalit të argumentimit të kriterëve
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë që për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, kriteret e veçanta për kualifikim ti argumentojë në një procesverbal dhe justifikojë ato me volumet dhe natyrën e punëve të kërkuara, në mënyrë që të krijojë një pjesëmarje të gjerë të operatorëve ekonomikë.

B.7. Auditim i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rekrutimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në buxhet. Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve gjyqftues me vendim gjykate të formës së prerë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në zbatim të pikës “6” të programit të auditimit nr. “Nr 676/1 Prot., datë 23.07.2020”, për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Struktura dhe organika e Institutit të Sigurimeve Shoqërore*
- *Dosjet e punonjësve të vlerësimit e punës, trajnimet, përshkrimet e punës, rekrutime,*
- *Rregullorja e Brendshme e ISSH*
- *Veprimtaria e KA, dosje vendimesh*
- *Data baza e vendimeve gjyqësore*
- *VKA Nr.3/2 datë 20.02.2008 “Për personelin e ISSH”.*
- *VKM nr. 262, datë 07.05.2014.*
- *VKM Nr.263, datë 07.05.2014*
- *Urdhri Nr.2518 prot datë 03.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*
- *Urdhri Nr.2597 prot datë 05.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*
- *Urdhri Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*
- *Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,*

Për vitin 2018 numri i punonjësve në strukturën organizative të Drejtorisë Qendrore të ISSH-së është 158, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.955 prot, datë 01.02.2017 dhe përbëhej nga:

Struktura	Nr. i punonjësve viti 2018
Drejtori i Përgjithshëm	1
Zëvendësdyrëtor	3
Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm	5
Drejtoria e Burimeve të Informacionit	11
Drejtoria e Financës	20
Drejtoria e Kontributeve	12
Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm	25
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	12
Drejtoria e Përfitimeve	22
Njësia e Inspektimit të Përfitimeve	19
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	9
Drejtoria Juridike	10
Drejtoria e Integritetit	9
Totali	158

Gjate vitin 2019 struktura organizative e Drejtorisë Qendrore të ISSH-së ka ndryshuar 3 herë, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Për vitin 2019, nga 158 punonjës plan, rezultojnë 156 punonjës në fillim të vitit janar dhe 154 punonjës në dhjetor 2019.

1) Me Urdhër Nr.2518 prot datë 03.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë ndryshimi i strukturës si në vijim:

-është pakësuar një vend Specialist për Debitorët në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës.

-është shtuar një vend pune Specialist në Sektorin e Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata në Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve.

2) Me Urdhër Nr.2597 prot datë 05.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë ndryshimi i strukturës si në vijim:

-është pakësuar një vend “Specialist në Sektorin e ndjekjes së procedurave gjyqësore dhe ankimit” në Drejtorinë Juridike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-është shtuar një vend pune “Specialist për Kërkesë-Ankesat” në Sektorin e Procedurave Administrative, Letrave dhe Platformës së Bashkëqeverisjes”.

3) Me Urdhrin Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, është bërë ndryshimi i strukturës si në vijim:

-është pakësuar një vend “Specialist i marrëdhënieve me shtypin dhe median” në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun.

-është shtuar një vend pune “Pastrues” në Sektorin e Administratës pranë Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm.

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, në dhjetor të vitit 2019 paraqitet sipas tabelës “Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, viti 2019”, Kreu Aneke. Pra në total numri i punonjësve gjatë vitit 2019 mbetet i pandryshuar, në raport me vitin 2018

Nga auditimi u konstatuan mangësi si në vijim:

- Në Rregulloren e brendshme për përshkrimin të punës u konstatua se kjo Rregullore nuk i përgjigjet strukturës aktuale, duke e bërë jonfunktionale në lidhje me detyrat e përcaktuara për çdo pozicion pune, pasi i përgjigjet strukturave të mëparshme të ISSH. Përpos faktit që në shumicën e Drejtorive nuk është përcaktuar kriteri i arsimit dhe eksperiencës.

Në Rregulloren e përshkrimin të punës për 6 drejtori nuk janë përcaktuar kriteri i arsimit dhe eksperiencës si më poshtë:

1. Drejtoria e financës (për 20 pozicione pune).

2. Drejtoria e integritit, marrëveshjeve, marrëveshjeve reformave dhe kërkimi social (për 7 pozicione pune).

3. Njësia e inspektimit të përfitimeve (19 pozicione pune).

4. Drejtoria përfitimeve (1 pozicion pune).

5. Drejtoria e Burimeve të Informacionit (1 pozicion pune).

6. Drejtoria e Administrimit të përgjithshëm (2 pozicione pune).

Në Rregulloren për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së janë përfshirë dhe detyrat funksionale për Drejtoritë Rajonale, por nuk janë të përcaktuara kriteret e arsimit dhe eksperiencës në punë. Situata për vitin 2019, është në të njëjtat kushte me vitin 2018.

Megjithatë nga auditimi konstatohet se pas rekomandimeve të lëna nga KLSH, në raportin e auditimit për vitin 2019, nga ana e ISSH janë marr masa për përmirësimin e situatës në lidhje me Rregulloren. Aktualisht Rregullorja ka përfunduar dhe pritet për miratim nga ana e KA.

Konstatohet se ndryshimet në strukturë janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74, pika b/1 “Kompetencat e Këshillit Administrativ” ku citohet se “Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Por me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së, Drejtori i Përgjithshëm është autorizuar për rialokime të burimeve njerëzore dhe ndryshime në strukturë, pa tejkalim të numrit total të punonjësve të miratuar nga VKA.

Vendim i Këshillit Administrativ	Numri punonjësve të miratuar
3/1, datë 26.02.2008	1153
Nr.5, datë 20.07.2010	1153
Datë 04.07.2011	1225
Nr. 7 , datë 29.04.2015	1279
Nr.26, datë 11.12.2015	1297
Nr. 18, datë 20.12.2017	1337



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloren “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 3/2, datë 26.02.2008, Vendimit nr.15, datë 20.10.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren nr.3/2 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, si dhe marrëdhëniet e pagave dhe shpërblimeve në rregulloren Financiare të ISSH nr. 5, datë 25.05.2009.

♦ Në lidhje me emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve, gjatë vitit 2019

Emërimet në ISSH 2019

Përgjatë vitit 2019 në ISSH janë emëruar 12 punonjës. Nga auditimi konstatohet se: Për procedurën e rekrutimit të punonjësve të rinj, nuk është zbatuar VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1 ku citohet: *“Vendet e lira të punës, brenda sistemit të sigurimeve shoqërore, plotësohen në varësi të kategorisë dhe natyrës së postit, nëpërmjet njërës prej procedurave të mëposhtme: a) me rekrutimin e personelit nëpërmjet konkurrimit të hapur; b) nëpërmjet konkurrimit të brendshëm nga personeli ekzistues.”* dhe pika 1.6 ku citohet: *“Njoftimi për shpalljen e vendit të lirë të punës, në rastin e procedurës së konkurrimit të hapur, bëhet njoftim në shtyp. Në njoftim duhet të përcaktohen...”* dhe pika 2. Komandimi i përkohshëm në detyrë. Paragrafi 2.4 *“Kur për nevoja operacionale, të dokumentuara, kërkohet, detyrimisht plotësimi i menjëhershëm i një vendi të lirë pune të sapokrijuar, atëherë mund të kryhen ngritje të përkohshme në kategori ose lëvizje paralele e punonjësve ekzistues ose të kontraktohen punonjës jashtë administratës së sigurimeve.”* dhe 2.4 *“Kur pavarësisht nga procedurat e mësipërme nuk arrihet zënia e vendit të lirë të punës, komandimi shtyhet dhe për tre muaj të tjerë”*

Për punonjësit e emëruar gjatë vitit 2019, u bë auditimi i dosjeve, për të verifikuar plotësinë dhe kualifikimin e tyre. Konstatohet se për punonjësit e larguar nga Institucioni ka disa mangësi të pjeshme dokumentacioni në dosjet e tyre, veçanërisht në kërkesa për punësim, referenca, certifikata etj. (dosja e ish-Drejtorit të Administrimit të Përgjithshëm). Për punonjësit e tjerë, në përgjithësi dosjet disponojnë dokumentacionin e nevojshëm. Problematikë mbetet fakti i komandimeve dhe rikomandimeve të herëpashershme. Gjithashtu konstatohet se përgjatë vitit 2019 janë vetëm 2 transferime në ISSH: një nga DRSSH Tiranë dhe një nga Drejtoria e Arkivit Qendror me kërkesën e tyre.

Largime në ISSH 2019

Përgjatë vitit 2019 janë larguar 15 punonjës nga të cilët:

- 8 me dorëheqje
- 1 ka dal në KEMP
- 4 kanë dal në pension
- 1 ka ndërruar jetë
- 1 është transferuar në Drejtorinë e Arkivit Qendror.

Për sa më sipër nuk ka largime për masa disiplinore apo pa shkaqe të justifikuara të cilat do të rrisnin riskun për largime të padrejta nga puna që mund të ndikonin në buxhetin e shtetit financiarisht.

Përgjatë vitit 2019 konstatohet se janë emëruar definitivë 2 punonjës që vijnë me rinovim kontratash që prej vitit 2016 dhe 2017. Nuk është bërë procedurë konkurimi për pozicionin specialist.

Konstatohet se në faqen zyrtare të ISSH nuk është publikuar informacion për vende vakante të punonjësve, duke reflektuar kështu një nivel të ulët të transparencës institucionale. Nga auditimi konstatohet se sektori i burimeve njerëzore nuk ka kryer publikime të pozicionit të punës, pas komandimeve të personelit të ISSH.

► Funksionimi i Këshillit Administrativ të ISSH.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga:

1. Këshilli Administrativ
2. Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Administrativ është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 12 anëtarë nga të cilët:

- 6 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave;
- 3 përfaqësues të punëdhënësve;
- 3 përfaqësues të sindikatave të cilët përzgjidhen dhe vendosen me VKM.

2. Bazuar në nenin 71, pika 4 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, organet drejtuese të këtij institucioni e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të neneve 72-75, të po këtij Ligji. KA-ja përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë përfaqësues të qeverisë, të ndarë si më poshtë:

- një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave,
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë,
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore;
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë si dhe;
- një përfaqësues nga Instituti i Statistikave;

Funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave;

Caktimi i funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ është përcaktuar me VKM Nr.263, datë 07.05.2014, si më poshtë:

- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministër;
- Ministria e Financave, zëvendësministër (që mbulon veprimtarinë e të ardhurave);
- Ministria e Ekonomisë, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Ekonomik, Tregtisë dhe të Pronës Publike dhe Sipërmarrjes;
- Ministria e Shëndetësisë, Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Ministria e Drejtësisë, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit;
- Instituti i Statistikave, Drejtor i Përgjithshëm;

Sipas VKM Nr. 262, datë 7.05.2014 “Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve dhe të sindikatave më të përfaqësuara në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” janë përcaktuar 6 përfaqësues nga këto organizata si më poshtë vijon:

A. Për punëdhënësit:

- B A një përfaqësues;
- Sh e B të U-P një përfaqësues;
- Sh e N të Sh një përfaqësues;

B. Për sindikatat:

- (KSSH) një përfaqësues;
- (BSPSH) një përfaqësues;
- S A U, T, T një përfaqësues;

Rezulton se është zbatuar drejtë pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr. 263, datë 07.05.2014 dhe VKM nr. 262, datë 07.05.2014.

Përbërja e Këshillit Administrativ, në fillim të vitit 2019 paraqitet si më poshtë vijon:

- | |
|--|
| 1. A D, kryetar përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave; |
| 2. A B, anëtar përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë, |
| 3. A Xh, anëtar përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë; |



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

4. - anëtar përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
5. D I, anëtar përfaqësues nga Instituti i Statistikave
6. L B, nënkryetar, përfaqësues nga Biznes Albania;
7. N H, anëtar përfaqësues nga Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije;
8. A K, anëtar përfaqësues nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë ;
9. K N, nënkryetar, përfaqësues nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
10. G K, anëtar përfaqësues nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPSH);
11. B K, anëtar përfaqësues nga Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit;
- Përfaqësues si anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore nuk ka të emëruar.

Koha e shërbimit të anëtarëve të KA-së si përfaqësues të organizatave dhe sindikatave më të përfaqësuar është jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Këshilli Administrativ ka nxjerrë Vendime të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit kryesor të ISSH-së, duke rregulluar marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore. ISSH-ja ka për mision zbatimin e strategjive dhe politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore si dhe ngritjen dhe menaxhimin e sistemit të informacionit për fushën e vet të përgjegjësisë.

Gjatë vitit 2019 ka pasur ndryshime në përbërjen e anëtarëve të KA-së dhe konkretisht është konfirmuar zj. Rudina Degjoni si përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë, dhe z. Besmir Peja si përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Konstatohet se funksionet e Sekretarit të Këshillit Administrativ prej vitit 20.12.1999 kryhen nga znj. H D si detyrim që i vinte nga organigrama e asaj kohe. Në mbledhje të KA-së këtë funksion e ka mbajtur zj. S D, në kundërshtim me nenin 19, të VKM Nr. 161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” ku specifikohet se *Kryetari i KA-së duhet të autorizojë një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes*, si dhe nenit 2, pika 1 të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” mungon autorizimi i kësaj detyre.

► Veprimtaria e Këshillit Administrativ

Gjatë vitit 2019, **konstatohet** se Këshilli Administrativ, ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje në përputhje me Statutin e ISSH-së, Kreu V, neni 15 i tij, ku citohet se: “*Këshilli Administrativ mbledhet jo më pak se 4 herë në vit*”.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar çështje të përcaktuara në rendin e ditës dhe procesverbalet janë mbajtur nga personi përgjegjës për mbajtjen e tyre. KA-ja, në mbledhjet e tij për vitin 2019, bazuar në projektvendimet e paraqitura, të shoqëruara me relacionet përkatëse ka nxjerrë gjithsej 18 vendime.

Çështjet e trajtuara në mbledhjet e Këshillit Administrativ përcaktohen në rendin e ditës së mbledhjeve, sipas përcaktimit në pikën 2.4 të “*Rregullores për funksionimin të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore*” duke specifikuar se përbëhet nga tre pjesë, ku pjesa e parë ka të bëjë me projekt ligjet dhe projekt aktet nënligjore, pjesa e dytë ka të bëjë me projektet me karakter urgjent, sipas vlerësimit të dy nënkryetarëve ose Drejtorit të Përgjithshëm dhe pjesa e tretë me raportime, informacione dhe probleme të tjera të ISSH.

► Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ për vitin 2019.

Nr.i mbledhjes	Dt. mbledhjes	Vendimet e marra
1	Dt.18.02.2019	Vendim nr.11, datë 18.02.2019 “Për disa shtesa e ndryshime në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”. Vendim nr.12, datë 18.02.2019 për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes Proces verbal i mbledhjes dt.18.02.2019.
2	Dt.28.03.2019	Vendim nr.15, datë 28.03.2019 “Për miratimin e projekt VKM “Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”. Vendim nr.16, datë 28.03.2019 Për miratimin e projekt VKM “Për indeksimin e pensioneve”. Vendim nr.17, datë 28.03.2019 për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

		Proces verbal i mbledhjes së dt.28.03.2019
3	Dt.31.07.2019	<u>Vendim nr.18, datë 31.07.2019</u> “Për miratimin e projekt VKM “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.787, date 28.01.2015. <u>Vendim nr.19, datë 31.07.2019</u> “Për një shtesë në Vendimin nr. 409, datë 1.06.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për ngushtimin e diferencave në masën e pensionit”. <u>Vendim nr.20, datë 31.07.2019</u> “Për miratimin e projekt VKM “Për dokumentacionin, indeksimin, procedurat e financimit të përfitimeve dhe transfertën nga buxheti I shtetit, në zbatim të ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. <u>Vendim nr.21, datë 31.07.2019</u> “Për miratimin e projekt VKM “Për disa ndryshime në VKM nr. 793, 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. <u>Vendim nr.22, datë 31.07.2019</u> “Për transferimin e përfitimeve për përfituesit me vendbanim jashtë territorit të Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore”. <u>Vendim nr.23, datë 31.07.2019</u> “Për miratimin e rregullores “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar suplementar të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. Proces verbal i mbledhjes së dt.31.07.2019.
4	Dt. 06.12.2019	<u>Vendim nr.24, datë 06.12.2019</u> “Për miratimin e “Projekt Ligjit “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” (i ndryshuar). Vendim nr.25, datë 06.12.2019 « Për miratimin e rezultatit financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2018”. Vendim nr.26, datë 06.12.2019 “Për Buxhetin e Drejtorive Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2020”. Vendim nr.27, datë 06.12.2019 “Projekt VKA “Për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikantë”. <u>Vendim nr.28, datë 06.12.2019 për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes.</u> Proces verbal i mbledhjes së datës 06.12.2019.

Mbledhja e parë e KA, është mbajtur në datën 18.02.2019. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e datës 18.02.2018 kanë marrë pjesë 9 anëtarë të KA-së konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (datë 25.02.2019) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Mbledhja e dytë e KA, është mbajtur në datën 28.03.2019. Sipas procesverbalit të mbledhjes, kanë marrë pjesë 9 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (datë 04.04.2019) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Mbledhja e tretë e KA, është mbajtur në datën 31.07.2019. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e datës 19.12.2018 kanë marrë pjesë 8 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (datë 05.08.2019) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Mbledhja e katërt e KA, është mbajtur në datën 06.12.2019. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e datës 19.12.2018 kanë marrë pjesë 8 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (datë 16.12.2018) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Konstatohet se procesverbali i 3 mbledhjeve të para është firmosur nga anëtari Gëzim Kalaja, por nga listë pagesat e urdhër transfertave konstatohet se nuk është paguar. Gjithashtu në dosje mungojnë njoftimet për mbledhje i cili duhet të dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm 10 ditë përpara tek të gjithë anëtarët e Këshillit Administrativ.

Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Administrativ konstatohet se, në mbledhjet e realizuara, numri i anëtarëve ka qenë 9 në mbledhjen e parë, 9 në mbledhjen e dytë, 8 në mbledhjen e tretë dhe 8 në mbledhjen e katërt. nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2019 nuk është vepruar në përputhje me nenin 72 të ligjit 7703, pika 1, germa “a” e ligjit, tek -“Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”, sepse KA nuk ka emëruar 12 anëtarë.

Në mbledhjen e datës 06.12.2019 është miratuar rezultati financiar i vitit 2018 ne tejkalim te afatit te parashikuar ne Rregulloren Financiare, Kreu VI “*Kontrolli financiar dhe raportimi*”/çështja D “Raportimi”/nënçështja 3, ku specifikohet se “*Raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet*”.

Komisioni Disiplinor

Në lidhje me veprimtarinë e Komisionit Disiplinor, përbërja e tij është e përcaktuar në Rregulloren e personelit si më poshtë:

Komisioni Disiplinor në ISSH përbëhet nga:

- Drejtori i Drejtorisë Juridike-Kryetar
- Drejtori i Drejtorisë së Përfitimeve-Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Kontributeve-Anëtar

Detyrën e sekretares së komisionit e kryen sekretarja e Këshillit Administrativ

Gjatë vitit 2019 nuk ka patur asnjë masë disiplinore dhe si rrjedhojë nuk ka patur raste të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore .

Vlerësimi i performances së punonjësve

Vlerësimi i punonjësve për vitin 2019 është kryer brenda afatit të caktuar sipas rregullores datë 10.02.2020 dhe është depozituar në dosjet personale të secilit punonjës. Ky vlerësim ka një format tip, në të cilin punonjësit janë vlerësuar me pikë. Shkalla më e lartë e vlerësimit është 100 pikë. Në përgjithësi punonjësit janë vlerësuar në intervalin 72 pikë – 100 pikë.

Trajnimet

Gjatë vitit 2019 është arritur të trajnohen rreth **520 punonjës** të sistemit të Sigurimeve Shoqërore. **Aktivitete trajnuese** janë kryer në ambientet e ISSH-së me specialistë të degëve të ndryshme nga të gjitha DRSSH-të. Është bërë plani vjetor për planifikimet e trajnimeve për vitin 2019 me nr.296 Prot datë 11.01.2019. Sipas planit, janë përcaktuar temat kryesore sipas fushave dhe Drejtorive, ku janë përfshirë punonjës të ndryshëm nga Drejtoritë Rajonale. Sipas planit janë caktuar 30 tema trajnimi, por janë realizuar vetëm 20 OSE 67 % e tyre, për shkak edhe të situatës së tërmetit në fund të vitit 2019.

- "Ndryshimet në programin PASH" trajnim 2-ditor, me specialistët e përfitimeve afatshkurtra, 10-11 janar 2019
- "Problematika, zbatimi i rregullores, kriteret klinike orientuese për mjekët e paaftësisë së përkohshme në punë" 28 shkurt 2019, ora 10 00 – 16 00, në ambientet e ISSH
- "Procedurat e caktimit të përfitimeve afatgjata monitorimi sistematik i ushtruar" me K/Degës së Përfitimeve në DRSSH 3 prill 2019
- "Funksionimi i sistemit PCAMS, forma e re e PASH, 10 prill 2019, ISSH
- “Për punësimin e studentëve të ekslencës në Institucionet e administratës shtetërore jashtë shërbimit civil” 11 prill 2019
- “Caktimi i përfitimeve, zbatimi i Ligjit 10142, 15.05.2009, i ndryshuar” me specialistët e përfitimeve suplementare në DRSSH, 17 prill 2019
- "Zbatimi i nenit 35, ligji 7703, 11.05.1993, i ndryshuar, problematikat dhe sugjerimet" 23 prill 2019,
- "Sistemi menaxhimit financiar për audituesit, programi CMIS" me specialistët e auditit ISSH 3 maj 2019,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- "Zbatimi i vendimeve të formës së prerë të Gjykatës, zyra përmbarimore, begatimi pa shkak" me Juristët në DRSSH, 7 maj 2019, ora 10 00 – 16 00, në ambientet e ISSH
- "Dhënia e vërtetimeve nga sistemi CMIS, nga DPT me K/Degës së Informatikës në DRSSH 22 maj 2019,
- "Ndjekja, zbatimi dhe vlerësimi në dinamike i programit të ri të PASH" me Specialistët e PASH në DRSSH 30 maj 2019
- "Zbatimi i kodit të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve dhe punëdhënësve" me studentët e ekselencës të sapo punësuar 11.06.2019
- “Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës ndërmjet sektorëve, pjesë e procedurave të caktimit të përfitimit me qëllim zbatimin rigoroz të rregullores "Për caktimin Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve" me K/D Përfitimeve K/D Arkivës, Koordinatorët Mjekë KMCAP, P/Agjencive në DRSSH 25 – 26 qershor
- “Etika e punonjësve në sistemin e sigurimeve Shoqërore, rrit imazhin e Institucionit” me Studentët e ekselencës të sapo punësuar 27.06.2019
- "Rregullore e kontributeve, bashkëveprimi i specialistëve të sigurimit vullnetar me inspektorin pritës " me specialistet e kontributeve ne DRSSH, 26 shtator 2019 ora 10 00 – 16 00, në ambientet e ISSH
- "Përditësimi i njohurive mbi legjislacionin e zbatueshëm në fushën e sig. shoq. me qëllim ofrimin në kohë dhe cilësi të shërbimeve ndaj qytetareve" me K/D Përfitimeve, specialistët të përfitimeve afatgjata P/Agjensive në DRSSH (të ndarë në dy grupe) 12 tetor 2019
- “Njohja e specialistëve të sektorit të inspektimit të përfitimeve afatgjata me ndryshimet më të fundit ligjore dhe VKM sqaruese të dala në zbatim të tyre” afatgjata 28 tetor 2019
- “Barazia gjinore në ofrimin e shërbimeve në Administratën Publike“, 7 qershor ASPA
- “Kujdesi ndaj klientit dhe komunikimi, 26 janar, 30 mars, 4 prill, 11 prill, 18 prill, 5 korrik, ASPA
- “Trajnim për HRMIS“, 23 maj, 12 qershor, ASPA

Gjithsej janë trajnuar 343 punonjës nga DRSSH, 9 studentë të ekselencës, 6 praktikantë dhe 60 specialistë në ASPA. Konstatohet se këto trajnime janë realizuar për stafin e Drejtorive Rajonale dhe jo për stafin e ISSH.

Vendimet gjyqësore

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, konstatohet se në databazë rezultojnë 33 ish-punonjës nga të cilët:

- 5 i takojnë ISSH
- 1 arkivit qëndror Lundër
- 2 DRSSH Durrës
- 3 DRSSH Elbasan
- 6 DRSSH Gjirokastrë
- 6 DRSSH Korçë
- 8 DRSSH Kukës
- 1 DRSSH Tiranë
- 1 DRSSH Sarandë

Vendimet gjyqësore ndiqen dhe ekzekutohen nga secila DRSSH.

Të ndara sipas DRSSH ekzekutimet e vendimeve gjyqësore rezultojnë si në vijim:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Drejtoria/Dega	Nr total çështjesh gjyqësore	Vlera e ekzekutuar sipas databazës 2018-2020	Vlera e ekzekutuar vetëm për vitin 2019
ISSH	5	5,072,822	2,578,349
DRSSH Tirane	1	2,329,636	2,329,636
Arkivi Qendror Lunder	1	2,208,676	2,208,676
DRSSH Kukes	8	5,711,074	1,036,900
DRSSH Durrës	2	2,145,982	0
DRSSH Korce	6	2,497,234	2,426,344
DRSSH Gjirokastrë	6	3,026,976	1,072,422
DRSSH Elbasan	3	0	0
DRSSH Sarandë	1	3,600,000	3,600,000
TOTAL	33	26,592,400	15,252,327

Për sa më sipër konstatohet se vlera e ekzekutuar për vendime gjyqësore për largime nga puna për vitin 2019 është në vlerën 15,252,327, vlerë e cila i ka rënduar buxhetit të shtetit. Këto ekzekutime janë si rezultat i vendimeve të formës së prerë së Gjykata, dhe u takojnë largimeve nga puna të kryera gjatë vitit 2018.

Aktualisht janë në proces 2 në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe 7 në Gjykatën e Apelit. Për rastet që janë në proces gjyqësor grupi auditimit nisur nga vlera e padisë ka bërë një llogaritje si në vijim për të konkluduar një vlerë të përafërt, në rast se proceset gjyqësore përfundojnë me vendim të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të ISSH dhe të DRSSH-ve.

NR	Emer/Mbiemer	Drejtoria	Pozicioni	Paga e kërkuar në padi	Shkalla e parë		Gjykata e apelit	Vlera e pagës	Total
1	S L	ISSH	Drejtor i Auditit	14 paga		10 paga		124,520	1,245,200
2	E N	ISSH	Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm	21 paga		17 paga		129,149	2,195,533
3	A D	DAQ LUNDER	Drejtor i DAQ Lunder	19.5 paga		proces		129,149	2,518,405
4	U K	DRSSH ELBASAN	Inspektore bujku ALSSH Gramsh	15 paga		11 paga		57,704	634,744
5	G K	DRSSH ELBASAN	specialist verifikues	22 paga		18 paga		51,362	924,516
6	R K	DRSSH ELBASAN	Inspektore bujku ALSSH Librazhd	15 paga	përfunduar shk I	pushim		29,196	437,940
	TOTALI								7,956,338

Vlera e pritshme nëse vendimet përfundojnë në favor të ish-punonjësve të larguar nga puna dhe që kanë ngritur padi për largim të padrejtë nga puna shkon në 7,956,338 lekë.

Për vitin 2020 në Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH u konstatua:

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, në dhjetor të vitit 2020 paraqitet sipas tabelës “Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, viti 2020” në kreun Aneksë. Pra në total numri i punonjësve gjatë vitit 2020 mbetet i pandryshuar, në raport me vitin 2019. Gjithsej 158.

Numri i përgjithshëm i punonjësve përcaktohet me Vendim të Këshillit Administrativ, i cili propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm sipas nevojës së institucionit për plotësimin e strukturës, konkretisht ky numër nuk ka lëvizje për vitin 2020.

ISSH ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së e cila nuk ishte miratuar në KA deri në fund të vitit 2019. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrat Nr.2518 prot datë 03.04.2019, Nr.2597 prot datë 05.04.2019, Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Struktura organizative sipas kësaj rregullore, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të drejtorisë të Aparatit të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtorinë Rajonale. Ndryshimet në strukturë janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74, pika b/1 “Kompetencat e Këshillit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Administrativ” ku citohet se “Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Por me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së, Drejtori i Përgjithshëm është autorizuar për rialokime të burimeve njerëzore dhe ndryshime në strukturë, pa tejkalim të numrit total të punonjësve të miratuar nga VKA. Nga ana e ISSH-s janë marrë masa për rikonceptimin e një rregulloreje të re përgjatë vitit 2020, ku janë bërë disa shtesa dhe ndryshime për personelin e ISSH e cila u miratua nga ana e KA, ne mbledhjen nr. 2 të këtij këshilli me *Vendimin nr.5, datë.14.08.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren Nr.3/2, date 26.02.2008.” Personelin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore .*

Emërimet në ISSH 2020

Përgjatë vitit 2020 në ISSH janë emëruar 7 punonjës. Për punonjësit e emëruar gjatë vitit 2020, u bë auditimi i dosjeve, për të verifikuar plotësinë dhe kualifikimin e tyre . Në përgjithësi dosjet disponojnë dokumentacionin e nevojshëm. Problematikë mbetet fakti i komandimeve dhe rikomandimeve të herëpashershme.

Largime në ISSH 2020

Përgjatë vitit 2020 janë larguar 14 punonjës nga të cilët:

- 4 me dorëheqje
- 1 ka dalë në KEMP
- 7 kanë dalë në pension
- 1 masë disiplinore
- 1 është transferuar në Drejtorinë e Arkivit Qendror.

Për sa më sipër ka një largim me masë disiplinore për znj Rezarta Mersinin me pozicion pune Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm ,largim i bazuar ne *Rregulloren Nr.3/2 datë 26.02.2008, “Për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” Kapitulli V, pika 1, “Përbëjnë shkelje disiplinore”, germa (j) Kapitulli VI pika 3 “Largimi nga puna dhe zgjidhja e kontratës”, nënpika 1.2, germa (b) dhe (f), arsyeja e largimit masë disiplinore “Largim nga puna” me motivacion ,*

- a. Kryerja brenda ose jashtë kohës së punës, të veprimeve të cilat çënojnë interesat e detyrës zyrtare ose që pengojnë përmbushjen e saj;
- b. Shkeljes së integritetit dhe autoritetit, duke përdorur emrin dhe autoritetin e Kryetarit të Këshillit Administrativ të ISSH-së.
- c. shkeljes së kodit etik të ISSH-së, mos respektim i hierarkisë institucionale dhe vendimeve.

Vendet vakante

Në fakt për vitin 2020, janë 9 vende vakant.

Nga auditimi konstatohet Problematikë mbetet fakti i komandimeve dhe rikomandimeve të herëpashershme, dhe bërjes së konkursit pas komandimit.

Për procedurën e rekrutimit të punonjësve të rinj, u konstatua se nuk është zbatuar VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1 ku citohet: *“Vendet e lira të punës, brenda sistemit të sigurimeve shoqërore , plotësohen në varësi të kategorisë dhe natyrës së postit, nëpërmjet njëres prej procedurave të mëposhtme: a) me rekrutimin e personelit nëpërmjet konkurrimit të hapur; b) nëpërmjet konkurrimit të brendshëm nga personeli ekzistues.” dhe pika 1.6 ku citohet: “Njoftimi për shpalljen e vendit të lirë të punës, në rastin e procedurës së konkurrimit të hapur, bëhet njoftim në shtyp. Në njoftim duhet të përcaktohen...” dhe pika 2. Komandimi i përkohshëm në detyrë. Paragrafi 2.4 “Kur për nevoja operacional , të dokumentuara, kërkohet, detyrimisht plotësimi i menjëhershëm i një vendi të lirë pune të sapokrijuar, atëherë mund të*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

kryhen ngritje të përkohshme në kategori ose lëvizje paralele e punonjësve ekzistues ose të kontraktohen punonjës jashtë administratës së sigurimeve.” dhe 2.4 “ Kur pavarësisht nga procedurat e mësipërme nuk arrihet zënia e vendit të lirë të punës, komandimi shtyhet dhe për tre muaj të tjerë..

► Veprimtaria e Këshillit Administrativ për vitin 2020

Përbërja e Këshillit Administrativ, në vitin 2020 paraqitet si më poshtë vijon:

1. A D, kryetar përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave;
2. V V, anëtar përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
3. S H, anëtar Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike;
4. B B, anëtar përfaqësues i Ministrisë të Drejtësisë;
5. E Dh, anëtar përfaqësues si Drejtore e INSTAT-it;
6. L B, nënkryetar, përfaqësues nga Biznes Albania;
7. N H, anëtar përfaqësues nga Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije;
8. A K, anëtar përfaqësues nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë ;
9. K N, nënkryetar, përfaqësues nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
10. G K, anëtar përfaqësues nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPSH);
11. B K, anëtar përfaqësues nga Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit;
12.A C, anëtar përfaqësues Drejtor i Përgjithshëm (i komanduar) në FSDKSH

Gjatë vitit 2020 ka pasur ndryshime në përbërjen e anëtarëve të KA-së dhe konkretisht është konfirmuar znj. V V si përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe znj. S H Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike si përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 9159 dt 22.05.2020, dhe me shkresën nr.7750 prot, datë 14.12.2020 është caktuar znj A C, Drejtor i Përgjithshëm (i komanduar) në FSDKSH, si përfaqësues në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. ; E D, anëtar përfaqësues si Drejtore e INSTAT-it;

Konstatohet se Këshilli Administrativ, ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje në përputhje me Statutin e ISSh-së, Kreu V, neni 15 i tij, ku citohet se: *“Këshilli Administrativ mbledhet jo më pak se 4 herë në vit”*.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar çështje të përcaktuara në rendin e ditës dhe procesverbalet janë mbajtur nga personi përgjegjës për mbajtjen e tyre. Në mbledhje të KA-së këtë funksion e ka mbajtur zj.S D, KA-ja, në mbledhjet e tij për vitin 2020, bazuar në projektvendimet e paraqitura, të shoqëruara me relacionet përkatëse ka nxjerrë gjithsej 9 vendime.

Çështjet e trajtuara në mbledhjet e Këshillit Administrativ përcaktohen në rendin e ditës së mbledhjeve, sipas përcaktimit në pikën 2.4 të *“Rregullores për funksionimin të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”* duke specifikuar se përbëhet nga tre pjesë, ku pjesa e parë ka të bëjë me projekt ligjet dhe projekt aktet nënligjore, pjesa e dytë ka të bëjë me projektet me karakter urgjent, sipas vlerësimit të dy nënkryetarëve ose Drejtorit të Përgjithshëm dhe pjesa e tretë me raportime, informacione dhe probleme të tjera të ISSH.

Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ për vitin 2020.

Nr. i mbledhjes	DT. mbledhjes	Vendimet e marra
1	28.05.2020	Vendim nr.2, datë 28.05.2020“Për funksionimin e Komisioneve mjekësorë të caktimit të aftësisë për punë të invalidëve në kushtet e pandemisë Covid-19 “. Vendim nr.3, datë 28.05.2020 Për caktimin e afatit të dorëzimit të Deklaratës ” Për konfirmimin e kreditimit të llogarisë dhe rregullshmërinë e pagesave, në bankat e nivelit të dytë”” për shkak të zbatimit të masave në kushtet e pandemisë nga Covid -19 Vendim nr.4, datë 28.05.2020 për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes. Proces verbal i mbledhjes së dt.28.05.2020.
2	30.07.2020	Vendim nr.5, datë 14.08.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren Nr.3/2, date 26.02.2008.”Për Personelin e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

3	27.11.2020	Vendim nr.6, datë 27.11.2020 “Për miratimin e rezultatit financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2019”. Vendim nr.7, datë 27.11.2020 “Për Buxhetin e Drejtorive Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021”. Proces verbal i mbledhjes së datës 27.11.2020, për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes.
4	30.12.2020	Vendim nr.8, datë 30.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të drejtorive rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021”. Vendim nr.9, datë 30.12.2020 Proces verbal i mbledhjes së datës 30.12.2020, për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes.

Mbledhja e parë e KA, është mbajtur në datën 28.05.2020. Sipas procesverbalit të mbledhjes, kanë marrë pjesë 11 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga prezenca e firmosur në procesverbal. Kjo mbledhje nuk është paguar duke u mbështetur në Vendimin Nr. 267, datë 31.03.2020. Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor t ë disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjate periudhës së gjendjes së epidemisë e shkaktuar nga Covid-19, pika 2, *Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilat janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të administratës shtetërore, institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri ne përfundim të gjendjes se epidemisë se shkaktuar nga Covid-19, por jo me shume se tre muaj , nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.*

Mbledhja e dytë e KA, është mbajtur on line në datën 30.07.2020. Sipas procesverbalit të mbledhjes, kanë marrë pjesë 10 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga Urdhër transferata e bankës (datë 22.12.2020) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Mbledhja e tretë e KA, është mbajtur on line në datën 27.11.2020. Sipas procesverbalit të mbledhjes, kanë marrë pjesë 10 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga Urdhër transferata e bankës (datë 21.12.2020) dhe prezenca e firmosur në procesverbal.

Mbledhja e katërt e KA, është mbajtur në datën 30.12.2020. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e kryer on line kanë marrë pjesë 11 anëtarë të Këshillit Administrativ, e konfirmuar nga prezenca e firmosur në procesverbal.

Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Administrativ për vitin 2020 konstatohet se, në mbledhjet e realizuara, numri i anëtarëve ka qenë 11 në mbledhjen e parë, 10 në mbledhjen e dytë, 10 në mbledhjen e tretë dhe në të katërten 11 nga 12 anëtarë të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2020 është vepruar në përputhje me nenin 72 të ligjit 7703, pika 1, germa “a” e ligjit, tek -“Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”, sepse KA ka emëruar 12 anëtarë, por në mbledhje asnjëherë nuk kanë marrë pjesë 12 anëtarët duke influencuar në një farë mënyre në vendimmarrje.

Gjithashtu në dosje mungojnë njoftimet për mbledhje i cili duhet të dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm 10 ditë përpara tek të gjithë anëtarët e Këshillit Administrativ.

Në mbledhjen e datës 27.11.2020 është miratuar rezultati financiar i vitit 2019 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI “Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”/nënçështja 3, ku specifikohet se “Raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet”.

Komisioni Disiplinor

Në lidhje me veprimtarinë e Komisionit Disiplinor, përbërja e tij është e përcaktuar në Rregulloren e personelit si më poshtë:

Komisioni Disiplinor në ISSH përbëhet nga:

- Drejtori i Drejtorisë Juridike-Kryetar
- Drejtori i Drejtorisë së Përfitimeve-Anëtar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Drejtori i Drejtorisë së Kontributeve-Anëtar

Detyrën e sekretares së komisionit e kryen sekretarja e Këshillit Administrativ

Gjatë vitit 2020 ka patur një masë disiplinore por punonjësja e ka pranuar menjëherë rastin e vet dhe kështu nuk ka patur raste të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore .

Vlerësimi i performancës së punonjësve

Vlerësimi i punonjësve për vitin 2019-2020 është kryer brenda afatit të caktuar sipas rregullores datë 10.02.2020 dhe është depozituar në dosjet personale të secilit punonjës. Ky vlerësim ka një format tip, në të cilin punonjësit janë vlerësuar me pikë. Shkalla më e lartë e vlerësimit është 100 pikë. Në përgjithësi punonjësit janë vlerësuar në intervalin 72 pikë – 100 pikë.

Trajnimet

Nevojat për trajnim në institucion janë diktuar nga arsye të ndryshme si:

- njohjen me ndryshimet dhe vendimet e reja në legjislacion;
- promovimi i punës etj., proces ky i realizuar në përmjet analizave të punës dhe detyrave të gjithë secilit, veçanërisht në detyrat kryesore që kryen çdo njeri si vetëm, ashtu dhe brenda grupit dhe institucionit.
- marrja në punë e punonjësve të rinj; realizimi i detyrave të përditshme sipas standardeve; ndryshimet në teknikë (informatizimi);

Për vitin 2020 është miratuar me shkresë nr. 219 prot, datë 10.01.2020 ,kalendari i trajnimeve për vitin 2020, nga ku është realizuar vetëm një program trajnimi për arsye të situatës së pandemisë Covid -19 e cila ka sjell vështirësi në realizimin e aktiviteteve trajnuese për stafin e ISSH-së, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit. Si rezultat, është arritur që gjatë vitit 2020 e në vazhdim punonjësit janë trajnuar kryesisht në mënyrë individuale kur ka lindur nevoja, Përsa u përket të punësuarve të rinj kane marrë asistencë teknike nga punonjës me eksperiencë në sistemin e sigurimeve.

Vendimet gjyqësore

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, konstatohet se për vitet 2019-2020 në databazë rezultojnë 36 ish-punonjës me vlerë të padisë të ekzekutuar prej 27,047,019 lekë.

Për sa më sipër konstatohet se shkallët e para të gjykimit janë fituar nga punonjësit çka tregon se vendimet e marra për largimet nga puna janë të pa drejta dhe vlera që do ju kthehet punonjësve rëndon buxhetin e shtetit.

Vendimet gjyqësore ndiqen dhe ekzekutohen nga secila DRSSH.

Data baza e vendimeve gjyqësore që ka lidhje edhe me vendimet e DRSSH-ve është për efekt raportimi.

Për sa më sipër konstatohet se ka disa mangësi si:

-mos realizimi plotësisht i trajnimeve me gjithë vështirësitë e krijuara si pasojë e situatës krijuar nga pandemia Covid -19 e cila ka sjell vështirësi në realizimin e aktiviteteve trajnuese për stafin e ISSH-së, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit gjë e cila mund të ishte realizuar online;

- në drejtim të komandimit të përkohshëm në punë të punonjësve në kundërshtim me , VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1 dhe pika 1.6, pika 2. Komandimi i përkohshëm në detyrë. Paragrafi 2.4 dhe 2.4.

- në drejtim të mos marrjes pjesë në mbledhje të këshillit të 12 anëtarëve të tij e cila është në kundërshtim me, Nenin 72 të ligjit 7703, pika 1, germa “a” e ligjit, tek -“Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”

- mos miratimit në kohë të rezultatit financiar të vitit 2019 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI “Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

“Raportimi”/nën çështja 3, ku specifikohet se “*Raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet*”.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt konstatimi Nr.5 datë 27.04.2021 i dorëzuar e protokolluar në ISSH me nr.4047/11 prot. datë 27.04.2021. Në lidhje me këtë akt nuk u paraqitën vërejtje nga personat me të cilën u mbajt.

Gjetje: Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2019 dhe 2020, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores së më parshme të pa miratuar nga Këshilli Administrativ dhe që paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrat Nr.2518 prot datë 03.04.2019, Nr.2597 prot datë 05.04.2019, Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Situata: ISSH ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme në ISSH-së e cila nuk është miratuar në KA. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrat Nr.2518 prot datë 03.04.2019, Nr.2597 prot datë 05.04.2019, Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Struktura organizative sipas kësaj rregullore, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të drejtorisë të Aparatit të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtoritë Rajonale. Ndryshimet në strukturë janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74, pika b/1 “Kompetencat e Këshillit Administrativ” ku citohet se “*Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore*”. Por me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së, Drejtori i Përgjithshëm është autorizuar për rialokime të burimeve njerëzore dhe ndryshime në strukturë, pa tejkalim të numrit total të punonjësve të miratuar nga VKA. Nga ana e ISSH-s janë marr masa për rikonceptimin e një rregulloreje të re përgjatë vitit 2020, e cila është miratuar në mbledhjen nr. 2 e KA me *Vendimin nr.5, datë.14.08.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren Nr.3/2, date 26.02.2008.” Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për personelin por jo si strukture organizative.*

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20.
Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 të Sigurimeve Shoqërore, të ndryshuar, neni 74.

VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i hapësirave për rekrutim të një stafi të pakualifikuar, ndikim në performancën e punonjësve dhe mbarëvajtjen e punës.

Shkaku: Mos marrja e masave për analizimin dhe miratimin e saj sipas kërkesave dhe përcaktimeve ligjore në lidhje me kualifikimet e nevojshme për punonjësit e ISSH-s.

Rëndësia: E mesme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Rekomandime: ISSH të marrë masa, për amendimin e Rregullores dhe miratimin e saj në me VKA, për përmisimin e saj në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative të ISSH, për t’iu përgjigjur strukturës aktuale organizative, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet ligjore për struktura të veçanta. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masa për mbikëqyrjen e Rregullores dhe implementimin e saj në ISSH, sipas përcaktimeve dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Gjetje: Përgjatë vitit 2019 dhe 2020 në ISSH nuk janë ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe komandimit për vendet e punës vakante, duke rekrutuar punonjës pa konkurrim të hapur. Konstatohen punonjës që janë rekrutuar me kontrata me afat të përcaktuar 3 mujore, disa prej të cilave ripërsëritura, pa u emëruar. Pas largimit të punonjësve, pozicionet e punës nuk janë paraqitur si vende vakante. Në dosjet e personelit të larguar u konstatuan mungesa të pjesshme në dokumentacion. Trajnimet e zhvilluara përgjatë vitit, në përgjithësi janë realizuar për stafin e Drejtorive Rajonale dhe jo për stafin e ISSH.

Situata: Përgjatë vitit 2019 në ISSH nuk janë ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe komandimit për vendet e punës vakante, duke rekrutuar punonjës pa konkurrim të hapur. Konstatohen punonjës që rekrutohen me kontrata me afat të përcaktuar 3 mujore, disa prej të cilave ripërsëriten pa u emëruar. Nga auditimi konstatohet se: Për procedurën e rekrutimit të punonjësve të rinj, nuk është zbatuar VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1 ku citohet: *“Vendet e lira të punës, brenda sistemit të sigurimeve shoqërore, plotësohen në varësi të kategorisë dhe natyrës së postit, nëpërmjet njërës prej procedurave të mëposhtme: a) me rekrutimin e personelit nëpërmjet konkurrimit të hapur; b) nëpërmjet konkurrimit të brendshëm nga personeli ekzistues.”* dhe pika 1.6 ku citohet: *“Njoftimi për shpalljen e vendit të lirë të punës, në rastin e procedurës së konkurrimit të hapur, bëhet njoftim në shtyp. Në njoftim duhet të përcaktohen...”* dhe pika 2. Komandimi i përkohshëm në detyrë. Paragrafi 2.4 *“Kur për nevoja operationale, të dokumentuara, kërkohet, detyrimisht plotësimi i menjëhershëm i një vendi të lirë pune të sapokrijuar, atëherë mund të kryhen ngritje të përkohshme në kategori ose lëvizje paralele e punonjësve ekzistues ose të kontraktohen punonjës jashtë administratës së sigurimeve.”* dhe 2.4 *“Kur pavarësisht nga procedurat e mësipërme nuk arrihet zënia e vendit të lirë të punës, komandimi shtyhet dhe për tre muaj të tjerë...”* Pas largimit të punonjësve, pozicionet e punës nuk janë paraqitur si vende vakant. Në dosjet e personelit të larguar konstatohen mungesa të pjesshme në dokumentacion veçanërisht në kërkesa për punësim, referenca, certifikata etj. Trajnimet e zhvilluara përgjatë vitit, në përgjithësi janë realizuar për stafin e Drejtorive Rajonale dhe jo për stafin e ISSH.

Kriteri: VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1, pika 1.6 dhe pika 2.

Ndikimi/Efekti: Mos garantim për realizimin e detyrave funksionale të pozicionit të punës dhe mirëfunksionimin e Institucionit

Shkaku: Moszbatimi i VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” dhe i dispozitave ligjore në fuqi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:** Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH të marrin masa për:
- plotësimin e vendeve të lira të punës me staf të kualifikuar dhe në përputhje me strukturën organizative
 - përfshirjen në trajnime të gjithë personelit të ISSH-s dhe DRSSH-ve, me qëllim mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.
- Gjetje:** Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ përgjatë vitit 2019 janë konstatuar disa mangësi pasi nuk janë emëruar 12 anëtarë, në kundërshtim me nenin 72, i ligjit nr.7703, pika 1/a “Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”, nuk ka patur punonjës të emëruar në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 19, dhe për vitin 2020 janë emëruar 12 anëtarë por asnjëherë mbledhjet nuk kanë patur 12 anëtarë pjesëmarrës, të VKM Nr. 161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” dhe rezultati financiar i vitit 2018 dhe 2019 nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara në Rregullore.
- Situata:** Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ (KA) si:
- Për funksionimin e KA nuk është zbatuar neni 72, i ligjit nr.7703, pika 1/a “Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”, sepse nuk janë emëruar 12 anëtarë. Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Administrativ konstatohet se, në mbledhjet e realizuara, numri i anëtarëve ka qenë 9 në mbledhjen e parë, 9 në mbledhjen e dytë, 8 në mbledhjen e tretë dhe 8 në mbledhjen e katërt. nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nuk ka punonjës të emëruar në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 19, të VKM Nr. 161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” ku specifikohet se: *“Kryetari i KA-së duhet të autorizojë një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes”*, si dhe nenit 2 pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*. Rezultati financiar i vitit 2018 nuk është miratuar sipas rregulloreve financiare, pika *“Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”/nën çështja 3*, ku specifikohet se *“raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet”*, duke e miratuar atë në mbledhjen e datës 06.12.2019.
- Kriteri:** Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar; Statuti i ISSH-së, VKM Nr.161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së”, Ligji nr.8480, datë 27.5.1999 Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike, Rregullore financiare, pika *“Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”*.
- Ndikimi/Efekti:** Ndikim në funksionimin e Institucionit dhe vendimmarrjen
- Shkaku:** Moszbatim i dispozitave ligjore të Institucionit
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandime:** Këshilli Administrativ të marrë masa për zbatimin e rregullave në zhvillimin e mbledhjeve dhe ushtrimin e kompetencave në zbatimin e detyrave e përgjegjësitë e tij, për shmangien e parregullsive të konstatuara, me qëllim përmirësimin e aktivitetit të tij.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

8. Të tjera të trajtuara gjatë auditimit.

Pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit janë paraqitur dy ankesa qytetarësh, të cilat kanë të bëjnë me pretendime në lidhje me masën e pensionit të pleqërisë.

Duke qenë se nga ana e KLSH pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore sipas Programit të Auditimit nr.671/1, datë 23.07.2020 është ushtruar auditim këto ankesa u adresuan, sipas shënimeve në kartelat shoqëruese janë përcjellë për adresim në institucionin e ISSH, me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe kthim përgjigje ankuesve.

Këto ankesa u trajtuan në këtë mision auditimi dhe paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

1- Ankesa e paraqitur me shkresën e shtetases E K me adresë: Rruga: "A M", Kompleksi "M", Apartamenti, A. T.

Kjo ankesë është protokolluar në KLSH me nr.780 Prot. datë 17.08.2020 dhe u protokollua në ISSH me nr. 4047/2 Prot. datë 23.08.2020.

Në ankesë pretendohet llogaritje gabim e pensionit të pleqërisë duke pretenduar se do të duhej të ishte llogaritur si pension minimal shtetëror dhe jo si pension kooperative.

Në lidhje me sa pretendohet në ankesë nga ana e institucionit të ISSH pasi u bënë verifikimet e nevojshme në lidhje me pretendimet duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar e të administruar nga ISSH rezultoi se, kërkesa e ankueses nuk qëndron dhe njëkohësisht nga ISSH u përgatit dhe dërgua shkresa kthim përgjigje ankueses me shkresën nr. 4047/4 datë 30.09.2020 duke ju vendosur një kopje në dispozicion të grupit të auditimit.

Përgjigja në mënyrë të përmbledhur konsiston në faktin se, periudha e punës për ankuesen në ish-kooperativen bujqësore K, fshati R është nga viti 1978 deri në vitin 1990, gjithsej 18 vite, 11 muaj e 18 ditë dhe se në dosje nuk administrohet asnjë dokument zyrtar që të provon qenien në punë si kuadër dhe as vendim emërimi si kuadër në ish-KB. Nga llogaritja e periudhave të punës ka rezultuar se ankuesja ka realizuar 16 vite 2 muaj e 16 ditë pune në marrëdhënie me shtetin dhe përfitimi është caktuar në zbatim të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas nenit 92 të ligjit kërkohej 35 vite periudhë sigurimi dhe për të përfituar pension pleqërie urban duhet që ankuesja të kishte realizuar 17 vite e 6 muaj vjetërsi pune në shtet, ndërkohë që ka realizuar (sipas dokumentacionit) 16 vite, 2 muaj e 16 ditë.

Rezulton se, ankuesja, mbështetur në nenin 86 të Ligjit 7703/1993, i ndryshuar, ka ndjekur procedurën e ankimit administrativ, duke paraqitur ankesë në Komisionin Rajonal të Ankimit në DRSSH Tiranë i cili me vendimin nr.1 datë 19.01.2015 ka refuzuar kërkesën e saj dhe ka lënë në fuqi vendimin e Degës së Përfitimeve duke e sqaruar edhe me shkresën e ISSH nr. 5431/5 datë 21.11.2014.

2- Ankesa e shtetasit Xh A me adresë: Lagjia “I B”, Rruga: "N V", V.

Kjo ankesë është protokolluar në KLSH me nr.749 Prot. datë 03.08.2020 dhe sipas shënimeve në kartelën shoqëruese është përcjellë për adresim në institucionin e ISSH në të cilën u protokollua me nr. 4047/2 Prot. datë 23.08.2020.

Në lidhje me sa pretendohet në ankesë nga ana e Institucionit të ISSH pasi u bënë verifikimet e nevojshme në lidhje me pretendimet duke u bazuar në informacionin e marrë dhe nga Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë rezultoi se, kërkesa e ankuesit nuk qëndron dhe njëkohësisht nga ISSH u përgatit dhe dërgua shkresa kthim përgjigje me shkresën nr. 4047/3 datë 30.09.2020 duke ju vendosur një kopje në dispozicion të grupit të auditimit. Në këtë rast përsa i përket, ndër të tjera, kërkesës së bërë nga ankuesi për tju mundësuar takimi i drejtpërdrejtë në zyrat e DRSSH Vlorë, pavarësisht rregullave të pandemisë, kjo kërkesë ju aprovua duke e njoftuar personin, në shkresën kthim përgjigje dhe me faktin se, ISSH ka



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ngarkuar DRSSH Vlorë që ta sqarojë, pranë zyrave të saj, mbi caktimin e përfitimit sipas ligjit 29/2019 dhe për gjithë pretendimet e tij.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit të buxhetit të ISSH për vitin 2019-2020, u konstatua se:

Programimi i buxhetit realizohet në 15 njësitë e sistemit për: 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtorinë Qendrore të Arkivit, Llogarinë e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm); Sektorin e Buxhetit të Përgjithshëm, ku realizohen transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale për pagesat e pensione, marrëdhëniet financiare me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Bankën e Shqipërisë.

Programi i përgjithshëm i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore të subjekteve me përgjegjësi mbledhjeje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat. ISSH është pjesëmarrëse vetëm në Ekipin e Menaxhimit të Programit, ngritur në MFE. Funkcioni i anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit konsiston kryesisht në realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore.

Në procesin e programimit të shpenzimeve nuk janë përfshirë të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke bërë që ISSH të ketë një ndikim të ulët në mbledhjen e të ardhurave, sidomos për subjektet që nuk paguajnë kontribute dhe në rakordimin e të dhënave të tyre me listë pagesat e dërguara nga DPT, problematikë që ndikon jo vetëm në identifikimin e subjekteve debitorë të kontributeve por dhe në monitorimin e plotë të procesit. Kjo procedurë është në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me ligjin nr.7703, datë 01.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat standarte të përgatitjes së PBA” të ndryshuar; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vjetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të mundësojnë përfshirjen e ISSH në të gjitha fazat e programimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e këtyre të ardhurave, në mënyrë që ato mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen referuar një analize të drejtë dhe përfshirjen e të gjithë faktorëve ndikues.

1.2. Rekomandim: Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke pasur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të bazës së të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.

Deri me datë 31.12.2021 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2019, debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 12.6 miliard lekë ose 0.7 miliard lekë më shumë se viti 2018, ndërkohë që deficitin e skemës së qytetit, për vitin 2019, ka rezultuar në shumën 18.1 miliard



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

lekë, pra niveli i borxhit llogaritet sa 70% e deficitit të skemës së qytetit. Në vitin 2019, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 86,558 ose 13,818 subjekte më shumë se në vitin 2018. Pra numri i subjekteve debitorë është rritur me 19%, ndërkohë që debia është rritur në masën 5.9% krahasuar me vitin 2018. Borxhi prej 12.6 miliard lekë u përket 86,558 subjekteve, prej të cilave: 39,626 subjekte ose 46% e tyre janë subjekte aktive, me një debi në shumën 6,4 miliard lekë, ose 51% e debisë totale; 35,897 subjekte ose 41% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 5,7 miliard lekë, ose 45% e debisë totale (diferenca prej 13% janë subjekte të çregjistruar/kërkesë për çregjistrim/falimentuar).

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2020 paraqitet në shumën 19.2 miliard lekë, ndërkohë që deri në fund të vitit 2020 debitorët për sigurimet shoqërore nga organet tatimore rezultojnë në shumën 14.4 miliard lekë, pra niveli i borxhit është sa 75% e deficitit të skemës së qytetit, me një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020, për skemën e qytetit, numri i subjekteve debitorë arriti në 96,833 ose 10,275 subjekte më shumë se në vitin 2019. Shuma totale e debisë në vitin 2020 arriti në 14.4 miliard lekë ose 1.8 miliard lekë më shumë se në vitin 2019. Numri i subjekteve debitorë është rritur me 12%, ndërkohë që debia është rritur në masën 14% krahasuar me vitin 2019.

Borxhi prej 14.4 miliard lekë u përket 96,833 subjekteve, prej të cilave: 45,818 subjekte ose 47% e tyre janë subjekte aktive me një debi në shumën 7.4 miliard lekë, ose 51% e debisë totale; 38,398 subjekte ose 40% e tyre janë subjekte pasive me një debi në shumën 6.3 miliard lekë, ose 44% e debisë totale; 3 janë subjekte të çregjistruara me debi prej 7,515 lekë; 12,613 janë subjekte që kanë bërë kërkesë për çregjistrim me debi në shumën 0.6 miliard lekë dhe vetëm 1 subjekt i falimentuar me debi në shumën 10,000 lekë.

Numri i subjekteve debitorë në vitin 2020 është rritur me 12%, ndërkohë që debia është rritur në masën 14% krahasuar me vitin 2019. Subjekte buxhetore debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 rezultojnë 491 subjekte me debi totale në shumën 385,683 mijë lekë, nga 492 subjekte me debi totale në shumën 452,490 mijë lekë për vitin 2019. Nga këto subjekte buxhetore debitorë për sigurimet shoqërore, 200 subjekte ose 40.6% të subjekteve e kanë principalin 0, që do të thotë, në këto subjekte nuk ka punëmarrës të pasiguruar

Mos pagesat e kontributeve nga ana e punëdhënësve për punëmarrësit e tyre, krijojnë deficit në fondin e sigurimeve shoqërore në tërësi dhe në mbulimin e shpenzimeve të programuara për pagesat e pensione në veçanti. Pas borxheve të subjekteve debitorë qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk përfitojnë, jo për fajin e tyre, nga skema e sigurimeve shoqërore. Kjo procedurë është në mospërputhje me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar dhe Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr.1142, datë 19.05.2017 ndërmjet ISSH dhe DPT (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 69-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi: ISSH në bashkëpunim me MFE të ndërmarrin masat e nevojshme për mbledhjen dhe sistemimin e borxheve të subjekteve buxhetore dhe krahas tyre të marrin masat për sistemimin e kontributeve individuale në llogaritë e periudhave të sigurimit.

2.2-Rekomandimi: Nga ana e ISSH me qëllim për të zgjidhur problematikën e krijuar ndaj individëve të punësuar në subjekte juridike e që rezultojnë me detyrime kontributive të papaguara, si dhe për të zgjidhur problematikën e shfaqura në mosnjohjen e periudhave të sigurimit, të punëmarrësve, subjektet e të cilëve kanë detyrime kontributive, të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative, duke përfshirë përsa është e mundur dhe e nevojshme iniciimin e ndryshimeve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.

Brenda vitit 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e skemës së fshatit dhe problematikat e saj, konstatohet se, për vitin 2019 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 14,065,531 mijë lekë, të cilat i kanë përfituar 121,208 persona, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrë lindjet.

Për vitin 2020 shpenzimet për pensionet e fshatit janë realizuar në shumën 13,676,769 mijë lekë me një ulje prej 388,762 mijë lekë nga viti 2019, të cilat i kanë përfituar 115,443 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, si dhe shpenzimet për barrë lindjet.

Konstatohet se shpenzimet e skemës së fshatit sipas programeve, krahasuar me të ardhurat e mbledhura janë mbuluar kryesisht nga buxheti i shtetit, ku diferencën më të madhe e ka dega e barrë lindjeve, në të cilën të ardhurat për vitin 2020 mbulojnë vetëm 28,7% të shpenzimeve, ndërsa në vitin 2019 mbulonin 38% të shpenzimeve të kësaj dege, gjë e cila tregon rritjen e masës së kontributit buxhetor për këtë degë.

Problematikë mbetet subvencionimi i skemës së fshatit në një masë shumë më të madhe edhe në pagimin e pensioneve, duke krijuar subvencionim të dyfishtë për fermerët, si në kontribut, por dhe në përfitim, gjë që është e unifikuar në përfituesit e tjerë që paguajnë vetë të gjithë kontributin. Shteti ka kontribuar në skemën e fshatit në subvencionimin në vitin 2019 në shumën 1,980 milion lekë, ose në masën 47.2% të të ardhurave të skemës dhe në vitin 2020 në shumën 1,684 milion lekë, ose në masën 50.2% të të ardhurave të skemës.

Për shkak të interesit shumë të ulët të të vetëpunësuarve në bujqësi për të paguar kontribut, në vitet e fundit nuk është bërë rritja e masës së kontributit, duke “ngrirë” në një nivel prej 38,400 lekë për zonat fushore dhe 29,400 lekë për zonat malore, ndërkohë që një i vetëpunësuar në qytet paguan 66,240 lekë në vit kontribute, ku për të vetëpunësuarin në bujqësi diferencën e përballon buxheti i shtetit, ndërsa për efekt pensioni këto periudha konsiderohen të barabarta për të dy kategoritë.

Subvencionimi i lartë për kontributet nga buxheti i shtetit për bujqit, pjesëmarrja e ulët në skemë edhe për shkak të masës së lartë të kontributit referuar dhe produktivitetit të ekonomive bujqësore, shpesh me sipërfaqe të vogla dhe jo eficiente, pamundësia e detyrimit për të paguar kontribute, si dhe lënia mbi baza vullnetare e pagesës së kontributit, ka sjellë problematikat e skemës së fshatit, duke thelluar defiçitin e saj dhe mbulimin në masë më të madhe nga buxheti i shtetit.

Defiçiti i skemës së fshatit edhe pse rezulton më i ulët në krahasim me programimin, sikurse në disa vite radhazi, ka pësuar rritje duke kaluar nga 9,796,089 lekë ose 0.58% të PBB për vitin 2019 në 10,322,244 lekë ose 0.66% PBB në vitin 2020.

Në kushtet e thellimit të defiçitit të skemës, e cila përballohet nga buxheti i shtetit, me qëllim eliminimin sa më shumë të këtij defiçiti e për pasojë dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit mbetet e vetmja rrugë ajo e zbatimit të sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në përshtatje sa më të plotë me stadin e arritur të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Kjo kërkon rishikimin, me qëllim zgjerimin e parimit kontributiv të sistemit, duke riformuluar skemën e pensioneve për personat e vetëpunësuar në bujqësi.

Për këto arsye, ashtu si dhe vetë ISSH ka konkluduar, për realizimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, në mënyrë që të krijohet mundësia, që nëse një bujk dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlogaritur mbi bazën e një page më të lartë. Një ndërhyrje e tillë në legjislacionin garanton nga njëra anë mos cënimin e sistemit, të formulës së llogaritjes së përfitimeve apo të parimit kontributiv të skemës dhe nga ana tjetër adreson dhe krijon nxitjen e nevojshme të një kategorie të caktuar të popullsisë në drejtim të rritjes e ndërgjegjësimit për mundësinë e përfitimit të një pensioni më të lartë. Kjo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

do të çojë në krijimin e ofrimit të një mundësie shtesë si për skemën ashtu dhe për individin (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1-Rekomandimi: Nga ISSH të merren masat e nevojshme për uljen e deficitit të skemës së fshatit si dhe të barrës kontributive të buxhetit të shtetit për këtë skemë, duke rritur numrin e kontribuuesve bujq, si dhe të vazhdohet realizimi i inicimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, i ndryshuar, me qëllim që në të të parashikohet mundësia, që nëse një bujq dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përlogaritur mbi bazën e një page më të lartë.

Brenda vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë kontrolleve të kryera nga Sektori i Kontrollit të Pagesave, gjatë vitit 2019, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 861 raste, në shumën 20,487 mijë lekë, ose 66% më pak se në vitin 2018, ku dëmtimet arritën në shumën 67,845 mijë lekë. Në vitin 2020, në total, për të gjithë rajonet, janë konstatuar fonde të dëmtuara, në 969 raste, në shumën 18,364 mijë lekë, ose 11% më pak se në vitin 2019, ku dëmtimet arritën në shumën 20,487 mijë lekë.

Shkeljet e konstatuara për vitin 2019 kanë rezultuar të natyrave të ndryshme si: dublim pagesash, pagesa pas vdekjes, pagesa marrë tepër ose pagesë jashtë afatit, prej të cilave, 64 raste, ose 7% e rasteve, rezultojnë dublim pagese në shumën 1,844 mijë lekë; 702 raste, ose 82% e tyre, rezultojnë pagesa pas vdekjes në shumën 15,916 mijë lekë dhe 95 raste, ose 11% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 2,276 mijë lekë. Për vitin 2020 shkeljet e konstatuara sipas natyrës renditen në 46 raste, ose 4.5% e rasteve, dublim pagese në shumën 839 mijë lekë; 863 raste, ose 92% e tyre, pagesa pas vdekjes në shumën 16,869 mijë lekë; 60 raste, ose 3.5% e rasteve, pagesa dhënë tepër dhe jashtë afatit, në shumën 657 mijë lekë. Rastet e dublimit të pagesës lidhen kryesisht me pagesat në ato banka që ende nuk janë pjesë e sistemit on-line. Sistemi on- line zbatohet për mbi 60 % të pagesave. Jashtë këtij sistemi janë kryesisht bankat e nivelit të dytë, BKT dhe I S B A që kanë 90 % të pensioneve off-line që paguhet në banka. Kjo procedurë e ndjekur është në mospërputhje me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Marrëveshjen nr.4357, datë 21.08.2008 lidhur ndërmjet ISSH dhe Postës Shqiptare (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 69-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1-Rekomandimi: ISSH të intensifikojë bashkëpunim me BKT dhe I S B A të cilat kanë 90 % të pensioneve që paguhet në banka off-line, me qëllim finalizimin e automatizimit të sistemit të pagesave të pensioneve nga këto banka (kalimin on-line), duke synuar eliminimin e pagesave të dubluara.

Brenda vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Problematikë në zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH mbetet dërgimi i listë pagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012. Në fund të vitit 2019 rezultojnë gjithsej 1,506,140 listë pagesa të munguara prej të cilave, 1,423,634 ose rreth 94.5% janë listë pagesa të munguara të të vetë punësuarve (biznes i vogël); 78,804 ose 5.32% janë listë pagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,702 apo 0.25% janë listë pagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Gjatë vitit 2019 u janë dërguar nga ana e DRT-ve, DRSSH-ve, gjithsej 14,283 listë pagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012 prej të cilave, 832 listë pagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore), 2,106 listë pagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 11,345 listë pagesa të subjekteve biznes i vogël. Në fund të vitit 2020 rezultojnë gjithsej 1,501,931 listë pagesa të munguara (4,209 më pak krahasuar me vitin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

2019), prej të cilave 1,421,307 ose rreth 94.6% janë listë pagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznes i vogël); 77,033 ose 5.13% janë listë pagesa të munguara të biznesit të madh (firma private) dhe 3,591 apo 0.24% janë listë pagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Volumin më të madh të listë pagesave të munguara për periudhën 2019-2020 me rreth 95% të totalit e ka biznesi i vogël, të cilët përgjithësisht janë “Të vetëpunësuar të vetëm”, por një pjesë e tyre janë persona “Të vetëpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë” siç janë anëtarë të tjerë të familjes që punojnë e jetojnë me të vetë punësuarin. Sipas marrëveshjes ISSH-DPT pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për këtë kategori biznesi do të merren si liste pagesa të mirëfillta (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 47-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: ISSH të zhvillojë një program informatik, nëpërmjet të cilit të mundësojë krijimin e bazës së të dhënave për personat “Të vetëpunësuar të vetëm”, duke përdorur informacionin e marrë zyrtarisht nga DPT, me synim zgjidhje në mbi 80% të rasteve, për këtë kategori personash, që rezultojnë me liste pagesa të munguara. Për personat “Të vetëpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë”, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, ISSH të marrë masa që të kryejë njoftime dhe në rastet pa adresë të bëjë fushatë sensibilizimi, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listë pagesave për këtë kategori.

Brenda vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Strategjia afatgjatë e sistemit të sigurimeve shoqërore e materializuar në Dokumentin e Politikave të Pensioneve të miratuara nga Qeveria, në themel të saj ka: *Respektimin e të drejtave financiare të fituara, duke i garantuar dhe zhvilluar ato; Formatimin e një sistemi pensionesh në përgjithësi dhe veçanërisht të pensioneve individuale të varura drejtpërdrejt nga kontributet e paguara, nëpërmjet të cilit standardizon dhe ruan në një shkallë të pranueshme raportin pagë/pension në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë; Një qëndrueshmëri fiskale të sistemit të përmirësuar në një periudhë afatmesme.*

Gjatë periudhës 2019-2020, krahas arritjeve në realizimin e objektivave të vendosur nga ISSH, janë identifikuar risqe të cilët vënë në rrezik arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, ndër të cilët më kryesorët janë: Niveli shumë i lartë i detyrimeve për kontribute të papaguara në subjektet juridike dhe fizike; Mangësi administrative në zbatimin e përgjegjësi të posteve të ëork-floë të konformimit dhe gjenerimit të përfitimeve për pagesë, mos llogaritja drejt e bazës së vlerësuar, si dhe vitet e sigurimit, për shkak të mos sigurimit të dokumenteve, vonesave në proceset gjyqësore, moszbatim të koeficientëve të indeksimit, mostrajtimi i njëjtë nga ana e DRSSH-ve për probleme të njëjta sa i përket mënyrës së llogaritjes së pensioneve; Mangësi në identifikimin e numrit të ri të përfituesve për shkak të emigracionit dhe programimit të përafërt të pensioneve të pleqërisë invaliditetit dhe familjar, që mbyllen; Vonesa në inspektimin e përfitimeve (krahasuar me momentin e caktimit të përfitimit); Vonesa në dixhitalizimin e listë pagesave të kontributeve për periudhën 1994- 2011, etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 47-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në ISSH, me synim arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e indikatorëve të vendosur në plan veprimin e zbatimit të strategjisë afatmesme, me synim minimizimin e risqeve, që vënë në rrezik përmbushjen e indikatorëve të vendosur me fokus, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimin e deficitit të skemës së pensioneve duke synuar rritjen graduale, por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

Brenda vitit 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020 për fondet e dëmtuara të vitit 2019, rezultoi se kanë mbetur pa arkëtuar gjithsej 36 raste në rajonin e Tiranës, të gjitha pagesa të pensioneve pas vdekjes së përfituesve të paguara me autorizim ose prokurë, në shumën 534,866 lekë ose rreth 3% e totalit të fondeve të dëmtuara.

Për fondet e dëmtuara të vitit 2020, nga verifikimi i pagesave të kryera deri në datën 19.04.2021, rezultoi se janë pa arkëtuar 29 raste, të gjitha pagesa pas vdekjes të paguar me autorizim ose prokurë në shumën 593,884 lekë. Në marrëveshjen shtesë nr. 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare nuk parashikohet në asnjë dispozitë mënyra e rekuperimit të këtyre fondeve të paguara me prokurë në rast të vonesave në arkëtimin e tyre, si dhe nga ana e ISSH nuk rezultojnë të jetë kryer asnjë veprim për rikuperimin e fondeve. Kjo procedurë e ndjekur është në mospërputhje me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me Marrëveshjen shtesë nr 2038, datë 12.06.2014 mes ISSH dhe Postës Shqiptare (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 69-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: ISSH të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative me qëllim arkëtimin e fondeve të dëmtuara nga pagesat e pensioneve të kryera pas vdekjes së përfituesve me autorizim ose prokurë.

Brenda vitit 2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultojnë nivel ende i lartë i dosjeve të painspektuara dhe të pacertifikuara, si dhe detyrime të pa arkëtuara. Për vitin 2019, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, nga të dy sektorët, janë inspektuar 57219, nga këto 50719 dosje përfitimi objekt inspektimi, 6500 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total kanë rezultuar 1401 dosje debitore me efekt financiar në shumën 88,088,781 lekë dhe 1908 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 77,506,145 lekë, si dhe një efekt financiar debitor 9,136,821 lekë nga pezullimet për 6 dosje. Për vitin 2020, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, nga të dy sektorët, janë inspektuar 51415 përfitime, nga këto 49879 dosje përfitimi objekt inspektimi, 1536 zbatim rekomandimesh. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 78,935,547 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 36,425,780 lekë. Si përfundim rezultojnë se gjatë viteve 2019-2020, Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve afatgjata, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2015-31.12.2018. Gjatë periudhës 01.01.2015-31.12.2020, janë lëshuar 180869 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 85978 përfitime suplementare afatgjata, apo 47.5 %, dhe kanë mbetur pa inspektuar 94891, gati më shumë se gjysma e përfitimeve. Gjithashtu në 5 subjekte DRSSH Vlorë, Durrës, Berat, Gjirokastrë, Dibër periudha e pa kontrolluar rezultojnë që nga 01.01.2018, ndërkohë në DRSSH Elbasan që nga data 01.01.2017, çka do të përbente risk për mos evidentimin e shumave të përfituara tepër për shkak të kalimit të afatit ligjor 3 vite nga marrja e përfitimit në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, Neni 62 ligjit nr Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. - Njësia e Inspektimit, Sektori i përfitimeve suplementare, rezultojnë se gjatë viteve 2019-2020, ka inspektuar përfitime të lëshuara dhe të pa inspektuara për periudhën 01.01.2017-31.12.2019. Gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2020, janë lëshuar 34153 përfitime (të pa kontrolluara) nga 14 DRSSH/DSSH, nga të cilat janë inspektuar 11614 përfitime suplementare afatgjata, apo 34 %, dhe kanë mbetur pa inspektuar 22539 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 81-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve të marrë masa, që planifikimi i inspektimeve të kryhet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

brenda një viti nga data e lidhjes së pensioneve dhe të përfundojë inspektimin e certifikimin e dosjeve të lidhura nga viti 2017 e në vazhdim.

Brenda vitit 2021

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar 81 raste të përfituesve debitorë, që janë akoma në proces arkëtimi me një vlerë totale debitorë 25,377,547 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 4,709,362 lekë dhe kanë mbetur pa arkëtuar 20,668,185 lekë, më hollësisht trajtuar sipas tabelës “*Lista e subjekteve debitorë në proces arkëtimi për vitet 2019-2020*”, 11 subjekte përfitues debitor që nuk janë futur në proces arkëtimi me vlerë 1,990,346 lekë, trajtuar sipas tabelës “*Lista e subjekteve debitorë që nuk janë futur në proces arkëtimi 2019-2020*”, Kreu V-Aneksë, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 81-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të fillojë procesin e arkëtimit për 11 përfitues në vlerën 1,990,346 lekë si dhe të ndjekë në vazhdimësi procesin e arkëtimit për 81 përfitues në vlerën e mbetur 20,668,185 lekë.

Brenda datës 31.11.2021

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se niveli i masave disiplinore në raport me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në DRSSH-t, nuk është i njëjtë nga njëri subjekt inspektimi në tjetrin. Nga analiza e treguesve për dosjet me problematika rezulton se subjektet që kanë numrin më të lartë dosjeve me problematika janë DRSSH Kukës, Tropjë dhe Sarandë, ndërkohë që masa disiplinore janë propozuar vetëm për DRSSH Kukës, Tropojë, Elbasan dhe nuk është propozuar për DSSH Sarandë megjithëse ka përqindje më të lartë të dosjeve me problematika se sa DRSSH Elbasan. Në rastin e DRSSH Tiranë sipas Raportit Përfundimtar janë konstatuar mangësi dhe shkelje për 21 Inspektor dhe nuk është propozuar masë disiplinore. Nga *Spektori Inspektiveve të Përfitimeve Suplementare* dhe të veçanta për vitin 2019 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Korçë dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 14.29% dhe DRSSH Tiranë me 14.3 %, të cilat kanë përqindjen më të lartë të dosjeve me problematika. Në rastin e DRSSH Tiranë janë konstatuar 497 dosje me probleme, nga të cilat 224 me efekt financiar në shumën 18,840,102 debitor dhe 2,297,413 kreditor. Nga *Spektori Inspektiveve të Përfitimeve Suplementare* dhe të veçanta për vitin 2020 është propozuar vetëm një masë disiplinore për DRSSH Dibër dhe asnjë masë për DRSSH Lezhë me 15.4% dosje me problematika dhe DRSSH Shkodër me 12.32 % dosje me problematika. Në disa raste në Raportet e Përfundimtare të Inspektimit nuk janë identifikuar dhe ngarkuar me përgjegjësi Inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në dosjet e përfitimit, përmendim këtu DRSSH Kukës dhe Elbasan për vitin 2019, por vetëm janë adresuar sipas Komunave apo Njësisve dhe nuk ka të dhëna për ecurinë e zbatimit të tyre. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pika 1 dhe 2, Kreu V të Rregullores nr.3/2, datë 26.02.2008 “Për miratimin e rregullores “Për personelin e ISSH-së”, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 14.08.2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren Nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 81-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: ISSH nëpërmjet Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve të rekomandojë marrjen e masave disiplinore në raport me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, duke zbatuar të njëjtin standard për çdo subjekt të inspektuar, gjithashtu të identifikojë Inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në dosjet e përfitimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Brenda vitit 2021

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, afatet për evadimin e materialeve, gjithashtu ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Në asnjë prej rregulloreve të administruara në ISSH nuk janë përcaktuar afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi inspektimit në terren, mbajtja e akt konstatimeve, hartimi i Raportit Paraprak, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i Raportit Përfundimtar dhe evadimi i materialeve të inspektimit. Në dosjet e inspektimit nuk administrohen informacione periodike për raportimin e ecursisë së inspektimit nga Specialistët dhe nga Përgjegjësit e Sektorit në kundërshtim me përcaktimet bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, pika 1.7.2 dhe 1.7.3, gjithashtu në Rregullore nuk është parashikuar periodha periodike e raportimit. Në rregullore ka mbivendosje kompetencash të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, pasi në Kreun X- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Prezantimi Detyrave/ për Auditues, ndër të tjera citohet se: - *Kontrollon respektimin e standartëve të cilësisë për administrimin e shërbimeve; - për përfitimet afatshkurtra dhe afatgjata: Kontrollon respektimin e rregullave të dhënies së të drejtës, vërtetësisë së dokumenteve justifikuese dhe llogaritjen e përfitimeve.* Në këtë pikë në kompetencat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është përfshirë dhe kontrolli i përfitimeve afatgjata që është kompetencë e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 81-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për të bërë ndryshime në rregulloret, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj, duke përcaktuar qartësisht afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi i inspektimit në terren deri tek evadimi i materialeve të inspektimit, afatin për raportimin periodik nga çdo inspektor dhe Përgjegjësi i Sektorit. Gjithashtu të bëjë ndryshimet përkatëse në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, me qëllim shmangien e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.

Brenda vitit 2021

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Njësia e Inspektimit nuk ka menaxhuar siç duhet burimet njerëzore në dispozicion. Nga Inspektimet e ushtruara në vitin 2019-2020, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, rezulton se nga raporti i afateve të shfrytëzuara për secilin inspektim me volumin e punës apo numrin e dosjeve të inspektuara nuk ka një shpërndarje të drejtë dhe njëtrajtshme, ku për periodha më të shkurta kohore janë inspektuar një numër më i lartë dosjesh dhe anasjelltas, çka tregon një shfrytëzim jo eficient të kohës së punës sipas subjekteve të inspektuara. Nga të dhënat mbi inspektimet e ushtruara nga Njësia e Inspektimit për vitet 2019-2020, vërehet se për periodha të njëjta auditimi, shpërndarja e volumit të punës për secilin inspektor nuk është e njëjtë në raport me numrin total të dosjeve të inspektuara për subjektin përkatës. Gjithashtu nga verifikimi i evidencave mbi inspektimet e kryera për vitet 2019-2020, rezulton se planifikimi i shpërndarjes së inspektorëve sipas programeve të inspektimit për subjektet e inspektuara dhe numrit total të dosjeve të planifikuara për kontroll nuk është bërë në raport të drejtë, në subjekte që ka një numër më të vogël dosjesh përfitimi janë caktuar i njëjtë numër inspektorësh me ato subjekte që kanë volum më të madh dosjesh. Ndërkohë nga inspektimet e ushtruara nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta, për vitet 2019-2020, rezulton se 5 prej tyre DRSSH Vlorë, Sarandë, Fier, Berat dhe Gjirokastrë janë kryer në bashkëpunim me sektorin e Inspektimeve të përfitimeve afatgjata, me një numër



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

më të lartë inspektorësh, por numri dosjeve të inspektuara është më i vogël se sa subjektet e tjera të inspektuara gjatë viteve 2019-2020. Gjithashtu në inspektimet e kryera nga Sektori i Inspektimeve Suplementare dhe të veçanta rezulton se nga 18 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 14 prej tyre ka marrë pjesë si anëtar grupi dhe Përgjegjësi i Sektorit, ndërsa në Sektorin e Inspektimeve Afatgjata nga 15 inspektime të kryera për vitet 2019-2020, në 2 prej tyre ka marrë pjesë si anëtar grupi dhe Përgjegjësi i Sektorit. Në përshkrimet e bëra mbi përgjegjësit dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit sipas “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Urdhër nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu VII, nuk është parashikuar përfshirja e Përgjegjësit të Sektorit në programet e inspektimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 81-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për menaxhimin me efektivitet të burimeve njerëzore në dispozicion, sipas përcaktimeve të bëra në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Gjithashtu ISSH duhet të marrë masa të shtojë burimet njerëzore për këtë Njësi, me qëllim inspektimin dhe certifikimin e pensioneve të përfituara brenda afatit ligjor 3 vjeçar, si dhe shmangien e efekteve financiare për ISSH dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të këtij afati për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi mungesë e një databaze të plotë dhe gjithë përfshirëse të vendimeve gjyqësore të ISSH dhe DRSSH-ve, ndër vite, ndjekjen dhe ecurinë e tyre. Informacioni i disponuar grupit të auditimit është informacion statistikor, sipas së cilit nga viti 2019 në vitin 2020 ka rënë numri i proceseve gjyqësore nga 6316 në 5195 procese, gjithashtu ka rënë dhe numri i proceseve gjyqësore që janë humbur nga 3543 në 2504 procese, si dhe numri i proceseve gjyqësore që nuk janë ankimuar për shkak të VKM nr. 482, datë 29.06.2016, dhe VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, nga 2775 në 1987 procese. Nga të gjithë çështjet në gjykata në dy shkallët e para, rreth 84 % e tyre kanë kaluar në favor të kërkuësve, shumica e këtyre proceseve, të cilat rezultojnë të humbura, janë me objekt “Vërtetim fakti juridik”, me bazë ligjore nenin 388, të Kodit të Procedurës Civile, ku DRSSH-të kanë qenë palë e tretë. Këto gjyqe kanë karakter njohjeje. Në Gjykatën e Lartë aktualisht janë 1221 procese gjyqësore të mbartura ndër vite për shkak të mosfunksionimit normal të kësaj gjykate, të cilat përbejnë kosto si për individin ashtu dhe për institucionin.

Gjithashtu Drejtoria Juridike nuk ka mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për zbatimin e afateve në ekzekutimin e vendime gjyqësore të formës së prerë, për rastet kur këto vendime janë ekzekutuar me përmbarrim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, nuk ka relacione për ndjekjen dhe raportimin e tyre. Veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” sipas Urdhrit nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, Kreu- Detyrat dhe Përgjegjësit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 107-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të hartojnë një databazë të plotë të vendimeve gjyqësore, për ndjekjen dhe ecurinë e tyre për të gjitha shkallët e gjyqësorisht, për t'i mundësuar menaxhimin monitorimin, analizën dhe vlerësimin e ecurisë së proceseve në tërësinë e tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Brenda vitit 2021

13.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të evidentojë shpenzimet e vendimeve gjyqësore, duke mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. për rastet e vendimeve që janë ekzekutuar me përmbarrim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, ndjekjen dhe raportimin e tyre, si dhe të marrë masa për zbatimin e afateve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke shmangur rritjen e shpenzimeve përmbarrimore.

Brenda vitit 2021

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nga ISSH përveç raportimeve dhe evidencave statistikore nga DRSSH dhe DSSH për periudhën objekt auditimi 2019-2020 nuk ka të dhëna të tjera mbi zbatimin e VKM nr. 482, datë 29. 06. 2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni” si dhe VKM nr. 660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, mbi impaktin dhe efektet e tyre të shtrira në kohë që nga viti 2016, kur ka filluar zbatimi, evidentimi i mangësive apo risqeve, respektimi i procedurave ligjore në tërheqjen e ankimimeve nga DRSSH. Gjithashtu ka munguar koordinimi ndërmjet sektorëve të Drejtorisë Juridike/Sektorit i ndjekjes së procedurave dhe ankimimeve, me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, për të mbikqyrur punën e juristëve të DRSSH dhe DSSH, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në zbatim të këtyre VKM-ve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 107-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të menjëhershme për përcaktimin e strukturës përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në proceset gjyqësore në rastin e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29.06.2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”; VKM nr.660, datë 10.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr.77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar; VKM nr.657, datë 10.10.2019, “Për disa shtesa në vendimin nr.793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave ‘Për zbatimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”.

Brenda vitit 2021

15. Gjetje nga auditimi: Në Rregulloren e Brendshme të ISSH-së, për shkak të vjetërsisë në kohë të saj, e cila është hartuar që nga viti 2008 dhe mos amendimit në lidhje me Strukturën e DAB pas daljes së ligjit të AB në vitin 2014, paraqet mangësi në përcaktimet e saj në lidhje me: Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtuesin e njësisë dhe specialistët e AB, të cilat nuk janë të plota sipas përcaktimeve në nenet 14,15 dhe 16 të ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe MAB Kapitulli II pikat 2.6.1 dhe 2.6.3. Sipas rregullores



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Drejtori i NJAB ngarkohet me detyrë t'i propozojë Drejtori i Përgjithshëm argumenta për masa disiplinore, detyrë e cila nuk përfshihet në dispozitat ligjore të sipërpërmendura; Staf i auditimit të brendshëm nuk përjashtohet nga aktivitetet operacionale, ku në përshkrimin e punës të Drejtorit të AB në rubrikën “Marrja e vendimit” përcaktohet: “... nis dhe përgatit në bashkëpunim me Drejtorinë e ISSH, ligje, nënligje, udhëzime dhe rregullore për përmirësimin e veprimtarisë së ISSH”, bazuar në raportet e auditimit...”, detyrë kjo në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili përcakton se: “Audituesve të brendshëm u ndalohet të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese”. Kriteret e diplomës, të përvojës së punës në profesion dhe në fushën e auditimit të brendshëm si për Drejtuesin e DAB ashtu edhe për specialistët janë vendosur në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 ligjit 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nuk janë përcaktuar qartë linjat e komunikimit dhe raportimit, në disa drejtime, ndërmjet DAB, Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Bordit të Drejtorëve, Këshillit Administrativ, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi i veprimtarisë së DAB konstatohet se nga ana e audituesve në 16 raste nuk janë respektuar afatet e dërgimit të projekt raportit dhe raportit përfundimtar njësisë së audituar. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin. nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 14,15,16,17 të Kapitullit IV të Manuali i Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm (MAB) në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020, Kapitullit IV pika 4.1.12, (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 135-147, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për të finalizuar procesin e rishikimit të përmbajtjes së Rregullores së Brendshme të Funksionimit të saj, në lidhje me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm si për drejtuesin e njësisë dhe audituesit e brendshëm, si dhe mos përfshirjen e DAB në veprimtari operacionale me qëllim mos cënimin e objektivitetit, kompetencën dhe paanësinë e audituesve.

15.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të marrë masa, që të shmangë vonesat dhe të kërkojë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë, të respektojë dhe ti përmbahet kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në drejtim të respektimit të afateve të hartimit të dokumenteve të auditimit dhe përcjelljes së tyre në subjekt, përkatësisht projekt-raportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël është konstatuar se:

- Inventarët e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk janë plotësuar me numër rendor progresiv;
- Nuk është dokumentuar me procesverbal procedura e verifikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nëse operatori ekonomik ofertues ka në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet;
- Nuk është zbatuar i njëjti standard për hartimin e fondit limit, në ato raste ku është marrë si referencë kontrata e vitit të mëparshëm, pasi në disa procedura i referohet ofertës më vlerë më të ulët ndërsa në disa raste është marrë për bazë çmimi mesatar i tre ofertave të marra nga tregu;
- Në 9 raste sipas të dhënave nga sistemi elektronik i APP-së, ftesa për ofertë i është drejtuar 3 apo 4 operatorëve dhe jo 5 operatorëve;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Në realizimin e procedurave të prokurimit blerje “Bileta –Avioni”, në dosje nuk administrohet ftesa zyrtare drejtuar ISSH nga organizatorët e konferencës, seminareve apo trajnimeve, shoqëruar nga programi përkatës;
 - Në 5 raste në procedurat si vijon “Furnizimi i dispenserave me ujë të pijshëm për ISSH-në, 2019”; “Rinovimi i licensës së programit E-mail brendshëm për ISSH-në viti 2019”; “Riparim Automjetit tip Volkswagen Tiguan me targë AA 592 PM, viti 2020”; “Rinovimi i licensës së programit të antivirusit, viti 2020”; “Krijimi i Web- Service të dedikuar për organet gjyqësore dhe strukturat e Vetingut”, nuk janë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë;
 - Në 5 raste në ftesën për ofertë publikuar në sistemin elektronik nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik fitues, ku për shkak të natyrës së shërbimit, mallit apo punës që do të kryhet është e nevojshme dorëzimi i dokumentacionit që provon kapacitet e operatorit ekonomik;
 - Në 1 rast në zhvillimin e procedurës “Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit hidraulik” viti 2020, nga Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla nuk është mbajtur procesverbal sipas formularit standard nr. 4, si dhe fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit;
 - Në 3 raste mungon relacioni apo procesverbali paraprak konstatues për nevojën për mallra, punë dhe shërbime, mbajtur nga personat kompetent apo nga një komision i ngritur nga titullari i autoritet kontraktor;
 - Në 9 raste janë konstatuar mangësi në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve, pasi mungon procesverbali për marrjen në dorëzim, faturat tatimore janë firmosur nga magazinierja dhe jo nga anëtarët Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël, si dhe rastet kur nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët Komisionit, nuk janë ngritur grupe për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara;
 - Në 2 raste në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohet procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për shpalljen e fituesit;
 - Në 3 raste përcaktimi i kriterëve për kualifikim në ftesën për ofertë, nga Njësia e Prokurimit, nuk është i argumentuar dhe në raport të drejtë në krahasim me natyrën e shërbimit që do të kryhet;
 - Në 1 rast në procedurën e prokurimit “Shërbim printim për ISSH-n, viti 2020” është bërë përlllogaritja e fondit limit në vlerën 535,000 lekë pa TVSH, duke u marrë për bazë procedura e zhvilluar vitin e kaluar për këtë prokurim, çmimi mesatar i tre ofertat e ofruara, ndërkohë që autoriteti duhet ti referohet çmimit të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues I S me vlerë 317,720 lekë pa TVSH dhe 381,264 me TVSH, ku llogaritet 0.72 leke/ faqe dhe jo 0.88 lekë/faqe siç është miratuar, me një diferencë prej 0.16 leke/faqe * 440000 kopje = 70,400 lekë llogaritur më tepër fondi limit.
- Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenin 4/26; Ligji nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat”, Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Nenit 59, 61, pika 2 e nenit 62, Kreu IX, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, Udhëzimi i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36, 42, 43, 45, 47, 52 dhe 54, Udhëzimi Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3, 7, 9, 14, 15, 16, 17 dhe 18 (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 147-179, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

16.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat, që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të argumentohet hartimi i fondit limit, hartimi i kriterëve për kualifikim, të administrohet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, të punëve apo shërbimeve, procesverbali konstatues paraprak për ato rastet kur nevojitet, ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara; të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2020 me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore” zhvilluar në 2020, me fond limit 7 816 350 lekë, u konstatua se: Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar veçoritë apo karakteristikat për objektet, ndërtimet edhe konstruksionet shoqëruar me foto, skica apo planimetri, gjendjen teknike të tyre. Gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214- Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218 inventarin ekonomik. Në termat e referencës është përfshirë dhe sigurimi për rastet: - Përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij; - Rrëshqitjes së Tokës. Për këto raste nuk ka asnjë të dhënë, relacion apo studim risku nëse këto ngjarje, që kanë ndodhur në të kaluarën dhe mundësia e ndodhjes së tyre. Mangësitë në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. - Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjektit mbi vlerësimin e procedurës për shpalljen fitues të shoqërisë “I V I G”, konstatohet se OE ka përmbushur kriteret e DST, përveç përcaktimit të kontratës së risigurimit, pasi sipas letër konfirmimit datë 06.01.2020, kontrata e risigurimit për shoqërinë “I V I G” mbulon vetëm vitin 2020, ndërkohë që në kriteret për kualifikim është përcaktuar se: Ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit, që kërkohet në këtë procedurë prokurimi. Kontrata e sigurimit të aseteve është lidhur për një periudhë 1 vjeçare nga data 10.03.2020-09.03.2021, pra periudha e kontratës për vitin 2021 nuk është e mbuluar me kontratë risigurimi, sipas përcaktimeve të DST. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59- Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, neni 66-Shqyrtimi dhe Vlersimi i ofertave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 147-179, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë që, për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, të përcaktojë nevojën për punë, shërbime dhe mallra si dhe të bëjë argumentimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues. Gjithashtu në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

17.2. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të analizojë rast pas rasti mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit, të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të iniciojë kontrolle për respektimin e procedurave.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2019 konkretisht në procedurën me objekt “Blerje karburant për ISSH-në” zhvilluar në 2019, me fond limit 1,880,000 lekë, u konstatua se: nga autoriteti kontraktor (Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm) dhe Njësia e Prokurimit nuk disponohet asnjë dokument për përllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për 100 km, të çdo automjeti. Në parashikimin e normës prej 13000 litra, janë përfshira dhe Gjenerator 2 me 300 litra dhe Lundër me 2000 litra, por nuk ka asnjë dokument apo relacion mbi gjëndjen teknike të gjeneratorit, përdorimin e tij gjatë vitit si dhe normën e konsumit. Sipas kontratës së lidhur Nr 3988/5 datë 19.07.2019, Neni 6- Afatet dhe mënyra e furnizimit, pika 6.2, në automjetet që do furnizohen me karburant, janë përfshirë vetëm 5 automjete nga 7 që janë llogaritur në tabelën e konsumit, mungojnë automjetet TR8765R dhe TR8763R. Mbi bazën e kësaj tablele është bërë përllogaritja e sasisë së karburantit për hartimin e fondit limit. Gjithashtu sipas inventarit kontabël 31.12.2019, rezulton se automjetet me Targa TR8765R dhe TR8763R, janë bërë dalje nga ISSH duke i kaluar DRSSH-ve, përkatësisht automjeti me targa TR8765 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 8, datë 30.01.2019, automjeti me targa TR 8763 R, është bërë dalje, sipas fletë daljes nr. 15, datë 13.02.2019, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në datë 02.07.2019. Në këto kushte, konstatohet se përllogaritja e nevojave të AK për sasinë prej 13,000 litra karburant nuk është e saktë, e konfirmuar edhe nga fakti se kjo kontratë vazhdon të shërbejë dhe për vitin 2020, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet faqet 147-179, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

18.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjithë masat, që në përllogaritjen e nevojave për karburant të bazohet në dokumentacion justifikues, tabelën e konsumit të karburantit, procesverbalin për përllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për çdo automjet dhe pajisje të mbajtur nga komisioni përkatës.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2019 konkretisht në procedurën me objekt “Blerje karburant për ISSH-në” zhvilluar në 2019, me fond limit 1,880,000 lekë, u konstatua se hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, që lidhen me kapacitetin ekonomik financiar, teknik si dhe aftësinë zbatuese të operatorit ekonomik janë vendosur në mënyrë të paargumentuar, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 147-179, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

19.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë, që për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, kriteret e veçanta për kualifikim të argumentojë në një procesverbal dhe ti justifikojë ato me volumet dhe natyrën e punëve të kërkuara, në mënyrë që të krijojë një pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2019 dhe 2020, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ (VKA) nr. 3/2, datë 26.02.2008, të ndryshuar me VKA nr.15, datë 20.10.2017, e cila paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale miratuar me Urdhrat Nr.2518 prot datë 03.04.2019, Nr.2597 prot. datë 05.04.2019, Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Struktura organizative sipas kësaj rregulloreje, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të drejtorisë të Aparatit të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtoritë Rajonale. Ndryshimet në strukturë janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74, pika b/1 “Kompetencat e Këshillit Administrativ” ku citohet se “Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. Por me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së, Drejtori i Përgjithshëm është autorizuar për rialokime të burimeve njerëzore dhe ndryshime në strukturë, pa tejkalim të numrit total të punonjësve të miratuar nga VKA. Nga ana e ISSH-s janë marrë masa për rikonceptimin e një rregulloreje të re përgjatë vitit 2020, e cila është miratuar në mbledhjen nr. 2 e KA me Vendimin nr.5, datë.14.08.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren Nr.3/2, date 26.02.2008.” Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” i cili ka përcaktuar rregullat dhe kriteret e rekrutimit dhe të punonjësve, lëvizjet, hartimin e kontratave, marrdhëniet e punës deri në largimin e tyre, duke mos trajtuar strukturën organizative aktuale dhe funksionin e saj (misionin detyrat dhe përgjegjësitë). (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 179-199, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa, për amendimin e Rregullores dhe miratimin e saj me VKA, me qëllim përmirësimin në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative të ISSH, për t’iu përgjigjur strukturës aktuale organizative, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet ligjore për struktura të veçanta. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masa për mbikëqyrjen e Rregullores dhe implementimin e saj në ISSH, sipas përcaktimeve dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Brenda vitit 2021

21. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2019 dhe 2020 në ISSH nuk janë ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe komandimit për vendet e punës vakante, duke rekrutuar punonjës pa konkurim të hapur. Konstatohen punonjës, që janë rekrutuar me kontrata me afat të përcaktuar 3 mujore, disa prej të cilave të rinovuara, pa u emëruar. Pra për rekrutimin e punonjësve të rinj nuk është zbatuar VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, pika 1.1, 1.6 dhe pika 2. “Komandimi i përkohshëm në detyrë”, Paragrafi 2.4. Në dosjet e personelit të larguar konstatohen mungesa të pjesshme në dokumentacion, veçanërisht në kërkesa për punësim, referenca, certifikata etj. Trajnimet e zhvilluara përgjatë vitit, në përgjithësi janë realizuar për stafin e Drejtorive Rajonale dhe jo për stafin e ISSH (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 179-199, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH të marrin masa për plotësimin e vendeve të lira të punës me staf të kualifikuar dhe në përputhje me strukturën organizative, si dhe përfshirjen në trajnime të gjithë personelit të ISSH-s dhe DRSSH-ve, me qëllim mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.

Në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Ri-Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ përgjatë vitit 2019 janë konstatuar disa mangësi pasi nuk janë emëruar 12 anëtarë, në kundërshtim me nenin 72, i ligjit nr.7703, pika 1/a “Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ”, nuk ka patur punonjës të emëruar në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 19, dhe për vitin 2020 janë emëruar 12 anëtarë por asnjëherë mbledhjet nuk kanë patur 12 anëtarë pjesëmarrës, të VKM Nr. 161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” dhe rezultati financiar i vitit 2018 dhe 2019 nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara në Rregullore. Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ (KA) si:

. Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Administrativ konstatohet se, në mbledhjet e realizuara, numri i anëtarëve ka qenë 9 në mbledhjen e parë, 9 në mbledhjen e dytë, 8 në mbledhjen e tretë dhe 8 në mbledhjen e katërt nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nuk ka punonjës të emëruar në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 19, të VKM Nr. 161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së”, ku specifikohet se: “Kryetari i KA-së duhet të autorizojë një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes”, si dhe nenit 2 pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Rezultati financiar i vitit 2018 nuk është miratuar sipas rregullores financiare, pika “Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”/nën çështja 3, ku specifikohet se “raporti vjetor së bashku me bilancin, si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin, të cilit ai i referohet”, duke e miratuar atë në mbledhjen e datës 06.12.2019 (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 179-199, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa që të krijojë kushte, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit Administrativ të sigurohet zbatimi i rregullave në zhvillimin e mbledhjeve me qëllim ushtrimin e kompetencave në zbatimin e detyrave e përgjegjësitë e tij, për shmangien e parregullsive të konstatuara, me qëllim përmirësimin e aktivitetit të tij.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 5 datë 14.08.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, kapitulli V “Shkeljet, masat disiplinore dhe procedimi disiplinor”, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga puna”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLI I LARTË I SHTETIT